

PËR MËSIMDHËNËSIN/EN

duk^agjini
shtëpia botuese publishing house

**Majlind Ferdulli, Diturie Gashi-Halimi,
Nevzat Nevzati, Pajtim Hodolli**

GJEOGRAFIA

Për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët

6

PËRMBAJTJA

Udhërrëfyes.....	6
Hyrje.....	8
Planifikimi vjetor.....	17
Plani dymujor: shtator—tetor.....	18
Plani dymujor: nëntor—dhjetor.....	22
Plani tremujor: janar—shkurt—mars.....	25
Plani tremujor: prill—maj—qershor.....	29
Mësimi 1: Gjeografia, lënda e studimit, ndarja dhe ndërlidhja me shkencat e tjera.....	34
Mësimi 2: Forma dhe madhësia e Tokës.....	36
Mësimi 3: Sistemi Diellor dhe Toka.....	38
Mësimi 4: Aktivitetet: Sistemi Diellor dhe Toka.....	40
Mësimi 5: Rotacioni (lëvizja e Tokës rreth boshtit të vet).....	42
Mësimi 6: Revolucioni (lëvizja e Tokës rreth Diellit).....	44
Mësimi 7: Koha vendore (lokale) dhe zonale.....	46
Mësimi 8: Paraqitja e Tokës në glob dhe në hartë.....	48
Mësimi 9: Koordinatat gjeografike dhe lartësia mbidetare.....	50
Mësimi 10: Elementet që paraqiten në hartë.....	52
Mësimi 11: Orientimi i hartës dhe orientimi në natyrë.....	54
Mësimi 12: Aktivitetet: Orientimi në natyrë.....	56
Mësimi 13: Përcaktimi i vendndodhjes në hartë.....	58
Mësimi 14: Ushtrime: Përcaktimi i vendndodhjes në hartë.....	60
Mësimi 15: Përbërja dhe struktura e Tokës.....	62
Mësimi 16: Mineralet dhe shkëmbinjtë.....	64
Mësimi 17: Zhvillimi gjeologjik i kores së Tokës.....	66
Mësimi 18: Formimi i relievit në Tokë - Lëvizjet epirogjene dhe orogjene.....	68
Mësimi 19: Strukturat tektonike.....	70
Mësimi 20: Vullkanet.....	72
Mësimi 21: Tërmetet.....	74
Mësimi 22: Përforsim - Forcat e brendshme të Tokës.....	76
Mësimi 23: Vlerësim i punimeve: Vullkanet-Tërmetet.....	78
Mësimi 24: Proceset e jashtme – Alterimi.....	80
Mësimi 25: Procesi i shpatit.....	82
Mësimi 26: Erozioni karstik.....	84
Mësimi 27: Veprimtaria e ujërave rrjedhëse (fluvial).....	86
Mësimi 28: Veprimtaria e akullnajave (glaciale).....	88
Mësimi 29: Veprimtaria e erës (eolike).....	90
Mësimi 30: Veprimtaria e valëve të detit (abrazive).....	92
Mësimi 31: Klasifikimi i relievit - Roli i relievit në veprimtarinë e njeriut.....	94
Mësimi 32: Përbërja dhe struktura e atmosferës.....	96
Mësimi 33: Test përmbledhës.....	97
Mësimi 34: Rrezatimi diellor.....	98
Mësimi 35: Temperatura e ajrit.....	100
Mësimi 36: Përforsim - përbërja dhe struktura e atmosferës.....	102

Mësimi 37: Shtypja e ajrit	104
Mësimi 38: Qarkullimet e ajrit në atmosferë	106
Mësimi 39: Lagështia e ajrit dhe reshjet atmosferike	108
Mësimi 40: Moti dhe klima	110
Mësimi 41: Tipat klimatikë në Tokë	112
Mësimi 42: Hidrosfera: Cikli hidrologjik - Oqeanet dhe detet	114
Mësimi 43: Vetitë fiziko-kimike të oqeanit (detit) botëror - Lëvizjet e ujit në detin botëror	116
Mësimi 44: Zhvillimi bregdetar	118
Mësimi 45: Ujërat nëntokësore	120
Mësimi 46: Lumenjtë	122
Mësimi 47: Liqenet dhe Akullnajat	124
Mësimi 48: Biosfera	126
Mësimi 49: Aktivitet: Sferat koncentrike të Tokës	128
Mësimi 50: Popullsia në botë	130
Mësimi 51: Strukturat e popullsisë	132
Mësimi 52: Ushtrime: Popullsia në botë	134
Mësimi 53: Lëvizjet e popullsisë	136
Mësimi 54: Vendbanimet	138
Mësimi 55: Shtetet, grupimet politike, ekonomike, ushtarake dhe organizatat	140
Mësimi 56: Ekonomia	142
Mësimi 57: Kushtet gjeografike për zhvillimin e bujqësisë	144
Mësimi 58: Industria	146
Mësimi 59: Transporti	148
Mësimi 60: Turizmi dhe tregtia	150
Mësimi 61: Ushtrime: Transporti, tregtia dhe turizmi	152
Mësimi 62: Mjedisi gjeografik dhe ruajtja e tij	154
Mësimi 63: Ndikimet e njeriut në mjedis	156
Mësimi 64: Ndryshimet klimatike	158
Mësimi 65: Shkrirja e akullnajave	160
Mësimi 66: Shfrytëzimi i burimeve natyrore dhe problemet mjedisore	162
Mësimi 67: Aktivitet: Riciklimi	164
Mësimi 68: Rrezikimi i pyjeve	166
Mësimi 69: Aktivitet: Pylli im	168
Mësimi 70: Aktivitet: Mbrojtja e pyllit/parkut të qytetit (Ora realizohet jashtë klase)	170
Mësimi 71: Test përmbledhës – gjysmëvjetori i dytë	172
Mësimi 72: Problemet me ujin në Tokë	174
Mësimi 73: Menaxhimi i burimeve natyrore	176
Mësimi 74: Përfundim: Bashkëveprimi njeri/natyrë	178

Të dashur mësimdhënës dhe mësimdhënëse,

Në duar keni librin tuaj, i hartuar për t'ju ardhur në ndihmë në zhvillimin e mësimi, mbështetur në metodologjitë më të përparuara të sotme.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar përmes vështirësive të panumërta dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimdhënies. Sot kemi mundësinë që arsimit t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për të formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuar në shoqëri. Për të gjetur mënyrën më të mirë dhe për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese "Dukagjini" në vazhdim të nismës për përfshirjen e metodologjive të mësimdhënies ndërvepruese në librat e mësimdhënësve, ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: *Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Kosovës për të formësuar të ardhmen e tyre?*

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimdhënies dhe nxënies, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehje të menduarit kritik, krijues, komunikues, bashkëpunues dhe kurioz, i aftë për të përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme dhe të nesërme shqiptare.

Cilësia e re e të nxënësve dhe mësimdhënies përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por kërkohet të përdorni metoda dinamike të mësimdhënies, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen më shumë në mësim.

Modeli i këtyre librave është i pranishëm për herë të parë në Kosovë i zbatuar në vitin 2022 dhe mësimet janë hartuar nga kolegët tuaj, me përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

UDHËRRËFYES për konceptimin e mësimëve model

Faqja në të majtë


Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.

Mësimi synon që, përmes rezultateve të të nxënët, të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.

Rezultatet specifike janë në koherencë me ato të fushës.

Të gjitha mjetet dhe materialet, e çdo lloji, që shërbejnë për konkretizim në ndihmë të të nxënët.

Parashikimi është faza e parë e orës mësimore që siguron përqendrimin dhe aktivizimin e nxënësve në mësim.



Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësimdhënësin/en gjatë përgatitjes.

Rezultatet e të nxënët të temës janë në koherencë me ato të orës mësimore; tema është më e gjerë.

Rezultatet specifike të të nxënët janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.

Janë zërthim i rezultateve të të nxënët sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësit në klasë.


Zakonisht, mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera, të cilat evidentoohen.

Faqja në të djathtë

Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësimdhënësin gjatë përgatitjes.

Vlerësimi formues në raport me rezultatet e të nxënët.

Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.



Përpunimi i përmbajtjes është faza e dytë e orës mësimore, ku bëhet përzgjedhja e materialit mësimor dhe organizimin metodologjik i tij.

Përforsimi është faza e tretë e orës mësimore, ku bëhet integrimi i dijeve dhe shprehive, si dhe zbatimi i tyre.

Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mësimin

Rezultatet e të nxënët të temës janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxënët për këtë temë. Në këtë rast, mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me Kurrikulën Bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënët të lëndës mësimore mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore - kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënët dhe nga elementet përbërëse të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës. Duke filluar nga klasa e tretë e më lart, nxënësit zotërojnë operacione mendore; të menduarit e tyre është konkret, me elemente të të menduarit abstrakt. Prandaj, mësimi me këta nxënës kalon në tri faza, dhe të menduarit e tyre sipas proceseve njohëse.

Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare, e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zërthehen në rezultate të të nxënësve. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës. Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

Rezultatet e të nxënësve. Rezultatet specifike të të nxënësve janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimin, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënësve të temës që janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

Kriteret e vlerësimit/suksesit janë zërtim i rezultateve të të nxënësve sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënës - fazat e zhvillimit të mësimin. Tashmë nxënësit, duke filluar nga klasa e tretë e lart, zotërojnë operacionet mendore, të cilat kanë karakter konkret, me elemente të të menduarit abstrakt. Me kalimin në klasat më të larta, marrin karakter mbizotërues, pasi të menduarit është formal. Mësimi me këta nxënës kalon në tri faza të të menduarit gjatë të nxënësve, sipas proceseve njohëse.

Cfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit në tri fazat e mësimin?

Mbillet një farë. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësimdhënësi vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të vazhduar më tej.



Parashikimi: Përgatitja për të nxënësve

Në fazën e parashikimit mbillet një farë në një truall pjellor. Mësimi duhet të mbështetet edhe në njohuritë ekzistuese të nxënësve, ashtu si fara merr ushqim nga trualli ku është mbjellë.

Kjo është faza e parë e strukturës për zhvillimin e të menduarit dhe të të nxënësve. Në këtë fazë kryhen veprimtari të ndryshme njohëse, nxënësi është i përfshirë gjallërisht në rikujtimin e asaj çka di rreth temës së mësimin, bën lidhjen e njohurive të reja me ato që dihen. Nxënësit ndërtojnë njohuritë, konceptet, kuptimin e ri mbi dukuritë e caktuara nga bazat e njohurive të mëparshme.



Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimi vazhdon me fazën e ndërtimit të njohurive; fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kjo është faza e dytë e strukturës për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë gjatë të nxënësve dhe nxënësi është i përfshirë në procesin e përfundimit të kuptimit të njohurive. Gjithashtu, ruan interesin dhe ritmin e vendosur gjatë fazës së parashikimit.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve

Mësimi përfundon me fazën e përforcimit. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Në këtë fazë, nxënësit konsolidojnë të nxënësve të ri dhe ristrukturojnë skemën e tyre për të përshtatur konceptet e reja dhe për t'i zbatuar ato.

HYRJE

Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësimdhënësin/en

GJEOGRAFIA 6

Fusha kurrikulare *Shoqëria dhe mjedisi* në nivelin e dytë, realizohet përmes mëimit lëndor. Lëndë mësimore e kësaj fushe në këtë nivel është edhe gjeografia. Meqenëse kjo fushë realizohet përmes mëimit lëndor, mësimdhënësit duhet t'i kenë parasysh qëllimet e përbashkëta të fushës, të cilat do të realizohen përmes përmbajtjeve lëndore duke synuar mësimin e integruar.

Fusha *Shoqëria dhe mjedisi* i ndihmon nxënësit për t'i njohur dhe për t'i kuptuar më mirë konceptet, proceset dhe zhvillimet historike në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe botëror, duke përfshirë lindjen dhe zhvillimin e qytetërimeve të ndryshme si dhe ngjarjet dhe personalitetet e rëndësishme nga kohët më të lashta deri më sot.

Kjo fushë ndihmon nxënësit për t'i thelluar njohuritë mbi vendet dhe hapësirën, sistemet fizike e humane, rajonet dhe karakteristikat e tyre. Gjithashtu, ndihmon krijimin e shprehive, vlerave dhe qëndrimeve në raport me diversitetin kulturor, identitetin social, trashëgiminë kulturore dhe natyrore, organizimin shoqëror, liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe rolin dhe funksionimin e institucioneve demokratike.

Fusha *Shoqëria dhe mjedisi*, në shkallën e tretë kurrikulare, ka për qëllim zhvillimin e aftësive, shkathëtësive, vlerave dhe qëndrimeve, për të qenë qytetar i përgjegjshëm, për të zhvilluar identitetin personal dhe për të njohur më mirë atë kolektiv (social, kombëtar, shtetëror, etnik, fetar, racor, gjinor, kulturor, regjional). Kjo fushë ndihmon zhvillimin e aftësive për të gjykuar drejt dhe për të marrë vendime të përgjegjshme në jetën e përditshme, kultivimin e shprehive dhe marrjen e nismave për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Fusha *Shoqëria dhe mjedisi* në këtë nivel ndihmon nxënësit për t'i zhvilluar e për t'i përforcuar më tej njohuritë e tyre duke siguruar një bazë fillestare për orientim akademik dhe orientim në karrierë.

Udhëzime metodologjike

Për të realizuar qëllimet e kurrikulës, përmes fushës *Shoqëria dhe mjedisi*, këshillohet përdorimi i metodave të ndryshme që plotësojnë njëra-tjetrën dhe që mundësojnë zhvillimin e të menduarit kritik e krijues të nxënësi, për zbatimin e njohurive dhe shkathtësive në situata të ndryshme.


Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimitdhënësit/es të fushës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes tematike mësimore dhe të rezultateve të kompetencave për shkallën e tretë kurrikulare, me bazën didaktike dhe me nivelin e formimit të nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë maksimumin e potencialit që zotëron brenda vetes.

Mësimitdhënësi/ja është i/e lirë të përdorë metoda mësimore bashkëkohore ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks të tërë procedurash. Këto metoda duhet të jenë në funksion të nxitjes së mendimit të pavarur, kritik e krijues. Metodatat dhe teknikat e punës me nxënës, kërkohen të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, në funksion të arritjeve të rezultateve të të nxënësve dhe të zbatimit në jetën e përditshme.

Metodologjia ndërvepruese në mësimitdhënie dhe të nxënësve

Libri që keni në duar, është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimit të shkathtësive. Ai trajton temat mësimore në përputhje “Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës” (e rishikuar) (2016) si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi ku është mbështetur metodologjia me të gjithë elementet përbërëse, duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënësve të fushës, rezultatet specifike të të nxënësve të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecuria metodologjike e orës së mësimit e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*. Qëllimi i kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arritjet, por edhe dështimet, dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvilloni mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimi, është treguar kujdes i veçantë në harmonizimin e të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënësve - procedurave të mësimitdhënies dhe të nxënësve - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet “trekëndësh magjik”. Ky trekëndësh paraqet marrëdhëniet koherente midis rezultateve të të nxënësve, veprimtaritë e mësimitdhënies të të nxënësve dhe vlerësimit. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëri-tjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e dijeve dhe të shkathtësive.



Burimi: Nga *Metodologji e mësimdhënies*, (faqe 102), B. Musai, 2014. Botuar në Tiranë: CDE



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Musai. B. (2014)

Metodologji e mësimdhënies. Tiranë: CDE, faqe 101-128.

Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimin të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimin ka dhënë rezultate mjaft të mira.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijues është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënit e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e Zhvillimit Proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës, sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen




Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011)

Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 47-51.

e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve, apo në bashkëpunim me bashkëmoshatarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënien mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e zhvillimit proksimal është hapësira e mësimin midis së mërzitshmes dhe së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësimdhënësi apo nga një bashkëmoshatar mund të bëjë që mësimi të japë rezultate.



Burimi: *Psikologji edukimi*, (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Woolfolk, A. (2011) *Psikologji edukimi*. Tiranë: CDE, faqe 32-36.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 3

I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv	
1.	Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim.
2.	Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
4.	Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5.	Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.
6.	Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të rinj, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik	
1.	Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.
3.	Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre, duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
5.	Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror), duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatit e njëjtë.
6.	Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
7.	Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.

III Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm	
1.	Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3.	Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5.	Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6.	Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.
8.	Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, veprë arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

IV **Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm**

- | | |
|-----------|--|
| 3. | Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre. |
| 5. | Shpjegon, në forma të ndryshme të të shprehurit, domosdoshmërinë e respektimit dhe të zbatimit të rregullave dhe ligjeve për raportet e shëndosha në bashkësi të ndryshme shoqërore apo në grupe të interesit. |
| 6. | Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit. |

V **Kompetenca personale - Individ i shëndoshë**

- | | |
|-----------|---|
| 5. | Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale. |
|-----------|---|

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e gjashtë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Shoqëria dhe mjedisi-Gjeografi, të shkallës së tretë të kurrikulës (Shk. 3), në Kurrikulën Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët:

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Proceset shoqërore dhe natyrore	RNF: 2. Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre. 2.2.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Vendi dhe hapësira	<ul style="list-style-type: none"> Përshkruan përmes shembujve kuptimin e koncepteve që përdoren nga gjeografët për organizimin e kërkimeve të tyre: vendndodhja/vendi, mjedisi, regionit, ndërveprimi dhe zhvillimi; Përshkruan formën e Tokës, përmasat e saj dhe rëndësinë e tyre; Identifikon veçoritë kryesore të Tokës e Sistemit Diellor, të planetëve, të asteroideve, të kometave, të satelitëve dhe të hënës si trup qiellor e satelit natyror i Tokës; Vlerëson rëndësinë e Diellit për dukuritë gjeografike; Identifikon provat dhe pasojat e lëvizjes së Tokës rreth boshtit të vet; Shpjegon rrjedhjat e lëvizjes së Tokës rreth Diellit; Përcakton kohën vendore dhe zonale në vende të ndryshme në bazë të gjatësisë së tyre gjeografike; Përshkruan mënyrat e orientimit në natyrë (me anë të diellit, të orës, të myshqeve, të yllit polar, të busullës, të objekteve fetare, etj.); Krahason hartën dhe globin duke treguar ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre (elementet matematike dhe gjeografike të hartës); Mat distanca në vijë ajrore dhe distanca rrugore në harta me shkallë zvogëlimi të ndryshme; Shpjegon ndërtimin e sistemit të koordinatave gjeografike (rrjetin e paraleleve dhe meridianeve, gjerësinë dhe gjatësinë gjeografike); Përshkruan përmbajtjen e hartës-elementet gjeografike të hartës, metodat e paraqitjes së relievit në hartë dhe lartësinë absolute dhe relative; Përcakton vendndodhjen absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike.

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Proceset shoqërore dhe natyrore	RNF: 2. Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre. 2.2.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Sistemet fizike - Gjeosferat	<ul style="list-style-type: none"> • Diferencon shtresat e brendshme të Tokës përmes veçorive tipike të secilës prej tyre; • Shpjegon rolin dhe llojet e fuqive të brendshme (endogjene) dhe të jashtme (ekzogjene) dhe krijimin e tyre; • Përshkruan format relievoe, llojet dhe shkaktarët e krijimit (format e krijuara nga forcat e brendshme dhe nga forcat e jashtme); • Përshkruan shkaqet dhe rrjedhojat e vullkaneve, tërmeteve dhe zonat kryesore të paraqitjes së tyre; • Përshkruan shkaqet e tjetërsimit (alterimit), kushtet në cilat zhvillohet procesi i karstit dhe format sipërfaqësore dhe nëntokësore të krijuara nga veprimtaria karstike; • Përshkruan format erozive dhe akumulative të relievit fluvial (lumor) glacial, eolik dhe abraziv; • Argumenton pasojat globale të shkrirjes së akullnajave; • Shpjegon rolin e relievit në veprimtaritë njerëzore dhe rreziqet në litosferë; • Tregon përbërjen e atmosferës, shtresat dhe karakteristikat kryesore të tyre; • Përshkruan rëndësinë e rrezatimit diellor, temperaturat dhe ndryshimet në planin horizontal dhe në atë vertikal; • Gjen temperaturën mesatare ditore, mujore e vjetore të ajrit dhe amplitudat ditore dhe vjetore të temperaturës së ajrit; • Shpjegon shtypjen atmosferike, ndryshimin e saj, rolin e saj në erëra dhe në vetë jetën e njeriut; • Përshkruan konceptetin lagështi e ajrit dhe kushtet e formimit të reshjeve atmosferike; • Punon dhe interpreton grafikët e shpërndarjes hapësinore dhe kohore të reshjeve; • Formulon konceptet “mot” dhe “klimë”, bën dallimin midis tyre; • Identifikon faktorët që ndikojnë në formimin e klimës dhe zonat klimatike nga ekuatori në pole; • Përshkruan lidhjen e hidrosferës me litosferën, atmosferën, biosferën, qarkullimin e ujit në natyrë dhe vetitë fizike e kimike të ujit të detit botëror; • Dallon veçoritë e formave të lëvizjeve të ujërave të detit botëror (valët, rrymat detare dhe baticën e zbaticën); • Identifikon format kryesore të zhvillueshmërisë horizontale të bregdetit, duke veçuar veçoritë kryesore të tyre; • Identifikon llojet e ujërave nëntokësore, mënyrën e formimit të tyre dhe karakteristikat kryesore të pjesëve përbërëse të lumit; • Diferencon liqenet sipas origjinës së formimit të tyre; • Përshkruan veçoritë themelore të biosferës dhe lidhjen e saj me sistemet e tjera fizike (litosferën, atmosferën, hidrosferën); • Identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore e shtazore sipas brezave të nxehtësisë.

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore	RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe të përfshirjes në të; 1.1. 1.3.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Sistemet humane	<ul style="list-style-type: none"> Përshkruan ndikimin e faktorëve fizikë, mjedisorë, ekonomikë dhe politikë në shpërndarjen e popullsisë në botë (lëvizjen numerike, dendësinë, lëvizjen natyrore dhe teorinë e transicionit demografik); Diferencon strukturat themelore të popullsisë në botë; Shpjegon llojet, shkaqet dhe pasojat e migrimeve; Shpjegon faktorët që kanë ndikuar dhe ndikojnë në krijimin e vendbanimeve, funksionet dhe kriteret kryesore të tyre; Identifikon elementet e shtetit, grupimet e ndryshme ekonomike, politike, ushtarake si dhe rëndësinë e organizatave ndërkombëtare; Përshkruan veçoritë themelore ekonomike-gjeografike në botë si faktorët kryesorë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik; Dallon veprimtaritë ekonomike sipas sektorëve përkatës (parësorë, dytësorë dhe tretësorë); Shpjegon llojet dhe rëndësinë e secilës veprimtari; ekonomike (bujqësinë, xehetarinë, industrinë, turizmin, transportin, tregtinë, etj.); Identifikon degët kryesore të bujqësisë dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e saj; Përshkruan procesin e industrializimit; Identifikon degët kryesore të industrisë, faktorët që ndikojnë në zhvillimin e saj; Shpjegon veçoritë e transportit (automobilistik, hekurudhor, ujqor, ajror) dhe rolin e tij në zhvillimin e veprimtarive ekonomike dhe vetë ekonomisë; Përshkruan rëndësinë e tregtisë për zhvillimin ekonomik; Shpjegon rolin e turizmit dhe të veprimtarive të tjera (të sipërpërmendura) në zhvillimin ekonomik; Vlerëson rolin e turizmit në shoqërinë bashkëkohore.
Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm	RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm 5.1. 5.2.	
	Bashkëveprimi njeri/natyrë	<ul style="list-style-type: none"> Përshkruan ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik dhe anasjellas; Shpjegon marrëdhënien ndërmjet njeriut dhe mjedisit, si: pasojat e ndryshimeve klimatike në mjedis dhe në shëndet, të rreziqeve natyrore dhe të atyre të krijuara nga njeriu dhe mënyra të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore; Ofron alternativa dhe strategji të mundshme të mbrojtjes dhe të shfrytëzimit të burimeve natyrore; Hulumton për raste të keqmenaxhimit të burimeve natyrore, duke parashikuar rrugë dhe mundësi të parandalimit ose trajtimit të tyre.

Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi **Klasa VI**

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Rezultatet e kompetencave (Rezultatet e të nxënit për shkallë)
	Gjysmëvjetori I		Gjysmëvjetori II		
	shtator—tetor	nëntor—dhjetor	janar—shkurt—mars	prill—maj—qershor	
GJEOGRAFI	Vendi dhe hapësira Sistemet fizike - Gjeosferat	Sistemet fizike - Gjeosferat	Sistemet fizike - Gjeosferat Sistemet humane	Sistemet humane Bashkëveprimi njeri/natyre	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv 1, 2, 4, 5, 6, 7, 8 Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ 1, 3, 4, 5, 6, 7, 8 Kompetenca e të nxënit- Nxënës i suksesshëm 1, 3, 5, 7, 8 Kompetenca për punë dhe mjedis: 3 Kompetenca personale - Individ i shëndoshë 5 Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm 3, 5, 6
	Gjithsej 17 orë	Gjithsej 17 orë	Gjithsej 21 orë	Gjithsej 19 orë	

Për mësimdhënësin/en

PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

Lënda mësimore: Gjeografi

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Klasa: VI

Temat mësimore: Vendi dhe hapësira; Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ temave: I. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv*

1.	Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2.	Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3.	Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4.	Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
6.	Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ dhe kritik

1.	Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.
2.	Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3.	Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
5.	Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.
6.	Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
7.	Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
8.	Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

Kompetenca e të nxënës – Nxënës i suksesshëm

1.	Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
2.	Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.
3.	Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5.	Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
8.	Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, veprë arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

5.	Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.
----	--

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet	
	<ul style="list-style-type: none"> - Përkrauan përmes shembujve kuptimin e koncepteve që përdoren nga gjeografët për organizimin e kërkimeve të tyre: vendndodhja/vendi, mjedisi, regjioni, ndërveprimi dhe zhvillimi; - Përkrauan formën e Tokës, përmasat e saj dhe rëndësinë e tyre; - Vlerëson rëndësinë e Diellit për dukuritë gjeografike; - Identifikon veçoritë kryesore të Tokës e të Sistemit Diellor, të planetëve, të asteroideve, të kometave, të satelitëve dhe të hënës si trup qellore e satelit natyror i Tokës; - Shpjegon rrjedhojat e lëvizjes së Tokës rreth Diellit; - Identifikon provat dhe pasojat e lëvizjes së Tokës, rreth boshtit të vet; - Përcakton kohën vendore dhe zonale në vende të ndryshme, në bazë të gjatësisë së tyre gjeografike; - Përkrauan mënyrat e orientimit në natyrë (me anë të diellit, të orës, të myshqeve, të yllit polar, të busullës, të objekteve fetare, etj.); 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Gjeografia, lënda e studimit, ndarja dhe ndërlidhja me shkencat e tjera 2. Forma dhe madhësia e Tokës 3. Sistemi Diellor dhe Toka 4. Aktivitet: Sistemi Diellor 5. Revolucioni (Lëvizja e Tokës rreth Diellit) 6. Rotacioni (Lëvizja e Tokës rreth boshtit të vet) 7. Koha vendore (lokale) dhe zonale 8. Paraqitja e sipërfaqes së tokës në glob dhe në hartë 9. Koordinatat gjeografike dhe lartësia mbidetare 10. Elementet që paraqiten në hartë 11. Orientimi i hartës dhe orientimi në natyrë 12. Aktivitet: Orientimi i hartës dhe orientimi në natyrë (Plani) 13. Përcaktimi i vendndodhjes në hartë 14. Ushtrime: Përcaktimi i vendndodhjes në hartë 	17	<ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, biseda, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt); - Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve); - Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); - Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale; - Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve; - Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale. 	<p>Nxënësit vlerësohen sipas veprimtarive të listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke pasur parasysh kriteret;</p> <p>Nxënësit vlerësohen sipas veprimtarive të listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke pasur parasysh kriteret;</p> <p>Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.);</p> <p>Vlerësimi me anë të dëgjimit;</p>	<p>Histori</p> <p>Biologji</p> <p>Fizikë</p> <p>Edukataë qytetare</p> <p>Kimi</p>	<p>Teksti bazë;</p> <p>Atlas;</p> <p>Enciklopedi;</p> <p>Internet.</p>

<ul style="list-style-type: none"> - Krahason hartën dhe globin duke treguar ngjashmëritë dhe dallimet dhe gjeografike të hartës); - Mat distanca në vijë ajrore dhe distanca rrugore në harta me shkallë zvogëlimi të ndryshme; - Shpjegon ndërtimin e sistemit të koordinatave gjeografike (rrjetin e paraleleve dhe meridianëve, gjerësinë dhe gjatësinë gjeografike); - Përkrauan përmbajtjen e hartës-elementet gjeografike të hartës, metodat e paraqitjes së relievit në hartë dhe lartësinë absolute dhe relative; - Përcakton vendndodhjen absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike. - ==//== - Tema 2 - Diferencon shtrësat e brendshme të Tokës përmes veçorive tipike të secilës prej tyre. - Nuk ka në PL. - Të formohet si rezultat i orës mësimore nga mësimdhënësi. - Tema 2 - Diferencon shtrësat e brendshme të Tokës përmes veçorive tipike të secilës prej tyre. 	<p>15. Përbërja dhe struktura e Tokës</p> <p>16. Mineralët dhe shkëmbinjtë</p> <p>17. Zhvillimi gjeologjik i kores së Tokës</p>	<p>Vlerësimi i punimeve dhe paraqitjeve të faktëve për trupat qiellore dhe paraqitja dhe renditja e tyre në formën vizuale (vizatimit);</p> <p>Shënimet mbahen në listën e kontrollit me nota.</p>	
--	---	--	--

PLANI DYMUJOR: NËNTOR—DHJETOR

Lënda mësimore: Gjeografi

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Klasa: VI

Temat mësimore: Sistemet fizike - Gjeosferat

Kompetenca komunikim dhe të shprehur - Komunikues efektivave:

1.	Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2.	Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3.	Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4.	Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5.	Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.
6.	Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
7.	Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ dhe kritik

6.	Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
----	--

Kompetenca e të nxënës – Nxënës i suksesshëm

1.	Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
5.	Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv

1.	Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
----	--

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e Vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	<ul style="list-style-type: none"> - Diferencen shtresat e brendshme të Tokës përmes veçorive tipike të secilës prej tyre; - Shpjegon rolin dhe llojet e fuqive të brendshme (endogjene) dhe të jashtme (ekzogjene) dhe krijimin e tyre; - Përshkruan format relievo, llojet dhe shkaaktarët e krijimit (format e krijuara nga forcat e brendshme dhe nga forcat e jashtme); - Përshkruan shkaqet dhe rrjedhojat e vullkaneve, të tërmeteve dhe zonat kryesore të paraqitjes së tyre; - Përshkruan shkaqet e tjetërsimit (alterimit), kushtet në cilat zhvillohet procesi i karsitit dhe format sipërfaqësore dhe nëntokësore të krijuara nga veprimtaria karstike; - Përshkruan format erozive dhe akumulative të relievit fluvial (lumenor) glacial, eolik dhe abraziv; - Argumenton pasojat globale të shkrirjes së akullnajave; 	<p>17</p> <p>18. Formimi i relievit në Tokë</p> <p>19. Strukturat tektonike</p> <p>20. Vullkanet</p> <p>21. Tërmetet</p> <p>22. Përforcim: Forcat e brendshme të Tokës</p> <p>23. Vlerësimi i punimit: Vullkanet dhe Tërmetet</p> <p>24. Proceset e jashtme</p> <p>25. Proceset e shpatit</p> <p>26. Erozioni karstik</p> <p>27. Veprimtaria e ujërave rrjedhëse</p> <p>28. Veprimtaria e akullnajave</p> <p>29. Veprimtaria e erës</p> <p>30. Veprimtaria e valëve të detit</p> <p>31. Klasifikimi i relievit</p> <p>Roli i relievit në jetën dhe veprimtarinë e njerëzve</p> <p>32. Përberja dhe struktura e atmosferës</p> <p>33. TESTIM Gj.V.1</p> <p>34. Rrezatimi diellor</p>		<ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, biseda, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt); - Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve); - Diskutimi dhe të nxënimit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); - Të mësuarit dhe të nxënimit përmes mjeteve multimediale; - Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve; - Të mësuarit dhe të nxënimit përmes mjeteve multimediale. 	<ul style="list-style-type: none"> -Nxënësit vlerësohen sipas veprimtarive të listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke pasur parasysh kriteret; -Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.); -Vlerësimi me anë të dëgjimit; -Vlerësimi i punimeve dhe i paraqitjeve të fakteve për trupat qiellore dhe paraqitja dhe renditja e tyre në formën vizuale (vizatim). Shënimet mbahen në listën e kontrollit. 	<p>Histori</p> <p>Biologji</p> <p>Fizikë</p> <p>Edukatë qytetare</p> <p>Kimi</p> <p>...</p>	<p>Teksti bazë;</p> <p>Atlas;</p> <p>Enciklopedi;</p> <p>Internet.</p> <p>...</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Përkruan format erozive dhe akumulative të relievit fluvial (lu-mor) glacial, eolik dhe abraziv; - Shpjegon rolin e relievit në vep-rintaritë njerëzore dhe rreziqet në litosferë; //// - Tema 2 - Tregon përbërjen e atmosferës, shtresat dhe karakteristikat krye-sore të tyre; - JANAR 2024 - Përkruan rëndësinë e rrezatimit diellor, temperaturat dhe ndry-shimet në planin horizontal dhe në atë vertikal. 					
--	---	--	--	--	--	--

PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

Lënda mësimore: Gjeografi

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Klasa: VI

Temat mësimore: Sistemet fizike - Gjeosferat, Sistemet humane

Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ temave: I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv

1.	Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkruar, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2.	Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3.	Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4.	Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5.	Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.
6.	Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
7.	Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevojë (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ dhe kritik

1.	Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.
4.	Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.
5.	Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatit e njëjtë.
6.	Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
7.	Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
8.	Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ dhe kritik

1.	Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
2.	Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.
3.	Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
4.	Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
7.	I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.

Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv

3.	Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre.
----	--

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e Vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<ul style="list-style-type: none"> - Përkshuan rëndësinë e rrezatimit diellor; temperaturat dhe ndryshimet në planin horizontal dhe në atë vertikal; - Tema 2 - Gjen temperaturën mesatare ditore, mujore e vjetore të ajrit dhe amplitudat ditore dhe vjetore të temperaturës së ajrit; - Shpjegon shpytjen atmosferike, ndryshimin e saj, rolin e saj në erëra dhe në vetë jetën e njeriut; SHKURT 2024 - Përkshuan konceptimin lagështi e ajrit dhe kushtet e formimit të reshjeve atmosferike; - Punon dhe interpreton grafikët e shpërndarjes hapësimore dhe kohore të reshjeve; - Formulon konceptet mot dhe klimë, dhe bëm dallimin midis tyre; - Identifikon faktorët që ndikojnë në formimin e klimës dhe zonat klimatik e nga ekuatori në pole; - Përkshuan lidhjen e hidrosferës me litosferën, atmosferën, biosferën qarkullimin e ujit në natyrë dhe vetitë fizike e kimike të ujit të detit botëror; 	<ul style="list-style-type: none"> 35. Temperatura e ajrit 36. Përformim: Përbërja dhe struktura e atmosferës 37. Shpytja e ajrit 38. Qarkullimi i ajrit në atmosferë 39. Lagështia e ajrit dhe reshjet atmosferike 40. Moti dhe klima 41. Tipat klimatik në Tokë 42. Hidrosfera 43. Vetitë fiziko-kimike të oqeanit (detit) botëror <ul style="list-style-type: none"> - Lëvizjet e ujit në detin botëror 44. Zhvillimi bregdetar 45. Ujërat nëntokësore 46. Lumenjtë 47. Liqenet dhe Akullnajat 48. Biosfera 49. Aktivitet: Sferat koncentrike të Tokës 50. Popullsia në botë 51. Strukturat e popullsisë 52. Ushtrime: Struktura e popullsisë në botë 53. Lëvizjet e popullsisë 54. Vendbanimet 55. Shtetet, grupimet politike, ekonomike, ushtarake dhe organizatat 	21	<ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, biseda, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt); - Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve); - Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); - Të mësuarit dhe të nxënët përmes mjeteve multimediale; - Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, problemeve; - Të mësuarit dhe të nxënët përmes mjeteve multimediale. 	<ul style="list-style-type: none"> -Nxënësit vlerësohen sipas veprimtarive të listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke e patur parasysh kriteret; - Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.); - Vlerësimi me anë të dëgjimit; - Vlerësimi i punimeve dhe paraqitjeve të fakteve për trupat qellore dhe paraqitja dhe renditja e tyre në formën vizuale (vizatimit). Shënimet mbahen në listën e kontrollit me nota. 	<ul style="list-style-type: none"> Histori Biologji Fizikë Edukatë qytetare Kimi ... 	<ul style="list-style-type: none"> Teksti bazë; Atlas; Enciklopedi; Internet. ... 	

-	Dallon veçoritë e formave të lëvizjeve të ujërave të detit botëror (valët, rrymat detare dhe baticën dhe zbaticën);				
-	Identifikon format kryesore të zhvillueshmërisë horizontale të bregdetit duke veçuar veçoritë kryesore të tyre;				
-	Identifikon llojet e ujërave nëntokësore, mënyrën e formimit të tyre dhe karakteristikat kryesore të pjesëve përbërëse të lumit;				
-	Diferencon liqenet sipas origjinës së formimit të tyre;				
-	MARS 2024				
-	Pëshkruan veçoritë themelore të biosferës dhe lidhjen e saj me sistemet e tjera fizike (litosferën, atmosferën, hidrosferën);				
-	Identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore e shtazore sipas brezave të nxehtësisë;				
-	--/--				
-	Tema 3				
-	Pëshkruan ndikimin e faktorëve fizikë, mjedisorë, ekonomikë dhe politikë në shpërndarjen e popullsisë në botë (lëvizja numerike, dendësia, lëvizjen natyrore dhe teorinë e transicionit demografik);				
-	Diferencon strukturat themelore të popullsisë në botë;				
-	--/--				
-	Shpjegon llojet, shkaqet dhe pasojat e migrimeve;				
-	--/--				
-	Shpjegon faktorët që kanë ndikuar dhe ndikojnë në krijimin e vendbanimeve, funksionet dhe kriterit kryesore të tyre;				
-	Identifikon elementet e shtetit, grupimet e ndryshme ekonomike, politike, ushtarake si dhe rëndësinë e organizatave ndërkombëtare.				

PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

Lënda mësimore: Gjeografi

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Klasa: VI

Temat mësimore: Sistemet humane; Bashkëveprimi njeri/natyre

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

1.	Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2.	Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3.	Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4.	Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5.	Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.
6.	Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
7.	Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.
8.	Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevoje (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.

Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik

1.	Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.
2.	Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3.	Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
4.	Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.
5.	Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.
6.	Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
7.	Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
8.	Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm

1.	Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3.	Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5.	Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
8.	Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, veprë arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

3.	Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndër personale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.
----	---

Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

5.	Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale.
----	---

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

3.	Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.
5.	Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale.
6.	Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e Vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera, ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<ul style="list-style-type: none"> - Përkruan rëndësinë e rrezatimit diellor, temperaturat dhe ndryshimet në planin horizontal dhe në atë vertikal; - Tema 2 - Gjen temperaturën mesatare ditore, mujore e vjetore të ajrit dhe amplitudat ditore dhe vjetore të temperaturës së ajrit; - Shpjegon shtypjen atmosferike, ndryshimin e saj, rolin e saj në erëra dhe në vetë jetën e njeriut; SHKURT 2024 - Përkruan konceptimin lagështi e ajrit dhe kushtet e formimit të reshjeve atmosferike; - Punon dhe interpreton grafikët e shpërndarjes hapësinore dhe kohore të reshjeve; - Formulon konceptet mot dhe klimë, dhe bën dallimin midis tyre; - Identifikon faktorët që ndikojnë në formimin e klimës dhe zonat klimatike e nga ekuatori në polë; - Përkruan lidhjen e hidrosferës me litosferën, atmosferën, biosferën, qarkullimin e ujit në natyrë dhe vetitë fizike e kimike të ujit të detit botëror; 	<ul style="list-style-type: none"> 56. Ekonomia 57. Kushitet gjeografike për zhvillimin e bujqësisë 58. Industria 59. Transporti 60. Tregtia dhe Turizmi... 61. Ushtrime: Transporti, Tregtia dhe turizmi 62. Mjedisi gjeografik dhe ruajtja e tij 63. Ndikimi i njeriut në mjedis 64. Ndryshimet klimatike 65. Shkrija e akullnajave 66. Shfrytëzimi i burimeve natyrore dhe problemet mjedisore 67. Aktivitet: Riciklimi 68. Rrezikimi i pyjeve 69. Aktivitet: Pylli im 70. Aktivitet: Mbrojtja e pyllit/parkut të qytetit (Ora realizohet jashtë klasës) 71. TESTIM 72. Problemet me ujën në Tokë 73. Menaxhimi i burimeve natyrore 74. Përforcim: Bashkëpunimi njeri/natyre 	<ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, biseda, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt); - Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve); - Diskutimi dhe të nxënimit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); - Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve; - Të mësuarit dhe të nxënimit përmes mjeteve multimediale. 	18	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit vlerësohen sipas veprimtarive të listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, pasur parasysh kriteret; - Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.); - Vlerësimi me anë të dëgjimit; - Vlerësimi i punimeve dhe paraqitjeve të fakteve për trupat qëllor dhe paraqitja dhe renditja e tyre në formën vizuale (vizatimit). Shënimet mbahen në listën e kontrollit me nota. 	<ul style="list-style-type: none"> Histori Biologji Fizikë Edukatë qytetare Kimi ... 	<ul style="list-style-type: none"> Teksti bazë; Atlas; Enciklopedi; Internet. ... 	

-	Dallon veçoritë e formave të lëvizjeve të ujërave të detit botëror (valët, rrymat detare dhe baticën dhe zbaticën);				
-	Identifikon format kryesore të zhvillueshmërisë horizontale të bregdetit, duke veçuar veçoritë kryesore të tyre;				
-	Identifikon llojet e ujërave nën-tokësore, mënyrën e formimit të tyre dhe karakteristikat kryesore të pjesëve përbërëse të lumit;				
-	Diferencën liqenet sipas origjinës së formimit të tyre;				
-	MARS 2024				
-	Përshkruan veçoritë themelore të biosferës dhe lidhjen e saj me sistemet e tjera fizike (litosferën, atmosferën, hidrosferën);				
-	Identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore e shtazore sipas brezave të nxehtësisë;				
-	--/--				
-	Tema 3				
-	Përshkruan ndikimin e faktorëve fizikë, mjedisorë, ekonomikë dhe politikë në shpërndarjen e popullsisë në botë (lëvizja numerike, dendësia, lëvizjen natyrore dhe teorinë e transicionit demografik);				
-	Diferencën strukturat themelore të popullsisë në botë;				
-	--/--				
-	Shpjegon llojet, shkaqet dhe pasojat e migrimeve;				
-	--/--				
-	Shpjegon faktorët që kanë ndikuar dhe ndikojnë në krijimin e vendbanimeve, funksionet dhe kriterit kryesore të tyre;				
-	Identifikon elementet e shtetit, grupimet e ndryshme ekonomike, politike, ushtarake si dhe rëndësinë e organizatave ndërkombëtare.				

Mësimi 1

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VI

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan përmes shembujve kuptimin e koncepteve që përdoren nga gjeografët për organizimin e kërkimeve të tyre: vendndodhja/vendi, mjedisi, regionii, ndërveprimi dhe zhvillimi.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

I.1,2; III.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Gjeografia, lënda e studimit, ndarja dhe ndërlidhja me shkencat e tjera

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon përpjekjet për njohjen e hapësirës gjeografike;
- Identifikon dijetarët që dhanë kontribut për studimin e gjeografisë;
- Përcakton ndarjen e gjeografisë sipas objektivit të studimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë e botës, atlas gjeografik.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Historia, Biologjia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësve iu drejtohen pyetje se çfarë dinë për lëndën e gjeografisë, njohuritë që mund t'i kenë nga lëndët “Njeriu dhe natyra” ose “Shoqëria dhe mjedisi”.

Disa nga pyetjet mund të jenë:

1. Nga cilat sfera/mbështjellës përbëhet hapësira gjeografike e tokës?
2. Cili e përbën mjedisin natyror?

GJEOGRAFIA, LËNDA E STUDIMIT, NNDARJA DHE NDËRLIDHJA ME SHKENCAT E TJERA

Oysh nga kohët e lashta, njeriu kishte bërë përpjekje për ta njohur sa më mirë hapësirën në të cilën jetonte. Me kalimin e kohës, nisi ta zgjeronte horizontin gjeografik dhe tentoi t'i kuptonte ndodhitë në natyrë dhe shoqëri. Ai filloi ta përshkruante rrethinën, kurse në muret e shpellave nisi të vizatonte objekte natyrore dhe motive nga veprimtaria e tij.

Shumë njerëz mendojnë se gjeografia ka të bëjë me njohjen e shteteve, por gjeografia është më shumë se kaq. **Gjeografia studion marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe mjedisit natyror.** Gjeografia është një ndër shkencat më të vjetra. Fjala “gjeografi” e ka prejardhjen nga greqishtja e vjetër dhe përbëhet nga dy fjalë: **geos** - tokë dhe **grafein** - përshkrim. Për herë të parë këtë nocion e ka përdorur dijetari grek, Eratosteni, rreth 2200 vjet më parë.




Objekti i studimit të gjeografisë është i gjerë. Ajo studion marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe mjedisit natyror, hapësirën, dukuritë që zhvillohen në Tokë etj.

Hapësira gjeografike e Tokës përbëhet prej katër mbështjellësve. Këta janë: **litosfera, hidrosfera, atmosfera dhe biosfera.** **Litosfera** është mbështjellësi i ngurtë ose shkëmbor, i cili quhet ndryshe korja e Tokës. **Hidrosfera** është mbështjellësi ujor i Tokës, i cili përfshin të gjitha oqeanet, detet, liqenet dhe lumenjtë. **Atmosfera** është mbështjellësi i gaztë ose ajror i Tokës dhe **biosfera** është mbështjellësi i Tokës, që përfshin botën e gjallë në Tokë. Të gjithë këta mbështjellës përbëjnë së bashku të ashtuquajturin **mbështjellës gjeografik.**

Sipas objektivit të studimit, gjeografia ndahet në: **gjeografi fizike, gjeografi shoqërore dhe gjeografi regionale.** **Gjeografia fizike** merret me studimin e veçorive të mjedisit natyror, ku bëjnë pjesë: relievi, klima, uji dhe bota e gjallë.

Gjeografia shoqërore merret me studimin e popullsisë, të vendbanimeve dhe të ekonomisë, ndërsa **gjeografia regionale** studion ndikimet dhe lidhjet ndërmjet natyrës dhe njeriut në kuadër të tërësive të caktuara, që quhen **regjione.**

6



Edhe pse gjeografia është disiplinë shkencore shumë e gjerë, ajo shfrytëzon njohuritë dhe të arriturat e shkencave të tjera, si: të astronomisë - e cila studion trupat qiellorë; gjeologjisë - e cila studion mbështjellësin shkëmbor të Tokës; biologjisë - që studion botën e gjallë, pastaj të historisë, arkeologjisë, etnologjisë etj.

Gjeografia është shkencë mbi hapësirën, e cila na mëson për vendet e ndryshme, pozitën e tyre, karakteristikat themelore natyrore dhe shoqërore. Ne e mësojmë gjeografinë për t'u njohur me pozitën e Tokës dhe trupave të tjerë qiellorë në gjithësi. Toka ua siguron njerëzve kushtet dhe resurset për jetë dhe punë. Duke u njohur me kushtet natyrore, vërejmë se të gjitha pjesët e planetit tonë nuk kanë kushte të njëjta për jetë, se disa hapësira janë më shumë të banuara e disa më pak etj. Duke mësuar për botën në të cilën jetojmë, ne i kultivojmë virtutet e tolerancës ndërmjet njerëzve dhe popujve, mësohemi të respektojmë diversitetin e kulturave, të racave dhe të etnive.

Kujtohuni se në cilat lëndë në klasat e mëhershme keni mësuar për dukuritë që i studion gjeografia. Bisedoni me shoqën ose shokun se ku keni dëgjuar më herët për gjeografinë.

7

Përgjigjet e mundshme:

1. Hapësira gjeografike e Tokës përbëhet nga: litosfera, atmosfera, hidrosfera dhe biosfera.
2. Mjedisi natyror përbëhet nga: malet, fushat, uji, bota bimore, bota shtazore.

Diskutohet me nxënësit dhe shpjegohet më gjerësisht për objektin e studimit të lëndës së gjeografisë.



Ndërtimi i njohurive:

Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Nxënësit hapin librin në faqe 6, të lexohet teksti dhe të zhvillohet diskutimi me pyetje:

1. Si arriti njeriu ta zgjerojë horizontin gjeografik?
2. Ku i përshkruanin njohuritë e tyre njerëzit në kohët e lashta?
3. Kush e përdori për herë të parë fjalën “gjeografi”?
4. Cili është objekti i studimit të gjeografisë?
5. Kush e përbën mbështjellësin gjeografik?
6. Si ndahet gjeografia sipas objektit të studimit?
7. Çka studiojnë gjeografia fizike, gjeografia shoqërore dhe ajo regjionale?
8. Me cilat shkenca ka lidhje gjeografia?

Disa nga përgjigjet e mundshme:

1. Lëvizja nga një vend në tjetrin, nevoja për sigurim të ushqimit etj.
2. Njohuritë e tyre njerëzit i përshkruanin nëpër muret e shpellave përmes vizatimeve.
3. Fjalën “gjeografi” për herë të parë e ka përdorur dijetari grek, Eratosteni, rreth 2200 vjet më parë. Njëjtë vazhdohet edhe me përgjigjet e tjera.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Nxënësit udhëzohen të shkruajnë për njohjen e hapësirës gjeografike, dijetarët që dhanë kontribut për studimin e gjeografisë dhe ndarjen e gjeografisë sipas objektit të studimit.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e shpjegimit të hapësirës gjeografike, identifikimin e dijetarëve që dhanë kontribut për studimin e gjeografisë dhe përcaktimin e ndarjes së gjeografisë.

Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, faqe 6, detyrat për këtë njësi mësimore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 2

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VI

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan formën e Tokës, përmasat e saj dhe rëndësinë e tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, II.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Forma dhe madhësia e Tokës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon mendimet e para për formën e Tokës;
- Përshkruan formën e Tokës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Glob, hartë e botës, laptop, TV ose projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Fizika, Matematika, Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë


Diskutim për njohuritë paraprake

Përmes disa pyetjeve, nxënësit nxiten të tregojnë se çfarë njohurish kanë për formën e Tokës dhe për madhësinë e saj. Disa nga pyetjet:

1. Nga këndvështrimi juaj, si ju duket forma e Tokës?
2. Sa mendoni se është madhësia e Tokës krahasuar me Hënë dhe Diellin?
3. Me cilin mjet konkretizimi mund ta kuptojmë se çfarë forme ka Toka? Etj.

Diskutohet me nxënësit dhe disa nga përgjigjet e mundshme janë:

1. Neve na duket Toka e rrafshët, mirëpo forma e saj nuk është e tillë.
2. Mendojmë se Toka është më e madhe se Hëna, por shumë më e vogël se Dielli.
3. Formën e Tokës mund ta kuptojmë përmes globit etj.



Forma dhe madhësia e Tokës

Interesimi i njerëzve për formën dhe madhësinë e Tokës u shfaq shumë herët. Për shkak të mungesës së njohurive dhe horizontit të ngushtë gjeografik, ata dikur kishin bindje të gabuara për formën e Tokës. Disa e mendonin atë si një pllakë të rrafshët, të rrethuar nga oqeani, kurse disa të tjerë mendonin se atë e bartnin kafshët gjigante, si: balena, elefanti, breshka etj.

Ideja për formën e rumbullakët të Tokës haset te **Pitagora**, qysh në shekullin VI p.e.s., ndërsa, dëshmitë e para shkencore për formën e rumbullakët të Tokës i jep filozofi grek, **Aristoteli**, në shekullin IV p.e.s. Njëra nga dëshmitë e tij është shpjegimi që jep për hijen gjysmërrëthore, e cila shfaqet në Hënë me rastin e nxënies së pjesërishme të saj. Aristoteli po ashtu ofron edhe një dëshmi tjetër për formën e rumbullakët të Tokës. Sipas tij, nëse udhëtoni drejt jugut, ndryshon pamja e qiellit me yje, duke u shfaqur yje të reja, ndërsa disa të tjera nuk duken më.

Ekspedita e lundërtarit portugez, **Ferdinando Magelanit**, nga viti 1519 deri në vitin 1522, që udhëtimi i parë rreth botës. Ai dëshmoi se Toka e ka formën e rumbullakët. Duke lundruar prej lindjes në drejtim të perëndimit, ekspedita e tij arriti të kthehej në vendin e njëjtë prej nga e kishte nisur udhëtimin.




Pamjet e Tokës të marra nga satelitetë artificiale janë dëshmitë më bindëse për formën e rumbullakët të Tokës. Prandaj, forma e rumbullakët e Tokës sot është një e vërtetë të cilën e pranojnë të gjithë.

Pamje e Tokës nga satelitetë artificiale




Vrojtimi i anijes si dëshmi e formës sferike të Tokës

Toka në pole është pak e shtypur, kurse në ekuator është pak e fryrë, prandaj ajo ka formën e **elipsoidit**. Kjo formë është për shkak të rrotullimit të Tokës rreth boshtit të vet. **Boshti i Tokës** është një vijë e imagjinuar, i cili kalon nëpër qendrën e planetit, duke bashkuar Polin Verior dhe Polin Jugor. Ka kënd prej 23.5°.



Sipërfaqja e vërtetë e Tokës është jo e rrafshët. Prandaj, ajo nuk është një elipsoid i përkryer, por ka formën e cila quhet **gjeoide**. Për të parë më saktë formën e Tokës, përdoret **globi**. Ekzistojnë disa lloje të globeve, të cilat dallohen për nga përmbajtja. Në glob mund të shihet më së miri shpërndarja e kontinenteve dhe e oqeaneve në Tokë.



10



Ndërtimi i njohurive: Leximi i drejtuar

Mësimdhënësi/ja drejton nxënësit në lexim, duke u parashtruar disa pyetje.

Paragrafi i parë:

1. Çfarë mendimesh kishin njerëzit në kohët e lashta për formën e Tokës?
2. Kush ishin dijetarët e parë që dhanë idetë për formën e rumbullakët të Tokës?

Paragrafi i dytë:

1. Kush e bëri udhëtimin e parë rreth Tokës me anije dhe cili ishte kontributi i këtij udhëtimi?


Paragrafi i tretë:

1. Në ditët e sotme, cilat janë dëshmitë që na ndihmojnë për ta kuptuar formën e vërtetë të Tokës?
 2. Cila është forma e vërtetë e Tokës?
- Identifikohen përgjigjet e mundshme dhe diskutohet me nxënësit.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit: Harta e konceptit

Pasi të lexohet dhe të komentohet përmes pyetjeve dhe përgjigjeve, në tabelë formohet harta e konceptit “Forma dhe madhësia e Tokës” dhe kërkohet nga nxënësit që ta plotësojnë atë në tabelë dhe në fletoret e tyre.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve për identifikimin dhe përshkrimin e formës së Tokës në plotësimin e hartës së konceptit.

Detyrë:

Në shtëpi, të hulumtojnë në internet për udhëtimin e Ferdinando Magelanit dhe të mbajnë shënime.

Reflektim përvojëdhën e orës mësimore:

Mësimi 3

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultati i të nxënit të temës:

Identifikon veçoritë kryesore të Tokës e të Sistemit Diellor, të planetëve, të asteroidëve, të kometave, të satelitëve dhe të Hënës si trup qiellor e satelit natyror i Tokës;

Vlerëson rëndësinë e Diellit për dukuritë gjeografike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2; III.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Sistemi Diellor dhe Toka

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon trupat qiellorë sipas vetive të tyre;
- Radhit planetët sipas largësisë nga Dielli;
- Analizon rëndësinë e Diellit për jetën në Tokë.


Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë e Sistemit Diellor, atlas gjeografik, laptop, TV ose projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Astronomia, Biologjia.

SISTEMI DIELLOR DHE TOKA

Shumë kohë më parë te njerëzit është zgjuar kureshtja për qiellin dhe dukuritë në të. Kinezët, qysh para 5000 vjetësh, i kanë vërejtur fenomenet dhe dukuritë në qiell. Teleskopin e parë për vërtimin e qiellit e ka punuar astronomi italian **Galileo Galilei**, në shekullin XVII.



14

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Para nxënësve prezantohet një video: <https://www.youtube.com/watch?v=MQ1UAe8dh24>, ku paraqitet gjithësia. Hapet diskutimi, ku nxënësit mund t'i shprehin njohuritë e tyre për Sistemin Diellor, për rëndësinë e Diellit për jetën në Tokë etj.

Sqarim: Nëse nuk ka në dispozicion projektor ose laptop, hyrja mund të bëhet duke prezantuar hartën e Sistemit Diellor, apo me pamjet që janë në atlasin gjeografik.



Gjithësia paraqet hapësirë të madhe dhe të pakufishme, në të cilën ndodhet një numër i madh i **trupave qiellorë**. Në trupa qiellorë bëjnë pjesë: *yjet, planetët, satelitët, kometat, meteorët dhe asteroidët*. Shkenca që merret me studimin e Gjithësisë dhe trupave qiellorë quhet **astronomi**.

Gjithësia ka një shtrirje të madhe dhe kufijtë e saj nuk dihen. Distancat ndërmjet trupave qiellorë janë shumë më të mëdha se distancat ndërmjet vendeve në Tokë, prandaj ato maten me vite dritë. Një vit drite paraqet distancën të cilën e kalon drita duke lëvizur me shpejtësi prej 300,000 km/s.

Yjet janë trupa qiellorë të zjarrtë në gjendje të gaztë. Ato rrezatojnë dritë dhe nxehtësi. Ylli më i afërt i Tokës është Dielli, i cili ndodhet mesatarisht 150 milionë kilometra larg prej Tokës. Pas tij, ylli tjetër më i afërt është Proxima Kentauri, rreth 4.3 vite dritë larg Tokës.

Yjet janë trupa qiellorë që kanë madhësi dhe ngjyra të ndryshme. Ekzistojnë yjet e verdha, të kuqe, të kaltra dhe të bardha. Yjet e kuqe janë më të ftohta, kurse yjet e kaltra janë më të ngrohta. Yjet me madhësi të vogël i quajmë "yje xhuxhe" (ku bën pjesë edhe Dielli), ndërsa yjet e mëdha i quajmë "yje gjigante". Yjet më të mëdha, për të cilat dihet deri më sot, e kanë diametrin rreth 2,600 herë më të madh se të Diellit.



Galileo Galilei - ishte astronom italian, i cili në shekullin XVII e punoi teleskopin e parë për vëzhgimin e qiellit.



MENDO

Si quhen shkencëtarët që e studiojnë gjithësinë?

Secili yll në qiell i takon ndonjë vjeshtë. Në qiell ka gjithsej 88 vjeshtë, por të cilat nuk vërehen nga të gjitha vendet e Tokës. Kështu, për shembull, banorët e Amerikës Jugore, Afrikës Jugore dhe Australisë nuk mund të shohin vjeshtë që i shohim ne nga Kosova dhe Evropa.

Me bashkimin e yjeve më të ndritshme brenda një vjeshtë, krijohet forma që u përngajnë kafshëve të ndryshme, gjësendeve apo figurave njerëzore. Vjeshtë më të njohura janë: Arusha e Madhe dhe Arusha e Vogël, Karroca, Virgjëresha, Shigjetari, Oriani etj.

15



Ndërtimi i njohurive:

Ditari dypjesësh

Mësimdhënësi ndan tabelën në dy shtylla: fjalët kyçe dhe përshkrimin për këto fjalë:

Fjalët kyçe	Komentimi /përshkrimi
Gjithësia	Hapësirë e pafund në të cilën gjenden trupat qiellorë.
Galaktika	Grup yjesh (deri 100mld), ka pamjen e një mjegulline spirale, eliptike.
Planetët	Trupat qiellorë që sillen rreth Diellit, nga ai e marrin dritën dhe nxehtësinë. Radhitja e planetëve sipas largësisë nga Dielli: Merkuri, Venera, Toka, Marsi, Jupiteri, Saturni, Urani, Neptuni.
Yjet	Trupa qiellorë që kanë nxehtësinë dhe dritën e tyre. Ylli më i rëndësishëm është Dielli, nga i cili varet jeta në Tokë.
Hëna	Satelit natyror i Tokës.
Asteroid	Trupa të vegjël qiellorë që kanë ndërtim të njëjtë me planetët.
Kometa	Kanë pamjen e një bërthame të ndritshme me bisht.
Meteor	Janë trupa të errët dhe të vegjël qiellorë. Në kontakt me atmosferën e Tokës ndizen nga fërkimi.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënësve:

Mendo, krijo në dyshe dhe diskuto

Nxënësit të punojnë në dyshe dhe t'ia përmbledhin informacionet shokut për pjesën e pëlqyer, ndërkohë ata ndërrojnë rolet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e analizës për rëndësinë e Diellit, të radhitjes së planetëve në Sistemin Diellor.

Detyrë:

Detyrë shtëpie: të punohet modeli i Sistemit Diellor me materiale të ndryshme, p.sh., me plastelinë.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

Mësimi 4

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultati i të nxënit të temës:

Identifikon veçoritë kryesore të Tokës e të Sistemit Diellor, të planetëve, të asteroidëve, të kometave, të satelitëve dhe të hënës si trup qiellor e satelit natyror i Tokës.; Vlerëson rëndësinë e Diellit për dukuritë gjeografike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-2,4,6; II-3,5,6; III-3,8, VI-3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: Shpjegon orientimin në hapësirë, paraqitjen e Tokës në hartë dhe në glob, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen, ndërtimin dhe strukturën e gjeosferave, dukuritë dhe proceset që ndodhin në to dhe bashkëveprimin njeri/natyre në nivel lokal, regional dhe ndërkombëtar.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Aktivitet: Sistemi Diellor dhe Toka

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon karakteristika kryesore të trupave qiellorë që janë pjesë e Sistemit Diellor;
- Interpretin rolin e Diellit të trupave në Sistemin Diellor.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.


Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri "Gjeografia 6", atlas enciklopedik, fotografi, hartë, projektor, laptop, foto.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Biologjia.

SISTEMI DIELLOR DHE TOKA

Shumë kohë më parë te njerëzit është zgjuar kureshtja për qiellin dhe dukuritë në të. Kinezët, qysh para 5000 vjetësh, i kanë vërejtur fenomenet dhe dukuritë në qiell. Teleskopin e parë për vërtetimin e qiellit e ka punuar astronomi italian **Galileo Galilei**, në shekullin XVII.



14

Gjithësia paraqet hapësirë të madhe dhe të pakufishme, në të cilën ndodhet një numër i madh i **trupave qiellorë**. Në trupa qiellorë bëjnë pjesë: *yjet, planetët, satelitët, kometat, meteorët dhe asteroidët*. Shkenca që merret me studimin e Gjithësisë dhe trupave qiellorë quhet **astronomi**.

Gjithësia ka një shtrirje të madhe dhe kufijtë e saj nuk dihen. Distancat ndërmjet trupave qiellorë janë shumë më të mëdha se distancat ndërmjet vendeve në Tokë, prandaj ato maten me vite dritë. Një vit drite paraqet distancën të cilën e kalon drita duke lëvizur me shpejtësi prej 300,000 km/s.

Yjet janë trupa qiellorë të zjarrtë në gjendje të gaztë. Ato rrezatojnë dritë dhe nxehtësi. Ylli më i afërt i Tokës është Dielli, i cili ndodhet mesatarisht 150 milionë kilometra larg prej Tokës. Pas tij, ylli tjetër më i afërt është Proksima Kentauri, rreth 4.3 vite dritë larg Tokës.

Yjet janë trupa qiellorë që kanë madhësi dhe ngjyra të ndryshme. Ekzistojnë yjet e verdha, të kuqe, të kaltra dhe të bardha. Yjet e kuqe janë më të ftohta, kurse yjet e kaltra janë më të ngrohta. Yjet me madhësi të vogël i quajmë "yje xhuxhe" (ku bën pjesë edhe Dielli), ndërsa yjet e mëdha i quajmë "yje gjigante". Yjet më të mëdha, për të cilat dihet deri më sot, e kanë diametrin rreth 2,600 herë më të madh se të Diellit.



Galileo Galilei - ishte astronom italian, i cili në shekullin XVII e punoi teleskopin e parë për vërtetimin e qiellit.



MENDO

Si quhen shkencëtarët që e studiojnë gjithësinë?

Secili yll në qiell i takon ndonjë yjësie. Në qiell ka gjithsej 88 yjësi, por të cilat nuk vërehen nga të gjitha vendet e Tokës. Kështu, për shembull, banorët e Amerikës Jugore, Afrikës Jugore dhe Australisë nuk mund të shohin yjësitë që i shohim ne nga Kosova dhe Evropa.

Me bashkimin e yjeve më të ndritshme brenda një yjësie, krijohet forma që u përngjajnë kafshëve të ndryshme, gjësendeve apo figurave njerëzore. Yjësitë më të njohura janë: Arusha e Madhe dhe Arusha e Vogël, Karroca, Virgjëresha, Shigjetari, Oriion etj.

15

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Diskutim për njohuritë paraprake

Mësimi realizohet në formën e një aktiviteti.

Pastrohet klasa (krijohet hapësirë) pa karrige dhe banka.

Arsimtari përgatit fotografi (fletë A4), ku secila fotografi pasqyron një objekt në Sistemin Diellor dhe në gjithësi (Dielli, Hëna, Toka, meteorët, asteroidët, galaktikat, planetët...).

Nxënësve iu shpërndahen (tërheqin nga një fletë/ fotografi/vizatim) individualisht dhe në formë të fshehtë, varësisht prej trupave qiellorë, ku disa paraqiten në grupe. Pasi të kuptojnë se cilin trup përfaqësojnë ata, shënojnë fakte dhe komente në një letër dhe e vendosin pas fotografisë dhe e mbajnë në dorë.

Arsimtari kërkon nga nxënësit që t'i zënë pozicionet e tyre të renditura në formë të njëjtë si trupat qiellor në gjithësi. Arsimtari e shtron një pyetje: cili është trupi më i rëndësishëm për jetën e njeriut nga të gjithë këta? Dielli vendos rregullin e rreshtimit të trupave së bashku me nxënësit tjerë duke bashkëpunuar.

Pasi që nxënësit vendosen në pozicione, "Dielli" me një elektrik, drejton nga nxënësi tjetër dhe e pyet se kush është. Nxënësi përgjigjet duke e përshkruar trupin që përfaqëson.

Reflektim: Arsimtari pyet nxënësit (pyetje logjike të nivelit më të lartë):

- Pse nuk ka jetë në planetët e tjerë (numëro tri arsye)?
- Çfarë do të kishte ndodhur sikur të mos ishte Dielli?
- Pse Dielli (yjet) janë më të rëndësishme se trupat e tjerë qiellorë?
- Pse Hëna nuk paraqitet çdoherë në një formë? (ilustroni fazat e Hënës).

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të analizës, të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotësojnë në fletore pune.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

Mësimi 5

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultati i të nxënit të temës:

Identifikon provat dhe pasojat e lëvizjes së Tokës rreth boshtit të vet.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Rotacioni (lëvizja e Tokës rreth boshtit të vet)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Arsyetohet ndryshimet që ndodhin në Tokë si rezultat i rrotullimit të Tokës rreth boshtit të vet.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Glob, laptop, TV ose projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Matematika, Fizika.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësve iu parashtrihen disa pyetje për lëvizjet e Tokës, për të kuptuar nivelin e njohurive që ata kanë për këtë dukuri.

1. Si e kuptojmë ne lëvizjen e Tokës rreth boshtit të vet?
2. A e ndiejmë ne këtë lëvizje? Etj.

Pastaj para nxënësve prezantohet një video e shkurtër: <https://www.youtube.com/watch?v=ZZ01WPJQ4A>, ku paraqitet lëvizja e Tokës rreth boshtit të vet.

Sqarim: Nëse nuk ka në dispozicion projektor/laptop, kjo pjesë mund të zëvendësohet me një demonstrim të lëvizjes së Tokës rreth boshtit të vet përmes globit.



Pyetje

1. Çka janë yjet?
2. Si ndahen planetët?
3. Cilat janë karakteristikat e planetëve të brendshëm?

Rotacioni (lëvizja e Tokës rreth boshtit të vet)



A E DINI SE

Bima e luledielli quhet me këtë emër, sepse lulet e saj drejtohen në drejtim të Diellit, duke e përcjellë atë nga lindja në perëndim. Mendohet që sumerët, një popull i vjetër i Mesopotamisë, ishin të parët që filluan të masnin kohën pothuajse në mënyrë të njëjtë me atë që ne e matim sot. Instrumentet e para për matjen e kohës ishin orët diellore, ujore dhe të zallit.


Rotacioni është rrotullimi i Tokës rreth boshtit të vet, që kryhet për 24 orë. Kjo do të thotë se Toka për një ditë e bën një rrotullim për 360°. Ajo rrotullohet nga perëndimi në drejtim të lindjes.

Për shkak të formës së Tokës, të gjitha pikat në sipërfaqe rrotullohen në drejtim të lindjes, me shpejtësi të ndryshme. Më shpejt rrotullohen pikat që ndodhen në ekuator, kurse, duke shkuar drejt poleve, shpejtësia e rrotullimit vjen duke u zvogëluar. Pasojat e rotacionit janë: *ndërrimi i ditës dhe i natës, lëvizja e dukshme ditore e Diellit dhe koha lokale (diellore).*

Gjatë rotacionit, rrezet e diellit ndriçojnë vetëm gjysmësferën, e cila është e kthyer nga Dielli. Në këtë gjysmësferë është **dita**, ndërsa në gjysmësferën tjetër, e cila nuk ndriçohet, është **nata**.

Lëvizja e përditshme e Diellit prej lindjes drejt perëndimit është lëvizje e dukshme, e cila paraqitet për shkak të rrotullimit të Tokës rreth Diellit prej perëndimit drejt lindjes. Kjo është e ngjashme me lëvizjen e dukshme të drurëve apo shtëpive në drejtim të kundërt me lëvizjen e automobilit me të cilin jeni duke udhëtuar.

Kur e vëzhgojmë Diellin, vërejmë që ai paraqitet në lindje, dalëngadalë ngrihet mbi horizont dhe pastaj lëshohet kah perëndimi. Kur Dielli arrin pikën më të lartë mbi qiellin e vëzhguesit, atëherë themi që ai ndodhet në **zenit**.



Mësimi 6

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultati i të nxënit të temës:

Shpjegon rrjedhojat e lëvizjes së Tokës rreth Diellit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Revolucioni (lëvizja e Tokës rreth Diellit)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Analizon pasojat e lëvizjes së Tokës rreth Diellit;
- Vlerëson rëndësinë e rrotullimit të Tokës rreth Diellit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Laptop, projektor/TV.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Matematika, Fizika.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësve iu parashtrihen disa pyetje për lëvizjet që bën Toka, për të kuptuar nivelin e njohurive që ata kanë për këtë dukuri.

1. Sa lëvizje i bën Toka?
2. Pse na duket se po lëviz Dielli nga lindja në perëndim? Etj.

Pas përgjigjeve të mundshme: para nxënësve prezantohet një video e shkurtër: <https://www.youtube.com/watch?v=4CoO8uGmMB4>, ku paraqitet lëvizja e Tokës rreth Diellit.



Sqarim: Prezantimi realizohet nëse ka në dispozicion projektor/laptop.

Revolucioni (lëvizja e Tokës rreth Diellit)

Revolucioni është rrotullimi i Tokës rreth Diellit. Toka rrotullohet rreth Diellit prej perëndimit drejt lindjes nëpër rrugën ose orbitën e cila quhet **ekliptikë**. Shpejtësia mesatare e lëvizjes është 30 km/s. Revolucioni zgjat 365 ditë e 6 orë ose një vit. Pasojat e rrotullimit të Tokës rreth Diellit janë: *kohëzgjatja jo e njëjtë e ditës dhe e natës, ndërrimi i stinëve të vitit dhe brezat e nxehtësisë*.

Gjatë revolucionit, Toka ndodhet në largësi të ndryshme nga Dielli. Më 4 janar, Toka është më afër Diellit (rreth 147.5 milionë km) dhe kjo pikë në orbitën e Tokës quhet **ahel**. Ndërsa, më datë 4 korrik, Toka ndodhet më larg nga Dielli dhe kjo pikë quhet **perihel**.

Boshti i Tokës ndaj rrafshit të ekliptikës krijon këndin prej 66.5°. Gjatë vitit, hemisfera veriore dhe ajo jugore ndriçohen në mënyrë jo të njëjtë, prandaj ndryshon edhe kohëzgjatja e ditës dhe e natës. Dy herë gjatë vitit, më 21 mars dhe 22 shtator, kufiri ndriçimit kalon nëpër pole. Dita dhe nata kanë gjatësi të njëjtë dhe këto njihen si **ekuinoksi pranveror** dhe **vjeshtor**. Në këto data rrezet e diellit bien pingul mbi ekuator.




22

Lëvizja ditore e Diellit në ekuinoks dhe solstic

Pas ekuinoksit pranveror, dita në hemisferën veriore zgjatet më shumë se nata. Dita më e gjatë dhe nata më e shkurtër janë më 21 qershor dhe ky është **solstici veror** në hemisferën veriore. Në këtë datë rrezet e diellit bien pingul në tropikun e veriut. Në hemisferën veriore fillon vera, ndërsa në jugore fillon dimri. Dita më e shkurtër dhe nata më e gjatë është më 22 dhjetor dhe ky është **solstici dimëror**. Rrezet e diellit bien pingul në tropikun e jugut dhe në hemisferën jugore fillon vera, ndërsa në atë veriore fillon dimri.

Sasia e nxehtësisë, të cilën e merr Toka, varet nga këndi i rënies së rrezeve të diellit. Kur bien më kënd të drejtë (pingull), ato e ngrohin më shumë.



Dimri
Ditët janë të shkurtra, të ftohta dhe të errëta. Mund të ketë ngrica, borë.

Pranvera
Ditët fillojnë të ngrohen. Nata është e freskët. Ka reshje ose nuk ka fare.


Vera
Ditët janë të nxehta dhe të gjata. Reshje mund të ketë pasdite ose nuk ka fare.

Vjeshta
Ditët janë të freskëta dhe në mëngjes ka njequll. Ditët shpeshherë shoqërohen me shi.

Vijat në veri ose jug të ekuatorit, deri të të cilat rrezet e diellit bien me kënd të drejtë, quhen **tropiku verior** dhe **tropiku jugor**.

Për shkak të ndryshimit të pozitës së Tokës ndaj Diellit dhe këndit të ndryshëm të rënies së rrezeve të diellit, ndodh shpërndarja jo e njëjtë e nxehtësisë. Dallimet në ngrohje, si dhe në kohëzgjatjen jo të njëjtë të ditës dhe të natës, kushtëzojnë paraqitjen e stinëve të vitit. Ndryshimet hasen sidomos në pjesët e mesme të hemisferës veriore dhe jugore ku dallohen qartë katër stinët e vitit: pranvera, vera, vjeshta dhe dimri.

Për shkak të kohëzgjatjes jo të njëjtë të ditës dhe natës, si dhe këndit të rënies së rrezeve të diellit në Tokë, paraqiten edhe brezat e nxehtësisë. Ata janë: **brezi i vapës**, **brezi mesatar (verior dhe jugor)** dhe **brezi i ftohtë (verior dhe jugor)**.



23



Ndërtimi i njohurive: Leximi i drejtuar

Mësimdhënësi/ja drejton nxënësit në lexim duke u parashtruar disa pyetje.

Paragrafi i parë:

1. Si quhet lëvizja e Tokës rreth Diellit?
2. Sa është shpejtësia mesatare e lëvizjes së Tokës rreth Diellit?
3. Cilat janë pasojat e lëvizjes së Tokës rreth Diellit?

Përgjigje e mundshme:

Pasojat e lëvizjes së Tokës rreth Diellit janë: kohëzgjatja jo e njëjtë e ditës dhe natës, ndërrimi i stinëve të vitit dhe brezat e nxehtësisë.

Paragrafi i dytë:

1. A ndodhet Toka në largësi të njëjtë gjatë lëvizjes rreth Diellit?

Përgjigje e mundshme:

1. Jo, Toka ndodhet në largësi të ndryshme nga Dielli, në janar është më afër Diellit, ndërsa në korrik më larg.

Paragrafi i tretë:

1. Pse dita dhe nata kanë gjatësi të ndryshme gjatë vitit?

Përgjigje e mundshme:

1. Sepse Toka nuk arrin të ndriçohet në mënyrë të njëjtë gjatë vitit, për shkak të boshtit të Tokës ndaj rrafshit të ekliptikës.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit: Shkrim përmbledhës

Nxënësit do të shkruajnë një paragraf përmbledhës në lidhje me lëvizjen e Tokës rreth Diellit, kohën për të cilën kryhet kjo lëvizje, pasojat e kësaj lëvizjeje.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve për analizën dhe vlerësimin për lëvizjen e Tokës.

Detyrë:

Të plotësohen në fletore pune, fq.11-12, njësitë mësimore “Revolucioni” dhe “Rotacioni”.

Reflektim për veprimet e orës mësimore:

Mësimi 7

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultati i të nxënit të temës:

Përcakton kohën vendore dhe atë zonale në vende të ndryshme në bazë të gjatësisë së tyre gjeografike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,4; II.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Koha vendore (lokale) dhe zonale

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon zonat kohore në të cilat është e ndarë Toka;
- Analizon arsyen e ndërrimit të orës gjatë lëvizjes (udhëtimit) nga lindja në perëndim dhe anasjellas.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë e botës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Matematika.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:


Përgatitja për të nxënë

Stuhi mendimesh

Diskutohet me nxënësit, duke bërë përsëritje të njëjve të kaluara, duke u fokusuar në zgjatjen jo të njëjtë të ditës dhe të natës, llogaritjen e kohës verore dhe të asaj dimërore. Diskutimi realizohet përmes pyetjeve dhe përgjigjeve që iu parashtrihen nxënësve.

Disa nga pyetjet:

1. Pse është e rëndësishme llogaritja e kohës?
2. A është koha/ora e njëjtë në secilin vend në Tokë? Etj.



24


Koha vendore (lokale) dhe zonale

Meqenëse Toka ka formë sferike dhe rrotullohet rreth boshtit të vet, rrezet e diellit nuk bien në gjithë Tokën përnjëherë. Prandaj, në disa vende është mëngjes, në disa të tjera është mesdite, ndërsa në të tjerat është natë. Duke u rrotulluar Toka, ndryshon edhe ora në një vend.

Mesdita në secilin vend në Tokë është atëherë kur Dielli arrin pikën më të lartë në qiell. Koha që përcaktohet në momentin që Dielli është në zenit në një vend quhet **kohë lokale**. Çdo pikë, vend apo meridian ka kohën e vendit, prandaj i bie që sa është numri i meridianeve, ka po aq kohë lokale, të cilat llogariten përmes orës diellore. Lëvizja e madhe e njerëzve sjell probleme dhe shtrton nevojën për llogaritjen e kohës në nivel global.

Koha zonale caktohet nëpërmjet kohës lokale të meridianit të mesëm (qendror). Kur Tokën e rrumbullakët prej 360°, e ndajmë për 24 orë (një ditë), del që në çdo 15° të gjatësisë gjeografike ka një zonë kohore.

Sipas kohës lokale dhe zonale, në vendet, të cilat ndodhen në perëndim të vendit mbi të cilin ndodhet Dielli, mesdita do të jetë më vonë, ndërsa në vendet që janë në lindje të tij, mesdita tanimë ka kaluar.



Sipas pozitës së qyteteve në gadishullin Ballkanik, Dielli e arrin pikën më të lartë në qiell së pari në Sofje (Bullgari), pastaj në Prishtinë dhe më vonë në Romë (Itali). Prandaj, koha lokale ose vendore përcaktohet nga kalimi i dukshëm ditor i Diellit mbi vendin e caktuar.

Kufiri i datës shërben për të treguar kalimin nga një datë në datën tjetër. Ky kufi ndjek meridianin 180°. Nëse e kalojmë kufirin e datës prej lindjes kah perëndimi ose në drejtim të kundërt të rotacionit të Tokës, atëherë e kapërcejmë një ditë sipas kalendarit.

Kosova i takon zonës kohore të Evropës së Mesme.



Pyetje dhe detyra

1. Cilat lëvizje i bën Toka?
2. Përmend pasojat e rotacionit.
3. Çka është revolucioni dhe cilat janë pasojat?
4. Cila stinë fillon më 22 dhjetor në hemisferën jugore?

Shënimi (rrethoni) përgjigjen e saktë.

1. Toka një rrotullim rreth boshtit të vet e bën për:
 - a) 26 orë
 - b) 23 orë
 - c) 24 orë
2. Toka rrotullohet rreth Diellit në drejtimin:
 - a) lindje-perëndim
 - b) perëndim-lindje
 - c) veri-jug
3. Toka e bën një rrotullim rreth Diellit për:
 - a) 346 ditë
 - b) 365 ditë
 - c) 356 ditë
4. Dita më e gjatë dhe nata më e shkurtër e vitit në Kosovë është më:
 - a) 21 mars
 - b) 21 qershor
 - c) 21 dhjetor

Plotësoni vendet boshe.

- a) Vjeshta në hemisferën veriore fillon më (data): _____.
- b) _____ quhet pozita kur Toka gjendet më larg prej Diellit (152 mil./km).
- c) _____ është dita më e gjatë e vitit në hemisferën veriore.
- c) Nëse në Kosovë është ora 14:00, sa është ora në Kinë? _____

Kontrollo njohuritë

25



Ndërtimi i njohurive:

Ditari dypjesësh

Tabela ndahet në dy shtylla. Në shtyllën e parë shënon disa pyetje dhe nxënësit duke lexuar njësinë mësimore “Koha vendore (lokale) dhe zonale”, shkruajnë përgjigjet.

Pyetjet	Përgjigjet
Çka është koha lokale? Kur arrin mesdita? Në sa zona kohore është e ndarë Toka?	Koha kur Dielli është në zenit në një vend. Mesdita është atëherë kur Dielli arrin pikën më të lartë në qiellin e vështruesit. Toka është e ndarë në 24 zona kohore.
Si ndryshon llogaritja e orës në secilën zonë? Cilës zonë kohore i takon Kosova?	Zonat kohore në lindje e kanë orën më përpara, ndërsa duke shkuar në drejtim të perëndimit ora është më mbrapa. Kosova i takon zonës kohore të Evropës së Mesme.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Zbatim praktik në hartë

Pas leximit dhe përgjigjes së pyetjeve, analizohet përmes hartës së botës llogaritja e kohës në vendet që janë në lindje të Meridianit të Grinuiçit dhe ato që janë në perëndim, si ndryshon ora kur kalojmë nga një zonë kohore në tjetrën nga perëndimi në lindje dhe anasjellas.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve në dallimin dhe analizën e zonave kohore dhe për zbatimin praktik përmes hartës.

Detyrë:

Të plotësohet libri bazë, fq.25, “kontrollo njohuritë”.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 8

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultati i të nxënit të temës:

Krahason hartën dhe globin, duke treguar ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre (elementet matematike dhe gjeografike të hartës).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; II.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Paraqitja e Tokës në glob dhe në hartë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Analizon përparësitë dhe mangësitë e paraqitjes së Tokës në glob dhe në hartë;
- Vlerëson rëndësinë e përdorimit të hartave në jetën e përditshme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë e botës, glob.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Matematika.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Stuhi mendimesh

Para nxënësve paraqiten globi dhe harta e botës, ku kërkohet nga ta që të tregojnë se për çka na nevojiten këto dy mjete mësimore, ku qëndron dallimi në mes tyre etj. Disa nga mendimet e nxënësve shkruhen në tabelë.



Leximi i shkallës së zvogëlimit bëhet duke marrë parasysh njësinë e njëjtë në hartë dhe natyrë. P.sh.: te shkalla 1:100,000, 1 cm në hartë = 100,000 cm në natyrë (1,000 m ose 1 km); 1 mm në hartë = 100,000 mm në natyrë.

Hartat me shkallë të vogël dhe shkallë të mesme quhen **harta gjeografike**. Ato kanë shkallë më të vogël se 1:200,000. Punohehen në formë të atlaseve, hartave të murit etj., ku paraqiten sipërfaqe të mëdha të Tokës, si: kontinentet, regjionet e mëdha etj.

Hartat me shkallë të madhe quhen **harta topografike**. Ato punohehen në shkallë nga 1:10,000 deri në 1:200,000. Në këto harta, në mënyrë të detajizuar, paraqiten relievi, hidrografia, vendbanimet, rrugët etj. Për shkak të shkallës, përmbajnë shumë elemente të realitetit hapësinor.


Hartat me shkallë deri 1:5,000 quhen **plane**. Përdoren për planifikim të vendbanimeve, rrugëve, sistemeve të ujitjes, ujësjellësve etj.



MBANI MEND!

Sa më i madh të jetë numri të shkalla numerike e hartës, shkalla është më e vogël dhe anasjelltas.

Efektet e shkallës së zvogëlimit në sipërfaqe dhe detaje



27



Ndërtimi i njohurive:

Lexim i drejtuar

Nxënësit të hapin librin në faqe 26, lexohet teksti dhe pastaj zhvillohet diskutimi me pyetje:

1. Pse na duhen hartat?
2. Çka paraqitet në hartë?
3. Çka është atlas?
4. Cilat janë disa dallime në mes të globit dhe hartës?
5. A është globi i përshtatshëm për punë në terren?
6. Çfarë lloje të globeve kemi?
7. Çka na tregon shkalla e zvogëlimit?
8. Si ndahen hartat sipas shkallës së zvogëlimit? Etj.

Disa përgjigje të mundshme:

1. Në hartë paraqiten vendet e ndryshme, malet, lumenjtë, liqenet, detet, oqeanet etj.
2. Ka disa dallime në mes të globit dhe hartës p.sh., në glob, Toka paraqitet në formë sferike, në hartë paraqitet në formë të rrafshët.
3. Kemi disa lloje të globit: glob shkollor, glob fiziko-gjeografik, politik, induktiv.
4. Shkalla e zvogëlimit na tregon raportin e zvogëlimit të sipërfaqes prej natyrës në hartë.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Organizuesi grafik - Diagrami i Venit

Nxënësit paraqesin dallimet dhe ngjashmëritë në mes të globit dhe hartës, përparësitë dhe mangësitë e tyre.

Globi-paraqitja e Tokës në formë sferike, nuk është i përshtatshëm për punë në terren etj.

Harta-paraqitja e Tokës në formë të rrafshët, e përshtatshme për terren, për orientim etj.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve në analizën, rëndësinë, dallimet dhe ngjashmëritë që arrijnë t'i bëjnë në mes globit dhe hartës.

Detyrë:

Të vizatohen globi dhe harta e botës.

Reflektim për veprimtarinë e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultati i të nxënimit të temës:

Shpjegon ndërtimin e sistemit të koordinatave gjeografike (rrjetin e paraleleve dhe meridianeve, gjerësinë dhe gjatësinë gjeografike).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, 6; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Koordinatat gjeografike dhe lartësia mbidetare

Rezultatet e të nxënimit të orës mësimore:

- Dallon paralelet nga meridianet;
- Shpjegon dallimin në mes të gjatësisë dhe gjerësisë gjeografike;
- Analizon ndryshimet në mes të lartësisë absolute dhe të asaj relative.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë e botës, glob.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Matematika.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim për njohuritë para-prake

Paraqitet harta dhe globi dhe kërkohet nga nxënësit të tregojnë se çka paraqitet në glob dhe në hartë, pse janë të rëndësishme këto mjete? Në formë të diskutimit arrijmë të kuptojmë nivelin e njohurive që kanë nxënësit për këtë njësi mësimore.





MËSONI MË SHUMË
Gjerësia gjeografike shënohet me shkronjën greke ϕ (fi), kurse gjatësia gjeografike me λ (lambda). Në hartografi, për të treguar anët e horizontit, përdoren shkronjat e alfabetit anglez:
N – North (veriu)
S – South (jugu)
E – East (lindja).
W – West (perëndimi).
Meqë gjerësia dhe gjatësia gjeografike janë kënde, njësia e tyre është shkalla ($^{\circ}$), minuta ($'$) dhe sekonda ($''$).

28

Koordinatat gjeografike dhe lartësia mbidetare

Përcaktimi i pozitës së një vendi në Tokë, glob e hartë bëhet përmes koordinatave gjeografike. Koordinatat gjeografike funksionojnë sikur sistemi koordinativ në matematikë, i cili përbëhet nga dy boshte, të cilat kanë një pikënisje (pikëtakim). Në glob dhe hartë paraqiten vija horizontale e vertikale, të cilat përfaqësojnë paralelet dhe meridianet.


Paralelet janë rrethë koncentrikë të imagjinuar, të cilët përshkojnë Tokën prej lindjes në perëndim (anasjellas), duke bashkuar pikat me gjerësi të njëjtte gjeografike. Për shkak të formës së Tokës, paralelet nuk kanë gjatësi (perimetër) të njëjtte. Meqenëse Toka është e zjerzuar në ekuator, atëherë ekuatori është paraleli më i gjatë në Tokë. Gjatësia e tij është 40,075 km. Ekuatori e ndan Tokën në dy hemisfera: veriore dhe jugore.



Vijat imagjinare që bashkojnë Polin e Veriut me Polin e Jugut quhen **meridiane**. Ato bashkojnë pikat me gjatësi të njëjtte gjeografike. Meridianet i presin paralelet, përfshirë edhe ekuatorin, në kënd prej 90°. Për shkak të drejtimit të meridianeve, gjatësia e tyre është gati e njëjtte.

Meridiani i Grinuit është meridiani kryesor. Kalon nëpër Londër (Angli) dhe e ndan Tokën në dy hemisfera: lindore dhe perëndimore.

Paralelet dhe meridianet ndërtojnë **rrjetin e koordinatave gjeografike**. Duke përdorur paralelet dhe meridianet, përcaktohet gjerësia dhe gjatësia gjeografike. Nacionet gjerësi dhe gjatësi gjeografike janë përdorur që në shek. I p.e.s., kurse i pari që i përmendi ishte Eratosteni.



Sistemi i koordinatave gjeografike

Lartësia mbidetare paraqet lartësinë e pikës në raport me nivelin e detit. Niveli i detit paraqet pikën zero. Dallohet lartësia absolute mbidetare dhe lartësia relative mbidetare.

Lartësia absolute mbidetare paraqet diferencën në lartësi në mes pikës (kuotës) në Tokë në raport me nivelin e detit. Pika më e lartë në Kosovë është Rudoka (Malet e Sharrit) me lartësi mbidetare 2,658 m, ndërsa Gjeravica është maja e dytë më e lartë me lartësi mbidetare 2,656 m, e cila ndodhet në Bjeshkët e Nemuna. Lartësia e majës së Rudokës 2,658 m është lartësia absolute mbidetare. Nëse bëjmë ndonjë krahasim të lartësive të pikave në natyrë, duke mos marrë për bazë nivelin e detit, atëherë kemi të bëjmë me **lartësinë relative mbidetare**. Nëse lartësia mbidetare e qendrës së Prishtinës është 600 metra, kurse lartësia e majës së Lubetenit është 2,498 metra, atëherë diferenca në


Gjerësia gjeografike është këndi që formohet në mes të ekuatorit dhe pikës së dhënë në drejtim të veriut apo jugut. Ka vlera deri në 90°. Me 90° paraqitet Poli i Veriut, kurse me -90° paraqitet Poli i Jugut. Ekuatori e ka gjerësinë gjeografike 0°.

Gjatësia gjeografike është këndi në mes dy meridianeve në drejtim të lindjes apo perëndimit. Ka vlera deri në 180° në lindje dhe perëndim. Gjatësia gjeografike e ka pikënisjen nga meridiani fillestar i Grinuiçit (0°), i cili kalon nëpër Observatoriumin Mbretëror në Grinuiç të Londrës.



MESONI MË SHUMË

Duke përdorur Google Earth, gjeni koordinatat gjeografike të vendbanimit tuaj, shtëpisë suaj etj.



29



Ndërtimi i njohurive:

Lexim i drejtuar

Udhëzohen nxënësit të lexojnë njësinë mësimore në mënyrë individuale dhe të ndalen pas leximit të secilit paragraf për të bërë komentimin përmes përgjigjeve të pyetjeve.

Paragrafi i parë:

1. Si bëhet përcaktimi i pozitës së një vendi në Tokë?
2. Çka janë paralelet?
3. Cili është paraleli më i madh në tokë?

Paragrafi i dytë:

1. Çka janë meridianet?
2. Cili është meridiani kryesor?
3. Çka ndërtojnë së bashku paralelet dhe meridianet?

Njëjtë vazhdohet me pyetjet për paragrafin e tretë dhe të katërt.


Përgjigjet e mundshme diskutohen me nxënësit.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Harta e konceptit



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve në dallimin, shpjegimin dhe analizën e ndryshimeve midis lartësisë relative dhe absolute.

Detyrë:

Duke përdorur "Google Earth" gjeni koordinatat e vendbanimit tuaj/shtëpisë.

Reflektim përvojëdhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan përmbajtjen e hartës - elementet gjeografike të hartës, metodat e paraqitjes së relievit në hartë dhe lartësinë absolute dhe atë relative.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; II.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Elementet që paraqiten në hartë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Rendit elementet e hartës;
- Shpjegon domethënien e ngjyrave në hartë;
- Demonstron në hartë paraqitjen e relievit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë e botës, glob.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Matematika, Arti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme përmes disa pyetjeve:



1. Cili e përbën rrjetin e koordinatave gjeografike?
2. Për çfarë na shërben harta?
3. Pse kemi ngjyra të ndryshme në harta?

Realizohet diskutim i shkurtër me nxënësit.

Elementet që paraqiten në hartë

Elementet që paraqiten në hartë varen nga tematika e hartës dhe shkalla e zvogëlim-it. Pjesa më e madhe e hartave të punuara janë harta tematike, të cilat kanë një temë kryesore, ndërsa elementet e tjera janë ndihmëse. Të gjitha objektet, të cilat paraqiten në hartë, janë në formë **pike, vije dhe poligoni**. Gjatë përpilimit të hartës, me rëndësi janë edhe simbolat, ngjyrat, shrafurat etj. Përzgjedhja e ngjyrave bëhet sipas standardeve hartografike. Disa prej ngjyrave të përdorura në hartë janë: **e kaltër për hidrografinë; e kaftë për izohipset; e zeze për paraqitjen e objekteve natyrore, objekteve të ndërtuara dhe emërtime; e gjelbër për vegetacion; e hirtë për paraqitjen e hijeve në hartë; e verdhë për paraqitjen e objekteve të ndritshme etj.**

Paraqitja e relievit me izohipset



Paraqitja e relievit me Model Digjital të Relievit

Në hartë paraqiten elementet matematike, gjeografike dhe tematike, si dhe elementet plotësuese.

Elementet matematike të hartës janë: **shkalla e zvogëlimit, baza gjeodezike, projeksionet hartografike dhe sistemet e koordinatave**. Këto elemente mundësojnë përcaktimin e pozitës gjeografike, matjen e gjatësive, të sipërfaqes etj.

Elementet plotësuese të hartës janë: **titulli, autori, legjenda, data, orientimi, rrjeta dhe shkalla**.

Elementet gjeografike janë elemente të ndryshme natyrore dhe shoqërore, të cilat hasen në sipërfaqen e Tokës. Këto elemente kanë formë, madhësi dhe pozitë të caktuar në natyrë. Relievi në hartë paraqitet në varësi të shkallës së hartës. Në hartat me shkallë të madhe, për paraqitjen e relievit përdoren: **kuotat, izohipset, simbollet, vizatimi apo hijezimi, modeli digjital i relievit, shkalla hipsometrike me ngjyra etj.**

Kuotat janë pika me lartësi absolute mbidetare. **Izohipset** janë vija të cilat bashkojnë vendet me lartësi të njëjtë mbidetare. Ndërsa, për thellësi të njëjtë përdoren **izobatet**. Izohipset paraqiten me **ngjyrë të kaftë**. Te harta me izohipse dallohet ekuidistancia dhe intervali. **Ekuidistancia** është largësia vertikale e izohipsit dhe është e njëjtë në gjithë hartën. Ndërsa, **intervali** paraqet distancën horizontale ndërmjet izohipseve. Intervali varet nga pjerrësia e terrenit. Në vende fushore me pjerrësi të vogël, intervali është i madh, ndërsa në vendet malore me pjerrësi të madhe, intervali është i vogël.

Përveç izohipseve dhe kuotës, relievi paraqitet me Model Digjital të Relievit (MDR), vizatime, hijezim, shkallë hipsometrike të ngjyrave etj.



Hidrografia paraqitet me **ngjyrë të kaltër**. Rrjedhat ujore, liqenet dhe detet paraqiten në shkallë të zvogëluar pa humbur formën e tyre. Përveç rrjedhave ujore, në harta paraqiten edhe burimet (me anë të pikës), rrjedhat e përkohshme (me vijë të kaltër të ndërprerë), ujërat nëntokësore etj.


Vegjetacioni paraqitet me **ngjyrë të gjelbër**. Shpeshherë në harta të ndryshme vegjetacioni paraqitet vetëm me anë të poligonit, pa saktësuar llojin e drurëve.

Vendbanimet paraqiten në varësi të shkallës së hartës. Në harta me shkallë të madhe mund të paraqiten edhe shtëpitë me poligone të vogla. Ndërsa, në hartat me shkallë të imët vendbanimet paraqiten si një poligon i vetëm ose me anë të pikës me dimensione të caktuara, që mund të tregojë numrin e banorëve.

Infrastruktura paraqitet me anë të shenjave të ndryshme hartografike. Rrugët mund të paraqiten me vija të ndryshme, në varësi të kategorisë së rrugës. Ekziston vijë e veçantë për hekurudhën, aeroportet, antenat e komunikimit etj.



A. Pamje e relievit (terrenit)



B. Hartë me izohipse

Ekuidistanca = 20 metra

Paraqitja e relievit me vizatim, hijezim dhe shkallë hipsometrike me ngjyra

Relievi dhe mënyra e paraqitjes në hartën topografike (burimi: Lutgens et al.)

32



Ndërtimi i njohurive:

Leximi i drejtuar

Mësimdhënësi/ja drejton nxënësit në lexim, duke u parashtruar disa pyetje.

Paragrafi i parë:

1. Çka paraqesin ngjyrat në hartë (e kaltër, kafe, e gjelbër...)?

Paragrafi i dytë:

1. Cilat janë elementet matematike dhe plotësuese në hartë? (Mësimdhënësi paraqet një hartë para nxënësve).

Paragrafi i tretë:

1. Çka janë kuotat, izohipsat dhe izobatet?

Paragrafi i katërt:

1. Si paraqiten në hartë vendbanimet, kufijtë, lumenjtë? Përgjigjet diskutohen me nxënësit.




Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Organizues grafik: Tabela e konceptit

Pas leximit dhe komentimit të njësisë mësimore përmes pyetjeve dhe përgjigjeve, do të punohet në tabelë *pema e mendjes*, përmes të cilës do të paraqiten elementet e hartës të cilën do ta plotësojnë nxënësit në fletoret e tyre dhe në tabelë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen sipas përgjigjeve të sakta për renditjen, shpjegimin dhe kuptimin e ngjyrave në hartë dhe demonstrimin e relievit.

Detyrë:

Të vizatohet harta e Kosovës, të paraqitet me ngjyra relievi (malet, fushat).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan mënyrat e orientimit në natyrë (me anë të Diellit, të orës, të myshqeve, të Yllit Polar, të busullës, të objekteve fetare etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2; II.5; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Orientimi i hartës dhe orientimi në natyrë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon mënyrat e ndryshme të orientimit në natyrë;
- Demonstron njërën nga mënyrat e orientimit në natyrë (busullës).

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Busull, hartë e botës, orë me akrepa.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Matematika, Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake


Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme përmes disa pyetjeve:

1. Për çka na shërben harta?
2. Si mund ta gjejmë anën lindore të horizontit nga pozita ku jemi? Realizohet diskutim i shkurtër me nxënësit. Diskutohet me nxënësit për mënyrat e orientimit në kohët e lashta, për mjetet që janë përdorur për orientim në ato kohë dhe për mjetet që përdoren në ditët e sotme për orientim.



Orientimi i hartës dhe orientimi në natyrë


Që ta përdorim një hartë në terren, atëherë duhet ta bëjmë orientimin e saj. Orientimi i hartës nënkupton vendosjen e hartës në atë pozitë që objektet e paraqitura në hartë përputhen me objektet e paraqitura në natyrë. Orientimi i hartës është i rëndësishëm si në përdorimin civil, ashtu edhe në atë ushtarak. Njeriu, duke vërejtur dukuri dhe procese natyrore, ka krijuar njohuri rreth pozitës së tyre në raport me anën e horizontit. Psh.: Dielli lind gjithmonë në lindje e perëndon në perëndim. Në hemisferën veriore kur kulminon në zenit tregon jugu. Polet ruajnë pozitën e tyre veriore dhe jugore. **Orientimi gjeografik** ka të bëjë me gjetjen e verit gjeografik. Për shkak të fushës magnetike të Tokës, veriu konsiderohet drejtimi kryesor. Nëse ktheheni nga veriu, në anën e djathtë e keni lindjen, në anën e majtë perëndimin, ndërsa prapa e keni jugun. Veriu mund të përcaktohet me objekte apo fenomene në natyrë, hartë apo busull. **Busulla** orientohet me anë të fushës magnetike të Tokës. Gjilpëra në busull gjithmonë tregon veriu magnetik.




Orientimi topografik bëhet përmes topografisë së relievit dhe paraqites së tyre në hartë. Zakonisht bëhet për orientim më të saktë, duke gjetur objektet më të dallueshme.



Orientimi taktik përdoret në sport, ekspedita, ushtri etj. Ky orientim bëhet për të vlerësuar lokacionin tuaj (pozitën) në raport me detyrat dhe aktivitetet e paracaktuara.




Orientimi me anë të Diellit



Orientimi me anë të Yllit Polar

Anët e horizontit në natyrë mund të përcaktohen me anë të trupave qjellorë

- Dielli lind nga lindja e perëndon nga perëndimi. Në mesditë, kur Dielli është në zenit, tregon jugun. Por, bëni kujdes, sepse gjatë revolucionit, Toka merr pozitë të tillë që nga pozicioni i saktë i lindjes, mund të ndryshojë deri në 23.5 shkallë.
- Hëna i ka 4 faza. Hëna e re lind pas perëndimit të diellit dhe duket në perëndim. Katërshja e parë del në orën 12:00 dhe në orën 18:00 ndodhet në jug. Hëna e plotë del në lindje dhe më së miri duket pas perëndimit të diellit. Katërshja e fundit së pari duket në mesnatë në lindje, kurse rreth orës 6:00 është në jug.
- Ylli polar shihet gjatë natës. Ai nuk e ndërron pozitën e tij dhe gjendet në veri. Ndodhet mbi Polin Verior dhe shihet vetëm nga hemisfera veriore. I takon njësisë së Arushës së Vogël.



Orientimi me anë të orës (burimi: Markoski, 2016)



Orientimi me anë të trungjeve (burimi: Markoski, 2016)

Orientimi me anë të orës bëhet duke përdorur orë me tregues (akrepa). Treguesi i vogël orientohet kah Dielli. Simetralja në mes treguesit të orës në atë moment dhe orës 12:00 tregon jugun. Dielli për një orë lëviz 15° . Andaj, nëse është ora 15:00, atëherë treguesi ka lëvizur për $3 \times 15^\circ = 45^\circ$.

Orientimi me anë të **rathëve në trungje** bëhet duke vrotuar gjerësinë e rathëve. Rrathët janë më të dendur kah veriu dhe më të rrallë nga jugu. Lëvorja e drurëve është më e vrazhdë nga veriu, degët e drurëve janë më të shpeshta nga jugu për shkak të erës veriore etj.

Gjithashtu, në natyrë mund të orientohemi edhe me anë të objekteve fetare, përfshirë xhaminë, kishën etj.

35



Ndërtimi i njohurive:
Ditari dypjesësh

Mësimdhënësi ndan tabelën në dy shtylla. Në shtyllën e parë shënon disa fjalë kyçe dhe përshkrimin në shtyllën e dytë për këto fjalë kyçe.

Fjalët kyçe	Komentimi
Orientimi i hartës	Vendosja e hartës në pozitë që objektet në hartë të përputhen me objektet në natyrë.
Llojet e orientimit	Orientimi gjeografik, topografik, taktik.
Busulla	Mjet që përdoret për orientim.
Mënyrat e orientimit	Orientimi me Diell, me Yllin Polar, me Hënë, me busull, me hartë, me orë, me rrrathët e trungjeve, objekte fetare; xhami, kisha, GPS.



Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënësve:
Shqyrtim i përbashkët

Bëhet përmbledhje e përbashkët për njohuritë e fituara gjatë leximit/komentimit dhe para nxënësve demonstron si bëhet orientimi i hartës, demonstron po ashtu gjetja e anëve të horizontit përmes busullës.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve në identifikimin dhe demonstrimin e mënyrave të orientimit në hartë dhe përdorimin e busullës.

Detyrë:

Praktikoni në shtëpi mënyrat e orientimit përmes Diellit, orës me akrepa, trungjeve të drunjve.

Reflektim për rrezjedkën e orës mësimore:

Mësimi 12

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan mënyrat e orientimit në natyrë (me anë të Diellit, të orës, të myshqeve, të Yllit Polar, të busullës, të objekteve fetare etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2; II.5; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Aktivitet: Orientimi në natyrë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Demonstron mënyrat e orientimit në natyrë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Busull, hartë, orë me akrepa, GPS, telefon.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit


Diskutim për njohuritë paraprake

Organizohet përsëritje e njësive mësimore “Orientimi i hartës dhe orientimi në natyrë”. Rikujtohen mënyrat e orientimit në natyrë, mjete që mund të përdoren.


Orientimi i hartës dhe orientimi në natyrë

Çka nënkupton orientimi i hartës dhe çka nënkupton orientimi në natyrë?

Plotëso në fjalëkryq tri llojet e orientimit:




Shkruaj anët e horizontit, duke u bazuar në këndin nga veriu:



20

Cilat objekte janë përzgjedhur për orientim topografik dhe pse?



Shënonianët e horizontit në trungun e paraqitur.



21



Ndërtimi i njohurive:

Veprimtari praktike me nxënësit në oborrin e shkollës

Nxënësit dalin në oborrin e shkollës dhe demonstrojnë disa mënyra të orientimit në natyrë.

Për këtë aktivitet janë të nevojshme disa mjete për orientim, si: busull, orë me akrepa, GPS, telefon.

Përpara se të fillojnë demonstrimin jepen disa udhëzime paraprake.



Përforsimi:

Konsolidimi i të nxënët:

Pas përfundimit të aktivitetit, nxënësit do të bëjnë një përmbledhje dhe më pas plotësojnë fletoren e punës, faqe 20 dhe 21.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për orientimin e saktë që kanë arritur ta demonstrojnë në mënyrat e orientimit gjatë aktivitetit.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 13

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultati i të nxënit të temës:

Përcakton vendndodhjen absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-4; II-5,6; III-1,3,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre. 2.2

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përcaktimi i vendndodhjes në hartë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Demonstron me anën e GPS-it identifikimin e një pike (vendi), sipas koordinatave gjeografike në mjedis.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti “Gjeografia 6” - Dukagjini, atlas gjeografik, fletë A4, mjete shkrimi, GPS ose telefon i mençur.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Teknologjia; Globalizimi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Rrjeti i diskutimit

Fillon diskutimi me nxënësit për anijen Titanik.

Pyetje për diskutim:

- Si mundemi sot të kuptojmë vendndodhjen e një anijeje që mund të fundoset, si rasti i Titanikut, përderisa uji nuk mban objekte në sipërfaqe në të njëjtin vend si shenjë për lokalizim?
- Pse përdoret rrjeti shkallëzor gjeografik në këtë rast (ndërlidhje me njësitë paraprake)?
- Tregoni nga një shembull kur ju ose një familjar ka përdorur GPS ose telefon të mençur për nevoja gjeografike.



Pyetje dhe detyra



1. Çka është orientimi i hartës dhe çka nënkuptoni me orientim në natyrë?
2. Tregoni disa mënyra si t'i gjeni anët e horizontit në natyrë.
3. Së bashku me mësimdhënësin, dilni në oborr të shkollës dhe ushtroni format e mundshme të orientimit.



Përcaktimi i vendndodhjes në hartë

Gjatë përdorimit të hartës në jetën e përditshme, është me rëndësi të dini vendndodhjen tuaj. Duke e ditur vendndodhjen tuaj, ju mund të lëvizni deri në destinacionin e kërkuar përmes hartës. Së pari, duhet të bëhet orientimi i hartës, ku bëhet përputhja e objekteve që janë në hartë me objektet respektive në natyrë. Pasi të bëhet orientimi i hartës, duhet të gjendet vendndodhja. Përcaktimi i vendndodhjes në hartë nënkupton gjetjen e pozicionit tonë të saktë në natyrë.

Përcaktimi i pikës së vendqëndrimit (vendndodhjes) bëhet duke shfrytëzuar hartën e terrenit që jeni duke e vrojtuar. Mënyrat kryesore të gjetjes së vendndodhjes janë: *me anë të krahasimit të vendit përreth me përmbajtjen e hartës, me matjen e rrugës së kaluar nga një objekt i njohur, me prerje, GPS etj.*



Përcaktimi i vendndodhjes në hartë (burimi: Markoski, 2016)



GPS dore

Përcaktimi i vendqëndrimit përmes matjes së rrugës së kaluar bëhet kur rruga është e paraqitur në hartë dhe njihet lehtë në natyrë. Pastaj bëhet matja e rrugës së kaluar nga pika e nisjes.

Përcaktimi i vendndodhjes bëhet sipas prerjes së drejtëzave të tërhequra prej objekteve që paraprakisht janë identifikuar në natyrë dhe hartë. Kjo mënyrë quhet me **prekje prapa**. Identifikohen tri objekte në natyrë dhe të njëjtat në hartë. Tërhiqen drejtëzat për objektet në natyrë dhe hartë. Pika ku priten drejtëzat është vendndodhja juaj.

Me përdorimin e pajisjeve teknologjike është e mundur të caktohet vendndodhja në hartë. Së pari harta duhet të ketë rrjetin e shënuar të koordinatave. Pastaj, me një pajisje **GPS (Sistem i Pozicionimit Global)** merren koordinatat nga satelitet, të cilat pastaj gjenden në hartë. Përmes telefonave të mençur (smartphones), mund të aktivizoni lokacionin dhe në hartë do t'ju shfaqet vendndodhja juaj.



Ndërtimi i njohurive:

DLTA

Udhëzohet njëri nga nxënësit ose lexon vetë me zë pjesën e njësisë (paragrafin). Kur përfundon leximi i paragrafit, diskutohet për atë se çka u lexua. Pas këtij leximi, nxënësve iu shtrohen pyetjet varësisht nga natyra e përmbajtjes:

- Identifikoni mënyrat kryesore të gjetjes së vendndodhjes.
- Si bëhet përcaktimi i vendqëndrimit përmes matjes së rrugës së kaluar?

Hapa të njëjtë merren edhe te leximi i pjesës/paragrafit 2, 3...

Në fund pyeten nxënësit: A mundet shoqëria njerëzore të zhvillohet pa rrjetin e koordinatave gjeografike?



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Misioni

Paraqiten disa objekte rreth shkollës dhe një plan, hartë... si dhe një telefon të mençur (një për secilin grup pune) me aplikacion GPS. Detyra e nxënësve është që të identifikojnë objektin, të marrin shënimet e

koordinatave gjeografike nga objekti që ka selektuar (shënuar) mësimdhënësi në hartë (plan).

Në planin e punës së nxënësve (hartën e misionit), formo një hapësirë që të jetë pjesa vlerësuese, duke lënë hapësirën për vendosjen e notës për arritjet e tyre (vlerësim).

Detyrë në grup:

- Gjeneroni koordinatën gjeografike të lapidarit të shkollës (G1);
- Përshkruani pozicionin gjeografik të sheshit të shkollës;
- Në planin e punës (hartën) caktoni anët e horizontit në skajet e saj.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të demonstrimit dhe aplikimit të teknologjisë për orën.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 22.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultati i të nxënit të temës:

Përcakton vendndodhjen absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime: Përcaktimi i vendndodhjes në hartë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon anët e horizontit;
- Përcakton vendndodhjen e fshatit/qytetit ku jeton në hartën e Kosovës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta e Kosovës, atlas gjeografik, fletë të printuara me hartën e fshatit apo qytetit ku gjendet shkolla.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Rikujtim i njohurive paraprake

Bëhet përsëritje të njësisë mësimore “Përcaktimi i vendndodhjes në hartë”. U rikujtohet nxënësve se si bëhet orientimi i hartës në natyrë, si bëhet përcaktimi i pikës së vendqëndrimit/vendndodhjes në hartë.

Përcaktimi i vendndodhjes në hartë


Orientimi i hartës nënkupton përputhjen e objekteve që janë në hartë me objektet respektive në natyrë. Pasi të bëhet orientimi i hartës, duhet të gjendet vendndodhja. Përcaktimi i vendndodhjes në hartë nënkupton gjetjen e pozicionit tonë të saktë në natyrë.

Përcaktimi i pikës së vendqëndrimit (vendndodhjes) mund të bëhet në disa mënyra. Harta duhet të jetë e terrenit ku vrojtohet.

Mënyrat kryesore të gjetjes së vendndodhjes janë: me anë të krahasimit të vendit përreth me përmbajtjen e hartës, me matjen e rrugës së kaluar nga një objekt i njohur, me prerje prapa, me prerje anash, me GPS etj.

Detyrë:

Shihni vendndodhjen e dy personave në skicën e mëposhtme. Përcaktoni vendndodhjen e tyre në hartë (shënoni X).



Përcaktimi i vendndodhjes në hartë


Orientimi i hartës nënkupton përputhjen e objekteve që janë në hartë me objektet respektive në natyrë. Pasi të bëhet orientimi i hartës, duhet të gjendet vendndodhja. Përcaktimi i vendndodhjes në hartë nënkupton gjetjen e pozicionit tonë të saktë në natyrë.

Përcaktimi i pikës së vendqëndrimit (vendndodhjes) mund të bëhet në disa mënyra. Harta duhet të jetë e terrenit ku vrojtohet.

Mënyrat kryesore të gjetjes së vendndodhjes janë: me anë të krahasimit të vendit përreth me përmbajtjen e hartës, me matjen e rrugës së kaluar nga një objekt i njohur, me prerje prapa, me prerje anash, me GPS etj.

Detyrë:

Shihni vendndodhjen e dy personave në skicën e mëposhtme. Përcaktoni vendndodhjen e tyre në hartë (shënoni X).



22



Ndërtimi i njohurive:

Veprimtari praktike: demonstrim në hartë

Gjatë kësaj ore mësimore demonstrohen disa mënyra të përcaktimit të vendndodhjes në hartë.

Fillohet duke gjetur vendndodhjen e fshatit/qytetit ku jemi në hartën e Kosovës (duhet përdorur atlasin gjeografik secili nxënës që të ketë mundësi ta realizojë këtë aktivitet).

Mësimdhënësi mund t'i sjellë në klasë në fletë të printuar hartën e fshatit/qytetit ku ndodhet shkolla, të shpërndajë te secili nxënës dhe të kërkojë nga ta që të gjejnë vendndodhjen e shkollës në hartë.

Po ashtu, demonstron edhe përcaktimi i vendndodhjes brenda klasës.



Përforsimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Gjatë kësaj pjese të orës së mësimit plotësohet fletorja e punës në faqen 22.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e orientimit sipas anëve të horizontit dhe përcaktimit të vendndodhjes në hartë dhe në klasë.

Detyrë:

Reflektim përvojën e orës mësimore:

Mësimi 15

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Diferencon shtresat e brendshme të Tokës përmes veçorive tipike të secilës prej tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-2,4; II-6,7; III-5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
RNF: 2. Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre. 2.2

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përbërja dhe struktura e Tokës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Analizon strukturën e brendshme të Tokës, specifikat për pjesët kryesore të saj.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti “Gjeografia 6-Dukagjini”, atlas gjeografik, fletë A4, mjete shkrimi, projektor, TV.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Fizika.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Stuhi mendimesh

Videoprezantim - Struktura e brendshme e Tokës

<https://www.youtube.com/watch?v=eXiVGEEPO6c>

Diskutohet rreth asaj që është paraqitur në videoprezantim:

- Çfarë mendimi keni për vullkanet nga ajo që shikuat?
- Si ka qenë Toka në të kaluarën?


PËRBËRJA DHE STRUKTURA E TOKËS

Përbërja dhe struktura e Tokës

Shkencëtarët marrin informacione për brendinë e Tokës nga vëzhgimet dhe hulumtimet e ndryshme në natyrë. Vullkanet aktive tregojnë çka ndodhet nën koren e Tokës. Shkëmbinjat e ndryshëm, që i vëzhgojmë përgjatë rrugëve, grykave e luginave lumore, tregojnë se si janë krijuar sedimentet për mijëra e miliona vjet. Me shpime të ndryshme mund ta studiojmë përbërjen e pjesës së sipërme të kores së Tokës. Përveç vëzhgimeve të ndryshme në natyrë (terren), shkencëtarët bëjnë eksperimente laboratorike për të kuptuar ndërtimin dhe përbërjen e Tokës.

Me anë të studimeve është konstatuar se Toka përbëhet nga disa shtresa të brendshme (gjeosfera), të cilat kanë trashësi, përbërje dhe veti fiziko-kimike të ndryshme. Shtresat e brendshme të Tokës janë: **bërthama**, **mbështjellësi i bërthamës (manteli)** dhe **korja e Tokës (litosfera)**.

Litosfera është pjesa më e skajshme (periferike) e Tokës. Ajo shtrihet deri në 70 km thellësi. Është e ftohtë, e ngurtë dhe e brishtë. Vetëm pjesa e ngurtë quhet kore e Tokës dhe ka trashësi prej 8 km deri në 40 km. Përfshin vetëm 1% të Tokës. Nën oqeanë është më e hollë (deri 8 km), ndërsa në kontinentë më e trashë (50-60 km). Ndryshe quhet SIAL (silic+alumin).



39



Mbështjellësi i Tokës apo manteli ndodhet ndërmjet kores së Tokës dhe bërthamës. Shtrihet deri në 2,900 km thellësi. Është i ngurtë dhe përbëhet nga hekuri e magnezi. Në pjesën e sipërme ndodhet astenosfera, ku e ka burimin lava e vullkaneve. Ndryshe quhet **Silica** (silic+magnez).

Bërthama është pjesa qendrore e Tokës. Shtrihet nga manteli deri në qendër të Tokës. Dallohet bërthama e brendshme dhe e jashtme. Bërthama përbëhet nga hekuri dhe nikeli (ndryshe quhet NIFE), nga e cila lind fusha magnetike e Tokës. Fusha magnetike e Tokës na mbrojnë nga stuhitë diellore.

Temperatura ndryshon duke shkuar në drejtim të qendrës së Tokës. Në sipërfaqe, temperatura në sipërfaqe të Tokës zvogëlohet deri në brezin e temperaturës konstante. Ndërsa, nga brezi i temperaturës konstante, temperatura rritet për 1°C çdo 33 metra thellësi. Kjo dukuri quhet **gradient gjeotermik**. Në thellësi prej 35 km temperatura e Tokës është 400-700 °C, kurse në qendër të Tokës vlerësohet të jetë 4,700 °C deri në 5,500 °C.



A E DINI SE

Shpimi më i thellë i bërë në Tokë është rreth **12,345 metra** (0.2% të rrezes së Tokës). Ndodhet në Katar (Lindja e Mesme) dhe është bërë për hulumtimin e nafesë.



Pyetje dhe detyra

1. Krijoni një tabelë ku do t'i shënoni veçoritë e gjeosferave të Tokës.
2. Çfarë roli luan fusha magnetike e Tokës?

40




Ndërtimi i njohurive:

Organizues grafik: Pema e mendimeve

Mësimdhënësi, vizaton hartën e të pyeturit për kuptimin e ndërtimit strukturor të Tokës.

Pasi që lexohet teksti, kërkohet që në formën e mendimeve të formohet “organizues grafik” me në qendër “Struktura e brendshme e Tokës”.



“Pema e mendimeve” bazohet kryesisht në disa kërkesa që parashtrihen. Prej sa shtresash përbëhet struktura e Tokës; gradienti termik, manteli, bërthama?



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Tabela e tipareve semantike

Në tabelën e paraqitur plotësohen karakteristikat e përgjithshme duke analizuar gjeosferat e brendshme të Tokës: Detyra: Plotëso tabelën duke përkrahur specifikat për secilën shtresë.

Gjeosfera	Thellësia (km)	Karakteristikat
Korja e Tokës		
Manteli		
Bërthama		

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, saktësinë e analizës dhe të detyrave si dhe bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 23-24.

• *Reflektim përvojën e orës mësimore:*

Për mësimdhënësin/en

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VI
Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:
 Shpjegon veçoritë e shkëmbinjve (magmatikë, sedimentarë dhe metamorfikë), kushtet e formimit të tyre dhe identifikon vetitë fizike të mineraleve dhe përdorimet e tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I-2,6; II-1,7; III-3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 RNF: 2. Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre. 2.2

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mineralet dhe shkëmbinjët

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon vetitë kryesore të mineraleve dhe përhapjen e tyre në rruzullin Tokësor.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti “Gjeografia 6-Dukagjini”, atlas gjeografik, fletë A4, mjete shkrimi, projektor, TV.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Fizika, Kimia.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Stuhi mendimesh

Parashtrihen pyetje që të nxënësit ngritin interesim dhe janë të hapura.

- Cilat janë pasuritë e nëntokës?
- Cilat pasuri nëntokësore i njihni?
- Si do t'i quani ndryshe këto pasuri nëntokësore?




Depozitime të argjilës, rërës, zhavorrit në breg të lumit

Me origjinë **organike** janë edhe lëndët djegëse, sikurse nafta dhe qymyret. Ndryshe nga shkëmbinjtë e tjerë organogjenë, te qymyret mund të dallohen mbetjet e drurëve. Qymyret formohen nga varrosja (groposja) e mbetjeve drunore, të cilat, nën ndikimin e temperaturës dhe presionit, shndërrohen në shkëmbinj. Janë disa lloje, si: *torfa, linjiti, qymyri i murrmë, antraciti*.

Shkëmbinjtë metamorfikë krijohen nga ndikimi i temperaturës dhe presionit në shkëmbinjtë ekzistues. Në këtë mënyrë ndryshon pamja dhe përbërja e shkëmbinjve, duke u krijuar shkëmbinj metamorfikë. Shkëmbinjtë metamorfikë më të njohur janë: *rëshpet argjilore, gnejsi, filiti, kuarciti, mermeri* etj.



Gnejsi Filiti Kuarciti Mermeri
Disa shkëmbinj metamorfikë



Pasi ta lexoni mësimin për shkëmbinjtë, plotësoni tabelën me llojet e shkëmbinjve sipas origjinës së tyre:

Shkëmbinjtë magmatikë	Shkëmbinjtë sedimentarë	Shkëmbinjtë metamorfikë

43

Mësimdhënësi, nëse ka në klasë fotografi ose projektor, paraqet disa minerale të njohura..

Komentet shkurtimisht përshkruhen në tabelë dhe diskutohen së bashku.



Ndërtimi i njohurive:

Të nxënëet me këmbime: Grupet e ekspertëve

Nxënësit ndahen në pesë grupe, ku secili nxënës ka një numër: 1, 2, 3, 4.

Mësimdhënësi/ja i jep secilit grup nga një detyrë të caktuar dhe punojnë, duke u bërë ekspertë të çështjes për të cilën janë caktuar.

Grupi 1

- Çka quajmë minerale?
- Sa minerale ekzistojnë?
- Cilat janë vetitë fizike të mineraleve?

Grupi 2

- Si i ndajmë shkëmbinjtë për nga origjina?
- Si i kemi ndarë shkëmbinjtë sedimentarë?
- Çka quajmë magmë?

Grupi 3

- Si janë formuar shkëmbinjtë sedimentarë mekanikë?
- Cilat janë shkëmbinjtë sedimentarë kompaktë?
- Plotëso tabelën me lloje shkëmbinjsh.

Grupi 4

- Cilët janë shkëmbinjtë sedimentarë me origjinë kimike?
- Cilat janë llojet e qymyreve?
- Si formohen shkëmbinjtë metamorfikë?

Prezantimi bëhet në grup vlerësohet puna individuale e grupit.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Të nxënëet me këmbime: Grupet e ekspertëve

Pasi kryejnë detyrën në grupet e reja që janë krijuar me njëshet, dyshet dhe treshet e kështu me radhë, kthehen dhe riformohen grupet bazë, në të cilat çdo nxënës ka një detyrë specifike të cilën do ta prezantojë. Të gjithë së bashku marrin pjesë me pyetje dhe komente.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 24-25.

Reflektim për veprimet e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VI
Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:
 Përshkruan ndarjen e kohës gjeologjike në era, periudha dhe epoka, duke dhënë veçoritë kryesore të secilës prej tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-1,2; II-1,6; III-3,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 RNF: 2. Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre. 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zhvillimi gjeologjik i kores së Tokës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon kronologjinë gjeologjike të Tokës sipas rëndësisë;
- Veçon periudhën kryesore të njerëzimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti “Gjeografia 6-Dukagjini”, fletore pune, atlas gjeografik, fletë A4, mjete shkrimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Rrjeti i diskutimit

Mësimdhënësi prezanton përpara nxënësve një video, ku paraqitet zhvillimi gjeologjik i Tokës. Bën një shpjegim përmbledhës rreth zhvillimit gjeologjik të Tokës. Pas prezantimit, formohet një diskutim mbi atë që u prezantua. Bisedë e lirë mes nxënësve dhe mësimdhënësit. <https://www.youtube.com/watch?v=QDqskltCixA>


Zhvillimi gjeologjik i kores së Tokës

Deri më tani, me të gjitha njohuritë nga astronomia, Toka është i vetmi vend në univers në të cilin zhvillohet jeta, që e bën planetin tonë unik në Sistemin Diellor dhe më gjerë. Moshë e Tokës vlerësohet të jetë rreth 4.6 miliardë vjet. Në fillim, Toka ishte një trup i zjarrtë, nuk kishte atmosferë e hidrosferë të përshtatshme.

Gjatë zhvillimit historik të Tokës kanë ekzistuar kushte të ndryshme. Nga një trup i zjarrtë, Toka filloi të ftohej dhe të ofronte kushte më të mira për jetë. Në fillim ka pasur organizma njëqelizorë (të thjeshtë), ndërsa organizmat më të komplikuar u paraqitën më vonë.



Lëvizja e kontinenteve gjatë zhvillimit gjeologjik të Tokës (burimi: Getis et al, 2014)



Historia e zhvillimit të Tokës i njeh tri era të zhvillimit të saj: **paleozoike, mezozoike dhe kenozoike.**

Gjatë **erës paleozoike**, dominonte bota e gjallë që jetonte në ujë, tek në fund të saj kemi organizmat shtazorë që jetojnë në Tokë. Edhe kontinentet nuk kanë pasur pozitë e sotme. Në fillim mbizotëronte oqeani. Kontinentet u bashkuan duke formuar një **superkontinent** (Pangaea). Pastaj filluan të ndaheshin. Edhe sot kontinentet lëvizin. Gjatë zhvillimit të Tokës u krijuan edhe format më të mëdha të relievit, duke filluar me malet, fushat e forma të tjera.

Gjatë **erës mezozoike**, u paraqitën dinozaurët, zogjtë e parë. Kjo erë mbaron me zhdukjen e dinozaurëve dhe krijesave të tjera.

Era kenozoike është era më e re. U shfaqën gjitarët, të cilët sot janë dominues në Tokë. U paraqitën bimët farëveshura, që shërbejnë si ushqim për zogj dhe gjitarë të ndryshëm. Barishtet u përhapën shumë duke mbuluar fushat. Kontinentet filluan të merrnin formën aktuale. U krijuan malet më të larta në Tokë: Himalajet, Alpet, Malet Shkëmbore. Andet etj. Në këtë kohë, në Tokë u paraqit edhe njeriu.

44 Zhvillimi gjeologjik i Tokës (burimi: Geology Insider)



Ndërtimi i njohurive:

Ditari dypjesësh

Arsimtari udhëzon nxënësit që të lexojnë tekstin në heshtje.


Derisa nxënësit lexojnë, arsimtari shënon në tabelë disa pyetje ku nxënësit pas leximit i plotësojnë me ato fragmente që mendojnë se e plotësojnë pyetjen e parashtruar.

Pyetje	Komente (fragmente nga teksti)
1. Sa është moshja e Tokës?	Rreth 4.6 miliardë vjet
2. Në cilën erë u krijuan malet më të larta në Tokë?	Në erën Kenozoike
3. Pse era Kenozoike njihet si era gjeologjike më me rëndësi në Tokë?	U paraqitën gjitarët që sot janë dominues në Tokë. U krijuan malet më të larta në Tokë: Himalajet, Alpet, Malet Shkëmbore, Andet etj.
4. Cilat ngjarje parashihen të kenë ndodhur në erën mezozoike?	Gjatë erës mezozoike u paraqitën dinozaurët, zogjtë e parë. Kjo erë mbaron me zhdukjen e dinozaurëve dhe të krijesave të tjera.
5. Ç'kuptoni me lëvizje epirogjene? etj.	Janë lëvizje shumë të ngadalshme dhe krijohen për shkak të ndryshimeve tektonike dhe klimatike.



Fosil dinozauri i gjetur në Meksikë

Historia më e re e zhvillimit gjeologjik të Tokës njihet si **periudha e kuaternarit**, që përfshin 2.5 milionë vitet e fundit. Ajo ndahet në pleistocen dhe holocen. Gjatë **pleistocenit** (2.5 milionë vjet më parë deri 12 mijë vjet më parë), klima në Tokë ishte më e ftohtë dhe kontinentet ishin të mbuluara me akullnaja. Ndërsa, në Kosovë pjesa më e madhe e maleve ishte e mbuluar nga akullnajat, gjë që dëshmohet nga pranira e cirqeve, luginave akullnajore, morenave etj. **Holoceni** është epoka më e re e zhvillimit historik të Tokës. Përfshin 12 mijë vitet e fundit. Gjatë kësaj epoke akullnajat u shkrinë duke u krijuar sipërfaqe të reja tokësore, që më vonë u pushtuan nga njerëzit; u paraqitën civilizimet njerëzore që kulmuan me zhvillimin teknologjik dhe jetën urbane.



Shembull i krijimit të fosileve të dinozaurëve

1. Kafshët ngordhin
Rreth 66 milionë vjet më parë, një dinozaur ngordhi dhe trupi i tij ra në një liqen.

2. Skeleti groposet
Balta e mbuloi trupin e tij para se të shkatërrohej tërësisht ose para se ta hanin kafshë të tjera.

3. Eshtrat kthehen në fosile
Përgjatë miliona vjetësh, balta u shndërrua në shkëmb dhe eshtrat e groposura u bënë fosile.

45



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Diskutim i përbashkët

Punë individuale dhe e pavarur në formën e diskutimit dhe të prezantimit me hartë.

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit në formën e pyetjeve që të diskutojnë në klasë:

- Si u ndërtua Venediku?
- Çka ka ndodhur me qytetin ku mungojnë rrugët, por të shumtë janë gondolierët?

Mësimdhënësi në letra ngjithëse shënon emrat e sistemeve malore, ku kërkon nga nxënësit që i përzgjedh t'i ngjisin në hartën (vendin e caktuar).

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 25.

Reflektim për veprimtarinë e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan format relievore, llojet dhe shkaktarët e krijimit, format e krijuara nga forcat e brendshme dhe nga forcat e jashtme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.3,5; II.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Formimi i relievit në Tokë - Lëvizjet epirogjene dhe orogjene

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan mënyrat e formimit të relievit;
- Analizon ndryshimet në mes të lëvizjeve epirogjene dhe orogjene.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë e botës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Stuhi mendimesh

Kërkohet nga nxënësit të tregojnë se cilat forma të relievit ndodhen në vendbanimin e tyre. Si mendoni se janë të krijuara këto forma? Etj.



Formimi i relievit në Tokë


Relievi paraqet të gjitha format e ngritura dhe të zbritura që ndodhen në sipërfaqe të Tokës dhe afër saj, të krijuara nga veprimi i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Relievi i Tokës krijohet në kontaktin në mes litosferës, hidrosferës e atmosferës, madje disa forma edhe nga veprimi i organizmave të gjallë.

Pamja e kontinenteve që shohim sot ka ndryshuar gjatë kohës dhe do të ndryshojë në të ardhmen. Disa forma ndryshojnë më shpejt e disa më ngadalë.

Në përgjithësi, relievi i Tokës formohet nga faktorët tektonikë, litologjikë dhe erozivë. Prandaj, dallojmë forma strukturore-tektonike dhe forma gjenetike.

Format strukturore krijohen nga veprimi i lëvizjeve të ndryshme tektonike të tipit rrudhosës e zhvendosës, pastaj nga vullkanet e tërmetet.

Ndërsa, **format gjenetike** krijohen nga veprimi i faktorëve, siç janë: lumenjtë, era, akullnajat, valët e detit, tretja e shkëmbinjve karbonatikë, të cilë janë emërtuar, si: reliev fluvial (*lumenor*), eolik (*i erës*), glacial (*akullnajor*), abraziv (*i valëve të detit*), karstik (*në shkëmbinj të tretshëm*) etj.



Lëvizjet epirogjene dhe orogjene

Në bazë të karakterit të lëvizjeve dhe pasojave në koren e Tokës, lëvizjet tektonike ndahen në dy lloje: **luhatëse (vertikale)** ose **epirogjenike (kontinentformuese)** dhe **shformuese ose orogjenike (malformuese)**. Sot, këto lëvizje shpjegohen me anë të teorisë së tektonikës së pllakave.



Si u ndërtua Venediku? Çka ka ndodhur me qytetin ku mungojnë rrugët, por të shumta janë gondolat?

Lëvizjet luhatëse (epirogjenike) janë lëvizje shumë të ngadalshme dhe krijohen për shkak të ndryshimeve tektonike dhe klimatike. Në disa pjesë të Tokës niveli i detit bie dhe del tokë e re në sipërfaqe. Avancimi i nivelit të detit quhet **transgresion**, ndërsa tërheqja e nivelit të detit quhet **regresion**. Shembuj të tillë kemi Holandën, Venedikun etj.

Lëvizjet orogjene (shformuese) janë lëvizje kryesisht horizontale. Janë shkak kryesor i rrudhosjes së shkëmbinjve, zhvendosjeve tektonike (mbihijje, shkëputje, fundosje) etj. Pasojë e lëvizjeve shformuese janë krijimi i zonave të rrudhosura, sikurse malet: Alpet e Evropës, Kordileret, Himalaja, Alpet Shqiptare etj.



Spas disa studimeve, Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna ngrihen për 6-8 mm/vit. Për mijëra e miliona vjet, i kanë krijuar malet në këto lartësi. Por, mos harroni se malet përfshihen edhe nga erozioni, i cili tenton t'i rrafshojë ato.

Edhe në ditët e sotme, pjesë të Tokës lëvizin duke krijuar lëvizje **neotektonike (të reja)**. Këto lëvizje syri i njeriut nuk mund t'i hetojë, ngaqë janë shumë të ngadalshme. Por, në periudhë më të gjatë kohore, ato mund të vërehen. Shembuj të tillë janë: tempulli i Serapisë (Itali), Butrinti dhe Durrësi (Shqipëri) etj.



Pyetje dhe detyra

1. Cilët janë faktorët kryesorë në krijimin e relievit në Tokë?
2. Shpjegoni lëvizjet epirogjene dhe orogjene.
3. Çka ndodh me format aktuale të relievit?

47



Ndërtimi i njohurive:

Ditari dypjesësh

Ndahet tabela në dy shtylla. Në shtyllën e parë shënon disa fjalë kyçe dhe përshkrimi në shtyllën e dytë për këto fjalë kyçe.

Fjalët kyçe	Komentimi
Relievi	Relievi paraqet të gjitha format e ngritura dhe të zbritura që ndodhen në sipërfaqen e Tokës.
Format strukturore	Krijohen nga lëvizjet tektonike.
Format gjenetike	Krijohen nga faktorët e jashtëm.
Lëvizjet epirogjene	Janë lëvizje të ngadalshme, nga të cilat pjesë të Tokës mund të fundosën ose të ngriten.
Lëvizjet orogjene	Janë lëvizje nga të cilat ndodh rrudhosja e shkëmbinjve dhe krijohen malet e rrudhosura.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Demonstrim në hartë

Nxënësit ushtrohen të gjejnë në hartën e botës malet të cilat janë krijuar nga lëvizjet orogjene (malformuese).

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për anagazhimin gjatë orës së mësimi, saktësinë në formimin e relievit dhe analizën e lëvizjeve si edhe punën në hartë.

Detyrë:

Pyetjet dhe detyra, faqe 47.

Reflektim për rrjedkën e orës mësimore:

Mësimi 19

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan format relievore, llojet dhe shkaktarët e krijimit, format e krijuara nga forcat e brendshme dhe nga forcat e jashtme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.3, 5; II.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Strukturat tektonike

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan format relievore të krijuara me anë të rrudhosjes;
- Bën dallimin në mes të horstit dhe grabenit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë e botës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Diskutohet për njohuritë e mëparshme, përmes disa pyetjeve:


1. Çka është relievi?
2. Si u krijua relievi i Tokës?
3. Cilat forma të relievit i njihni?
4. Si u krijuan kontinentet dhe malet? Etj.

Strukturat tektonike

Shkëmbinjtë në koren e Tokës, pavarësisht origjinës së tyre, u nënshtrohen deformimeve të ndryshme, të cilat ndodhin nga veprimi i fuqive të brendshme. Si rezultat i veprimit të forcës në tërheqje apo në shtytje, ndodhin deformimet e tipit zhvendosës dhe rrudhosës, duke krijuar zhvendosje tektonike e rrudha të shkëmbinjve.

Rrudhat janë shformime në trajtë valore, ku shkëmbinjtë lakohen, por ruajnë vazhdimësinë e tyre. Dy tipat kryesorë të rrudhave janë: *rrudha antiklinale* dhe *sinklinale*.

Nga rrudhosja dhe zhvendosja e shkëmbinjve janë krijuar malet, në veçanti malet e reja. Andaj, malet e tilla quhen *malet e rrudhosura*. Janë malet e reja, të larta e të thepsura dhe i takojnë orogjenezës alpine. Malet e tilla në Tokë janë: **Alpet, Himalajet, Andet e Malet Shkëmbore, Atlasi, Hindokushi, Pamiri** etj., ndërsa në Kosovë: **Malet e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna** etj.



Përveç rrudhosjes, shkëmbinjtë nën ndikimin e fuqive të brendshme zhvendosen, duke krijuar **shkëputje tektonike ose zhvendosje**.


Përveç shkëputjeve me dy blloqe në natyrë, hasen edhe lëvizjet tektonike, ku marrin pjesë dy ose më shumë blloqe tektonike. Strukturat e tilla tektonike quhen **grabene**. Nëpër grabene zakonisht formohen gropa e fushëgropa. Ndërsa, e kundërta quhet **horst** (kur një bllok i mesëm nuk ka lëvizur kundrejt dy blloqeve anësore që kanë rënë) dhe zakonisht formohen malet e vargmalet.

Mund të ndodhë që shkëmbinjtë të zhvendosen horizontalisht duke krijuar **shtytje**.

Në Kosovë, grabene janë: fushëgropa e Kosovës, e Dukagjinit, e Drenicës, e Llapit, e Anamoravës, ndërsa horste janë: mali Golesh, Çiqavicë etj.



Diskutoni në klasë me mësimdhënësin: çfarë forme strukturore-tektonike paraqesin fushëgropat në Kosovë? Çfarë forme paraqesin malet e vargmalet? Merrni shembuj konkretë.



Pyetje dhe detyra

1. Çfarë struktura krijohen me anë të lëvizjeve tektonike?
2. Tregoni çfarë janë zhvendosja tektonike, horsti, grabeni, shtytja.
3. Çfarë struktura tektonike janë malet dhe fushëgropat në Kosovë?



Ndërtimi i njohurive:

Ditari dypjesësh

Ndahet tabela në dy shtylla. Në shtyllën e parë shënohen disa fjalë kyçe, në shtyllën e dytë komentet për këto fjalë kyçe.

Fjalët kyçe	Komentimi
Rrudhat	Rrudhat janë shformime në trajtë valore.
Tipat e rrudhave	Rrudha antiklinale dhe sinklinale.
Malet e rrudhosura	Alpet, Himalajet, Andet, Malet e Sharrit etj.
Grabeni	Grabeni krijohet kur lëviz blloku i mesëm tektonik dhe krijohen gropa dhe fushëgropa.
Horsti	Horsti krijohet kur lëvizin dy blloqet anësore tektonike kundrejt bllokut të mesëm dhe krijohen malet.
Shtytja	Ndodh kur shkëmbinjtë lëvizin në drejtim horizontal.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënësve:

Rrjeti i diskutimit

Diskutohet për format strukturore tektonike të cilat gjenden në Kosovë.

Çfarë forma strukturore tektonike paraqesin fushat, malet dhe vargmalet e Kosovës?

Prezantohet figura e cila paraqet horstin dhe grabenin, në mënyrë që nxënësit të demonstrojnë të kuptuarit e këtyre strukturave tektonike dhe të bëjnë dallimin në mes tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve në përshkrimin dhe dallimin në mes të horstit dhe grabenit.

Detyrë:

Pyetje dhe detyra, faqe 49.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
 Lënda: Gjeografi
 Shkalla e kurrikulës: 3 Klasa: VI
 Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:
 Përshkruan shkaqet dhe rrjedhojat e vullkaneve, të tërmeteve dhe zonat kryesore të paraqitjes së tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,4; III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vullkanet

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan pjesët e vullkanit;
- Identifikon zonat aktive vullkanike në Tokë;
- Analizon pasojat e shpërthimeve vullkanike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Laptop, projektor/TV, hartë e botës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Fizika, Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake


Kërkohej nga nxënësit të tregojnë mendimet/njohuritë që kanë për këto dukuri natyrore. Pasi të përfundojë diskutimi, para nxënësve shfaqet një videoprezentim: <https://www.youtube.com/watch?v=O5SadaU2oYA&t=165s>, “Shpërthime masive vullkanesh të kapura në kamera”.



Vullkanet

Magma është materie e zjarrtë, e cila ndodhet në pjesën e sipërme të mantelit (astenosferë) të Tokës. Magma ka temperaturë të lartë dhe përbërje të ndryshme. Kur magma del në sipërfaqe të Tokës, quhet lavë dhe krijon vullkane.

Gjatë shpërthimit vullkanik, përveç lavës, dalin edhe lëndë të tjera, si: avuj, hi, gaze etj.



Sipas kohës së shpërthimit, vullkanet ndahen në aktive dhe të shuara. Vullkanet aktive janë vullkane që herë pas here kanë erupsione vullkanike. Koha ndërmjet erupsioneve është e ndryshme. Vullkanet e shuara janë vullkane që kanë përfunduar aktivitetin vullkanik të tyre. Në Kosovë, në Zvečan është paleokupa vullkanike, që ishte aktive miliona vjet më herët.

Sot, në Tokë, ekzistojnë rreth 1,300 kupa të njohura vullkanike, ndërsa rreth 600 prej tyre janë aktive. Mesatarisht në vit, rreth 50 vullkane shpërthejnë në Tokë.

Dalohen katër zona kryesore të përhapjes së vullkaneve: Unaza e Zjarrtë e Paqësorisht, Kurrizorja Mesoqeanike e Atlantikut, Zona Mesdhetare (Transaziatike) dhe Bregu Lindor i Afrikës.

Në kontinentin evropian, vullkanet aktive ndodhen në pjesën jugore, kryesisht në detin Mesdhe, si dhe në ishullin e Islandës. Më të njohur (aktive) janë: Etna, Vezuvi, Vulkano, Stromboli (Itali), Santorini (Greqi), Hekla (Islandë) etj.



Njerëzit jetojnë afër kupave vullkanike për shkak të përfitimeve që kanë. Hiri vullkanik është shumë cilësor, ndikon në prodhimtarinë e tokës. Në vullkane ka edhe minerale të dobishme.



Përhapja e vullkanëve në Tokë



Malet Himalajet janë vargje malet në Azi dhe ndodhen në kufijtë e dy pllakave tektonike. Vargu malor është krijuar përgjatë miliona vjetësh, duke u ndërtuar pllakat tektonike mes vete. Malet janë shpesh në rritje me rreth 5 mm/vit.



Pyetje

1. Cilat janë zonat kryesore vullkanike në Tokë?
2. Pse disa njerëz, përkundër rrezikut nga vullkanet, jetojnë afër tyre?



Ndërtimi i njohurive:

Ditari dypjesësh

Ndahet tabela në dy shtylla. Në shtyllën e parë shënon disa fjalë kyçe dhe bëjnë përshkrimin në shtyllën e dytë për këto fjalë kyçe.

Nxënësit punojnë secili në mënyrë individuale në fletoret e tyre, pastaj bëhet përshkrimi edhe në tabelë. Para nxënësve prezantohet një fotografi, në të cilën paraqitet vullkani dhe pjesët e vullkanit.

Fjalët kyçe	Komentimi /përshkrimi
Magma	Materie e zjarrtë e cila ndodhet brenda tokës.
Lava	Kur magma del në sipërfaqen e tokës quhet lavë.
Llojet e vullkanëve	Vullkane aktive dhe vullkane të shuara.
Zonat kryesore vullkanike	Unaza e Zjarrtë e Paqësorit, Kurrizorja Mesoqeanike e Atlantikut, Zona Mesdhetare dhe Bregu Lindor i Afrikës.
Vullkanet aktive në Evropë	Etna, Vezufi, Vullkano, Stromboli, Santorini.
Pasojat nga vullkanet	Shkatojnë dëme, por kanë edhe disa dobi.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënësve:

Rrjeti i diskutimit

Diskutohet së bashku me nxënësit për dëmet dhe dobiet që mund të kenë njerëzit të cilët jetojnë afër zonave vullkanike, dhe në hartë identifikojnë zonat aktive vullkanike. Diskutimi realizohet duke parashtruar pyetjen: Pse njerëzit jetojnë afër zonave ku ka vullkane aktive, edhe përkundër rreziqeve që mund t'i kenë nga vullkanet?

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve në përshkrimin, identifikimin e zonave aktive vullkanike në botë përmes hartës dhe analizën e pasojave të shpërthimeve.

Detyrë:

Hulumtoni në internet për vullkanet aktive dhe mbani shënime për to, pastaj lexohen në klasë.

Reflektim për veprimet e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan shkaqet dhe rrjedhojat e vullkaneve, të tërmeteve dhe zonat kryesore të paraqitjes së tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,4; III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Tërmetet

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan llojet e tërmeteve;
- Identifikon zonat aktive seizmike në Tokë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Laptop, projektor/Tv, harta e botës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Fizika, Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësit përshkruajnë njohuritë që kanë për këto dukuri natyrore. Pasi të përfundojë diskutimi, para nxënësve shfaqet një videoprezantim: <https://www.youtube.com/watch?v=5q0oIH7w2IE>, “Tërmetet më të frikshme në botë”.



Tërmetet

Tërmetet janë lëvizje të papritura të kores së Tokës. Tërmetet e fuqishme dëshmojnë se Toka është një sistem dinamik dhe i ndryshueshëm. Ato përfaqësojnë lirimin e energjisë në litosferën e Tokës.


Pika në të cilën lind tërmeti quhet **hipoqendër**. Tërmetet mund të përhapen në territor të gjerë, por gjithmonë kanë një pikë në të cilën lindin lëvizjet për herë të parë. Hipoqendra e tërmeteve mund të jetë nga disa kilometra deri në 700 km thellësi. Vendi në sipërfaqe të Tokës në të cilin arrin dridhja më së shpejti quhet **epiqendra** e tërmetit. Pasi të ndodhë tërmeti, lirohen valë të cilat përhapen në drejtime të ndryshme - këto quhen **valë sizmike**. Tërmeti ka para dhe pasqoditjet, fuqia e të cilave është më e vogël se e tërmetit kryesor. Tërmetet dallohen për nga magnituda dhe intensiteti.

Në varësi të fuqisë, tërmetet mund të shkaktojnë dëme materiale e dëme në njerëz.

Sipas origjinës, tërmetet ndahen në tërmete **tektonike**, **vullkanike** dhe **të vithisjeve (rëshqitjeve të mëdha)**. Përhapjen më të madhe e kanë tërmetet tektonike, me 90 % të rasteve.

Gjatë vitit, nëpër stacione sizmike regjistrohen mbi 1 milion tërmete të madhësive të ndryshme. Tërmetet regjistrohen me instrumentin e quajtur **sizmograf**.

Tërmetet janë karakteristike për rajonet e pastabilizuara në Tokë. Janë të njohura 2 zona kryesore të paraqitjes së tërmeteve: **brezi ose unaza e Oqeanit Paqësor** dhe **brezi Mesdhetar-Aziatik**. Kosova i takon brezit Mesdhetar të tërmeteve. Gjatë së kaluarës janë paraqitur tërmete të vogla dhe mesatare, të cilat nuk kanë shkaktuar dëme shumë të mëdha. Vlerësohet se qyteti i Ulpanës u shkatërrua nga tërmeti.



Sizmograf




Diskutoni në klasë me mësimdhënësin: Si do të reagoni në rast të paraqitjes së tërmetit? Çka do të bënit nëse do të ishit në klasë?

Nëse epiqendra e tërmetit është në fund të detit apo oqeanit, shkaktohen valë të mëdha ujore që quhen **cunami**.


Disa nga tërmetet më të fuqishme që kanë ndodhur gjatë historisë së njerëzimit dhe që kanë shkaktuar dëme të mëdha njerëzore janë: në provincën Shanxi (Kinë, 1556) - rreth 1 milion të vdekur, Haiti - në vitin 2010, me më shumë se 222 mijë të vdekur, në vitin 2004, në Indonezi - me 230 mijë të vdekur etj.




Zhvendosja e krijuar nga tërmeti në Zelandën e Re. Magnituda 7.8 ballë, 14 nëntor 2016



Përhapja e tërmeteve në Tokë



Valët e cunami, të shkaktuara nga tërmeti nënujor



Tërmeti, valët



Pyetje dhe detyra

1. Tregoni karakteristikat kryesore të tërmetit.
2. Në cilat zona gjeografike kanë përhapjen më të madhe tërmetet?
3. Si do të mbroheshit në rast të paraqitjes së tërmetit?

53



Ndërtimi i njohurive:

Ditari dypjesësh

Ndahet tabela në dy shtylla. Në shtyllën e parë shënon disa fjalë kyçe dhe përshkrimi në shtyllën e dytë për këto fjalë kyçe.

Fjalët kyçe	Komentimi
Tërmetet	Lëvizje të papritura të kores së Tokës.
Hipoqendra	Vendi në brendi të tokës, ku lind tërmeti.
Epiqendra	Vendi në sipërfaqen e Tokës ku arrijn dridhja më së shpejti.
Llojet e tërmeteve	Tektonike, vullkanike, vithisjeve/rrëshqitjeve.
Seizmografi	Instrumenti që regjistron tërmetet.
Zonat kryesore seizmike	Unaza e Paqësorit dhe brezi Mesdhetar-Aziatik.
Cunami	Valët e mëdha ujore që shkakohen nga tërmete nënujore.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Rrjeti i diskutimit

Diskutohet së bashku me nxënësit për dëmet/rrëzimet që shkaktohen nga tërmetet, si të mbrohemi në rast të paraqitjes së tërmetit, dhe nëpërmes hartës identifikohen zonat aktive seizmike në Tokë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve dhe përshkrimin dhe për identifikimin e zonave aktive seizmike përmes hartës.

Detyrë:

Hulumtoni në internet për tërmetet më të fuqishme që kanë ndodhur gjatë historisë së njerëzimit, mbani shënime.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 22

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan format relievore, llojet dhe shkaktarët e krijimit, format e krijuara nga forcat e brendshme dhe nga forcat e jashtme;

Përshkruan shkaqet dhe rrjedhojat e vullkaneve, të tërmeteve dhe zonat kryesore të paraqitjes së tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përforcim - Forcat e brendshme të Tokës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan mënyrat e formimit të relievit;
- Identifikon forcat e brendshme që kanë ndikuar në krijimin e relievit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë e botës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Ora e mësimi është përforcim, ajo realizohet në formë diskutimi përmes pyetjeve-përgjigjeve për njësitë mësimore të cilat kanë të bëjnë me forcat e brendshme, duke filluar me forminin e relievit, forcat që kanë krijuar reliev, strukturat tektonike, vullkanet, tërmetet.

Cilët faktorë e formojnë relievin?


Si vepron energjia diellore në proceset e jashtme?

Lëvizjet epirogjene dhe orogjene

Në bazë të karakterit të lëvizjeve dhe pasojave në koren e Tokës, lëvizjet tektonike ndahen në dy lloje:

- luhatëse (vertikale) ose epirogjenike (kontinentformuese) dhe
- shformuese ose orogjenike (malformuese).

Shpjegoni se si është krijuar terreni në fotografi. Cilët faktorë kanë ndikuar?



Lëvizjet tektonike dhe krijimi i relievit strukturor

26

Lëvizjet luhatëse (epirogjenike) janë lëvizje shumë të ngadalshme dhe krijohen për shkak të ndryshimeve tektonike dhe klimatike. Në brendësi të Tokës ndodhin ndryshime në fluksin termik të saj. Kur temperatura rritet, arrihet te zgjerimi i litosferës ose ftohja, që sjell tkurrjen e saj. Në rast të lëvizjeve vertikale të masave tokësore (kontinenteve), arrihet deri te tërheqja ose avancimi i nivelit të detit. Avancimi i nivelit të detit quhet **transgresion**, ndërsa tërheqja e nivelit të detit quhet **regresion**. Në rastin e parë zvogëlohet sipërfaqja kontinentale, ndërsa në rastin e dytë rritet sipërfaqja e kontinenteve.

Shpjegoni:

Pse qyteti i Venecias, në pjesën më të madhe të tij nuk ka rrugë tokësore, por ujore? Në vend të makinave, përdoren **gondolat** për udhëtim. Si është ndërtuar ky qytet? Çfarë ka ndodhur?




27



Ndërtimi i njohurive:

Harta e konceptit

Në tabelë formohet harta e konceptit “Forcat e brendshme” dhe kërkohet nga nxënësit që të plotësojnë atë në tabelë dhe në fletoret e tyre.



Nxënësit e plotësojnë hartën e koncepteve me njohuritë që tani i kanë për forcat e brendshme të Tokës, për ndikimin e tyre në formimin e relievit, vullkanet, tërmetet. Në fund bëhet edhe demonstrimi i disa prej punimeve.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Veprimtari praktike

Plotësohet fletorja e punës - njësitë e mësuara për forcat e brendshme.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për përgjigjet e sakta që japin gjatë përsëritjes së njësive mësimore, për përshkrimin dhe identifikimin e zonave aktive.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 23

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VI
Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:
 Përshkruan shkaqet dhe rrjedhojat e vullkaneve, të tërmeteve dhe zonat kryesore të paraqitjes së tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 RNF: 2. Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre. 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerësim i punimeve: Vullkanet-Tërmetet

Prezantimi bëhet në dyshe, ashtu siç është kërkuar orë më parë nga mësimdhënësi.

Sqarim: Ky tip i orës realizohet vetëm me klasat që kanë numër mesatar ose të paktë të nxënësve. Në klasat që kanë shumë nxënës, administrohet koha, duke eliminuar aktivitetet gjatë orës.

Nxënësit, në mënyrë individuale, bëjnë prezantimin e maketit të vullkanit dhe ilustrimin e tërmeteve para klasës, detyrë e cila është dhënë dy orë më parë për t'u realizuar.

Kriteret për vlerësim	Emrat e nx.	Nota
Maketi i vullkanit	+	2
Prezantimi i maketit të vullkanit	+	2
Ilustrimet për termetin	+	3
Prezantimi i ilustrimeve të tërmetit	+	4
Përgjigjet e pyetjeve të parashtruara	+	5


Për të nxjerrë notën veprojmë kështu (shembull):

$$3 \times 0.25 + 5 \times 0.25 + 4 \times 0.30 + 3 \times 0.20 = 0.75 + 1.25 + 1.2 + 1.5 + 0.60 = 3.8, \text{ pra nota është } 4.$$

Mësimdhënësi mund të formojë një instrument sipas kriterëve të veta, ose t'i paraqesë kriteret së bashku me nxënësit.

Instrumenti 3 - Prezantim me gojë (30%). Nxënësi vlerësohet sipas standardeve të vlerësimit, të përshkruara në: UA, Kurrikulën Bërthamë dhe Udhëzuesin për vlerësim.


Nota 5. Nxënësi që bashkëbisedon me arsimtarin dhe ofron fakte, argumente dhe e analizon detyrën para se të përgjigjet, ka shprehje të rrjedhshme dhe logjike, bashkëbisedimin e përcjell me gesticulacion për sqarim të



Vullkanet

Magma është materie e zjarrtë, e cila ndodhet në pjesën e sipërme të mantelit (astenosferë) të Tokës. Magma ka temperaturë të lartë dhe përbërje të ndryshme. Kur magma del në sipërfaqe të Tokës, quhet **lavë** dhe krijon vullkane.

Gjatë shpërthimit vullkanik, përveç lavës, dalin edhe lëndë të tjera, si: avuj, hi, gaze etj.




Sipas kohës së shpërthimit, vullkanet ndahen në **aktive** dhe **të shuara**. Vullkanet aktive janë vullkane që herë pas here kanë erupsione vullkanike. Koha ndërmjet erupsioneve është e ndryshme. Vullkanet e shuara janë vullkane që kanë përfunduar aktivitetin vullkanik të tyre. Në Kosovë, në Zvečan është paleokupa vullkanike, që ishte aktive miliona vjet më herët.

Sot, në Tokë, ekzistojnë rreth 1,300 kupa të njohura vullkanike, ndërsa rreth 600 prej tyre janë aktive. Mesatarisht në vit, rreth 50 vullkane shpërthejnë në Tokë.

Dallohen katër zona kryesore të përhapjes së vullkaneve: *Unaza e Zjarrtë e Paqësorisht, Kurrizorja Mesogjeanike e Atlantikut, Zona Mesdhetare (Transaziatike) dhe Bregu Lindor i Afrikës.*

Në kontinentin evropian, vullkanet aktive ndodhen në pjesën jugore, kryesisht në detin Mesdhe, si dhe në ishullin e Islandës. Më të njohur (aktive) janë: *Etna, Vezuvi, Vulkano, Stromboli (Itali), Santorini (Greqi), Hekla (Islandë)* etj.



Tërmetet

Tërmetet janë lëvizje të papritura të kores së Tokës. Tërmetet e fuqishme dëshmojnë se Toka është një sistem dinamik dhe i ndryshueshëm. Ato përfaqësojnë lirin e energjisë në litosferën e Tokës.



Pika në të cilën lind tërmeti quhet **hipoqendër**. Tërmetet mund të përhapen në territor të gjerë, por gjithmonë kanë një pikë në të cilën lindin lëvizjet për herë të parë. **Hipoqendra** e tërmeteve mund të jetë nga disa kilometra deri në 700 km thellësi. Vendi në sipërfaqe të Tokës në të cilin arin dridhja më së shpejti quhet **epiqendra** e tërmetit. Pasi të ndodhë tërmeti, lirohen vale të cilat përhapen në drejtime të ndryshme - këto quhen **valë sizmike**. Tërmeti ka para dhe pasgoditjet, fuqia e të cilave është më e vogël se e tërmetit kryesor. Tërmetet dallohen për nga magnituda dhe intensiteti.

Në varësi të fuqisë, tërmetet mund të shkaktojnë dëme materiale e dëme në njerëz.

Sipas origjinës, tërmetet ndahen në tërmete **tektonike**, **vulkanike** dhe të **vithisjeve (rreshqitjeve të mëdha)**. Përhapjen më të madhe e kanë tërmetet tektonike, me 90 % të rasteve.

Gjatë vitit, nëpër stacione sizmike regjistrohen mbi 1 milion tërmete të madhësive të ndryshme. Tërmetet regjistrohen me instrumentin e quajtur **sizmograf**.

Tërmetet janë karakteristike për rajonet e pastabilizuara në Tokë. Janë të njohura 2 zona kryesore të paraqitjes së tërmeteve: **brezi ose unaza e Oqeanit Paqësor** dhe **brezi Mesdhetar-Aziatik**. Kosova i takon brezit Mesdhetar të tërmeteve. Gjatë së kaluarës janë paraqitur tërmete të vogla dhe mesatare, të cilat nuk kanë shkaktuar dëme shumë të mëdha. Vlerësohet se qyteti i Ulpianës u shkatërrua nga tërmeti.



rasteve, ofron faktet gjeografike, njeh objektet gjeografike, shpjegon dukuritë dhe proceset gjeografike si dhe raportet që janë në lidhshmëri me njësitë e përpunuara hapësinore, analizon lidhshmëritë dhe ligjshmëritë gjeografike që shprehen dhe veprojnë brenda këtyre njësive, paraqet aftësitë, shkathtësitë e shprehitë, të dinë të shërbehen me to dhe të përvetësojnë mënyrën e të menduarit gjeografik. Nota 4. Nxënësi i cili bashkëbisedon me arsimtarin, ofron fakte dhe e analizon detyrën para se të përgjigjet. Ka shprehje të rrjedhshme dhe logjike, me ngecje në informacion.

Bashkëbisedimin e përcjell me gjestikulacion për eksplikon të rasteve, jo në formë shumë të saktë. Ofron faktet gjeografike, njeh objektet gjeografike; shpjegon dukuritë dhe proceset gjeografike si dhe raportet që janë në lidhshmëri me njësitë e përpunuara hapësinore; analizon lidhshmëritë dhe ligjshmëritë gjeografike që shprehen dhe veprojnë brenda këtyre njësive, paraqet aftësitë, shkathtësitë e shprehitë, të dinë të shërbehen me to dhe të përvetësojnë mënyrën e të menduarit gjeografik jo shumë të saktë. Nota 3. Nxënësi iu përgjigjet pyetjeve të arsimtarit, por jo mjaftueshëm. Ka shprehje të rrjedhshme dhe deri diku të logjikshme, me ngecje në informacion, bashkëbisedimin e përcjell më me ngecje nga mungesa e leximit të mjaftueshëm.

shëm, ofron faktet gjeografike, njeh disa objekte gjeografike, shpjegon dukuritë dhe proceset gjeografike (ato që i di) si dhe raportet që janë në lidhshmëri me njësitë e përpunuara hapësinore, paraqet aftësitë, shkathtësitë e shprehitë, të dinë të shërbehen me to.

Nota 2. Nxënësi mundohet të bisedojë, ofron fakte gjatë bisedës, por shumë pak. Vërehet mungesa e leximit, nuk i plotëson as 30 % të kriterëve të lartpërmendura.

Nota 1. Nxënësi nuk iu përgjigjet pyetjeve, nuk bashkëbisedon. Nuk i plotëson kriteret e lartpërmendura as 20 %.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan shkaqet e alterimit (tjetërsimit), kushtet në të cilat zhvillohet procesi i karstit dhe format sipërfaqësore dhe nëntokësore të krijuara nga veprimtaria karstike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2; III.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Proceset e jashtme - Alterimi

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon llojet e alterimit;
- Analizon llojet e ndryshme të alterimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Biologjia, Kimia, Fizika.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Stuhi mendimesh

Kërkohet nga nxënësit të tregojnë se cilat mund të jenë disa nga proceset e jashtme që mund të ndryshojnë pamjen e relievit, i cili fillimisht është krijuar nga forcat e brendshme të Tokës.


Shpjegohen disa shembuj të proceseve të jashtme, p.sh., ndikimin e temperaturës, të ujit, të reshjeve atmosferike, të botës bimore.

PROCESET E JASHTME

Proceset e jashtme janë veprime të cilat bëhen nga faktorë të jashtëm në sipërfaqe të Tokës. Ato luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e formave të ndryshme në relievit e sipërfaqes së Tokës. Ato janë të ndikuara nga veprimtaria e agjentëve të ndryshëm në sipërfaqen e Tokës, të cilët janë të ndikuar nga Dielli dhe Hëna.

Këto procese zhvillohen në kontaktin mes shkëmbinjve, ajrit dhe ujit në raport me forcën e gravitetit të Tokës. Të gjitha trajtat që i shohim si forma të relievit - male të rumbullakuara ose të rrëpirëta, luginat lumore, klifi dhe plazhi përjatë bregdetit, shpellat dhe dunat e rërës janë produkte të proceseve të jashtme.

Malet, kodrat, luginat lumore, brigjet detare, të cilat ndërtojnë peizazhin që ne shohim, duket se janë të pandryshueshme, por, në fakt, ato ndryshojnë vazhdimisht. Materialet shkëmbore në shpatet e maleve konsiderohen të paekuilibruara nën ndikimin e gravitetit. Nën ndikimin e gravitetit, agjentë të ndryshëm të erozionit (ujërat rrjedhëse, akulli, era) veprojnë në mënyrë konstante duke i bërë shpatet më të buta dhe duke rritur qëndrueshmërinë.



Gjeosferat e jashtme të Tokës dhe bashkëveprimi i tyre (burimi: Dahlman & Renwick, 2015)

Alterimi

Proceset që zhvillohen në sipërfaqe të Tokës janë të ndikuara nga energjia diellore. Ndryshimet në temperaturën e ajrit, qarkullimi i erës, qarkullimi i ujit në natyrë, veprimtaria e valëve të detit, forca e gravitetit të Tokës, veprimtaria e organizmave të gjallë janë faktorët kryesorë që kanë modeluar dhe vazhdojnë ta modelojnë relievin e sipërfaqes së Tokës. Këto veprimtari nuk janë të zhvilluara njësoj në gjithë Tokën, andaj shkalla e modelimit të relievit nuk është e njëjtë. Në varësi të faktorit që vepron, alterimi (tjetërsimi) mund të jetë **fizik**, **kimik** dhe **biologjik**.

Veprimi i ngricave




Veprimi i ngricave në shkëmbinj

Alterimi fizik është prishja dhe copëzimi i shkëmbinjve pa ndryshuar përbërjen fizike të tyre. Ai shkaktohet nga luhatjet e temperaturës, ngrirja dhe shkrirja e ujit, ngrohja e drejtpërdrejtë e shkëmbinjve nga rrezet e diellit dhe veprimi mekanik i organizmave. Gjatë ditës, me rritjen e temperaturës, në veçanti në zonat me mungesë bimësie, shkëmbinjët bymehen, ndërsa gjatë natës tkurren. Sa më të larta të jenë amplitudat e temperaturës, bymimi dhe tkurja e shkëmbit janë më të mëdha. Në këtë mënyrë krijohen të çarat dhe pjesë të shkëmbinjve shpëputen. Të çarat mundësojnë depërtimin e ujit. Uji në kushte klimatike të ftohta, gjatë ngrirjes rrit vëllimin për rreth 10% duke ndihmuar në zgjerimin e të çarave.

Alterimi kimik në shkëmb



Thyerja e shishes së khamit nga ngrirja e ujit



Ndërtimi i njohurive: Pyetja sjell pyetjen

Nxënësve iu parashtrohen pyetje:

- Çka janë proceset e jashtme?
- Çfarë roli kanë proceset e jashtme në relievin e Tokës?
- Kush i shkakton proceset e jashtme?
- Pse relievi ka pësuar dhe pëson ndryshime vazhdimisht?
- Çka është procesi i alterimit?
- Cilat janë llojet e alterimit?
- Kush e shkakton alterimin fizik?
- Kush e shkakton alterimin kimik?
- Nën ndikimin e kujt zhvillohet alterimi biologjik?
- Çfarë ndodh me materialet e copëzuara gjatë procesit të alterimit?

Më pas diskutohen përgjigjet e mundshme.




Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:

Organizues grafik: Përvijimi i të menduarit

Në tabelë formohet organizuesi grafik me fjalën

“Alterimi” dhe kërkohet nga nxënësit që të plotësojnë atë në tabelë dhe në fletoret e tyre.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, identifikimin dhe analizën e formave të alterimit dhe për plotësimin e tabelës “përvijimi i të menduarit”.

Detyrë:

Pyetje dhe detyra, faqe, 56

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan shkaqet e tjetërsimit (alterimit), kushtet në cilat zhvillohet procesi i karstit dhe format sipërfaqësore dhe nëntokësore të krijuara nga veprimtaria karstike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6; II-6; IV-3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2, 5.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Procesi i shpatit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon kushtet në të cilat zhvillohet procesi i shpatit;
- Propozon ide se si mund të minimizohet trejtërsimi (alterimi) i shkëmbinjve.

Kriteret e suksesit: Duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto apo edhe video të ndryshme të krijuara nga procesi i shpatit.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Kimia, Fizika, TIK (Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim për njohuritë paraprake

Drejtohem i pyetje:

1. Cilët janë kushtet në të cilat zhvillohet procesi i shpatit?
2. Çfarë pasojash mund të ndodhin?

Diskutohen me nxënësit përgjigjet e ndryshme.



Alterimi biologjik

Alterimi kimik zhvillohet në prani të ujit. Alterimi kimik është më i pranishëm në kushte me klimë mesatare, me lagështi e të nxehtë, ndërsa në kushte të klimës së thatë dhe të ftohtë është më pak i zhvilluar. Formë e alterimit kimik është tretja e shkëmbinjve, me ç'rast në gëlqerorë krijohen shpellat (shpella e Gadimes etj.).

Alterimi biologjik zhvillohet nën ndikimin e organizmave, në veçanti të bimëve. Bimët gjatë rritjes së rrënjëve të tyre ndikojnë në hapjen e të çarave në shkëmbinj duke shkaktuar shkëputje të copëzave nga shkëmbi rrënjësor. Paraprakisht, shkëmbinjët janë çarë nën ndikimin e bymimit e tkurrjes, pastaj nga veprimi i akullit, duke mundësuar zhvillimin e drurëve.

Materialet e copëzuara bien nën ndikimin e ujërave sipërfaqësore, e që përmes gravitetit lëvizin drejt shpatit tatëpjetë, ku copëzohen e rumbullakohen. Vendi përfundimtar i transportimit të materialeve të copëzuara janë detet dhe oqeanet.



Pyetje dhe detyra

1. Sa lloje të alterimit (tjetërsimit) ekzistojnë?
2. Shpjegoni në cilat kushte zhvillohet alterimi kimik dhe në cilat ai fizik.
3. Shihni ndonjë shembull të alterimit në vendlindjen apo rrethinën tuaj dhe shpjegoni shkaqet që kanë ndikuar.

Proceset e shpatit

Shpati është elementi kryesor i relievit. Për shkak të pjerrësisë, në shpate vepron forca e gravitetit. Sa më e madhe të jetë pjerrësia, forca e tërheqjes është më e madhe, dhe e kundërta, sa më e vogël të jetë pjerrësia, forca e rezistencës është më e madhe. Për shkak të ndërtimit gjeologjik të larmishëm dhe kushteve të veçanta klimatike, shpatet janë jostabile duke mundësuar lëvizjen e masës shkëmbore. Lëvizjet e masës shkëmbore paraqesin lëvizjen e shkëmbinjve, copëzave shkëmbore ose tokës së shkrifët nën ndikimin e forcës së gravitetit. Ndër shkaktarët me rëndësi të nxitjes së lëvizjes së masave shkëmbore në shpate janë tërmetet, reshjet intensive, ndërtimet etj.

Zakonisht, në shpatet me pjerrësi më të madhe vepron erozioni, ndërsa në shpatet me pjerrësi më të vogël vepron depozitimi i materies së shkatërruar.




Shembulli i alterimit biologjik. Tregoni se çka ndodh më vonë me shkëmbinjtë.



Lëvizjet e masave shkëmbore janë të ndryshme. Disa lëvizin përgjatë shpatit (rëshqitjet, lëvizjet e ngadalshme), disa me kërcim (shembjet e rrëzimet).

Rrëshqitjet dhe lëvizjet e ngadalshme janë karakteristike për shpate që ndërtohen nga shkëmbinj të butë (të shkrifët, të palidhur), ndërsa shembjet e rrëzimet janë karakteristike për shpate që ndërtohen nga shkëmbinj të fortë.

Në Kosovë, për shkak të terrenit kodrinor-malor, proceset e shpatit janë mjaft të shprehura. Me qëllim të parandalimit të proceseve të shpateve merren masa ndaj tyre, si p.sh.: pyllëzimi, muret nga betoni, rrjetat metalike, kullimi i ujit etj.



Shembje dhe rrëshqitje (burimi: Plummer et al, 2016)

Gjatë udhëtimit, nëpër rrugë do të shihni shenjë e trafikut për "rrezik gurësh". Në cilat terrene e shihni më shpesh? Me çfarë forma e trajta të relievit ndërlidhet? Tregoni ndonjë shembull që e keni vërejtur në natyrë.



Pyetje dhe detyra

1. Cilat janë format kryesore të lëvizjes së shpateve?
2. Çka ndodh me masën shkëmbore gjatë reshjeve të shumta?
3. Si duhen mbrojtur shpatet? Trego ndonjë shembull nga rrethina juaj.

57



Ndërtimi i njohurive:

Pyetja sjell pyetjen

Paraqiten video ose foto të ndryshme për shkaktarët dhe pasojat e alterimit të shkëmbinjve;

Gjatë shikimit të videos ose të fotove, nxënësit mbajnë parasysh:

1. Identifikimin e shkaktarëve
2. Evidentimin e pasojave
3. Si do të vepronit ju në një situatë të tillë?

<https://www.youtube.com/watch?v=pTs9Fb7uG0M>



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënësve:

Paragraf argumentues

Në mënyrë individuale, nxënësit shkruajnë paragraf argumentues për shkaktarët, pasojat dhe masat të cilat duhen marrë për ta minimizuar këtë proces. Pastaj në dyshe ndajnë idetë e tyre.

Disa nga punimet lexohen nga nxënësit, pjesa e palexuar merret nga arsimtari dhe vlerësohet në shtëpi.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e shpjegimit të kushteve në të cilat zhvillohet procesi i shpatit, si dhe masat që duhen marrë për ta minimizuar atë.

Detyrë:

Organizohen që të përgatitin prezantim në shkollë, me qëllim të vetëdijësimit të bashkëmoshatarëve në komunitet.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan shkaqet e tjetërsimit (alterimit), kushtet në cilat zhvillohet procesi i karstit dhe format sipërfaqësore dhe nëntokësore të krijuara nga veprimtaria karstike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6; II-6; IV-3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2, 5.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Erozioni karstik

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon shkaktarët që ndikojnë në procesin e erozionit karstik;
- Tregon nga 2 forma nga erozioni karstik sipërfaqësor dhe nga ai nëntokësor;
- Propozon ide se si mund të minimizohet erozioni i karstit.

Kriteret e suksesit: Caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto apo edhe video të ndryshme të erozionit karstik.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:


Kimia, Fizika, TIK (Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm).

Erozioni karstik

Është lloj i veçantë i erozionit, i cili lidhet me shkëmbinjtë karbonatikë (gëlqerorë, mermerë, dolomitë) dhe shkëmbinjtë e tjerë të tretshëm (gjipsë, anhidrite), ku formohen forma të veçanta të relievit, të cilat në aspektin gjeonetik njihen si **reliev karstik**. Për t'u zhvilluar relievi karstik duhen shkëmbinjtë caktuar, ujë dhe dyoksidi i karbonit. Uji në natyrë qarkullon me anë të ciklit hidrologjik, ndërsa atmosfera përmban dyoksid karboni.

Shkëmbinjtë karbonatikë, për shkak të çarjeve të shumta, kanë mungesë të ujërave rrjedhëse sipërfaqësore dhe rrjedhimisht janë të zhveshur nga bimësia, por në kushte të një klime të lagësht tropikale e ekuatoriale mund të zhvillohet edhe bimësia.

Dukuria e erozionit zhvillohet përmes procesit të tretjes, masa shkëmbore largohet duke krijuar zgavra, boshllëqe dhe hapësira të tjera boshe në shkëmb.



58

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Paraqiten disa foto dhe shtrohen pyetjet:

1. Tregoni disa nga shkaktarët e mundshëm.
2. A mund të krijohen forma të ndryshme mbi sipërfaqen e tokës? Nëse po, çfarë forma mund të krijohen?



Topografi karstike me hurdha në ShBA



Lapieza pusore në afërsi të Artanës (Novobërdës) në Kosovë

Në terrenet karstike zhvillohen **format sipërfaqësore** dhe **nëntokësore**, ndërsa përmasat e formave mund të jenë të vogla deri te të mëdhatë. Në përgjithësi dominojnë format negative (të ulëta). Format kryesore nëntokësore janë **shpella** dhe **humnera**. Dallimi i tyre qëndron te hyrja. Hyrja e shpellës është horizontale, ndërsa e humnerës është vertikale.

Në sipërfaqe zhvillohen format nga më të voglat, siç janë: *brazdat, ullukët, lapiezat, lugjinat qorre*, deri tek ato më të mëdhatë, siç janë: *humet, hurdhat, kanionet e fushat karstike*.

Forma më e madhe sipërfaqësore është **fusha karstike**. Sipërfaqja e tyre mund të jetë nga 5 deri 400 km². Zakonisht janë pa rrjedhje ujore. Nëse ka ndonjë lumë, atëherë, përmes ndonjë humbëlline (kanali), uji zhytet nën tokë duke dalë diku tjetër në formë të burimit.



A E DINI SE

Shpella e Mamuthit në ShBA është sistemi më i madh i shpellës në Tokë. Gjatësia e horizonteve të shpellës është rreth 640 km.



Fushë karstike në Kroaci

Disa nga përgjigjet e mundshme:

1. Temperatura, uji, era.
2. Gropa, vija-lugje të ndryshme.



Ndërtimi i njohurive:

Pyetja sjell pyetjen

Paraqiten video ose foto të ndryshme të shkaktarëve që ndikojnë në erozion karstik.

Gjatë shikimit të videos a fotove, nxënësit duhet të kenë parasysh pyetjet:

1. Identifikuat shkaktarët?
2. Cilat forma u krijuan?

<https://www.youtube.com/watch?v=vAOcqHgwTfg>




Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënësve:

Organizues grafik: Tabela e konceptit

Në mënyrë individuale, nxënësit përgatitin organizues grafik për erozionin karstik. Pastaj, secili në mënyrë individuale i shënon idetë e tyre në tabelë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e shpjegimit të shkaktarëve, kushtet në të cilat zhvillohet procesi i shpatit, si dhe masat të cilat duhen marrë për të minimizuar tjetërsimin e shkëmbinjve.

Detyrë:

Plotësojnë fletoren e punës, faqe 38.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VI
Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënësve të temës:
 Përshkruan format erozive dhe akumulative të relievit fluvial (lumor) glacial, të relievit eolik dhe të atij abraziv.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I-6, II-6, IV-3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2, 5.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Veprimtaria e ujërave rrjedhëse (fluvial)

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Identifikon format erozive dhe akumulative të relievit fluvial;
- Përshkruan nga dy forma erozive dhe akumulative të relievit fluvial.

Kriteret e suksesit: Duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto a video të veprimtarisë së ujërave rrjedhëse.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Kimia, Fizika, TIK (Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Stuhi mendimesh

Pyeten nxënësit:
 Çka dini për veprimin e ujërave rrjedhëse?

Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.

Veprimtaria e ujërave rrjedhëse

Uji në natyrë qarkullon me anë të ciklit hidrologjik. Një pjesë të tij e përbëjnë ujërat rrjedhëse. Ujërat janë faktor i rëndësishëm për ndryshimin e relievit të sipërfaqes së Tokës. Ujërat rrjedhëse kanë përhapje thuajse në gjithë Tokën, duke përjashtuar vetëm disa zona të caktuara klimatike. Thuajse çdo peizazh në Tokë ka shenja të veprimtarisë së ujërave rrjedhëse.

Veprimtaria lumore është proces kompleks dhe ka të bëjë me erozion, transport dhe depozitim të materialeve që ndodhen në sipërfaqe të Tokës, ndërsa format që krijohen quhen forma lumore ose fluviale.

Lumenjtë në sipërfaqen e Tokës janë të lidhur me kushtet klimatike, ndërtimin gjeologjik, veçoritë e relievit, përmasat e pellgut ujëmbledhës, vegjetacionin etj. Të gjithë këta faktorë kushtëzojnë veprimtarinë gjeryse, transportuese dhe depozituese të lumenjve.

Ujërat rrjedhëse sipërfaqësore përfshijnë rrjedhat nga më të voglat e deri tek ato më të mëdhatë, si të përkohshme, ashtu edhe të përhershme.


Veprimtaria e ujërave rrjedhëse është e lidhur ngushtë me prurjen (sasinë e ujit) dhe shpejtësinë.

Erozioni lumor paraqet largimin e shkëmbinjve nga sipërfaqja e Tokës drejt terreneve më të ulëta. Në rrjedhën ujore dallohen këto lloje të erozionit: thellësinor (vertikal), anësor (horizontal) dhe regresiv (prej grykëderdhjes drejt burimit).

Diskutoni në klasë me mësimdhënësin:
 Si mund të mbrohet Toka nga denudacioni dhe erozioni lumor? Tregoni ndonjë shembull nga rrethina juaj.

Transportimi (bartja) i materieve të erodura bëhet në varësi të fuqisë së lumit. Copëzat (kokërrzat) më të mëdha (zhavorr, popla, krepa etj.), në varësi të formës, barten duke u rrokullisur apo duke u zvarritur ndërsa copëzat kokërrmesme barten me kërcim. Copëzat kokërrimëta (argjilë e alevrolite) barten pezull.

Bartja pezull e copëzave vërehet më së miri kur uji në lumenj është i turbullt. Turbulllira fizike tregon për fuqinë e lumit. Me zvogëlimin e fuqisë së lumit, copëzat depozitohen duke krijuar forma akumulative lumore (fluviale), ndërsa uji i lumit pastrohet. Format depozituese janë më të pranishme në pjesën e poshtme të lumit, zakonisht nëpër ultësira, me ç'rast lumi nuk ka fuqi që t'i bartë këto copëza.




Mënyra e transportit të copëzave shkëmbore në lumë

anë të erozionit, meandra mund të ngushtohet dhe të shkëputet, me ç'rast krijohen liqene.

Veprimtaria e lumenjve krijon forma erozive dhe akumulative në relievin e sipërfaqes së Tokës. Format erozive janë: **shtrati, lugina, pellgu, tarracat lumore** etj. Ndërsa, format kryesore akumulative janë: **konet dhe rrafshi aluvional, ishujt lumorë (ada), delta.**

Shtrati i lumit është vendi ku rrjedh uji. Është formë erozive lumore. Në pjesën e sipërme lumenjtë kanë shtrat të ngushtë, ndërsa në pjesën e poshtme shtrati është i gjerë. Shtrati paraqet pjesën më të thellë të luginës së lumit. **Lugina** është formë erozive, ku përveç shtratit, ka edhe rrafshin aluvial dhe shpatet e luginës. Luginat në zonat malore janë të ngushta, të thella, shpeshherë në trajtë kanioni e grykash (gryka e Rugovës, e Prizrenit, e Deçanit etj.).



Shpejtësia maksimale në lumë



Ndërtimi i njohurive:
Pyetja sjell pyetjen

Paraqiten video a foto të ndryshme të veprimtarisë së ujërave rrjedhëse.

Gjatë shikimit të videos a fotove, nxënësit mbajnë parasysh pyetjet:

1. Identifikuat format erozive dhe ato akumulative?
2. Kush janë shkaktarët?

<https://www.youtube.com/watch?v=8a3r-cG8Wic>

<https://www.youtube.com/watch?v=wi0fT3TCIGs>



Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit:
Shënime të strukturuar

Secilit grup i jepet një fletë, në të cilën kërkohet të shkruajnë në mënyrë të strukturuar mendimet e tyre për temën a të plotësojnë mendimet që i kanë dhënë grupet e tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e identifikimit dhe të përshkrimit për format erozive dhe ato akumulative të veprimtarisë së ujërave rrjedhëse.

Detyrë:

Përgatitin dhe prezantojnë format erozive dhe akumulative të veprimtarisë së ujërave rrjedhëse.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan format erozive dhe akumulative të relievit fluvial (lumor) glacial, të relievit eolik dhe të atij abraziv.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6; II-6; IV-3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2, 5.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Veprimtaria e akullnajave (glaciale)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon format e krijuara nga veprimtaria e akullit;
- Përshkruan dy forma të krijuara nga veprimi i akullit.

Kriteret e suksesit: Duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto apo edhe video të krijuara nga veprimi i akullnajave.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe (apo) me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Kimia, Fizika, TIK (Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Stuhi mendimesh

Paraqiten këto foto dhe shtrohet pyetja:

1. Cili veprim i forcave të jashtme i ka shkaktuar këto forma?


Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.

Veprimtaria e akullnajave


Akullnaja është masë e akullit e formuar për qindra ose mijëra vjet. Akullnajat formohen në kushte klimatike të ftohta. Ato janë të përhapura në gjerësi të mëdha gjeografike dhe lartësi të mëdha mbidetare (male të larta).

Edhe pse duket e palëvizshme, akullnaja lëviz me shpejtësi të ndryshme, në varësi të kushteve të relievit, nga disa cm deri në disa qindra metra në vit. Gjatë periudhës së akullnajave (pleistocen), pjesa më e madhe e Euroazisë dhe e Amerikës Veriore ishte e mbuluar me shtresa të trasha akulli (*shih hartën*). Si rezultat, relievi ishte ndryshuar nga akullnaja deri në gjerësitë e mesme dhe subarkitike.


Akullnajat me anë të fuqisë së tyre mund të krijojnë forma të veçanta relievo-re, të cilat e ndryshojnë sipërfaqen e Tokës. Edhe pse pjesa më e madhe e tyre shtrihet rreth poleve, në malet e larta në Tokë paraqiten akullnajat. Lartësia e paraqitjes së tyre në male lidhet me **viçin e borës**, sipër së cilës temperaturat mesatare vjetore janë nën 0 °C, duke mundësuar gjendjen e ngrirë. Bora e grumbulluar ndër vite ngjeshet dhe nën veprimin e peshës së vet, me kalimin e kohës, shndërrohet në akull kokërrizor që quhet **firn**. Pastaj ngjeshet edhe më shumë dhe shndërrohet në akull të tejdukshëm me dendësi të madhe që quhet **gletçer**.



Përhapja e akullnajave deri para 12000 vjetësh



Shndërrimi i borës në akull



Diskutoni në klasë me mësimdhënësin: Në Kosovë nuk ka akullnaja, por ka forma të relievit akullnajor. Çfarë ka ndodhur në të kaluarën?

Akullnajat krijojnë forma erozive dhe akumulative. Format relievoze më të njohura janë në viset e larta të krijuara nga akullnajat alpine (nëpër male). Format erozive të akullnajave malore janë: **çirqet**, **luginat**, **luginat e varura**, ndërsa format akumulative janë: **morenat** dhe **bedemet morenike**.

Çirqet janë forma glaciale, me pamje amfiteatri, të krijuara nga erozioni akullnajor. Në çirqe zhvillohen liqene të çirqeve, të cilat njihen si "sytë e maleve". **Lugina akullnajore** zhvillohet në luginën lumore. Në fillim, lugina ka trajtë të shkronjës V, e zhvilluar nga erozioni lumor vertikal. Me veprimin e akullnajës, fundi i luginës zgjerohet duke marrë trajtë të shkronjës U. **Morenat** janë copëza shkëmbore të bartura dhe të depozituara nga akullnaja.

66



Ndërtimi i njohurive: Pyetja sjell pyetjen

Paraqiten video ose foto të ndryshme të veprimtarisë së akullit.

Gjatë shikimit të videos a fotove, nxënësit duhet të kenë parasysh pyetjet:

1. Identifikuat shkaktarët?
2. Cilat forma u krijuan?


<https://www.youtube.com/watch?v=loI584OFVpE>

<https://www.youtube.com/watch?v=NH-vnKR6A7A>



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit: Organizues grafik

Në mënyrë individuale, nxënësit përgatitin organizues grafik për veprimin e akullit. Pastaj, secili në mënyrë individuale i shënon idetë e tyre në tabelë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e identifikimit dhe për përshkrimin e qartë të formave të krijuara nga veprimi i akullit.

Detyrë:

Plotësojnë fletoren e punës, faqe 41 dhe 42.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënësve të temës:

Përshkruan format erozive dhe ato akumulative të relievit fluvial (lumor) glacial, të relievit eolik dhe të atij abraziv.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I-6; II-6; IV-3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2, 5.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Veprimtaria e erës (eolike)

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Identifikon prej librit-atlasit (videos) format e krijuara nga veprimi i erës (eolik);
- Përshkruan qartë format erozive dhe format akumulative të krijuara nga veprimi i erës.

Kriteret e suksesit: Duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto apo edhe video të krijuara nga veprimi i erës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Kimia, Fizika, TIK (Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Minileksion

Nxënësve iu jepen udhëzime në fillim të orës, sa për t'i orientuar ata drejt rezultateve.

Një prej sqarimeve të mundshme:


Nga veprimi i erës krijohen format erozive dhe ato akumulative.

Format e krijura nga veprimi i erës janë: oazat, dunet, kërpuhat, dritarja...

Veprimtaria e erës

Lëvizja horizontale e ajrit quhet **erë**. Në disa vende era ka shpejtësi të madhe dhe arrin ta ndryshojë relievin e Tokës. Më të përshtatshme për veprimin e erës janë vendet me amplituda të mëdha të temperaturës, lagështi të vogël dhe mungesë të vëgjetacionit, pra aty ku ajri mund të lëvizë me shpejtësi më të madhe. Shkretëtirat dhe brigjet detare janë vendet më të përshtatshme për krijimin e formave eolike (të erës). Në shkretëtirat e nxehta, temperatura e ajrit kalon 35 °C, madje temperatura e ajrit është regjistruar deri në 58 °C. Vise aride (të thata) konsiderohen territoret ku sasia vjetore e reshjeve është më e vogël se 250 mm/vit.

? Nëse temperatura e ajrit në shkretëtirën e Saharasë është regjistruar 58 °C, sa duhet të jetë temperatura e rërës?



Mënyra e bartjes së materialeve të shkërfëta nga era (burimi: Marshak, 2015)




Stuhi ere në Irak (burimi: Marshak, 2015)



Erozioni i erës është më i fuqishëm afër sipërfaqes së Tokës. Aty copëzat shkëmbore, që nuk mund të ngrihen nga era, përmes fuqisë së erës, godasin shkëmbinjët duke i erodur më shumë. Format që krijohen kanë trajtë të kërpudhës.

Format kryesore të veprimtarisë së erës janë: **dunat, valëzimet, hamadat, jardangët** etj. **Dunat** janë kodra të krijuara nga era. Ato mund të shkojnë disa metra lartësi dhe të jenë të njëpasnjëshme. Ndërsa, **valëzimet** janë forma valësh të ulëta të krijuara nga era, por në viset bregdetare. Hamadat janë pjesë të shkretëtirave, kryesisht të ngritura, ku rëra është larguar nga era.



Format e relievit eolik (burimi: Marshak, 2015)



Pyetje

1. Pse alterimi fizik është shumë i theksuar në viset shkretëtinore?
2. Cilat forma të relievit krijohen nëpër shkretëtira?

69



Ndërtimi i njohurive:

Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Nxënësit mbajnë shënime në fletore nga materialet e shkruara, prezantime, diskutime në klasë dhe nga shfaqjet në video.

Shfaqjet video dhe nxënësit organizojnë informacionet drejt veprimit të erës, si:

Problemi/zgjidhja

Krahaso/dallo

Shkak/pasojë

Propozimi/mbështetja

Qëllimi/veprimi/përfundimi

Koncepti/përfundimi

https://www.youtube.com/watch?v=kOf_xdgqpk8

<https://www.youtube.com/watch?v=PQmon7Rj6ns>



Përforsimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Paragraf përmbledhës

Secilit grup iu jepet një fletë, në të cilën kërkohet të shkruajnë mendimet e tyre për temën apo t'i plotësojnë mendimet që i kanë dhënë grupet e tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e identifikimit dhe të përshkrimit të formave erozive dhe të atyre akumulative të veprimtarisë së erës.

Detyrë:

Plotësojnë fletoren e punës, faqe 43.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VI
Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:
 Përshkruan format erozive dhe akumulative të relievit fluvial (lumor) glacial, të relievit eolik dhe të atij abraziv.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6; II-6; IV-3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2, 5.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Veprimtaria e valëve të detit (abrazive)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon format e krijuara nga veprimtaria e valëve të detit;
- Përshkruan format e krijuara nga veprimtaria e valëve të detit.

Kriteret e suksesit: Duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto apo edhe video të krijuara nga veprimi i valëve të detit.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Kimia, Fizika, TIK (Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Minileksion


Nxënësve iu jepen udhëzime në fillim të orës, sa për t'i orientuar ata drejt rezultateve. Një prej sqarimeve të mundshme: valët e detit, duke e goditur vazhdimisht bregun, tjetërsojnë-ndryshojnë bregun, duke krijuar forma të ndryshme. Nga veprimi i valëve të detit krijohen strofka e valës, klifi...

Veprimtaria e valëve të detit

Në ujin e deteve, oqeaneve e liqeneve zhvillohen tri lloje të lëvizjeve: valët, batica e zbatica, rrymat oqeanike, të cilat ndikojnë në ndryshimin e brigjeve të ishujve dhe kontinenteve. Rolin kryesor në ndryshimin e brigjeve e kanë **valët e detit**, që shkaktohen nga ndikimi erës.

Veprimtaria e valëve të detit njihet si **erozion abraziv**. Valët e detit krijojnë forma erozive dhe akumulative. Format më të njohura erozive janë: **strofka e valës** dhe **klifi**, ndërsa format më të njohura akumulative janë: **ranishta, laguna, shigjetat, tombola** etj. Strofka e valës dhe klifi formohen në brigje shkëmbore, ndërsa format akumulative janë më të pranishme në brigje të rrafshëta.

Klifi është shpat shkëmbor i pjerrët deri në nivel të detit. Në pjesën e poshtme të klifit, aty ku godet vala, krijohet **strofka e valës**.




Strofka e valës dhe klifi. Disa forma të relievit abraziv (burimi: Monroe & Wicander, 2015)

Ranishta (plazhi) është formë akumulative, e cila krijohet me anë të transportit dhe depozitimit të materialeve të erodura nga brigjet e detit. Me kalimin e kohës, copëzat këndore rumbullakohen dhe imtësohen. Materialet e erodura jo vetëm që ndikohen nga valët e detit, por edhe nga rrymat detare, të cilat ndikojnë në depozitimin e tyre dhe formojnë **ledhin ranor ose lidon**. Me anë të erozionit dhe depozitimit krijohet edhe **laguna**, e cila është formë e gjirit detar, ku uji i detit futet në të. Në Shqipëri njihet laguna e Karavastasë, e Nartës etj. **Tombola** është formë akumulative e cila lidh ndonjë ishull me pjesën kontinentale.



70




Veprimtaria e valëve të detit

Rolin kryesor në modelimin e bregdetit e kanë:

- a) rrymat oqeanike; b) valët e detit; c) baticat dhe zbaticat.

Shkruaj format e relievit abraziv në figurë.



Forma bregdetare e paraqitur në figurë është _____.

Format erozive të relievit detar janë:

Format akumulative të relievit detar janë:



Rretho përgjigjen e saktë:

Klifi dhe strofka e valës zhvillohen në shkëmbin:

- a) të fortë; b) të dobët.

Tombola krijohet nga shkëmbin:

- a) të fortë (kompaktë); b) të dobët (shkrifët).

44



Ndërtimi i njohurive:

Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Nxënësit mbajnë shënime në fletore nga materialet e shkruara, prezantime, diskutime në klasë dhe nga shfaqjet në video.

Shfaqet video dhe nxënësit duhet të kenë fokusin që të organizojnë informacionet drejt veprimit të valëve të detit, si:

Problemi/zgjidhja

Krahaso/dallo

Shkak/pasojë

Propozimi/mbështetja

Qëllimi/veprimi/përfundimi

Koncepti/përfundimi

<https://www.youtube.com/watch?v=ztemzxsx00U>


<https://www.youtube.com/watch?v=4rqrRPVrWJO>



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Harta e koncepteve



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e identifikimit dhe për përshkrimin e qartë të formave të krijuara nga veprimi i valëve të detit.

Detyrë:

Plotësojnë fletoren e punës, faqe 44.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VI
Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:
 Shpjegon rolin e relievit në veprimtaritë njerëzore dhe rreziqet në litosferë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II-6; IV-3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2, 5.1, 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Klasifikimi i relievit - Roli i relievit në veprimtarinë e njeriut

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan format e relievit;
- Shpjegon rolin e relievit në veprimtarinë e njerëzve;
- Propozon masat që duhen marrë për ta mbrojtur relievin-litosferën.

Kriteret e suksesit: Duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto apo edhe video të ndryshme të klasifikimit të relievit - roli i relievit në veprimtarinë e njeriut.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Kimia, Fizika, TIK (Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS


Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Stuhi menimesh

Shtrohet pyetja se çka dini ose mendoni se dini për njësinë mësimore “Klasifikimi i relievit - Roli i relievit në veprimtarinë e njeriut”.
 Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë, pa dallim, qofshin të sakta apo jo.

Klasifikimi i relievit

Relievi si pjesë përbërëse e gjeosferës është faktor me rëndësi jo vetëm për veprimtarinë e njeriut, por edhe për rolin që ka në kushtëzimin e proceseve të ndryshme natyrore. Relievi ndikon në shpërndarjen dhe drejtimin e ujërave sipërfaqësore. Masivët e mëdhenj të relievit ndikojnë në mot dhe klimë.


Sipas lartësisë mbidetare dhe pjerrësisë së shpatave, dallohen këto forma dhe elemente të relievit: ultësirat, fushat, kodrat, bregoret, malet mesatare, malet, majat, qafat.



Ultësira është pjesë e sheshtë e relievit, e cila lartësi deri në 200 metra. Ultësirat shtrihen kryesisht në skajet e kontinenteve, p.sh.: Ultësira Perëndimore Shqiptare, Ultësira e Evropës Perëndimore, Ultësira Gjermano-Polake. Ultësira dhe fusha mund të jenë nocione të njëjta, por ato dallojnë për nga lartësia mbidetare, ultësirat kanë lartësi të vogël mbidetare (p.sh.: Ultësira Perëndimore Shqiptare **0-200 m**), ndërsa fushat kanë lartësi mbidetare më të madhe (p.sh.: Fusha e Kosovës **500-600 m**, Fusha e Dukagjinit **300-500 m**).

Fushëgropa është sikurse fusha, por e rrethuar me male dhe ka origjinë tektonike.

Rrafshnalta është formë e relievit, e rrafshët, por që gjendet në lartësi të mëdha mbidetare, p.sh.: e Tibetit, Altiplano etj. **Kodra** është formë e relievit e cila veçohet në kuadër të një fushe. **Malet** janë forma të ngritura të relievit, të cilat veçohen për nga lartësia, vëllimi, drejtimi i shtrirjes etj. Në Kosovë janë të njohura: Bjeshkët e Nemuna, Malet e Sharrit. Pika më e lartë e një mali quhet **majë mali** (maja e Gjeravicës, e Rudokës, e Lubotinit etj.). Pika më e ulët ndërmjet dy majave të malit quhet **qafë malore** (qafa e Prevalles, e Duhllës etj.).



Roli i relievit në veprimtarinë e njeriut

Relievi është njëri nga komponentët kryesorë të mjedisit gjeografik, që ka luajtur rol kryesor në veprimtarinë e njeriut.

Relievi ndikon në klimë. Në terrenet malore, rrjedha e shpejtë e ujit, sasia e mjaftueshme e ujit, mundëson ndërtimin e akumulacioneve të ujit. Zonat malore karakterizohen me biodiversitet të lartë, që është edhe si rezultat i ndikimit të vogël të njeriut. Malet mund të jenë të pasura me xehe të caktuara. Edhe pse paraqesin pengesë për zhvillimin e komunikacionit, njeriu përmes teknologjisë ka arritur të ndërtojë rrugë moderne e të hapë tunele. Zonat koordinore-malore me pjerrësi të madhe, njeriu i ka përshtatur për nevoja të bujqësisë duke i tarracuar. Kullotat malore (alpine) bëjnë të mundshme zhvillimin e blegtorisë (Sharri në Kosovë).

Relievi fushor, për shkak të tokave cilësore dhe kushteve të tjera natyrore, ka mundësuar zhvillimin e bujqësisë, në veçanti të lavëtarisë. Pjerrësia e vogël e terrenit, tokat me kushte të mira fiziko-ujore dhe trashësia e shtresës pedologjike kanë mundësuar kultivimin e drithërave, perimeve etj. Në viset fushore është koncentruar pjesa më e madhe e popullsisë, vendbanimeve dhe infrastrukturës.

Meqë toka bujqësore është e kuftuar, njeriu duhet të bëjë planifikimin adekuat të vendbanimeve dhe infrastrukturës përcjellëse, me qëllim të ruajtjes së tokës.



Relievi i një pjese të Evropës



Tarracimi i shpateve

Detyrë

Përkruani relievit e rrethinës suaj.

72



Ndërtimi i njohurive:

Pyetja sjell pyetjen

Paraqiten video a foto të ndryshme të klasifikimit të relievit.

Roli i relievit në veprimtarinë e njeriut.

Gjatë shikimit të videos ose të fotove nxënësit duhet të kenë parasysh pyetjet:

1. Identifikuat format e relievit?
2. Cili është roli i relievit në jetën dhe veprimtarinë e njerëzve?
3. Cilat masa do t'i merrnit ju për të mbrojtur relievit?

<https://www.youtube.com/watch?v=XIE9IFVSu4U>

<https://www.youtube.com/watch?v=4C5FrjqndWg>



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Paragraf argumentues

Kërkohet nga nxënësit që në mënyrë individuale të punojnë një paragraf, duke arsyetuar rolin e relievit në rëndësinë ekonomike.

Disa nga punimet lexohen nga nxënësit, pjesa e palexuar merret nga arsimtari dhe vlerësohet në shtëpi.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përshkrimit, shpjegimit dhe masat e propozuara për ruajtjen e relievit.

Detyrë:

Të plotësojnë fletoren e punës, faqe 46.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 32

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Tregon përbërjen e atmosferës, shtresat dhe karakteristikat kryesore të tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-7; II-6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përbërja dhe struktura e atmosferës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon përbërësit kryesorë të atmosferës;
- Shpjegon shtresat e atmosferës;
- Përshkruan karakteristikat kryesore të shtresave të atmosferës.

Kriteret e suksesit: Duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto apo edhe video të ndryshme të shtresave të atmosferës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Kimia, Fizika, TIK (Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Organizues grafik: Përvijimi i të menduarit

Disa nga idetë e mundshme:



ATMOSFERA

Përbërja dhe struktura e atmosferës


Atmosfera është mbështjellësi i gaztë i Tokës. Ajo na mbron nga rrezatimi diellor dhe luan rolin kryesor në zhvillimin e proceseve meteorologjike, si dhe siguron kushte optimale për jetë të organizmave të gjallë. Po të mos ishte atmosfera, gjatë ditës temperatura e ajrit do të ishte shumë e lartë, kurse shumë e ulët gjatë natës.

Atmosfera e Tokës ka ndërtim shtresor dhe formë sikurse forma e Tokës, e shtypur në pole dhe e zgjeruar në ekuator. Pjesa më e madhe e atmosferës përbëhet nga dy elemente kimike: **azoti** dhe **oksigjeni**. Përbërësit e tjerë janë: argoni, dyoksidi i karbonit, avulli i ujit etj. Secili përbërës ka rëndësi jetike për gjallesat në Tokë. Ajri përmban edhe aerosole (grimca të ndryshme), që ndihmojnë në kondensimin e avujve të ujit.

Ajri është i pangjyrë, pa shije, pa erë dhe pa formë, me një përzierje që vepron si gaz i vetëm. Ajri është përçjellës i dobët i nxehtësisë. Është aq i rrallë, sa që rrezja e diellit e përshkon (**diaterm**). Prandaj, ajri ngrohet nga sipërfaqja ku ndodhet, duke marrë vetitë termike të saj. Po të ngrohej direkt nga dielli, do të duhej që me rritjen e lartësisë, të ishte temperatura më e lartë, por është e kundërta.

Deri në 100 km lartësi është e koncentruar 99.99 % e atmosferës. Sa më tepër që largohemi nga sipërfaqja e Tokës, grimcat që përbëjnë atmosferën rrallohen, për shkak se graviteti ka tërhequr më shumë grimca afër Tokës. Shtresat e atmosferës sipas temperaturës janë: **troposfera, stratosfera, mezosfera dhe termosfera**.

Troposfera është shtresa e poshtme e atmosferës dhe një nga shtresat më të rëndësishme. Rreth 90 % e masës së ajrit ndodhet këtu. Kufiri i sipërm luhatet deri në 18 km në ekuator, 12 km në gjerësi të mesme dhe 8 km në pole. Me rritjen e lartësisë, **temperatura ndryshon në 0.64 °C në çdo 100 m lartësi** (6.4 °C/1 km), i njohur si **gradienti termik**. Të gjitha dukuritë meteorologjike ndodhin në troposferë.




74

Stratosfera është shtresa e dytë e atmosferës dhe shtrihet deri në 50 km lartësi. Në këtë shtresë ndodhet **ozoni** që absorbon rrezet ultravjollçë, të cilat janë të dëmshme. Së bashku me troposferën përbëjnë 99.9 % të masës totale të atmosferës. Në bazë të matjeve të 25-vjeçarit të fundit vërehet zvogëlimi i ozonit, që tregon për ndryshimet klimatike në atmosferën e Tokës.

Mezosfera është shtresa e tretë dhe shtrihet nga 50-80 km lartësi. Ka shtypje shumë të vogël të ajrit. Shpeshherë pranon pluhur kozmik dhe të meteoritëve me të cilët krijohen kristale të vogla akulli dhe paraqiten retë e argjendta.

Termosfera i takon pjesës më të lartë të atmosferës. Ndodhet ndërmjet lartësisë 80-480 km. Temperatura arrin deri në 1,200 °C.

Në lartësi më të mëdha, atmosfera e Tokës rrallohet dhe kalon në hapësirën ndërplanetare ku temperatura është -273 °C (zero absolute).



75



Ndërtimi i njohurive:
Shpjegim i përparuar

Paraqitet përmbajtja e temës: Atmosfera, shtresat e saj dhe përbërja. Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin për çështjen e parë të mësimin i shkruajnë idetë. Paraqiten video ose foto të ndryshme të shtresave të atmosferës dhe shpjegon atmosferën.

https://www.vascak.cz/data/android/physicsatschool/template.php?s=mf_atmosfera&l=en

Pasi mbarohet pjesa e parë e leksionit, iu kërkohet të shohin shënimet-listat e tyre. Në vijim bëhet pyetje: Çka ka të përbashkët midis listave tuaja dhe atyre që u panë në video apo lexim? Cilat gjëra të reja mësuat? Vazhdohet me leksion dhe kërkesa/pyetje.

<https://www.liveworksheets.com/w/sq/gjeografi/7014638>



Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënës:
Tabela e koncepteve

Udhëzohen nxënësit se si të formohet tabela. Një model i mundshëm:

Shtresat e atmosferës	Lartësia	Temperatura	Veçoritë e tjera
Troposfera			
Stratosfera			
Mezosfera			
Termosfera			

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e shpjegimit dhe të përshkrimit të shtresave dhe karakteristikat e atmosferës.

Detyrë:

Të plotësojnë fletoren e punës, faqe 46 dhe 47.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 33

Test përmbledhës

Për mësimdhënësin/en

97

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan rëndësinë e rrezatimit diellor, temperaturat dhe ndryshimet në planin horizontal dhe në atë vertikal.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-7; II-6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Rrezatimi diellor

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon rëndësinë e rrezatimit diellor për planetin Tokë dhe jetën në të.

Kriteret e suksesit: Duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto apo edhe video të rrezatimit diellor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Kimia, Fizika, TIK (Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Stuhi mendimesh


Pyetje e mundshme:

1. Çka dini për rrezatimin diellor?


Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.

Rrezatimi diellor

Burimi kryesor i energjisë për Tokën është Dielli. Temperatura në sipërfaqen e Diellit është rreth 6,000 °C dhe kjo energji përhapet në formë të valëve elektromagnetike. Në Tokë arrijn vetëm 1 (një) nga 2 miliardë pjesë të rrezatimit.



Rrezatimi diellor dhe tokësor (burimi: Christopherson & Birkeland, 2015)



Heliografi

Rrezatimi elektromagnetik i Diellit përbëhet nga spektri ultravjollcë, i dukshëm dhe infrakuq. Syri i njeriut sheh vetëm spektrin e dukshëm (ngjyrat: vjollcë - kuq). Pjesa më e madhe e spektrit të padukshëm (ultravjollcë dhe infrakuq) absorbohet nga atmosfera dhe përbërësit e saj. Rrezatimi që vjen direkt në Tokë quhet rrezatim i drejtpërdrejtë, ndërsa rrezatimi që vjen si rezultat i shpërndarjes nga retë dhe elementet e tjera në atmosferë quhet rrezatim difuz. Vetëm një pjesë e energjisë arrijn deri në sipërfaqe të Tokës (tujë apo kontinent).




Diellzimi apo insolationi paraqet shkëlqimin diellor dhe shprehet me numrin e orëve me Diell të regjistruara në stacionin meteorologjik. Diellzimi matet me helio-

Diskutoni në klasë: Pse Prishtina ka më shumë orë me Diell se Peja?

Diskutoni në klasë: gjatë dimrit keni qenë për shkrim në një zonë malore. Pse e ndjeni nevojën e përdorimit të syzeve të ndërr Diellit? Gjatë ecjes për një breshkë në një tujë ju mund të marratohet më shumë se në viset e tjera tuashore. Pse Dielli na duket me ngjyrë të ndryshme gjatë ditës?

graf. Prishtina ka afërsisht 2,120 orë/vit, Prizreni 2,059 orë/vit, Peja 1,945 orë/vit, ndërsa Ferizaj 2,056 orë/vit. Edhe elementet në sipërfaqen fizike të Tokës ndikojnë në sasinë e rrezatimit, në veçanti në reflektimin e saj. Ky reflektim quhet albedo dhe shprehet në përqindje (%). Sipërfaqet e bardha reflektojnë më shumë se ato me ngjyra të zeza. Materialet me ngjyrë të zezë absorbojnë më shumë rrezatimin.


Gjatë mesditës, rrezet e diellit bëjnë rrugë më të shkurtrë nëpër atmosferë, ku me këtë rast absorbohet spektri i dritës me gjatësi valore më të madhe (e kuqe, e portokalltë), ndërsa drita e kaltër përthyeret nëpër atmosferë, andaj Dielli duket më i verdhë dhe qielli i kaltër. Ndryshe ndodh në mbrëmje, kur rrezet e diellit kalojnë rrugë më të gjatë nëpër atmosferë, andaj absorbohen rrezet me gjatësi valore më të vogël (e kaltër), kështu që vrojtuesit i duket sikur Dielli ka ngjyrë të kuqe.



Këndi në të cilin bien rrezet e diellit në Tokë në ekuinoks dhe solstic


Diskutoni në klasë. Si ndikon raporti ditë-natë (15h:9h) gjatë verës në vendin tuaj, në bilancin e energjisë që merr Toka? Po dimrit, kur raporti është në favor të natës (9h:15h)?

Trajektorja e Diellit në vende të ndryshme (burimi: Aguado & Burt, 2015)



Rrezet e diellit u duhen rreth 8 minuta për të ardhur deri te sipërfaqja e Tokës. Pasi të kalojnë nëpër atmosferë, arrijnë në sipërfaqen e Tokës. Këndi në të cilin bien varet nga forma e Tokës (gjerësia gjeografike) dhe pozita e saj gjatë rrotullimit rreth Diellit (revolucionit).

Rrezet e diellit përhapen në formë të tufës. Për shkak të formës elipsoide të Tokës, rrezet e diellit nuk bien në kënd të njëjtë në të gjitha gjerësitë gjeografike. Në gjerësitë e vogla gjeografike (brezi i vapës), rrezet bien në kënd të drejtë, duke zënë sipërfaqe më të vogël, ndërsa në gjerësitë e mëdha gjeografike rrezet e diellit bien në kënd më të vogël, duke zënë sipërfaqe më të madhe, me ç'rast reflektimi është më i madh.



Këndi dhe sipërfaqja që zënë rrezet e diellit në gjerësi të ndryshme gjeografike (burimi: Christopherson, 2015)

Ndërtimi i njohurive:
Pyetja sjell pyetjen

Paraqiten video ose foto të ndryshme të rrezatimit diellor.
Gjatë shikimit të videos ose të fotove, nxënësit duhet të kenë parasysh pyetjen:

1. Identifikuat shkaktarët e rrezatimit diellor?

<https://www.youtube.com/watch?v=abCHY3qbiaU>
<https://www.youtube.com/watch?v=tv5bbKxTO54>

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit:
Shkrim reflektues

Secilit grup iu jepet një fletë, në të cilën kërkohet të shkruajnë mendimet e tyre për temën, apo t'i plotësojnë mendimet që i kanë dhënë grupet e tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e shpjegimit mbi rrezatimin diellor.

Detyrë:

Plotësojnë fletoren e punës, faqe 48 dhe 49.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan rëndësinë e rrezatimit diellor, temperaturat dhe ndryshimet në planin horizontal dhe në atë vertikal; Gjen temperaturën mesatare ditore, mujore e vjetore të ajrit dhe amplitudat ditore dhe vjetore të temperaturës së ajrit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-7; II-6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2; 5.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Temperatura e ajrit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Interpreton ndryshimin e temperaturës me rritjen e lartësisë;
- Përshkruan ndryshimin e temperaturës në bazë të gjerësisë gjeografike;
- Llogarit temperaturën mesatare ditore, mujore e vjetore të ajrit;
- Shpjegon amplitudat ditore dhe ato vjetore të temperaturës së ajrit.

Kriteret e suksesit: Duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto apo edhe video të temperaturës së ajrit.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Kimia, Fizika, TIK (Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Copëza të përziera

“Copëzat e përziera” nënkupton teknikën ku nxënësve iu jepet një fjalë e ndarë në letra, në copëza fjalësh, për t'i radhitur ato dhe për të formuar me to një fjalë.

Temperatura e ajrit

Temperatura e ajrit është elementi i motit dhe i klimës. Njerëzit, kur interesohen për motin, së pari pyesin për temperaturën e ajrit. **Temperatura e ajrit** paraqet gjendjen e energjisë së masës së ajrit në moment të caktuar kohor në një vend të caktuar. Ajri është përcjellës i dobët i nxehtësisë dhe është diaterm, që nënkupton se përshkohet nga rrezet e diellit. Ajri merr veçori të substratit ku ndodhet. Dallimet më të mëdha janë në mes të masës ujore (det, oqean, liqen) dhe tokësore (kontinente), ngaqë kanë veti fizike të ndryshme.



Diskutoni në klasë: Në orët e paradites, në rërën e plazhit nuk mund të ecni kështu: zbatohet për shkak të temperaturës, ndërsa, nëse hyni në det për t'u larë, uji ju duket i ftohtë. Pse ndodh kjo?

Temperatura e ajrit ndryshon me rritjen e lartësisë mbidetare. Ky ndryshim quhet **gradient termik vertikal** dhe ka vlerën **0.64 °C/100 m**. Mund të ndodhë, në veçanti në fushëgropa, që me rritjen e lartësisë, të rritet temperatura e ajrit. Kjo dukuri quhet **inversion termik**.

Temperatura e ajrit matet në orët: 7, 14 e 21 dhe gjendet temperatura mesatare ditore. Temperatura mesatare mujore gjendet duke llogaritur temperaturën mesatare ditore për ditët e muajit. Kurse, temperatura mesatare vjetore llogaritet duke mbledhur temperaturën mesatare mujore për muajt e vitit.





Diskutoni në klasë: Në një ditë me diell, kur temperatura e ajrit është 15 °C ju mund të dilni jashtë me një bluzë të hollë, ndërsa ju duket shumë ftohtë për t'u larë në ujë (det, liqen, pishinë, banjë) në temperaturë të njëjtë. Si e shpjegoni këtë?

Ecuria ditore e temperaturës së ajrit është: në mëngjes është në minimum, pastaj vlera e temperaturës rritet deri në orën 14-15 kur është maksimumi dhe fillon të zvogëlohet deri në mëngjesin e ditës tjetër. Ndryshimi ditëor i temperaturës së ajrit quhet **amplitudë ditore**.

Gjatë vitit, nga janari deri në korrik-gusht, temperatura e ajrit rritet, pastaj ulët në drejtim të dhjetorit. Ndryshimi i temperaturës së ajrit ndërmjet muajit më të nxehtë (korrikut) dhe muajit më të ftohtë (janarit) quhet **amplitudë vjetore e ajrit**. Me rritjen e gjerësisë gjeografike, rritet amplituda vjetore dhe e kundërta.

Ecuria vjetore e temperaturës së ajrit në disa stacione në gjerësi të ndryshme gjeografike (burimi: Marshak, 2015)





Temperatura e ajrit matet me **termometër** dhe **termograf**. Me përdorimin e termometrave digjitalë, temperatura mund të matet në çdo moment brenda 24 orëve. Kështu, ne do të jemi të parapërgatitur për t'u veshur varësisht nga moti që do të mbretërojë.

Për të bërë analiza të temperaturës së ajrit, punohen harta me izoterme. Këto harta i ndihmojnë shkencëtarët që ta kuptojnë rolin e faktorëve natyrorë në shpërndarjen e temperaturës në Tokë.

Izotermet janë vija që bashkojnë vende me temperaturë të njëjtë në Tokë.



Termografi

Shtëpiaja e termometrave (vendoset në 1.8-2 metra lartësi, ka ngjyë të bardhë, orientohet veri-jug, dera është nga veriu)



Pyetje dhe detyra

1. Çfarë roli luan atmosfera për botën e gjallë në Tokë?
2. Krijo një tabelë ku do të vendosin shtresat e atmosferës dhe veçoritë e saj.
3. Çfarë roli luan ozoni? Çfarë po ndodh me shtresën e ozonit në Tokë? Cilat do të ishin pasojat e mungesës së shtresës së ozonit?

79

Një model i mundshëm:

matet termometër me Temperatura e ajrit



Ndërtimi i njohurive:
Shpjegim i përparuar

Paraqitet përmbajtja e temës: Atmosfera, shtresat e saj dhe përbërja. Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin për çështjen e parë të mësimi i shkruajnë idetë.

Lëshohet video ose paraqiten foto të ndryshme për temperaturën e ajrit.


<https://www.youtube.com/watch?v=Dk9VHHFUbqo>

Pasi mbarohet pjesa e parë e leksionit, iu kërkohet nxënësve të shohin shënimet-listat e tyre. Në vijim bëhet pyetje: Çka ka të përbashkët midis listave tuaja dhe të atyre që u panë në video apo lexim? Cilat gjëra të reja mësuat? Vazhdohet me leksion dhe kërkesa/pyetje.



Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit:
Organizues grafik: Harta e koncepteve

Një nga idetë e mundshme:



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e interpretimit, të përshkrimit dhe të shpjegimit mbi temperaturën e ajrit.

Detyrë:

Me termometër, një javë, nxënësit duhet ta matin temperaturën ditore në ora 07:00, 14:00 dhe 21:00, dhe të përfundojnë temperaturë mesatare javore.

Reflektim përvojë dhe orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VI
Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënimit të temës:
 Tregon përbërjen e atmosferës, shtresat dhe karakteristikat kryesore të tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-7; II-6; IV-3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përf forcim - përbërja dhe struktura e atmosferës

Rezultatet e të nxënimit të orës mësimore:

- Tregon përbërjen e atmosferës, katër shtresat dhe karakteristikat kryesore të secilës prej tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto apo edhe video të ndryshme të shtresave të atmosferës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Kimia, Fizika, TIK (Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit

Formohen grupet me 1, 2, 3 - 1, 2, 3..., varësisht nga numri i nxënësve që posedon klasa, pastaj formohen grupet me njëshet, pastaj me dyshet dhe treshet. Njësheve iu kërkohet të punojnë në flipçart për përbërjen e atmosferës, dysheve për troposferën dhe stratosferën, tresheve për mezosferën dhe termosferën. Në grupe diskutohet, komunikohet dhe bëhen pyetje, me qëllim të përfitimit të njohurive brenda grupit. Pastaj, njëri prej njësheve e shpjegon pjesën e vet, dyshet dhe treshet po ashtu. Dhe krejt në fund njëri nga të gjitha grupet i shpjegon të gjitha pjesët.


ATMOSFERA

Përbërja dhe struktura e atmosferës

Atmosfera është mbështjellësi i gaztë i Tokës. Ajo na mbrohet nga rrezatimi diellor dhe luan rolin kryesor në zhvillimin e proceseve meteorologjike, si dhe siguron kushte optimale për jetë të organizmave të gjallë. Po të mos ishte atmosfera, gjatë ditës temperatura e ajrit do të ishte shumë e lartë, kurse shumë e ulët gjatë natës.

Atmosfera e Tokës ka ndërtim shtresor dhe formë sikurse forma e Tokës, e shtypur në pole dhe e zgjeruar në ekuator. Pjesa më e madhe e atmosferës përbëhet nga dy elemente kimike: **azoti** dhe **oksigjeni**. Përbërësit e tjerë janë: argoni, dyoksidi i karbonit, avulli i ujit etj. Secili përbërës ka rëndësi jetike për gjallesat në Tokë. Ajri përmban edhe aerosole (grimca të ndryshme), që ndihmojnë në kondensimin e avujve të ujit.


Ajri është i pangjyrë, pa shije, pa erë dhe pa formë, me një përzierje që vepron si gaz i vetëm. Ajri është përcjellës i dobët i nxehtësisë. Është aq i rrallë, sa që rrezja e diellit e përshkon (**diaterm**). Prandaj, ajri ngrohet nga sipërfaqja ku ndodhet, duke marrë vetitë termike të saj. Po të ngrohej direkt nga dielli, do të duhej që me rritjen e lartësisë, të ishte temperatura më e lartë, por është e kundërta.



Deri në 100 km lartësi është e koncentruar 99.99% e atmosferës. Sa më tepër që largohemi nga sipërfaqja e Tokës, grimcat që përbëjnë atmosferën rrallohen, për shkak se graviteti ka tërhequr më shumë grimca afër Tokës. Shtresat e atmosferës sipas temperaturës janë: **troposfera**, **stratosfera**, **mezosfera** dhe **termosfera**.

Troposfera është shtresa e poshtme e atmosferës dhe një nga shtresat më të rëndësishme. Rreth 90% e masës së ajrit ndodhet këtu. Kufiri i sipërm luhatet deri në 18 km në ekuator, 12 km në gjerësi të mesme dhe 8 km në pole. Me rritjen e lartësisë, **temperatura ndryshon në 0.64 °C në çdo 100 m lartësi** (6.4 °C/1 km), i njohur si **gradienti termik**. Të gjitha dukuritë meteorologjike ndodhin në troposferë.

Në grafikun e mëposhtëm, paraqit përbërësit kryesorë të atmosferës.



Plotëso tabelën, duke shkruar të dhënat e kërkuara në kolona.

Shtresa e atmosferës	Lartësia	Temperatura	Veçoritë e tjera
Troposfera			
Stratosfera			
Mezosfera			
Termosfera			


Me rritjen e lartësisë mbidetare, temperatura zbrit për _____/100 m.

47



Ndërtimi i njohurive:

LAYERS OF THE ATMOSPHERE



https://www.vascak.cz/data/android/physicsatschool/template.php?s=mf_atmosfera&l=en

Në këtë pjesë të orës, mësimdhënësi, përmes linkut të paraqitur, u mundëson nxënësve t'i shohin shtresat e atmosferës, dhe në mënyrë interaktive ta demonstron ndryshimin e temperaturës dhe të presionit atmosferik me rritjen e lartësisë.



**Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit:**

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen grupet por edhe individët brenda grupeve. Ata vlerësohen për saktësinë e shpjegimit dhe përshkrimin të shtresave dhe karakteristikave të atmosferës.

Detyrë:

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografia

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Shpjegon shtypjen atmosferike, ndryshimin e saj, rolin e saj në erëra dhe në vetë jetën e njeriut.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-4,6; II-5,6; III-3,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre. 2.2

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shtypja e ajrit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Demonstron me eksperiment;
- Shpjegon procesin e shtypjes atmosferike në atmosferë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.



Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libër, fotografi, hartë, projektor, laptop, kavanoz, çakmak, letër, enë porcelani dhe monedhë metalike.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Fizika.

Shtypja e ajrit


Në jetojmë në pjesën e poshtme të atmosferës, andaj mbi trupin tonë është masa e ajrit e cila ndodhet në atmosferë. Ajri, përkundrazi që ka peshë shumë të vogël, bën presion mbi trupin tonë. Për shkak të gravitetit, thërrmijat e ajrit janë të koncentruara më afër sipërfaqes së Tokës. Edhe pse ajri bën presion në trupin tonë, trupi i njeriut ka shtypje në brendësi, që është e barasvlershme me shtypjen e ajrit, përndryshe ne do të shkatëroheshim nga ajri që na rrethon.



Thërrmijat e ajrit nuk janë të shpërndara njësoj në atmosferë. Sa më afër Tokës, ka thërrmija më shumë, ndërsa shtypja është më e lartë, sa më lart në atmosferë, thërrmija ka më pak, rrjedhimisht shtypja është më e vogël.

Shtypja e ajrit matet me **barometër** dhe **barograf**, ku shprehet në milibar (mb) dhe në njësi të tjera. Shtypja normale është 1013.2 mb ose 101,320 paskalë (Pa), ndryshe quhet **presion normal atmosferik**. Në 1 metër kub në nivel të detit janë rreth 1.3 kg ajër. Në jetën e përditshme për matjen e shtypjes së ajrit përdoret edhe barometri me merkur.

Shtypja e ajrit në sipërfaqe të Tokës është e lidhur ngushtë me veçoritë termike dhe lagështinë e masës së ajrit. Duke qenë se klima varet nga faktorë të ndryshëm, masat e ajrit në Tokë kanë veçori të ndryshme. **Ajri i ftohtë peshon më rëndë se ajri i nxehtë dhe ajri i thatë peshon më rëndë se ajri i lagësht.** Ajri që përmban lagështi është më i lehtë se ajri i thatë.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Demonstrim nga mësimdhënësi

Bëhet demonstrimi i një shembulli me një gotë të mbushur (1/2 gotës) me ujë dhe një letër, e cila vendoset në grykën e gotës. Gota kthehet përmbyss dhe uji nuk derdhet.





Ndërtimi i njohurive:

Veprimtari e drejtuar e të lexuarit dhe e të menduarit: DRTA

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të lexojnë tekstin i cili është ndarë në paragrafë, ku pas secilit paragraf parashtron pyetje për diskutim:

- Sa është presioni normal atmosferik mbi sipërfaqen e detit?

- Ç'kuptoni me presion atmosferik?

- A mendoni se shtypja e ajrit është e njëjtë në çdo vend të tokës? Pse?

- Cilët faktorë ndikojnë që me rritjen e lartësisë mbidetare të zvogëlohet shtypja e ajrit?

- Analizo grafikun:

- Diskutoni: me çfarë problemesh ballafaqohen alpinistët që ngjiten në majat më të larta në kontinente?


Vazhdohet me pyetje të tjera.

Përforsimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Eksperiment për demonstrim (punë individuale)

Për të realizuar këtë eksperiment na nevojitet një kavanoz, çakmak, letër, një enë porcelani (pjatë) dhe një monedhë metalike. Me këtë eksperiment arrijmë të



Barografi

Në harta të ndryshme, shtypja e ajrit paraqitet me izobare. **Izobaret** janë vijat të cilat bashkojnë vendet me shtypje të njëjtë të ajrit. Vendet me presion të lartë shënohen me H (*ang. High - e lartë*) dhe tregojnë maksimumin barik, ndërsa vendet me presion të ulët shënohen me L (*ang. Low - e ulët*) dhe tregojnë minimumin barik. *Ajri lëviz nga vendi me shtypje më të lartë në drejtim të vendit me shtypje më të ulët.*

Zonat barike janë të përhershme dhe të përkohshme. Në Evropë, në muajin janar, zonat kryesore barike janë: **cikloni i Islandës, anticikloni i Siberisë dhe anticikloni i Azoreve. Cikloni i Islandës** krijohet në Oqeanin Atlantik rreth ishullit të Islandës. Për vendet e Evropës sjell mot të vranët e me shi, ndërsa në dimër me borë. **Anticikloni i Azoreve** është zonë burimore barike e përhershme. Për vendet e Evropës sjell mot të ngrohtë dhe me shi. **Anticikloni i Siberisë** aktivizohet gjatë muajve të dimrit. Atje krijohet masa ajrore e ftohtë dhe e thatë. Lëviz deri në vendin tonë, duke sjellë mot të ftohtë dhe të thatë. Shpeshherë gjatë vitit, nga Afrika Veriore vjen masë ajrore e nxehtë dhe e thatë, e cila duke kaluar nëpër Mesdhe, merr lagështi. Në dimër, kjo masë e ajrit ndikon në shkrirjen e shpejtë të borës.

Gjatë muajit korrik, anticikloni i Siberisë zhduket, po ashtu edhe cikloni i Islandës. Rolin kryesor e ka Anticikloni i Azoreve dhe shpeshherë vjen i "nxehti afrikan" (*temperaturë e lartë e ajrit*).



Pyetje

1. Pse shtypja e ajrit është më e madhe afër sipërfaqes së Tokës?
2. Pse duke shkuar më në thellësi të ujit veshët tuaj "oshtijnë"? Po me rritjen e lartësisë mbidetare?
3. Pse Anticikloni i Siberisë zhduket në pjesën verore të vitit? Çka ndikon?

81

kuptojmë veprimet e shtypjes së ajrit.

- Në enën e mbushur me ujë, vendosim monedhën metalike.
- Në anën tjetër, brenda në kavanoz digjet letra.
- Kavanozi kthehet përmbys mbi pjatën e mbushur me ujë.

Rezultati është se vëllimi i gazit në fund është rreth 1/5 më pak, dhe presioni atmosferik mbi ujë në tigan heq ujin në shishe.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, demonstrim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 52-53.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VI
Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:
 Tregon përbërjen e atmosferës, shtresat dhe karakteristikat kryesore të tyre;
 Shpjegon shtypjen atmosferike, ndryshimin e saj, rolin e saj në erëra dhe në vetë jetën e njeriut.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I-2,6; II-6,7; III-5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 RNF: 2. Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre. 2.2

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Qarkullimet e ajrit në atmosferë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon qarkullimin e ajrit në atmosferë dhe proceset që ndodhin në shtresat atmosferike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti “Gjeografia 6-Dukagjini”, fletore pune, atlas gjeografik, fletë A4, mjete shkrimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Fizika.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
 Diskutim i përbashkët në klasë

Për të krijuar një diskutim me nxënësit, parashitrohen pyetje nga jeta e përditshme që lidhen me njësinë mësimore:

- Pse kur hapni derën dhe dritaren në dhomë krijohet rrymim i shpejtë i ajrit? Madje, disa personave më të

Qarkullimet e ajrit në atmosferë

Për shkak të ndikimit të faktorëve klimatikë, atmosfera në sipërfaqe të Tokës ka veçori të ndryshme fizike, që i bën masat e ajrit të dallojnë njëra nga tjetra. Duke qenë se masat e ajrit dallojnë mes vete në shtypje, ajri detyrohet të lëvizë. Lëvizja e ajrit pranë sipërfaqes së Tokës quhet **erë**. Drejtimi i erës varet nga gradienti barik horizontal që mundëson drejtimin e erës. Përveç drejtimin, era ka edhe shpejtësi. Instrumenti që shërben për matjen e shpejtësisë së erës quhet **anemometër**, ndërsa drejtimi matet me **erëtrregues**.



Drejtimi i erës shprehet me anë të horizontit nga fryn apo mund të ketë edhe emër të veçantë. Rastisja shprehet në promila (‰) dhe paraqitet drejtimi (V, J, L, P, VL, JL, VP, VL) ose mund të jetë me qetësi (C - calm).



Erëtrreguesi i Villit dhe anemometri

Erërat klasifikohen sipas qëndrueshmërisë kohore, duke u ndarë në **erëra të përhershme (planetare), periodike (sezonale) dhe të përkohshme**.

Erërat e përhershme janë: pasatet dhe antipasatet, erërat perëndimore dhe erërat polare (lindore).

Nga zona subtropike në drejtim të ekuatorit fryjnë **pasatet**. Drejtimi fillestar i tyre është për në ekuator, por, nën ndikimin e rotacionit të Tokës (forca e Koriolisit), ato devijojnë. Në ekuator ndeshen, ngrihen, kondensohen dhe sjellin reshje. Në kufirin e sipërm të troposferës marrin drejtimin e kundërt dhe quhen **antipasate**.

Nga zona subtropike (30°) në drejtim të gjerësive gjeografike 60° fryjnë **erërat perëndimore**. Për vendet e Evropës këto erëra sjellin reshje në vendet e Evropës Perëndimore, duke e bërë klimën e tyre më të lagësht.

Në gjerësitë e mëdha gjeografike, nga viset polare drejt gjerësive 60° fryjnë **erërat polare**, të cilat njihen si erëra lindore. Erërat polare janë të ftohta dhe të thata.



A E DINI SE

Në vitin 1861 në Cerapunxhi të Indisë kanë rënë 26.5 m reshje, kryesisht gjatë muajve prill-tetor (monsuni veror). Vetëm në korrik 1861 sasia e reshjeve ishte 9.3 m (9300 mm).


82




A E DINI SE

Edhe në Malet e Sharrit haset era e malit dhe luginës. Era e malit dallohet lehtë gjatë natës. Arsyja: në kullotat alpine të Sharrit, banorët zhvendosin delet. Në viset më të ulëta nuhatet era e plehut të deleve.

Era e luginës dhe era e malit janë karakteristike për zonat malore dhe realizohet nga mosngrohja e njëjtë e shpatëve malore dhe luginës. Gjatë ditës, për shkak të relievit më të rrafshët, luginat ngrohet më shumë se shpatët malore. Ajri i ftohtë zbrit në luginë dhe pastaj ngrihet drejt majave të malit. E kundërta ndodh gjatë natës. Nga majat e malit ajri i ftohtë zbrit duke lëvizur përgjatë shpatëve.



(a) Era e luginës



(b) Era e malit

Era e luginës dhe era e malit
(burimi: Christopherson & Birkeland, 2015)

Në Tokë paraqiten edhe erërat lokale, të cilat fryjnë në regjione të caktuara gjeografike. Më të njohurat janë: **bura**, **murrllani**, **juga** etj.

Bura (bora) është erë lokale që fryn përgjatë bregut lindor të Adriatikut me drejtim tokë-det, nga Trieshta deri në Shqipëri. Është erë e ftohtë dhe e thatë. **Murrllani** është erë e ftohtë dhe e thatë, që fryn dimrit me drejtim nga Alpet e Shqipërisë drejt detit Adriatik. **Juga** është erë e nxehtë që fryn nga Afrika Veriore drejt Gadishullit Ballkanik, duke shkakuar valë në bregdetë. Është erë mjaft e fortë.



Përforcimi: **Konsolidimi i të nxënës:** *Punë e pavarur*

Nxënësit analizojnë disa fotografi dhe japin përgjigje.

Plotësojnë figurat në fletore pune, duke emëruar erërat e përhershme dhe ato periodike, duke treguar drejtimin fillestar të tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 54-55.

- ndjeshëm mund t'u pengojë.
- Çka mendoni, a lëviz ajri?
- Si mund ta shpjegoni që ajri lëviz?

Përgjigjet e nxënësve shënohen në tabelë.



Ndërtimi i njohurive: *Ditari dypjesësh*

Arsimtari udhëzon nxënësit që të lexojnë tekstin në heshtje dhe individualisht.

Deri sa nxënësit lexojnë, arsimtari shënon në tabelë disa pyetje ku nxënësit, pas leximit, i plotësojnë me ato fragmente që mendojnë se e plotësojnë pyetjen e parashtruar.

Pyetje	Komente (fragmente nga teksti)
1. Çka quajmë erë?	
2. Cilat janë erërat e përhershme dhe si funksionojnë?	
3. Cilat janë erërat lokale?	
4. Çka është era e malit?	
5. Çka janë monsunet?	
6. Si i kemi klasifikuar erërat?	
7. Cilat janë erërat e përhershme?	

Reflektim përvojën e orës mësimore:

Mësimi 39

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan konceptin “lagështi e ajrit” dhe kushtet e formimit të reshjeve atmosferike; Punon dhe interpreton grafikët e shpërndarjes hapësinore dhe kohore të reshjeve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I-2, 4; II-6; III-5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre. 2.2

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lagështia e ajrit dhe reshjet atmosferike

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan qarkullimin e ujit në atmosferë dhe pasojat që ndodhin nga ky proces.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti “Gjeografia 6-Dukagjini”, fletore pune, atlas gjeografik, fletë A4, mjete shkrimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Fizika.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Rikujtim i njohurive paraprake


Fillon ora mësimore duke përsëritur me ndihmën e pyetjeve njësitë e kaluara. Gjatë marrjes së përgjigjeve nga ana e nxënësve, mësimdhënësi ndërlidh njësinë që do të zhvillohet, gjithnjë duke i shtyrë nxënësit që të identifikojnë njësinë e re.




Pyetje dhe detyra

1. Cilat janë erërat e përhershme dhe si funksionojnë?
2. Sqaro erërat: të luginës, të malit, të detit dhe të tokës.

Lagështia e ajrit dhe reshjet atmosferike



Sipas formës, janë tri lloje të reve: puplore (cirrus), shtresore (stratus) dhe grumbullore (kumululus). Në qiell, retë zakonisht kombinohen mes vete duke krijuar forma të ndryshme. Të mbuluarit e qiellit me re quhet **vransirë** dhe shprehet në të dhjetat (0-10) ose % (përqindje).



Reshjet janë produkt i kondensimit dhe sublimimit të avullit të ujit në atmosferë, në formë të lëngët apo të ngurtë, afër sipërfaqes së Tokës apo në lartësi. Dallohen **reshjet e ulëta** dhe **reshjet e larta**.

Reshjet e ulëta janë: *vesa, bryma, krahneza*. **Vesa** është formë e reshjeve të ulëta, kur avulli i ujit kondensohet në bimë në sipërfaqe të Tokës. Është karakteristike për fundin e verës. **Bryma** është reshje e ulët kur avulli i ujit sublimohet afër Tokës në bimë dhe barishte. Është karakteristike për vjeshtën dhe pranverën gjatë netëve të kthjellta. **Krahneza** është sikur bryma, por që prek edhe degët e pemëve.

87

- Sa shtresa i ka atmosfera?
- Nga cilat gazra përbëhet?
- Tregoni se si ngrohet atmosfera.
- Sa lloje të reshjeve i njihni?

Përgjigjet e nxënësve shënohen në tabelë.



Ndërtimi i njohurive:

Punë në grupe

Nxënësit të ndahen në tri grupe, sipas tri gjendjeve agregate (të gaztë, të ngurtë dhe të lëngët).

Secili grup duhet të hulumtojë për reshjet atmosferike që i takojnë gjendjes agregate përkatëse.

Pjesa e fundit; përhapja e reshjeve në Tokë është e përbashkët për të tria grupet, secili grup tregon se ku përhapen reshjet e tyre përkatëse.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Punë të pavarur individuale

- Duke u bazuar në librin bazë të gjeografisë, nxënësit plotësojnë llojet e reve në fletore pune (vransirave).
- Analizoni procesin e qarkullimit të madh të ujit.
- Shpjegoni këtë dukuri: Pse ura ngrin më shpejt se rruga?
- Kategorizo me tabelë llojet e reshjeve, të ulëta dhe të larta.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 56-57.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VI
Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:
 Formulon konceptet “mot” dhe “klimë”, dhe bën dallimin midis tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-7; II-6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Moti dhe klima

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon qartë konceptet “mot” dhe “klimë”;
- Përshkruan saktë dallimin në mes të koncepteve “mot” dhe “klimë”.

Kriteret e suksesit: Duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto apo edhe video të motit dhe të klimës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Kimia, Fizika, TIK (Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
 Minileksion

Gjatë kësaj faze të orës mësimore, mësimdhënësi jep disa sqarime për njësinë e re mësimore “Moti dhe klima”, vetëm sa për t’i orientuar nxënësit në drejtim të rezultateve të të nxënit për njësinë mësimore.



Pyetje

1. Si arrihet deri te kondensimi i masës së ajrit në lartësi?
2. Cilat janë reshjet e ulëta dhe reshjet e larta?
3. Diskutoni me familjarët tuaj: si mund të mbrohen pemët në rast të paraqitjes së ngricave?
4. Cilat janë dëmet nga breshri?


Moti dhe klima

Moti dhe klima janë dy nocione të ndryshme, të cilat kanë të bëjnë me atmosferën. Shpeshherë, në jetën e përditshme ne i ngatërrojmë këto dy nocione. **Moti** paraqet gjendjen e elementeve meteorologjike në një moment dhe vend të caktuar, ndërsa **klima** është gjendja mesatare e elementeve të motit në një vend të caktuar.

Në jetën e përditshme dëgjojmë shprehje të ndryshme si: “mot i keq”, “mot i lig”, “mot i mirë”, të cilat janë shumë relative dhe subjektive. Të gjitha këto nocione varen nga kërkesat e individëve të caktuar në jetën e përditshme apo në ndonjë veprimtari të tyre. Për turizmin veror, me rëndësi është moti me diell dhe pa shi. Për turizmin dimëror, me rëndësi është të ketë reshje bore. Bujku, në varësi të periudhës vegetative, dëshiron mot me reshje etj.

Moti mund të shprehet sipas elementeve meteorologjike që dominojnë, si: mot me diell, mot i vranët, mot me mjegull, mot me shi etj. Në të gjitha këto aspekte, me rëndësi jetike është parashikimi i motit, në veçanti në rast të motit ekstrem.

Moti dhe klima varen nga faktorët astronomikë dhe gjeografikë. *Gjerësia gjeografike, relievi (lartësia mbidetare, ekspozicioni, drejtimi i shtrijës), shpërndarja e masave tokësore e ujore, rymat oqeanike, lokacioni gjeografik, vegetacioni janë faktorët kryesorë që përcaktojnë motin dhe klimën e një vendi. Moti dhe klima përcaktohen duke njohur elementet meteorologjike/klimatike, si: temperaturën e ajrit, shtypjen e ajrit, reshjet, avullimin, drejtimin dhe shpejtësinë e erës etj.*



Moti është i lidhur ngushtë me veçoritë termike të masës së ajrit që ndodhen në trevën e caktuar. Në zonat anticiklonare (me shtypje më të lartë se normalja) mbretëron mot i kthjellët, stabil. Ndërsa, në zonat ciklonare (me shtypje më të ulët se normalja) mbretëron mot i vranët, jostabil, që shoqërohet me reshje, erë etj.

Moti dhe klima

Moti paraqet _____

Klima paraqet _____

Nëse themi se temperatura momentale e ajrit është 20 °C, lagështia relative e ajrit 70 °C, era fryn nga veriperëndimi me shpejtësi 10 km/h, fjala është për:

- a) klimën; b) motin.

Shkruaj faktorët kryesorë që ndikojnë në klimën e vendeve në Tokë.

Shtypja e ajrit tregon ndryshimet e motit. Tregoni llojin e motit në varësi të shtypjes së ajrit.

Provoni të tregoni motin në stinën e verës dhe të dimrit.



58



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Rishikim në dyshe

Nxënësit, në dyshe diskutojnë për motin dhe për klimën. Pastaj shikohet nëse ka mospërputhje mes informacionesh, nxirren konkluzione, krahasohen shenjat dhe diskutohen mospërputhjet mes tyre për temën e lartpërmendur.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e shpjegimit dhe të përshkrimit të koncepteve “mot” dhe “klimë”.

Detyrë:

Ushtroni në fletore pune, faqe 58.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:



Ndërtimi i njohurive:

Sistemi ndërveprues i shënimeve: INSERT

Para dhënies së tekstit për lexim, pjesëmarrësit udhëzohen që gjatë leximit, në fund të fjalisë apo të paragrafit në të cilin tregohet diçka, duhet të vihen shenjat e INSERTIT.

https://www.youtube.com/watch?v=A_LOsCaRzNA

√	+	-	?
*	*	*	*
*	*	*	*

Mësimi 41

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Identifikon faktorët që ndikojnë në formimin e klimës dhe zonat klimatike nga ekuatori në pole.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-7; II-6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 6.1; 6.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Tipat klimatikë në Tokë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon dy faktorët që ndikojnë në formimin e klimës;
- Interpretin zonat klimatike nga ekuatori në pole;
- Vlerëson rëndësinë e klimës në botën bimore, shtazore dhe njerëzore.

Kriteret e suksesit: Duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto apo edhe video të tipave klimatikë të Tokës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Kimia, Fizika, TIK (Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Minileksion

Gjatë kësaj faze të orës mësimore, mësimdhënësi jep disa sqarime për njësinë e re mësimore “Tipat klimatikë”, vetëm sa për t'i orientuar nxënësit në drejtim të rezultateve të të nxënit për njësinë mësimore.

Në jetën e përditshme ka shumë rëndësi parashikimi i motit. Duke njohur motin në ditët e ardhshme, njeriu mund të përgatitet për shëndetin dhe veprimtarinë e tij. Shkenca e cila merret me studimin e motit quhet **meteorologji**.

Derisa moti paraqet gjendjen momentale të elementeve meteorologjike, klima paraqet gjendjen mesatare shumëvjeçare të elementeve meteorologjike. Për njohjen e klimës duhen të dhëna të periudhave të gjata (30 vjet është periudha standarde). **Klimatologjia** është shkencë e cila merret me studimin e klimës.



Pyetje dhe detyra


1. Shpjegoni nocionet mot dhe klimë.
2. Çfarë moti mbretëron në anticiklon dhe çfarë në ciklon?
3. Tregoni llojin e motit në varësi të shtypjes së ajrit.

Tipat klimatikë në Tokë


Ekzistojnë klasifikime të ndryshme për klimën në Tokë. Klasifikimi i klimës bëhet edhe në bazë të veçorive të klimatit brenda brezave të ngrohtësisë në Tokë.

Brezi i vapës shtrihet ndërmjet dy rrafshëve tropikë. Në këtë brez, rrezet e diellit bien në kënd të madh gjatë gjithë vitit. Nga 2 herë rrezet e diellit kulminojnë në ekuator, ndërsa nga një herë në rrethin tropik përkatës. Në brezin e vapës ekziston **klima ekuatori-ale** me temperaturë të lartë dhe reshje të shumta; **klima tropikale** dhe **klima monsunike**, që kanë nga një stinë të thatë dhe një të lagësht. Në veri e jug të ekuatorit haset klima e thatë shkretënore dhe klima e stepave (barishte të ulëta). Këto lloje klimatike gjenden në Afrikë, Amerikën Jugore, Azinë Jugore e Juglindore.

Brezi mesatar klimatik shtrihet ndërmjet rrafshëve tropikë dhe rrafshëve polarë në të dyja hemisferat. Ekzistojnë dallime të mëdha ndërmjet pjesëve jugore dhe atyre veriore të brezit mesatar. Në kuadër të brezit mesatar hasen këta tipa klimatikë: mesdhetar, atlantik, kontinental, i ashpër kontinental.




Hartë klimatike e Tokës (burimi: Miller & Spoolman, 2012)



Klima mesdhetare dallohet me verë të nxehtë, të gjatë e të thatë dhe me dimër të butë, me reshje të pakta. Haset më së shumti në brigjet e detit Mesdhe. Edhe në bregdetin shqiptar haset klima mesdhetare. Është shumë e përshtatshme për turizmin veror, andaj miliona turistë vijnë verës në brigjet e Mesdheut për të pushuar. **Klima atlantike** veçohet me reshje të shumta e të shpërndara gati njësoj gjatë gjithë vitit. Dimri është i freskët, ndërsa vera është e ngrohtë (jo shumë e nxehtë). Haset në Evropën Perëndimore. **Klima kontinentale** veçohet me verë të nxehtë e dimër të ftohtë. Tipi kontinental ka përhapje të madhe në hemisferën veriore, në veçanti në Evropën Lindore. Edhe në Kosovë haset tipi kontinental, sidomos në Rrafshin e Kosovës. Ndërsa, **tipi i ashpër kontinental** me verë që nuk është shumë e nxehtë, ndërsa dimri është shumë i ashpër haset në Siberinë Lindore etj.

Tip i veçantë klimatik është **klima malore**, e cila haset në zonat e larta malore. Veçohet me dimra të gjatë, me bore, ndërsa vera të shkurtra e të freskëta. Edhe në Kosovë, në malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna haset ky tip klimatik.



92

Tipi klimatik shkretinor

Tipi klimatik mesdhetar

Tipi klimatik atlantik

Tipi i ashpër kontinental



Ndërtimi i njohurive:

Sistemi ndërveprues i shënimeve: INSERT

Para dhënies së tekstit për lexim, pjesëmarrësit udhëzoohen që gjatë leximit, në fund të fjalisë apo të paragrafit në të cilin tregohet diçka, duhet të vihen shenjat e INSERTIT.

Më pastaj jepet teksti për lexim. Pas leximit, pjesëmarrësit në dyshe diskutojnë çfarë lexuan, krahasojnë shenjat etj.

<https://www.bing.com/videos/riverview/related-video?q=Climate%20types%20zone&mid=1EF61A3BE245717813201EF61A3BE24571781320&ajaxhist=0>

√	+	-	?
*	*	*	*
*	*	*	*



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënësve:

Rishikim në dyshe

Nxënësit, në dyshe diskutojnë për tipat klimatikë. Pastaj shikohet nëse ka mospërputhje mes informacionesh, nxirren konkluzione, krahasohen shenjat dhe diskutohen mospërputhjet mes tyre për temën e lartpërmendur.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e identifikimit, të interpretimit dhe vlerësimin e motit dhe klimën në botën bimorë, shtazore dhe njerëzore.

Detyrë:

Duke i shfrytëzuar të dhënat tabelare për reshjet dhe temperaturat, nga fletore pune faqe 59, nxënësit i shfrytëzojnë ato për të punuar grafikun të reshjeve dhe të temperaturave të shpërndarë nëpër muaj.

Reflektim përvojëdhënës për orën mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VI
Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:
 Përshkruan lidhjen e hidrosferës me litosferën, atmosferën, biosferën; qarkullimin e ujit në natyrë dhe vetitë fizike e kimike të ujit të detit botëror.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-2, 6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Hidrosfera: Cikli hidrologjik - Oqeanet dhe detet

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan lidhjen e hidrosferës me litosferën, atmosferën dhe biosferën;
- Shpjegon, qarkullimin e ujit në natyrë (cikli hidrologjik).

Kriteret e suksesit: Duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto apo edhe video të qarkullimit të ujit në natyrë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Kimia, Fizika, TIK (Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Stuhi mendimesh

Gjatë kësaj faze të orës mësimore, mësimdhënësi shtron pyetje se çka dini ose mendoni se dini për temën “Hidrosferën - cikli hidrologjik”.
 Mësimdhënësi i shënon mendimet e nxënësve në një skaj të tabelës.

HIDROSFERA

Toka është planeti unik në Sistemin Diellor dhe në univers. Kushtet natyrore të planetit kanë ndikuar në paraqitjen e jetës në të. Hidrosfera paraqet pjesën e lëngshme të Tokës, që shtrihet në kuadër të mbështjellësve të Tokës (litosferës, atmosferës dhe të biosferës). Hidrosfera përfshin gjithë ujërat në planet.

29% - Ujëra të ngjyera
71% - Ujë
97.5% - Ujëra të ëmbla
2.5% - Ujëra të ëmbla
68.9% - Ujëra të ëmbla
30.8% - Ujëra të ëmbla
0.3% - Ujëra të ëmbla

UIJË NË TOKË
 Pjesa më e madhe e ujit në Tokë - 97.5% është ujë i ngjyret që ndodhet në dete dhe oqeanet. Ndërsa 2.5% është ujë i ëmbël që gjendet në akullnaja, liqene, lumenj dhe ujëra nënësore.

21 marsi është Dita Botërore e Ujit. Bëni ndonjë aktivitet në shkollë me temën “Problemet me ujë në Tokë”

Shpërndarja e ujit në Tokë


Cikli hidrologjik

Cikli hidrologjik paraqet lëvizjen e ujit nëpër gjeosferat e Tokës. Me këtë rast uji ndërron vendin, gjendjen agregate, kalon nëpër disa procese hidrometeorologjike. Faktori që vë në lëvizje ciklin hidrologjik është energjia diellore. Cikli hidrologjik fillon me avullimin e ujit nga objektet ujore. Detet dhe oqeanet janë rezervuarët kryesorë të ujit. Përveç tyre, uji gjendet edhe në liqene, lumenj, kënetë, botë bimë. Avulli i ujit nga objektet ujore, për shkak të peshës, ngrihet në lartësi, i nënshtrohet gradientit termik dhe shndërrohet në formë të reze (kondensohet), që pastaj bie në formë të reshjeve. Pasi të bjerë në tokë, një pjesë e ujit rrjedh, një pjesë infiltron në shkëmbinj dhe pjesa tjetër avullohet përsëri në atmosferë.

96 Qarkullimi (cikli) hidrologjik

Oqeanet dhe detet

Nga sipërfaqja e përgjithshme e Tokës prej 510 milionë km², rreth 360 milionë km² (71 %) janë të mbuluara me ujë (dete dhe oqean), ndërsa pjesa tjetër prej 150 milionë km² (29 %) është e mbuluar me masë tokësore (ishuj, kontinente). Kur shikohet nga satelitët artificialë, planeti ynë duket si një glob i kaltër, i bardhë dhe pak në të kaftë, por që prania dominuese e ujit në sipërfaqe bën që Toka të marrë emrin "**Planeti i Kaltër**".



Planeti i Kaltër - pamje e Tokës nga satelitët

Oqeanet janë objektet më të mëdha ujore në Tokë. Brenda tyre gjendet numër i madh i deteve dhe së bashku lagin brigjet e kontinenteve dhe të ishujve. Në Tokë janë 5 oqeanë: **Paqësori, Atlantiku, Oqeani Indiani, Oqeani i Ngrirë i Veriut dhe Oqeani i Ngrirë i Jugut**. Oqeani Paqësor është më i madhi në planet. Ze gjysmën e sipërfaqes së oqeanëve. Është aq i madh sa do t'i zinte të gjitha kontinentet së bashku dhe do të mbetej zbrazët.

Në periferi të oqeanëve ndodhen detet. **Detet** janë hapësira më të vogla ujore që kanë lidhje me oqeanë. Disa nga detet në afërsi të Kosovës dhe trojeve shqiptare janë: *deti Adriatik, Egje, Jon, Mesdhe, Marmara, i Zi etj.*

Vetitë fiziko-kimike të oqeanit (detit) botëror

Vetitë kryesore fiziko-kimike të ujit të oqeanit (detit) botëror janë: *temperatura, kripshmëria, tejdrukshmëria, ngjyra dhe lëvizja.*

Temperatura e ujit të oqeanit botëror është veti me rëndësi fizike, e cila ndikon jo vetëm në procese të caktuara fizike, por edhe në përhapjen e gjallesave detare. Duhet sasi e madhe e energjisë për rritje të temperaturës për 1 °C. Temperatura mesatare vjetore në sipërfaqen e oqeanit botëror është 17.5 °C. Temperaturat e ujit deri në 28 °C hasen në gjerësi të vogla (ekuator), pastaj me rritjen e gjerësisë gjeografike, temperatura zvogëlohet derisa në viset polare arrijnë në 0 °C. Ndërsa, me rritjen e thellësisë, zvogëlimi i temperaturës varion me gjerësinë gjeografike, por që në oqeanin (detin) e thellë temperatura është ndërmjet 0-4 °C.

97



Ndërtimi i njohurive:

Të nxënësit me këmbime: Grupet e ekspertëve

Në fillim, klasa ndahet në grupe të vogla fillestare. Më pas ftohen nxënësit t'i hapin librat, por para se të ftohen të lexojnë. Formohen grupet e ekspertëve.

1. Hidrosfera dhe cikli hidrolgjik;
2. Vetitë fizike dhe kimike të ujit të detit;
3. Lëvizja e ujit të detit.

Më pastaj, nga të gjitha grupet fillestare (1, 2, 3), ngritet një i njësheve, i cili është ekspert, dhe e shpjegon tërë njësinë mësimore, d.m.th., shpjegon pjesët e njësheve, të dysheve dhe të tresheve.

<https://www.youtube.com/watch?v=FzYjPpxP-Cw>




Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënësit:

Organizues grafik

Gjatë kësaj faze të orës kërkohet nga nxënësit që në mënyrë individuale të punojnë një organizues grafik, pastaj t'i prezantojnë punimet e tyre.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përshkrimit dhe të shpjegimit të lidhjes së hidrosferës me sferat e tjera dhe qarkullimin e ujit në natyrë.

Detyrë:

Plotësojnë fletoren e punës, faqe 59 dhe 60.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Dallon veçoritë e formave të lëvizjeve të ujërave të detit botëror (valët, rrymat detare dhe baticën dhe zbaticën).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-2, 6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vetitë fiziko-kimike të oqeanit (detit) botëror - Lëvizjet e ujit në detin botëror

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon tri vetitë fizike dhe kimike të ujit të detit;
- Dallon lëvizjet e ujërave të detit botëror, si: valët, rrymat detare, baticën dhe zbaticën.

Kriteret e suksesit: Duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto apo edhe video për vetitë fiziko-kimike të oqeanit (detit) botëror - Lëvizjet e ujit në detin botëror.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Kimia, Fizika, TIK (Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim për njohuritë paraprake

Drejtohemi me pyetje:

1. Cilat janë vetitë e ujit?
2. Çfarë lëvizje bën uji i detit?

Disa nga përgjigjet e mundshme:

1. Temperatura, ngjyra, i njelmët.
2. Valë, cunami...



Pilaka e Seki-t

Tejdukshmëria tregon thellësinë në metra, që mund të shihet me sy të lirë. Tejdukshmëria e ujit varet nga kripshmëria dhe prania e organizmave. Matet me pllakën e Seki-t, një disk me diametër 30 cm. Tejdukshmëria më e madhe është regjistruar në detin Sargas, 67 m.

Uji i detit është **pa ngjyrë**. Ngjyra është rezultat i veprimit të rrezeve të diellit. Spektri i kaltër i diellit depërton më thellë duke i dhënë ujit të detit ngjyrën e kaltër.

Në ujin e detit depërton edhe **zëri**. Shpejtësia e zërit është më e madhe në ujë se në ajër. Intensiteti i zërit zvogëlohet duke depërtuar në ujë për shkak të shpërndarjes, absorbimit dhe thyerjes në ujë. Shpejtësia e zërit në ujë me kripshmëri mesatare është 1500 m/sek.

Lëvizjet e ujit në detin botëror

Uji i oqeanit botëror është përherë në lëvizje. Për shkak të bashkëveprimit në mes të oqeanit botëror me atmosferën, veprimit të forcës gravitacionale të Hënës dhe Diellit, si dhe vetive të ndryshme fizike të shtresave të ujit, në oqeanin botëror mundësohet lëvizja e ujit. Uji bën tri lloje lëvizjesh: **valët, batica e zbatica** dhe **rrymat oqeanike**.

Valët janë lëvizje të ujit të detit të shkaktuara nga ndikimi i erës. Vala ka disa elemente, si: gjatësia, lartësia, perioda, kreshta, lugu etj. Këto elemente të valës varen nga shpejtësia e erës, koha e fryrjes së erës dhe distanca që ka bërë era. Valët zakonisht arrijnë deri në 4 m lartësi dhe 100 m në gjatësi. Në detin Adriatik, lartësia më e madhe e valës arrijn 10 m.

Në rast të ndonjë tërmeti me epiqendër nën oqean, krijohen valë të fuqishme disa metra që njihen si **cunami**, dëmet e të cilave janë shumë të mëdha, si në njerëz, ashtu edhe në infrastrukturë.

Batica e zbatica janë lëvizje të ujit të detit të shkaktuara nga ndikimi i forcës së gravitetit të Hënës dhe Diellit. Ngritja e ujit të detit quhet **baticë**, ndërsa tërheqja e ujit të detit quhet **zbaticë**. Këto lëvizje ndodhin çdo 6 orë dhe brenda 24 orëve shfaqen dy batica e dy zbatica. Hëna ka ndikim më të madh se Dielli për shkak të afërsisë. Lartësia e baticës në dete të hapura është 1-3 m. Në gjirin Fundy (Kanada) janë regjistruar baticat dhe zbaticat më të mëdha, deri në 17 m. Në Detin Adriatik afër Venedikut është regjistruar batica deri në 1 m, kurse në brigjet e Adriatikut në Shqipëri 30-40 cm.


Batica dhe zbatia në gjirin Fundy (Kanada)



Rrymat oqeanike (detare) janë lëvizje të cilat zhvillohen nën sipërfaqen e oqeanit (detit) deri në thellësi 200 m e rralë 300 m. Nga rrymat oqeanike më e njohura është rryma e Golfit, e cila nis nga gjiri i Meksikës dhe vjen në drejtim të Evropës Perëndimore dhe Veriore duke ndikuar shumë në klimën e vendeve.

Uji i detit ka veti të ndryshme fizike, në veçanti temperaturë dhe kripsmëri dhe rrjedhimisht dendësi të ndryshme.

Rrymat detare transportojnë sasi të madhe uji. Ato kanë rëndësi klimatike, duke mundësuar klimë më të nxehtë, respektivisht më të ftohtë për zonat bregdetare.



Rrymat kryesore detare (oqeanike) në Tokë (burimi: Trujillo & Thurman, 2016)



Pyetje

1. Cilat janë vetitë kryesore fizike të oqeanit botëror?
2. Çfarë lëvizje bën uji i detit (oqeanit)?
3. Si ndikojnë rrymat oqeanike në klimë?

100



Ndërtimi i njohurive:
Pyetja sjell pyetjen

Paraqitet video ose paraqiten foto të ndryshme për lëvizjet e ujit të detit;

Gjatë shikimit të videos ose fotove, nxënësit duhet të kenë parasysh pyetjet:

1. Identifikuat shkaktarët?
2. Cilat forma u krijuan?

<https://www.youtube.com/watch?v=p4pWafuvdrY>



Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit:

Organizues grafik: Përvijimi i të menduarit

Në mënyrë individuale nxënësit përgatitin organizues grafik për vetitë fiziko-kimike të oqeanit (detit) botëror - Lëvizjet e ujit në detin botëror. Pastaj, secili në mënyrë individuale i shënon idetë e tij/saj në tabelë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e tregimit dhe dallimit të vetive fiziko-kimike të oqeanit (detit) botëror - Lëvizjet e ujit në detin botëror.

Detyrë:

Plotësohet fletore pune, faqe 61 dhe 62.

Reflektim për veprimet e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Identifikon format kryesore të zhvillueshmërisë horizontale të bregdetit, duke veçuar veçoritë kryesore të tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-2, 6

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zhvillimi bregdetar

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon 3 format kryesore të zhvillimit horizontal të bregdetit;
- Shpjegon veçoritë kryesore të zhvillimit horizontal bregdetar;
- Arsyeton me shembuj zhvillimin e bregdetit në aspektin e zhvillimit ekonomik.

Kriteret e suksesit: Duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto apo edhe video të zhvillimit bregdetar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Kimia, Fizika, TIK (Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Minileksion

Gjatë kësaj faze të orës mësimore, mësimdhënësi jep disa sqarime për njësinë e re mësimore “Zhvillimi bregdetar”, vetëm sa për t’i orientuar nxënësit në drejtim të rezultateve të të nxënit për njësinë mësimore.



Zhvillimi bregdetar

Bregdet quhet vija e kontaktit në mes të tokës (kontinent, ishull) me detin apo oqeanin. Forma, shtrirja e bregdetit është e lidhur ngushtë me veprimin e forcave të brendshme dhe të jashtme, të cilat e kanë krijuar dhe ndryshuar vijën bregdetare.

Sa më shumë elemente të ketë bregdeti, si: ishuj, gadishuj, gjire, ngushtica etj., thuhet se ka **përthyeshmëri** më të madhe dhe e kundërta. Kontinenti evropian karakterizohet me përthyeshmëri të madhe bregdetare, por kontinenti afrikan ka përthyeshmëri të vogël. (*Gjeni në hartë dhe krahasoni*).

Sipas raportit morfologjik të kontinentit dhe oqeanit, bregdeti mund të jetë ultësinor (fushor), por edhe kodrinor-malor (i thepisur). Bregdeti i Adriatikut në Shqipëri është kryesisht fushor, ndërsa i Jonit në jug është i thepisur. Karakteri i bregdetit ka ndikuar edhe në llojin e plazhit. Derisa në Adriatikut e Shqipërisë plazhet janë kryesisht ranore, në detin Jon plazhet janë gurore.

Lagunat janë cekëtina ujore që ndahen nga objekte të mëdha ujore (deti, oqeani) me anë të një kordonit litoral (bregtor) apo atolit. Në bregdetin shqiptar hasen laguna e Nartës, e Karavastës etj. **Fjord** është luginë lumore e thepisur, e krijuar nga erozioni akullnajor. Ka shpate të thikëta e të larta, të cilat depertojnë thellë në kontinent. Fjordet hasen në Norvegji, Kili, Grenlandë, Alaskë etj.

Riasi është formë e bregdetit, e zhvilluar nga përmbytja e grykëderdhjes së lumit nga uji i detit apo oqeanit. Paraqiten në Spanjën VP, Irlandën JP, bregdetin jugor të Kinës etj.




Estuari është luginë lumore e përmytur. Uji i detit depërton thellë në sektorin e poshtëm të lumit. Grykëderdhja mund të ketë gjerësi deri në 100 km (Amazona). Estuaret kanë bërë të mundshme ndërtimin e porteve të mëdha detare, si: Londra në Temzë, Hamburgu në Elbe, Havri në Senë, Roterdami në Renë etj.

Korale janë organizma shtazorë që jetojnë si bimë. Lidhen kryesisht për vende të nxehta, në veçanti për rreth kupave vullkanike detare dhe krijojnë ishuj rrethorë të njohur si atole. Në oqeanin Indian është shteti i Maldiveve, i cili është i vendosur i tëri mbi korale. Përhapje shumë të madhe kanë në lindje të Australisë, ku ndodhet Barriera e Madhe Koralore.


Ishulli është pjesë tokësore e rrethuar në të gjitha anët me ujë. Një grup i madh ishujsh formojnë arkipelagun (arkipelagu i Malajës, i Egjeut, i Adriatikut etj.).

Gadishulli është pjesë tokësore, e cila rrethohet në tri anë me ujë, kurse ana tjetër është e ngjitur për kontinentin. Në Evropë janë: Gadishulli Ballkanik, Apenin, Pirinej, Skandinav etj.

Gjiri detar është pjesë e detit, e cila futet thellë në kontinent. Në bregdetin shqiptar dallohen: gjiri i Drinit, i Lalëzit, i Durrësit, i Vlorës etj. **Kepi** është kundërta e gjirit. Është pjesë tokësore e cila futet thellë në det (oqean). Në bregdetin shqiptar njihet kepi i Rodonit, i Gjuhëzës etj.



Riasi dhe krijimi i tij



Gjiri detar, ishulli dhe kepi

Forma të zhvillimit bregdetar



Ndërtimi i njohurive:

Sistemi ndërveprues i shënimeve: Tabela INSERT

Nxënësit pjesëmarrësit që gjatë leximit, në fund të fjalisë apo të paragrafit në të cilin tregohet diçka, duhet të vihen shenjat e INSERTIT.

Pastaj jepet teksti për lexim. Pas leximit, pjesëmarrësit në dyshe diskutojnë çfarë lexuan, bisedojnë për informacionet e reja, krahasojnë shenjat etj. Nxënësit i plotësojnë kolonat në tabelë.

<https://www.youtube.com/watch?v=lskmZCTKL68>

	√	+	-	?
*		*	*	*
*		*	*	*



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Paragraf argumentues

Gjatë kësaj faze të orës kërkohet nga nxënësit që në mënyrë individuale, për 5 minuta, të shkruajnë një paragraf: “Si ndikon zhvillueshmëria bregdetare në zhvillimin ekonomik”. Më pas lexohen paragrafët.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e identifikimit, të shpjegimit dhe arsytimin e ndikimit të zhvillimit bregdetar në zhvillimin ekonomik.

Detyrë:

Ushtrijnë në fletore pune, faqe 63.

● *Reflektim për veprimet e orës mësimore:*

Për mësimdhënësin/en

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Identifikon llojet e ujërave nëntokësore, mënyrën e formimit të tyre dhe karakteristikat kryesore të pjesëve përbërëse të lumit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I - 2, 4; II - 1, 5, 6; III - 1, 3, 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2. Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-gjeografike të mjedisit natyror e të atij human.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ujërat nëntokësore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan llojet e ujërave nëntokësore;
- Dallon ujërat arteziane nga ato sub-arteziane;
- Shpjegon rëndësinë e ujërave nëntokësore për jetën e njeriut.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografji, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi/ja iu drejtohet nxënësve me disa pyetje rreth njësisë mësimore që të nxisë kureshtje te ta:

- Si formohen ujërat nëntokësore?
- Pse në disa vende ujërat gjenden lehtë nën tokë, kurse në disa vende janë në thellësi të mëdha?


Ujërat nëntokësore

Gjatë ciklit hidrogjik, një pjesë e ujit rrjedh në sipërfaqe të Tokës duke formuar ujërat sipërfaqësore, ku uji mund të jetë në lëvizje (lumë) apo i qetë (liqen, moçal). Po ashtu, uji mund të jetë në gjendje të lëngtë dhe të ngurtë. Në **ujërat sipërfaqësore** hyjnë burimet, përrroskat, lumenjtë, liqenet, akullnajat dhe moçalet. Në varësi të veçorive të shkëmbinjve, një pjesë e ujit sipërfaqësor depërton (infiltron) në brendi të shkëmbinjve duke krijuar ujërat nëntokësore.

Ujëra nëntokësore janë ujëra që ndodhen nën sipërfaqen e Tokës e që lëvizin nëpër shkëmbinj. Pjesa më e madhe e ujërave nëntokësore e ka origjinën nga reshjet atmosferike, ku uji është infiltruar nën sipërfaqe të Tokës. Shkëmbinjtë përbajnë pore (zbrazëtira) që mundësojnë depërtimin, lëvizjen dhe grumbullimin e ujit nëntokësor. Poroziteti paraqet sasinë e zbrazëtirave (poreve) që ndodhet në shkëmbinj. Me rëndësi është që porët të jenë të lidhura mes tyre ku mund të qarkullojë uji.



Bëni një eksperiment të thjeshtë së bashku me mësimdhënësin. Mërrni një sasi dheu nga oborri i shkollës dhe vendosni në një enë. Shtoni ujë dhe shihni çka ndodh.



Përveç ujërave të lira, ujërat nëntokësore mund të jenë të rrethuara me shtresa joushleshuese, zakonisht shkëmbinj pa pore ose me shumë pak pore, ndërsa ndërmjet tyre ka një shtresë ujëmbajtëse (shkëmbinj me pore), duke formuar ujëra me presion (arteziane).

Ujërat arteziane janë me presion dhe, në rast të shpimit të tyre, krijohen burime si shatërvan (fontanë). Në varësi të presionit, uji nëntokësor mund të ngrihet, por të mos dalë mbi sipërfaqe të Tokës. Këto ujëra quhen **subarteziane**. Në Kosovë hasen ujërat arteziane, në veçanti në pjesën e Dukagjinit (Prizren, Suharekë) dhe në Istog.



Burimi i Drinit të Bardhë



Burimi termomineral i Banjës së Pejës

Dalja e ujit nëntokësor në sipërfaqe quhet **burim**. Burimet hasen në vendet ku niveli i ujërave nëntokësore prehet me sipërfaqen topografike. Ekzistojnë lloje të ndryshme të burimeve, të cilat klasifikohen sipas prurjes, temperaturës, kohës etj.

Burime të veçanta janë **burimet karstike** të cilat zhvillohen në shkëmbinj gëlqerorë. Njihen me emrin **gurra**. Të tilla në Kosovë janë: burimi i Drinit të Bardhë, Istogut, Vrellës etj.

Ndërsa, burimet të cilat kanë temperaturë qehen **burime termale**, ato që kanë mineralizim quhen **minerale** dhe, nëse përbajnë mineralizim e temperaturë, quhen **termominerale**. Të tilla në Kosovë janë: burimet e Banjës së Pejës, të Kllokotit, të Banjskës etj.



Diskutoni në klasë për llojet e burimeve që hasen në vendlindjen/rrethinën tuaj.



Pyetje

1. Çka është poroziteti i shkëmbinjve dhe çfarë rëndësie ka për ujërat nëntokësore?
2. Çka janë ujërat arteziane dhe subarteziane?
3. Shikoni në vendlindjen apo rrethinën tuaj për puset, të cilat shfrytëzohen për ujë nga popullsia. Sa është thellësia e tyre? Me çfarë kushte është e lidhur?

- Sa metra është thellësia e puseve në vendbanimin tuaj?
- Në vendet e ulëta ujë gjendet afër sipërfaqës së Tokës?
- Si ndikon relievi në ndryshimin e thellësisë së ujit në vende të ndryshme të Tokës?



Ndërtimi i njohurive:

Mësimdhënia e ndërsjellë

Mësimdhënësi u kërkon nxënësve ta lexojnë tekstin, të nxjerrin të dhënat për ujërat, ku derisa ata lexojnë dhe nxjerrin shënimet, të përvetësojnë pjesë të cilat iu caktohen dhe pastaj t'i thonë para të tjerëve, si p.sh.:

Nxënësi 1: Ujërat sipërfaqësore - janë burimet, përroskat, lumenjtë, liqenet, akullnajat dhe moçalet.

Nxënësi 2: Ujërat nëntokësore - janë ujëra që ndodhen nën sipërfaqen e Tokës e që lëvizin nëpër shkëmbinj.

Nxënësi 3: Ujërat arteziane - krijohen burime si shatërvan (fontanë).

Nxënësi 4: Burimi - është dalja e ujit nëntokësor në sipërfaqe.

Nxënësi 5: Burimet termale - janë burime të cilat kanë temperaturë.

Nxënësi 6: Burimet minerale - janë burime që kanë mineralizim.

Nxënësit e tjerë punojnë në fletoret e tyre dhe disa nga ta dalin e shënojnë në tabelë të klasës.



Përforsimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Rrjet i diskutimit

Paraqitet një figurë që përmban: burim normal, burim artezion, burim subartezion, akuifer artezion, akuifer i ujërave të lira (fletore pune, fq. 64).

Diskutohet për foton, me qëllim që mësimdhënësi, përmes saj, ta kuptojë se sa e kanë kuptuar nxënësit njësinë.

1. Çka është poroziteti i shkëmbinjve dhe çfarë rëndësie ka për ujërat nëntokësore?
2. Shikoni foton dhe jepni mendimin tuaj rreth ndikimit të ujërave nëntokësore në jetën e njerëzve?

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimin, gjithnjë duke e pasur parasysh kriterin mbi saktësinë e përgjigjeve për dallimin e llojeve të ujërave dhe shpjegimin e tyre.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune, në faqe 64.

Reflektim për veprimet e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Identifikon llojet e ujërave nëntokësore, mënyrën e formimit të tyre dhe karakteristikat kryesore të pjesëve përbërëse të lumit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I - 1, 4; II - 5,6; III - 1,3,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2. Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-gjeografike të mjedisit natyror e human.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lumenjtë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon format e lumenjve dhe format e ujërave të tjera;
- Shpjegon “Sistemin lumor” sipas sektorëve, duke treguar specifikat për secilin sektor.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, hartë memece, atlas gjeografik.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

A keni lumë afër vendbanimit tuaj? Sa lumenj të Kosovës dini? Sa janë të rëndësishëm lumenjtë për një vend? Nxënësit do të ngjyrosin në hartën memece rrjedhjet e lumenjve, të sjellë nga mësimdhënësi/ja në fleta të shtypura, duke u bazuar në atlaset e tyre.



106

Lumenjtë


Gjatë ciklit hidrologjik, një pjesë e ujit që bie në kontinente, rrjedh mbi sipërfaqe të Tokës. Rrjedha e ujit në sipërfaqe të Tokës në shtrat të caktuar quhet **lumë**. Lumenjtë paraqesin rëndësi të veçantë për njeriun. Civilizimet e lashta janë paraqitur buzë lumenjve. Kujtojmë se civilizimet, si: egjiptian (Nil), asirian e babilonas (Tigër e Euftrat), indus (Indi) dhe kinez (Huangho) janë paraqitur buzë lumenjve ku banorët përpos ujit kanë shfrytëzuar edhe tokën pjellore.

Lumenjtë në Tokë janë produkt i kushteve klimatike të ujëmbledhësit, në të cilin rrjedhin ata. Lumenjtë janë të përhapur gati në të gjitha pjesët e Tokës. Madje edhe në zonat aride (të thata) ekzistojnë lumenj, por që kanë veti hidrologjike karakteristike.


Lumi ka tri elemente kryesore: **burimin, rrjedhën dhe grykëderdhjen.**

Burimi i lumit mund të jetë ndonjë burim natyror, liqen, akullnaje apo edhe bashkim i përoskave. P.sh.: në Kosovë, Drini i Bardhë e ka burimin nga gurra e Radacit, që është burim i fuqishëm karstik. **Rrjedha hidrografike** është e gjithë gjatësia e shtratit të lumit prej burimit deri në grykëderdhje. Ndërsa, **grykëderdhja** është vendi ku lumi shkarkon ujërat e tij. Lumenjtë e mëdhenj (me kryesorët) derdhen në det apo oqean (Renë, Danubi, Rona, Temza, Po, Drini, Shkumbini etj.), por mund të derdhen edhe në liqen (Volga, Zeta, Tara etj.), në ndonjë lumë tjetër (Lumbardhi i Prizrenit derdhet në Drinin e Bardhë), ose edhe mund të avullohet uji i tyre (lumi Okavango në Afrikë).

Ujëmbledhësi lumor (pellgu ose basin) paraqet sipërfaqen që mbledh ujërat në drejtim të një lumi.




Ujëndarësi ndërmjet detit Ege dhe detit Adriatik (mali Oshlak)



Çdo ujëmbledhës lumor është i ndarë me ujëndarës, që zakonisht kalon nëpër pikat më të larta në terren. Në terrenet malore, ujëndarësi kalon nëpër kreshta dhe maja malesh, ndërsa në terrenet fushore është më vështirë që të përcaktohet shtrirja e tij.

Në Kosovë ndodhet "Suka e Dërmanit", e cila paraqet pikën nga e cila ujërat e Gadishullit Ballkanik rrjedhin në drejtim të tri deteve: **Adriatik, Detit të Zi dhe Egje**. Të gjitha ujërat e një vendi (lumenj, liqene, dete, akullnaja etj.) formojnë rrjetin hidrografik, ndërsa lumi me të gjitha degët e tij formon rrjetin lumor ose **sistemin lumor**.

Të lumenjtë vërehen dukuri të rralle hidrologjike siç është **bifurkacioni** - dukuria e ndarjes së lumit në dy degë, të cilat pa kthim rrjedhin në drejtim të dy deteve të ndryshme. I tillë është **bifurkacioni i Nerodimes**, në afërsi të Ferizajt, ku njëra degë rrjedh drejt Lepencit (Deti Egje), kurse tjetra drejt Sitnicës (Deti i Zi).



107



Ndërtimi i njohurive: Ditari dypjesësh

Në pjesën e dytë të orës, mësimmshënësi ndan tabelën në dy shtylla. Në shtyllën e parë, mësimmshënësi shënon disa fjalë kyçe dhe kërkon nga nxënësit që, duke lexuar njësinë mësimore "Lumenjtë", të bëjnë përshkrimin në shtyllën e dytë për këto fjalë.

Fjalët kyçe	Komenti jepet nga nxënësit
Lumenj	Formohet prej ujërave të burimit që lëvizin në drejtim të topografisë së relievit...
Ujëra sipërfaqësore	Përbëjnë të gjitha ujërat rrjedhëse në sipërfaqen e Tokës, si: lumenjtë, liqenet, kënetat, akullnajat.
Bifurkacion	Fenomen i rrallë ku lumi derdhet në dy degë.
Sistemi lumor	Kompleksiteti i degëve që ushqejnë lumenjtë.
Pellgu i lumit	E gjithë hapësira ku lumi ushqehet.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit: Rishikimi në dyshe

Nxënësit, së bashku me mësimmshënësin/en, shikojnë fotografinë në fletore pune, faqe 65, duke dhënë opinionin e tyre në pohimet e mëposhtme.

1. Gjatë një dite me diell, do të vëreni lumin e turbullt. Cilët faktorë kanë ndikuar që ai të bëhet i tillë?

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të saktësisë së përgjigjeve që kanë dhënë gjatë orës mësimore për dallimin e formave lumore dhe për shpjegimin e fotografisë.

Detyrë:

Të plotësojnë fletore pune, faqe 65 dhe 66.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VI
Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:
 Diferencon liqenet sipas origjinës së formimit të tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I - 1, 3; II - 1, 5, 6; III - 3, 5, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2. Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-gjeografike të mjedisit natyror e human.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Liqenet dhe Akullnajat

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Kategorizon liqenet sipas origjinës së formimit dhe tregon specifikat për llojin;
- Dallon tri lloje të liqeneve sipas origjinës;
- Krahason liqenet natyrore me ato artificiale.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkencat e natyrës, Matematika.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Diskutim i përbashkët

Cili është liqeni që e keni më afër vendlindjes suaj?
 Cila është rëndësia e këtij liqeni?
 Nga e marrin ujin liqenet?
 Në fotografi është liqeni i Batllavës. Tregoni sipas origjinës, cilit lloj të liqeneve i takon dhe pse.

Sasia e ujit që rrjedh nëpër lumë në një sektor të caktuar për njësi të kohës quhet **prurje**. Prurja e ujit në lumë varet nga kushtet klimatike. Në Kosovë, gjatë verës uji në lumenj pakësohet, ndërsa më së shumti ka ujë ndërmjet marsit dhe majit. Prurja mund të rritet në mënyrë të përnjëhershme gjatë reshjeve intensive.



Bifurkacioni i Nerodimes



Shpejtësia e ujit në lumë



Liqenet

Liqenet janë thellime në sipërfaqe të Tokës të rrethuara me masë tokësore, të mbushura me ujë dhe që nuk kanë lidhje direkte me detin. Liqenet janë objektet ujore, në të cilat ndodhet rreth 90 % e ujërave të ëmbla në gjendje të lëngshme në kontinente.

Shumica e liqeneve ndodhet në gjerësi të mëdha gjeografike dhe lartësi të mëdha mbidetare. Pjesa më e madhe e liqeneve ushqehet nga ujërat e lumenjve ose direkt nga reshjet. Shumica e liqeneve kanë ujë të ëmbël. Disa liqene në Tokë kanë ujë të njehtë, madje shumë të kripur (Deti i Vdekur). Liqeni më i madh në Tokë është liqeni Kaspik, ndërsa më i thelli është liqeni Bajkal.

Edhe uji në liqene, sikurse në dete lëviz, duke krijuar valë. Valët në liqene janë shumë më të vogla se në dete.

Origjina e liqeneve është e ndryshme. Hasen liqene **tektonike, erozive, akumulative dhe artificiale**.

Liqenet tektonike krijohen nga lëvizje tektonike (i Ohrit, i Prepsës, i Bajkalit etj.). Në këtë grup bëjnë pjesë liqenet rrelkte, që kanë qenë pjesë e deteve apo liqeneve të dikurshme (i Breznës – Kosovë, Kaspiku, Arali); liqenet vullkanike që krijohen në krater të vullkaneve të shuara etj.



Akullnajat

Akullnaja është masë e akullit e formuar për qindra ose mijëra vjet. Për t'u krijuar akullnaja, bora e këtij viti duhet të zihet nga bora e vitit të ardhshëm. Në këtë mënyrë bora akumulohet, ngjeshet dhe rikristalizohet. Akullnajat janë të përhapura gati në të gjitha gjerësitë gjeografike, madje edhe në viset në ekuator ka akullnaja të vogla malore (Papua Guinea e Re, Kilimanxharo). Në pjesët e larta të maleve po ashtu ka akullnaja (Alpe, Ande, Himalaje etj.).



Akullnajat kanë ndikim të rëndësishëm në klimën globale. Kur sipërfaqja dhe vëllimi i akullnajave ishin më të mëdha, niveli i oqeanit botëror ishte më i ulët për të mbajtur balancën e ujit në Tokë. Kur u shkrinë akullnajat, niveli i ujit u ngrit.



MËSONI MË SHUMË

Në malet e Kosovës deri para 11.700 vjet më parë kishte akullnaja. Ato shtriheshin në Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna. Kjo dihet për shkak të formave që kanë krijuar, si: cirqet, luginat, morenat, liqenet etj.



Akullnajë malore



Pyetje dhe detyra


1. Përkrahuni liqenin dhe akullnajën.
2. Klasifikoni liqenet sipas origjinës.
3. Pse në liqen valët janë të vogla?
4. Tregoni për përhapjen e akullnajave në Tokë.

110



Ndërtimi i njohurive: Organizues grafik

Mësimdhënësi, pasi shkruan në tabelë temën dhe çështjet kryesore, vizaton organizuesin grafik të analogjisë dhe kërkon nga nxënësit të identifikojnë në tekst përgjigjet për pyetjet.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:

Nxënësit punojnë në dyshe dhe, sipas fotografive, i gjejnë format e origjinës së liqeneve.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre individual gjatë mësimit. Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, varësisht nga përgjigjet që japin për dallimet dhe krahasimet e liqeneve.

Detyrë:

Në fletoret tuaja përgjigjuni pyetjeve nga libri bazë, në faqe 110.

Reflektim për rryjedkën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan veçoritë themelore të biosferës dhe lidhjen e saj me sistemet e tjera fizike (litosferën, atmosferën, hidrosferën).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I – 1, 2, 3, 4; II - 1, 4, 6; III – 1, 2, 3, 5, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-gjeografike të mjedisit natyror e human.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Biosfera

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore e asaj shtazore sipas brezave të nxehtësisë;
- Përshkruan veçoritë kryesore të biosferës;
- Argumenton lidhjen mes biosferës dhe sferave të tjera.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, laptop, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Biologjia, Teknologjia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësit/et përshkruajnë, diskutojnë, mbi bazën e atyre njohurive që kanë mbi botën e gjallë (nga emisione të ndryshme televizive, nga media, revista etj.) dhe të vendbanimit të tyre.




Biosferë quhet mbështjellësi i Tokës, në të cilën jetojnë qeniet e gjalla. Ajo përfshin shtresën e poshtme të atmosferës, pjesën sipërfaqësore të litosferës dhe tërë hidrosferën. Bota e gjallë zhvillohet kryesisht në sipërfaqen e Tokës dhe në ujë, por disa organizma jetojnë edhe në ajër në një lartësi të caktuar. Këto sfera depertojnë në njëra-tjetrën dhe bashkëveprojnë. Kështu, relievi ndikon në klimë, ndërsa uji, drita, nxehtësia etj., ndikojnë në zhvillimin e jetës. Për shkak të ambienteve të ndryshme, janë zhvilluar edhe llojet e shumta të bimëve dhe të shtazëve. Sipas nevojës që kanë për ujë, bimët ndahen në **higrofile**, të cilat jetojnë në ujë dhe në vendet me lagështi të madhe (moçallet), **mezofile**, të cilat jetojnë në ambiente me lagështi mesatare dhe **ksrofile**, që zhvillohen në ambiente të thata.

Biosferën e karakterizojnë ligjshmëritë e saj, sikurse zonaliteti horizontal dhe ai vertikal. **Zonaliteti horizontal** kushtëzohet nga gjerësia gjeografike, kurse **zonaliteti vertikal** nga lartësia mbidetare, me me ç'rast ndryshojnë kushtet jetësore. Renditja zonale e botës bimore dhe shtazore përcaktohet nga nxehtësia dhe sasia e lagështisë që ndryshon nga ekuatori në drejtim të polëve.

Zona e pyjeve ekuatoriale shtrihet në të dyja anët e ekuatorit, e mbuluar me pyje dhe me blerim të përhershëm. Pyjet tropike janë të dendura dhe të pasura me shumë lloje të drurit: *palma e kokosit, banania, bambusi, mahagoni, druri i kauçukut, i kakaos* etj. Gjatë gjithë vitit koha është e nxehtë dhe me reshje të shumta në formë të shiut. Pyjet tropike me lagështi janë zhvilluar në Amerikën Jugore, Afrikë, Indi, Arkipelagun e Malajës etj. Në Afrikë quhen **pyje të pashkelura**, në Indi **xhungla**, kurse në Amerikën Jugore quhen **selvase**. Disa lloje drunore arrijnë lartësinë prej disa dhjetëra metrash, ndërsa nën kurorat e tyre zhvillohen disa kate bimore. Pra, midis botës bimore zhvillohet konkurrenca për dritë. Vetëm katet e larta të kurorave të drurëve kanë mundësi t'i shijojnë rrezet e diellit, ndërsa të tjerat mbeten poshtë në gjysmërrësi. Në këto pyje, shumica e shtazëve jetojnë në drurë (lloje të shumtë të shpendëve, majmunëve dhe gjarpërinjve), aty ku ka ushqim dhe dritë të mjaftueshme.

Zona e pyjeve të brezit mesatar shtrihet në brezin e mesëm klimatik, që karakterizohet me ndërrim të stinëve dhe me periudha vegjetative verore e dimërore. **Brezi i pyjeve gjethërrëse** shtrihet kryesisht në kontinentin e Evropës dhe në Amerikën Veriore. Në këto pyje rritet dushku, ahu, shkoza, bliri etj.

Në këtë zonë jetojnë lloje të shumta shtazore, sikurse: dreri, ujku, dhelpra, lepuri, ketri, ariu, derri i egër etj. Kufiri i pyjeve gjethërrëse




varet nga disa faktorë natyrorë. Kufiri jugor kontakton me formacione barishtore për shkak të thatësisë, kurse në viset e ftohta në drejtim të Polin të Veriut ato kalojnë në pyje halore. **Pyjet halore** përbëhen kryesisht nga druri i pishës dhe quhen tajga. **Tajga** përfshin një brez të gjerë kontinental të Evropës Veriore, Azisë dhe Amerikës Veriore (Kanada, Skandinavi dhe Siberi), me klimë të thatë dhe të ftohtë dhe me botën shtazore mjaft të pasur.

T Gjeosferat e jashtme të Tokës dhe bashkëveprimi i tyre

Zona e savanave shtrihet në të dyja hemisferat, në veri dhe në jug të pyjeve tropike dhe me sasi të vogël të reshjeve. Savanat karakterizohen me formacione barishtore me gjatësi deri në tri metra, në të cilat druri shihet rrallë dhe i vetmuar. Barishtet zhvillohen shpejt gjatë stinës me lagështi, por edhe thahen brenda pak muajsh me paraqitjen e sezonit të thatësisë.

Savanat kanë shtrirje të madhe në Afrikë dhe në Amerikën Jugore. Në Orinoko quhen **lanose**, kurse në Brazil quhen **kampose**. Bota shtazore është shumë e pasur dhe e shumëllojshme, sikurse me bimëngrënës ashtu edhe me mishngrënës.



113

Nxënësit tregojnë bimët dhe kafshët që atyre iu përlejnë dhe ato të cilat i posedojnë. Në projektor paraqiten disa fotografi dhe nxënësit tregojnë cilat bimë apo kafshë janë paraqitur.



Ndërtimi i njohurive:
Ditari dypjesësh

Në pjesën e dytë të orës, mësimmhdhënësi ndan tabelën në dy shtylla. Në shtyllën e parë, mësimmhdhënësi shënon disa fjalë kyçe dhe kërkon nga nxënësit që, duke lexuar njësinë mësimore “Biosfera”, të bëjnë përshkrimin në shtyllën e dytë për këto fjalë.

Fjalët kyçe	Komenti jepet nga nxënësit
Biosferë	Është sferë e cila përfshin tërë jetën e gjallë në Tokë. Është e lidhur ngushtë me sferat e tjera.
Zonalitet horizontal	Shtrirja e botës bimore nga kushtëzimi i gjerësisë gjeografike.
Zonalitet vertikal	Shtrirja e bimëve varësisht prej lartësisë mbidetare.
Savane	Janë zona të barërave të larta. Më së shumti shtrihen në Afrikë.
.....



Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit:
Pesëvargëshi

Nxënësi/ja formon një pesëvargësh, me anë të të cilit do të reflektojë se sa është kuptuar biosfera.

Biosfera
 E llojlojshme E gjelbër
 Frymon lulëzon gjelbëron
 Biosfera është më e zhvilluar në sipërfaqe të tokës dhe në ujëra, e më pak në ajër.
 Bota e gjallë

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke e pasur parasysh kriterin mbi saktësinë e përgjigjeve në identifikimin e botës së gjallë dhe argumenteve që mund t'i japin për ndërlidhjen e sferave.

Detyrë:

Në sipërfaqën e tokës dallohen katër bashkësi bimore themelore: 1..... 2..... 3..... 4.....

Reflektim përvojëdhën e orës mësimore:

Mësimi 49

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet fizike - Gjeosferat

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan sferat e Tokës; atmosferën, litosferën, hidrosferën dhe biosferën.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I-6; II-6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2; 5.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Aktivitet: Sferat koncentrike të Tokës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan sferat e Tokës; atmosferës, litosferës, hidrosferës dhe biosferës;
- Vlerëson ndërlidhjen e sferave me njëra-tjetrën;
- Arsyeton ndikimin e tyre në jetën dhe veprimtarinë e njerëzve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto apo edhe video të krijuara nga veprimi i erës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Kimia, Fizika, TIK (Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm).


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS


Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit


Aktivitet:

Mësimdhënësi e ndan klasën në katër grupe të barabarta, pastaj katër flipçarta i vendos në katë markeri me gjyër të zezë, tema: Atmosfera; grupi 2, markeri me ngjyrë të kuqe, tema: Litosfera; grupi 3, markeri me ngjyrë të kltër, tema: Hidrosfera dhe grupi 4, markeri me ngjyrë të gjelbër, tema: Biosfera. Mësimdhënësi u jep kohë nxënësve që për 5 minuta të shkruajnë sa më tepër informacione për temën e caktuar. Kur të përfundojë koha prej 5 minutash, nxënësit ndalojnë dhe mësimdhënësi u rekomandon që, së bashku me markerin me ngjyrë të njëjtë, nxënësit të






bëjnë një lëvizje, pra grupi 1 lëviz te grupi 2, grupi 2 lëviz te grupi 3, grupi 3 lëviz te grupi 4 dhe grupi 4 lëviz te grupi 1.



Fillimisht ata duhet të lexojnë pjesën që e ka shkruar grupi paraprak, që mos të përsëriten shkrimet e njëjta, dhe pastaj për 5 minuta fillojnë të shkruajnë mbi temën e caktuar. Kështu vazhdohet deri sa të përfundojë një cikël.

Në fund, nxënësit kthehen te tema fillestare dhe secili prej grupeve i lexon të gjitha pjesët (të gjitha ngjyrat e markerave), i analizojnë për saktësinë, cilësinë dhe sasinë.

Kështu, njëri grup duhet të shpallet fitues mbi cilësitë e lartpërmendura.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përshkrimit të sferave koncentrike të Tokës.

Detyrë:

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VI
Tema: Sistemet humane

Rezultati i të nxënësve të temës:
 Përshkruan ndikimin e faktorëve fizikë, mjedisorë, ekonomikë dhe politikë në shpërndarjen e popullsisë në botë (lëvizja numerike, dendësia, lëvizjen natyrore dhe teorinë e transicionit demografik).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I - 3, 4, 6; II - 4, 5, 8; III - 1, 3, 5, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe të veprimit, shpërndarjen dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, rajonal dhe global.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: Popullsia në botë

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Sqaron përhapjen gjeografike të popullsisë sipas gjerësive gjeografike në botë;
- Dallon ekumenën dhe anekumenën;
- Identifikon pesë shtete me dendësinë më të madhe të popullsisë në botë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Tabelë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukata qytetare, Matematika.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënës
 Di-Dua të Di-Mësava

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të tregojnë se çfarë dinë ata rreth popullsisë në botë. Pas çdo informacioni

POPULLSIA NË BOTË (TOKË)

Popullsia në botë (Tokë)
 Popullsia botërore paraqet numrin e përgjithshëm të popullsisë në momentin e caktuar. Është vështirë të përcaktohet numri i saktë i popullsisë, meqenëse ai ndryshon në çdo sekondë. Sipas demografëve, në fillim të erës sonë, në Tokë kanë jetuar rreth 160 milionë njerëz. Në vitin 2022 në botë vlerësohet se jetojnë **8 miliardë banorë**.

Kontinenti që ka numrin më të madh të popullsisë është Azia, ku jetojnë 3.9 miliardë banorë, ndërsa kontinenti me numrin më të vogël të popullsisë është Australia me Oqeaninë, ku jetojnë vetëm 32 milionë banorë.

Azia	4.6 miliardë
Afrika	1.3 miliardë
Evropa	750 milionë
Amerika Jugore (Latine)	650 milionë
Amerika Veriore	370 milionë
Australia	42 milionë
Antarktiku	

RITJA GLOBALE E POPULLSISË

Lëvizja e numrit të popullsisë në botë

Numri i popullsisë botërore nuk rritet njëjtë në të gjitha kontinentet. Ai rritet më shpejt në Azi, Amerikën Jugore dhe Afrikë, ndërsa më ngadalë në Evropë dhe Amerikën Veriore. Në Azi, popullsia vazhdon të rritet me ritme të shpejta.

Popullsia rritet me ritme të shpejta edhe në Afrikë, vendet arabe, Amerikën Latine etj. Në anën tjetër, popullsia evropiane dhe ajo e Amerikës Veriore ka rritje të vogël, kurse të disa shtete numri i popullsisë ka filluar të bjerë.

Popullsia e botës nuk është e shpërndarë në mënyrë të barabartë. Dendësia e popullsisë tregon raportin ndërmjet numrit të popullsisë dhe sipërfaqes. Derisa disa pjesë të botës janë dendur të banuara, të tjerat janë rrallë të banuara apo edhe të pabanuara. Dendësia e banimit var nga kushtet natyrore (relievi, klima, ujërat, tokat, bota bimore dhe shtazore etj.) dhe kushtet shoqërore-ekonomike (shtimi natyror, migrimet, zhvillimi ekonomik etj.).

Dendësia e banimit shërben për të treguar se sa banorë jetojnë në një kilometër katror (banorë/km²). Llogaritet duke pjesëtuar numrin e popullsisë me sipërfaqen e ndonjë shteti apo regjioni.



A E DINI SE


Në vitin 1804, në botë kanë jetuar një miliard njerëz, në vitin 1927 dy miliardë, kurse në vitin 1959 tre miliardë njerëz. Shifren prej 4 miliardë banorësh popullsia botërore e arriti në vitin 1974, 5 miliardë në vitin 1987, 6 miliardë në vitin 1999. Më 31 tetor të vitit 2011, numri i popullsisë botërore arriti në 7 miliardë. Ndërsa, në nëntor 2022 vlerësohet se arriti 8 miliardë banorë.

Holanda me 405 banorë/km² dhe Belgjika me 374 banorë/km² janë vende me dendësi të madhe të banimit, kurse Kanadaja me 4 banorë/km² dhe Arabia Saudite me 15 banorë/km² janë vende me dendësi të vogël të banimit.

Kosova ka sipërfaqen prej 10905 km², ku jetojnë 2 milionë banorë. Dendësia e banimit të Kosovës llogaritet sipas kësaj formule:

$$D_{pop.} = \frac{Nr_{pop.}}{Sipërfaqja} = \frac{2000000}{10905} = 183 \text{ b/km}^2$$

Dendësia e popullsisë në (b/km²)



117



**Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit:
Di-Dua të Di-Mësova**

Pasi që nxënësit ta kenë lexuar njësinë mësimore, ata shpjegojnë pjesë-pjesë mësimin që mësuuan gjatë orës.

Di	Dua të di	Mësova
Popullsia e botës ka arritur shifrën në 8 miliardë banorë. Sipas vlerësimeve, popullsia e botës është në rritje. Në botë jetojnë tri raca të popullsisë.	Çka paraqet dendësia e një vendi? Ç' kuptoni me ekumenë dhe anekumenë? Cilët shtete mendoni që kanë popullsinë më të madhe? Si quhet shkenca që studion popullsinë?	Ekumena (sipërfaqja e banuar e Tokës) dhe anekumena (sipërfaqja e pabanuar e Tokës); Shkenca që merret me studimin e popullsisë është demografia.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për aktivitetin e tyre gjatë mësimin, gjithnjë duke e pasur parasysh saktësinë në përgjigje për përhapjen e popullsisë në botë, bëjnë dalimin mes ekumenës dhe anekumenës, dinë ta llogarisin dendësinë e popullsisë.

Detyrë:

Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve që, përmes webfaqes: <http://www.worldometers.info/world-population/>, të analizojnë shifrat aktuale të drejtpërdrejta të rritjes së numrit të popullsisë në botë - lindjet, vdekjet.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

për të cilin ata theksojnë se dinë, dalin dhe e shkruajnë në tabelë te rubrika “DI”.

Di	Dua të di	Mësova
Popullsia e botës ka arritur shifrën 8 miliardë. Sipas vlerësimeve, popullsia e botës është në rritje. Në botë jetojnë tri raca të popullsisë.		



**Ndërtimi i njohurive:
Di-Dua të Di-Mësova**

Nxënësit parashtrojnë pyetje rreth popullsisë së botës ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj mësimdhënësit. Të gjitha i vendosin në rubrikën “Dua të Di”.

Di	Dua të di	Mësova
Popullsia e botës ka arritur shifrën në 8 miliardë banorë. Sipas vlerësimeve, popullsia e botës është në rritje. Në botë jetojnë tri raca të popullsisë	Çka paraqet dendësia e një vendi? Ç' kuptoni me ekumenë dhe anekumenë? Cilët shtete mendoni që kanë popullsinë më të madhe? Si quhet shkenca që studion popullsinë?	

Nxënësit e lexojnë njësinë mësimore në heshtje.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet humane

Rezultati i të nxënit të temës:

Diferencon strukturat themelore të popullsisë në botë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I - 2, 3; II - 7, 8; III - 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.

Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe atë hapësinor;

1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe veprimin, shpërndarjen dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, në nivel rajonal dhe në atë global.



A E DINI SE

Moshën më të madhe mesatare në botë e kanë japonezët dhe disa popuj skandinavë. Për shkak të mbrojtjes së mirë shëndetësore dhe kujdesit social, në këto vende jetëgjatësia mesatare arrin edhe mbi 80 vjet.


120

Strukturat e popullsisë

Në strukturat e popullsisë bëjnë pjesë: struktura e moshës, e gjinisë, ekonomike, etnike, arsimore, fetare dhe gjuhësore. Ato ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme. Struktura e moshës dhe e gjinisë varet nga lëvizja natyrore dhe mekanike e popullsisë, shkalla e zhvillimit ekonomik, rrethanat historike dhe politike etj.

Struktura e popullsisë sipas gjinisë dhe moshës

Struktura gjinore paraqet raportin ndërmjet popullsisë mashkullore dhe femërore në kuadër të numrit të përgjithshëm të popullsisë. Përveç strukturës gjinore, popullsia dallohet ndërmjet vete edhe sipas moshës. Struktura e moshës tregon ndarjen e popullsisë sipas grupmoshave të caktuara. Tri grupmoshat kryesore të popullsisë janë: popullsia e re prej 0-19 vjet; popullsia e moshës së mesme prej 20-59 vjet; si dhe popullsia e vjetër mbi 60 vjet.



Përçindja e pop. nën 15 vjeç

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Strukturat e popullsisë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon strukturat e popullsisë;
- Vlerëson strukturat e popullsisë për zhvillimin ekonomik dhe atë demografik.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Tabelë, foto, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Historia, Edukata qytetare, Matematika.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim për njohuritë paraprake

Në këtë fazë do të parashtrihen pyetje nga njësia e kaluar, me qëllim të ndërlidhjes së njësive mësimore:



Religjionet kryesore në botë (burimi: Knox & Marson, 2016)

Struktura ekonomike e popullsisë

Struktura ekonomike tregon popullsinë sipas aktivitetit ekonomik. Popullsia sipas aktivitetit ekonomik ndahet në popullsi aktive dhe popullsi të mbajtur. Veprimtaritë ekonomike mund të jenë bujqësore ose jobujqësore, prandaj ato mund të grupohen në këta sektorë të veprimtarive:

Sektorit primar i takojnë bujqësia, pylltaria dhe gjuetia; **sektorit sekondar** i takojnë industria, xehtaria, energjetika, ndërtimtaria etj.; në **sektorin terciar** bëjnë pjesë tregtia, komunikacioni, turizmi, hoteleria, kurse **sektorit kuartar** i takojnë shëndetësia, shkollimi, shkenca, kultura, administrata shtetërore, teknologjia e informacionit etj.

Shtetet e zhvilluara kanë përqindje të vogël të popullsisë së inkuadruar në bujqësi (edhe më pak se 5 %), ndërsa te shtetet më pak të zhvilluara pjesa më e madhe e popullsisë është e angazhuar në veprimtaritë bujqësore.

Struktura arsimore e popullsisë

Niveli i shkrim-leximit është tregues i rëndësishëm i strukturës arsimore të popullsisë. Në vendet e zhvilluara, **analfabetizmi** pothuajse është çrënjosur, ndërsa në vendet e pazhvilluara të Afrikës ai kalon edhe mbi 80 % të popullsisë. Në shtetet e zhvilluara, pjesëmarrja e popullsisë me shkollim superior arrin edhe deri në mbi 40 %, ndërsa në vendet më pak të zhvilluara kjo përqindje është shumë e vogël.

125

1. Çka është ekumena?
2. Çka është anekumena?
3. Sa banorë ka planeti ynë?
4. Në cilat vende jetojnë më shumë popullsia, pse jetojnë atje?
5. Arsyeto pse ka dendësi të vogël të popullsisë në shkretëtira dhe në vendet e ftohta.



Ndërtimi i njohurive:

Të nxënësit me këmbime-Grupet e ekspertëve

Në këtë fazë, klasa do të ndahet në 6 grupe.

Grupi 1 – strukturën moshore;

Grupi 2 – strukturën gjinore;

Grupi 3 – strukturën ekonomike;

Grupi 4 – strukturën etnike;

Grupi 5 – strukturën racore;

Grupi 6 – strukturën fetare.

Secili grup do të përzgjedhë përfaqësuesin e vet, i cili do të shpjegojë pjesën e vet.

Do të ketë edhe pyetje në mes të grupeve.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënimit:

Asociacioni

A1-0-19 vjet	B1-popullsia aktive	C1-negroidët	D1-hindusët
A2-20-64 vjet	B2-popullsia e mbajtur	C2-mongolët	D2-krishterët
A3-Kosova	B3-të moshuarit	C3-melezët	D3-myslimanët
A4-mbi 65 vjet	B4-industria	C4-evropoidët	D4-budistët
A.Struktura moshore	B- St. ekonomike	C-St. nacionale	D-Strukturat fetare
Struktura e popullsisë			

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësi, do të vlerësohet duke u angazhuar në dhënien e përgjigjeve të sakta në të tria fazat e orës, duke dalluar strukturat e popullsisë, dhënien e shembujve se si mund të ndikojë struktura popullore në zhvillimin ekonomik, e sidomos në zgjidhjen e asociacionit.

Detyrë:

Nxënësve iu jepet detyrë që, në fletoret e tyre, në mënyrë individuale të plotësojnë faqe 72,73.

Reflektim për veprimtarinë e orës mësimore:

Mësimi 52

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet humane

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan ndikimin e faktorëve fizikë, mjedisorë, ekonomikë dhe politikë në shpërndarjen e popullsisë në botë (lëvizjen numerike, dendësinë, lëvizjen natyrore dhe teorinë e transicionit demografik).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,4; II-4,5,7; III-3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime: Popullsia në botë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Analizon lëvizjen e popullsisë në botë;
- Rendit arsyet e rritjes së shpejtë të popullsisë gjatë shek.XX;
- Llogarit dendësinë mesatare të popullsisë në disa shtete.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë e botës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Matematika.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:


Përgatitja për të nxënësit

Diskutim për njohuritë paraprake

Diskutohet për njohuritë që kanë mësuar nga ora e kaluar mësimore për popullsinë në botë, rritjen e popullsisë në botë nga e kaluara e deri më tani, arsyet/shkaqet e rritjes së shpejtë të popullsisë nga shek. XX etj.

Popullsia në botë (Tokë)

Analizoni grafikun e rritjes së popullsisë dhe tregoni: Pse deri në vitet e fillimshkullit XX, rritja e popullsisë ka qenë e vogël? Si u mundësua rritja e shpejtë gjatë shek. XX?




Llogarit dhe shkruaj në tabelë dendësinë mesatare të popullsisë së këtyre shteteve:


SHTETI	SIPËRFAQJA	NUMRI I POPULLSISË	DENDËSIA b/km ²
KOSOVA	10.905 km ²	1.920.000	
SHQIPËRIA	28.748 km ²	2.876.000	
HOLANDA	131.940 km ²	17.132.000	
KANADAJA	9.984.670 km ²	35.150.000	

70

Analizo hartën e dendësisë së popullsisë dhe nxirr konkludime.



Shkruaj tipat e piramidave të popullsisë.



71



Ndërtimi i njohurive:

Ushtrime/plotësim i fletores së punës, faqe 70

Në faqen 70, në fletore pune të analizohet grafiku në të cilin paraqitet rritja e popullsisë nga e kaluara e deri tani, në vitet e fundit.

- Pse deri në vitet e fillimshkullit XX, rritja e popullsisë ka qenë e vogël?

- Cilat ishin shkaqet e rritjes së ngadalshme të popullsisë deri në shekullin XX?

Si u mundësua rritja e shpejtë e popullsisë pas shekullit XX?

Në faqen 70 në fletore pune të plotësohet tabela, në të cilën janë paraqitur të dhënat për disa shtete, sipërfaqja dhe numri i popullsisë, dhe mesimdhënësi, së bashku me nxënësit, do të llogarisin dendësinë mesatare të popullsisë për secilin shtet.

Dendësia e banimit llogaritet sipas kësaj formule:

$$D_{pop} = \frac{Nr. pop.}{Sipërfaqja}$$



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Ushtrime/plotësim i fletores së punës, faqe 71

Në faqen 71, në fletore pune, analizohet harta e dendësisë së popullsisë në botë, duke treguar vendet me dendësi më të madhe dhe vendet me dendësi më të vogël.

Cilat janë shkaqet/faktorët e dendësisë së madhe në disa vende dhe shkaqet/faktorët e dendësisë së vogël në vendet e tjera?

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për plotësimin e fletores së punës në mënyrë të saktë.

Detyrë:

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet humane

Rezultati i të nxënit të temës:

Shpjegon llojet, shkaqet dhe pasojat e migrimeve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I - 3, 5; II - 4, 5; III - 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1. Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe atë hapësinor;
1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe të veprim-it, shpërndarjen dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, në nivel rajonal dhe në atë global.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lëvizjet e popullsisë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan shkaqet e migrimeve;
- Arsyeton shtimin e lartë natyror të popullsisë botërore;
- Shpjegon arsyet/dallimet ndërmjet natalitetit dhe mortalitetit për kontinente.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Tabelë, hartë politiko-gjeografike.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukata qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Stuhi mendimesh

- Çfarë janë migrimet dhe si ndahen ato?




Pyetje dhe detyra

1. Përmendi strukturat kryesore të popullsisë.
2. Për çka shërben piramida e moshës?
3. Përmendi racat e popullsisë botërore.

Lëvizjet e popullsisë

Numri i popullsisë ndryshon në mënyrë të vazhdueshme. Kjo ndodh për shkak të lëvizjes natyrore dhe mekanike të popullsisë. **Lëvizja natyrore përfshin natalitetin, mortalitetin dhe shtimin natyror.** Të dhënat mbi lëvizjen natyrore dhe mekanike të numrit të popullsisë merren nga regjistrimi i popullsisë, ofiqaritë, spitalet, mbledhja e të dhënave në terren etj.



Grafiku i lëvizjes së numrit të popullsisë në Kosovë për periudhën 1921-2011

Nataliteti paraqet numrin e të lindurve ndaj numrit të përgjithshëm të popullsisë. Shkalla e natalitetit tregon numrin e të lindurve në 1,000 banorë dhe shprehet me ‰ (promila). **Mortaliteti** paraqet numrin e të vdekurve në 1,000 banorë.



A E DINI SE

Afrika ka shkallën më të lartë të mortalitetit. Kjo ndodh për shkak të urisë, sëmundjeve epidemike dhe luftërave të vazhdueshme.




Dallimi ndërmjet natalitetit dhe mortalitetit ndaj numrit të përgjithshëm të popullsisë quhet shtim natyror i popullsisë. **Shtimi natyror** paraqet numrin e popullsisë që rritet në çdo 1,000 banorë dhe shprehet me ‰ (promila).

Shtimi natyror dallon shumë sipas kontinenteve, regjioneve dhe shteteve. Regjionet dhe vendet e zhvilluara kanë shkallë të ulët të shtimit natyror, ndërsa regjionet dhe vendet më pak të zhvilluara kanë shkallë të lartë të shtimit natyror. Në rastet kur numri i të lindurve është më i madh se numri i të vdekurve, shtimi natyror është **pozitiv**, ndërsa, kur

numri i të vdekurve është më i madh se numri i të lindurve, atëherë numri i popullsisë **bie**. Kosova për një kohë të gjatë ka pasur shkallë të lartë të shtimit natyror, i cili pas vitit 2000 filloi të binte.

Në lëvizjen e numrit të popullsisë ndikojnë edhe **migrimet**, të cilat janë lëvizje mekanike të popullsisë. Shkaqet e migrimëve janë: ekonomike, politike, fetare, mjedisore etj. Shumë njerëz e ndërrojnë vendbanimin për të siguruar kushte më të mira për jetesë, disa të tjerë për shkak të luftërave e të tjerët për shkak të fatkeqësive natyrore, si: vërshimet, tërmetet, stuhitë e erës etj. Migrimet ndahen në emigrime dhe imigrime. Kur popullsia shpërngulet dhe numri i popullsisë bie; ky proces njihet si **emigrim**, ndërsa, kur popullsia vendoset (vjen) dhe rritet numri i popullsisë, ky proces njihet si **imigrim**.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve: *Marrëdhëniet pyetje – përgjigje*

Përmes hartës, nxënësit shpjegojnë shtimin, mortalitetin më të theksuar në vendet e botës.

1. Çka është nataliteti dhe si shprehet ai?
2. Çka tregon shtimi natyror?
3. Kur kemi shtim natyror negativ?

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të saktësisë së përgjigjeve që kanë dhënë gjatë orës mësimore për shkaqet e migrimëve dhe arsyetimin e shtimit të popullsisë.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune, faqe 74,75.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

- Pse kemi kaq shumë mërgimtarë?
 - Në cilat shtete migruan shqiptarët dhe cilat ishin disa nga arsyet?
 - Bëj dallimin mes natalitetit dhe mortalitetit.
- Përgjigjet e nxënësve shënohen në tabelë, për t'i arsyetuar gjatë zhvillimit të mësimit (2-3 komente).



Ndërtimi i njohurive: *Sistemi ndërveprues i shënimeve: INSERT*

Udhëzohen nxënësit të lexojnë njësinë e re, duke i përdorur shenjat e insertit. Pastaj diskutojnë me radhë se cilat informata ishin të njohura, cilat të reja dhe sqarohen pyetje nga mësimdhënësi, të shënuara nga nxënësit.

√	+	-	?
Informacioni i njohur	Informacioni i ri	Informacion që ndryshon nga ai që di	Sqarime për informacionin

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet humane

Rezultati i të nxënit të temës:

Shpjegon faktorët që kanë ndikuar dhe ndikojnë në krijimin e vendbanimeve, funksionet dhe kriteret kryesore të tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I – 2, 3, 5; II – 6, 8; III – 3, 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe të veprim-it, shpërndarjen dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, në nivel rajonal dhe në atë global.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vendbanimet

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon faktorët që ndikojnë në krijimin e një vendbanimi;
- Dallon fshatrat dhe qytetet sipas kriterëve kryesore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografji, ilustrime, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Historia, Edukata qytetare, Teknologjia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi, me anë të projektorit shfaq disa fotografi, ku nxënësit do të mundohen t'i dallojnë tipat e vendbanimeve të Kosovës.



Përmend disa fshatra të mëdha në Kosovë.

130

Vendbanimet


Vendbanimet janë vende në të cilat jeton popullsia dhe që zhvillon aktivitetet e ndryshme ekonomike.

Fshatrat janë vendbanime me më pak banorë, në të cilat popullsia merret me bujqësi. Janë më pak të rregulluara se qytetet. Dallohet qendra e fshatit, e cila është më mirë e rregulluar, ku ndodhen objektet shërbyese, tregtare dhe fetare. Fshatrat mund të jenë të vogla, me vetëm disa banorë, dhe të mëdha, me mbi 2,000 banorë.

Në viset fushore, vendbanimet ndodhen afër lumit, në rrafshet me toka pjellore, në udhëkryqet e rrugëve etj. Në viset kodrinore, fshatrat ndodhen rrëzë shpateve apo në skaje të fushave. Një lokacion i tillë u mundëson banorëve të fshatit të merren me lavërtari dhe blegtori.



Fshat



Qytet



Qytetet janë vendbanime me numër më të madh të popullsisë dhe funksioneve të shumta. Ato paraqesin seli administrative, ekonomike, politike, arsimore, shëndetësore dhe kulturore për rrethinën e ngushtë apo të gjerë. Prandaj, çdo qytet ka hapësirën e vet gravituese. Popullsia e vendbanimeve përreth qytetit, për çdo ditë shkon në qytet për punë, shkollim, shërim, pastaj për kryerjen e shërbimeve të tjera në administratë, në gjyqësi etj.



Londra, kryeqytet i Britanisë së Madhe

1. Cilat elemente e dallojnë fshatin nga qyteti?
2. Cilat qytete dhe fshatra të Kosovës dini?
3. Pse qytetet kanë numër më të madh të popullsisë sesa fshatrat?



Ndërtimi i njohurive:

Lexim i orientuar

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit të lexojnë në heshtje temën. U kërkon që të nxjerrin shënime me informacionet kyçe të temës. Pastaj i ndan ata në dy grupe, për të hapur diskutimin me temën “Fshati vs. qyteti”.

Fshati	Qyteti
Popullsia rurale kryesisht merret me bujqësi, blegtori, gjueti dhe peshkim.	Popullsia merret me shërbime publike, administrative, ekonomike, industriale etj.
Ka më shumë gjelbrim.	Ka më shumë rrugë.
Ndërtesat janë të vogla.	Ndërtesat janë shumëkatëshe.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

E saktë apo e pasaktë

Me **S** rretho përgjigjen e saktë, kurse me **P** rretho përgjigjen e pasaktë.

- Urbanizimi paraqet rritjen e popullsisë së qyteteve; S P
- Konurbacionet për herë të parë shfaqen në kontinentin e Afrikës; S P
- Qytetet mund të jenë të tipit të ngjeshur dhe të shpërndarë; S P
- Zhvillimi dhe zgjerimi i qyteteve kushtëzohet nga zhvillimi i industrisë. S P

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të saktësisë së përgjigjeve që kanë dhënë gjatë orës mësimore rreth faktorëve që dërgojnë në krijimin e një vendbanimi, specifikave të fshatit dhe të qytetit, dallimet dhe të përbashkëtat e tyre.

Detyrë:

Ese – “Vendbanimi im”

• *Reflektim për rojedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet humane

Rezultati i të nxënit të temës:

Identifikon elementet e shtetit, grupimet e ndryshme ekonomike, politike, ushtarake si dhe rëndësinë e organizatave ndërkombëtare.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I – 2, 3, 5; II – 6, 8; III – 3, 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe të veprim-it, shpërndarjen dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, në nivel rajonal dhe në atë global.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shtetet, grupimet politike, ekonomike, ushtarake dhe organizatat

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon grupimet ushtarake dhe ekonomike më të njohura në botë;
- Shpjegon rëndësinë e organizatave për shtetin;
- Analizon pse disa shtete janë me ekonomi më të zhvilluar e disa më të përparuar.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Tabelë, hartë gjeografike.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Edukata qytetare, Historia, Edukimi për paqe.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi paraqet hartën politike para nxënësve dhe iu drejtohet me pyetje të ndryshme.

Shtetet, grupimet politike, ekonomike, ushtarake dhe organizatat

Shtetet janë forma të organizimit politik dhe të pushtetit brenda territoreve të caktuara. Shteti është entitet gjeografik me territor dhe kufij të caktuar brenda të cilëve pushteti sjell dhe zbaton vendime dhe ligje. Elementet kryesore të çdo shteti janë: territori, kufijtë, popullsia, pushteti dhe kryeqyteti.

Disa nga grupimet më të rëndësishme politike, ekonomike dhe ushtarake në botë janë: Organizata e Kombeve të Bashkuara, NATO-ja, BE-ja etj. Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) e ka selinë në Nju Jork. Brenda saj veprojnë më shumë organizata. Ajo ka për qëllim ruajtjen e paqes, kultivimin e marrëdhënieve miqësore ndërmjet shteteve, zvogëlimin e urisë dhe varfërisë, mbrojtjen e mjedisit etj.



Selia e BE-së



Flamuri i NATO-s




Flamuri i BE-së

NATO-ja (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior) është organizatë ushtarake e themeluar në vitin 1949 dhe e ka selinë në Bruksel. Kjo organizatë punon për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe evitimin e konflikteve. Ajo po ashtu ndërmer operacione ushtarake të cilat kanë për qëllim m-naxhimin e krizave dhe arritjen e paqes.

Gjatë vitit 1999, NATO-ja intervenoi në Kosovë duke e çli-ruar vendin tonë, proces që më vonë do të rezultonte me shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17.2.2008.

Bashkësia Evropiane (BE) apo Unioni Evropian është or-ganizatë ekonomike dhe politike me seli në Bruksel. Ajo nisi të krijohet në vitin 1957 kur Franca, Gjermania Perën-dimore dhe disa shtete të tjera krijuan tregun e përbashkët ekonomik. Deri në vitin 2020 Britania e Madhe ishte anëtare e BE-së. Ndërsa tani, BE-ja ka 27 shtete anëtare me sipërfaqe prej 4.2 milionë km², ku jetojnë 450 milionë banorë. Në të ardhmen BE-ja ka tendenca të zgjerimit në Gadishullin Bal-kanik dhe vendet e Evropës Lindore.



Harta e vendeve të BE-së (2022)

Pyetje dhe detyra

1. Çka janë shtetet?
2. Përmendi elementet kryesore të shtetit?
3. Trego disa kryeqytete monocentrike.
4. Cilat janë qëllimet e themelimit të OKB-së?

136

Pas kësaj, ata analizojnë faktorët që mundësojnë zhvi-llimin ekonomik të një shteti, duke argumentuar atë.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënës:

Rrjet i diskutimit

Për të reflektuar rreth temës, nxënësit do të tregojnë:

- 3 – tri gjëra të reja që mësuam;
- 2 – dy gjëra që duhen mbajtur në mend për urbanizimin;
- 1 – një gjë që më bën kureshtar ta di.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të saktësisë së përgjigjeve që kanë dhënë gjatë orës mësimore, duke identifikuar llojet e shteteve, rëndësinë që kanë organizatat për shtetin dhe analizën që bëjnë ata për zhvillimin ekonomik.

Detyrë:

Të plotësohet libri bazë në faqe 137. (kontrollo njohuritë)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Çka është shteti dhe çfarë rëndësie ka ai për njerëzit që jetojnë brenda tij?

Cilat shtete njihni në botë?



Ndërtimi i njohurive:

Ditari dypjesësh

Arsimtari/ja udhëzon nxënësit që të lexojnë tekstin në heshtje dhe individualisht. Deri sa nxënësit lexojnë, arsimtari shënon në tabelë disa pyetje, ku nxënësit, pas leximit, i plotësojnë me ato fragmente që mendojnë se e plotësojnë pyetjen e parashtruar.

Pyetje	Komente
1. Çka kuptoni me shtet?	Shteti është entitet gjeografik me territor dhe kufij të caktuar, brenda të cilëve pushteti sjell dhe zbaton vendime dhe ligje.
2. Cilat janë grupimet më të njohura politike, ushtarake, ekonomike në botë?	OKB, NATO, BE, UNESCO, UEFA....
3. Cilat janë elementet kryesore të një shteti?	Elementet kryesore të çdo shteti janë: territori, kufijtë, popullsia, pushteti dhe kryeqyteti.
4. Çka kuptoni me Bashkim Evropian?	...është organizatë ekonomike dhe politike me seli në Bruksel. Ajo nis të krijohet në vitin 1957 kur Franca, Gjermania Perëndimore dhe disa shtete të tjera krijojnë tregun e përbashkët ekonomik.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet humane

Rezultati i të nxënit të temës:

Dallon veprimtaritë ekonomike sipas sektorëve përkatës (parësorë, dytësorë dhe tretësorë); Shpjegon llojet dhe rëndësinë e secilës veprimtari ekonomike (bujqësinë, xehetarinë, industrinë, turizmin, transportin, tregtinë etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I – 2, 3, 5; II – 6, 8; III – 3, 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe të veprimt, shpërndarjen dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, në nivel rajonal dhe në atë global.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ekonomia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan faktorët kryesorë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik;
- Vlerëson rëndësinë e veprimtarive ekonomike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Tabelë, grafikone.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Ekonomia, Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Imaginatë e drejtuar

Mësimdhënësi/ja shënon në dërrasën e zezë disa fjalë kyçe dhe kërkon nga nxënësit të tregojnë se për çka është fjala.





Fabrikë bashkëkohore e automobilave




Pyetje dhe detyra

1. Çka është ekonomia?
2. Përmendi sektorët kryesorë të ekonomisë.
3. Cilat kushte natyrore kushtëzojnë zhvillimin e ekonomisë?

139

Nxënësit duhet të dinë që fjala është për ekonominë dhe duhet t'i japin mendimet për to.



Ndërtimi i njohurive: Lexim i orientuar

Mësimdhënësi/ja dhe nxënësit nxjerrin disa kriterë dhe kërkohet nga nxënësit që duke u bazuar në to të shkruajnë një shkrim, ku renditen informacionet e temës: “Ekonomia dhe veprimtaritë e saj”.

Kriteret e suksesit janë:

1. Përshkruaj disa prej faktorëve kryesorë që ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë së një vendi;
2. Dallo të gjitha veprimtaritë ekonomike sipas sektorëve përkatës: parësorë, dytësorë dhe tretësorë.
3. Trego pse janë të rëndësishme veprimtaritë si: bujqësia, xehetaria, industria, turizmi, transporti, tregtia etj., duke dhënë së paku një argument për secilën prej tyre.

Lexohen shkrimet dhe më pas komentohen sipas nevojës.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit: Tabela klasifikuese

Punë individuale me fletoret e klasës. Shëno në tabelë kushtet natyrore dhe shoqërore për zhvillimin e ekonomisë.

Kushtet natyrore	Kushtet shoqërore
Punimi i tokës	Popullsia e aftë për punë
Pasuritë natyrore	Arsimim i mirëfilltë i punëtorëve

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim formativ: informata kthyesë dhe të sakta për faktorët që ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe rëndësinë e veprimtarive ekonomike.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune, në faqe 76.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet humane

Rezultati i të nxënit të temës:

Identifikon degët kryesore të bujqësisë dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e saj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-2, 4; II-6; III-5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe të përfshirjes në të. 1.1, 1.3

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kushtet gjeografike për zhvillimin e bujqësisë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:


- Shpjegon rolin dhe rëndësinë e bujqësisë në jetën dhe veprimtarinë njerëzore;
- Krahason bujqësinë intensive me atë ekstensive dhe tregon dallimet.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Individit, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Teksti Gjeografia 6-Dukagjini”, fletore pune, atlas gjeografik, fletë A4, mjete shkrimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.



Kushtet gjeografike për zhvillimin e bujqësisë

Bujqësia është veprimtari e cila merret me kultivimin e bimëve dhe rritjen e kafshëve. Ajo siguron ushqimin për popullsinë dhe lëndën e parë për disa degë të industrisë së lehtë. Ajo ndahet në bujqësi dhe blegtori. Bujqësia përfshin kultivimin e bimëve të ndryshme dhe ndahet në: lavërtari, pemëtari dhe vreshtari. Blegtoaria përfshin kultivimin e kafshëve shtëpiake etj.

Zhvillimi i bujqësisë varet nga kushtet natyrore dhe shoqërore. Në kushte natyrore bëjnë pjesë pozita gjeografike, relievi, klima, ujërat dhe tokat. Kushtet natyrore më të volitshme për kultivimin e drithërave janë viset stepike, për kultivimin e agrumeve janë viset mesdhetare, kurse për kultivimin e orizit janë viset e lagështa tropikale. Në kushtet shoqërore për zhvillimin e bujqësisë bëjnë pjesë madhësia e pronave bujqësore, përdorimi i mjeteve agroteknike, arsimimi i popullsisë bujqësore.



Bujqësi ekstensive



Bujqësi intensive

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Ora mësimore fillon duke përsëritur me ndihmën e pyetjeve njësitë e kaluara. Gjatë marrjes së përgjigjeve nga ana e nxënësve, mësimdhënësi ndërlihd njësinë që do zhvillohet, gjithnjë duke i shtyrë nxënësit që të identifikojnë njësinë e re.

Bujqësia ekstensive paraqet një formë të prapambetur të punimit dhe shfrytëzimit të tokës. Me bujqësi ekstensive merret popullsia e vendeve të pazhvilluara, nga e cila përfitohet ushqimi dhe sigurohet mbijetesja. Përdor shumë fuqi punëtore, mjete primitive pune, nuk përdoren plehurat artificiale, andaj rendimentet janë të ulëta.

Bujqësia intensive është formë e përparuar e bujqësisë, e cila dallohet me përdorimin e mjeteve agroteknike dhe aplikimin e njohurive të reja shkencore; gjë që sjell deri te rritja e rendimenteve dhe e prodhimit të bujqësore. Kjo formë e bujqësisë arrin të krijojë teprica të prodhimeve bujqësore të cilat shiten në treg.

Përdorimi i madh i mjeteve agroteknike në bujqësinë intensive ka edhe anët e veta negative. Shkatërrohen dhe modifikohen ekosistemet natyrore, si: pyjet, kënetat e livadhet për t'u shndërruar ato në toka punuese. Përdorimi i madh i kimikateve çon deri te ndotja e tokave dhe ujit, metodat joadekuate të ujitjes çojnë deri te kripëzimi i tokave etj.

Industria

Industria është një ndër veprimtaritë më të rëndësishme ekonomike. Ajo merret me eksplotimin e mineraleve, prodhimin e energjisë dhe përpunimin e lëndëve të para. Industria prodhon produkte industriale, të cilat kanë një përdorim të gjerë, siç janë: ushqimi, veshmbathja, makinat, instrumentet, mjetet e ndryshme të punës etj. Përdorimi gjithnjë e më i madh i robotëve dhe i mjeteve të tjera automatike në prodhimtarinë industriale çon deri te rritja dhe llojllojshmëria e produkteve industriale.

Industria ndahet në **industri nxjerrëse ose ekstraktive** dhe **industri përpunuese**. Në industrinë ekstraktive bëjnë pjesë xehetaria, energjetika, industria e rëndë kimike, elektroindustria dhe makineria. Industria, po ashtu, ndahet në industrinë e rëndë dhe industrinë e lehtë. E para siguron mjetet për prodhimtari, kurse e dyta prodhon mjetet për përdorim të gjerë.



Industria ekstraktive

141



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve: Punë e pavarur

Mësimdhënësi shpërndan fleta me pyetjet për vlerësim.

Pranë fotografisë shëno tipin e bujqësisë dhe kategorizo kushtet dhe elementet që i përkasin llojit të bujqësisë intensive dhe ekstensive.

Me **S** rretho përgjigjen e saktë, kurse me **P** rretho përgjigjen e pasaktë:

- | | |
|--|-----|
| 1. Bujqësia intensive dallohet me përdorimin e vogël të mjeteve agroteknike. | S P |
| 2. Transporti tokësor ndahet në transportin detar dhe në atë lumor. | S P |
| 3. Në industrinë e lehtë bëjnë pjesë ajo ushqimore, e tekstilit, e drurit, e letrës. | S P |
| 4. Bujqësia ekstensive dallohet me rendimente të ulëta. | S P |
| 5. Përdorimi i kimikateve në bujqësi shkakton kripëzimin e tokave. | S P |

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 76-77.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

- Çka është ekonomia?
- Cilat janë degët kryesore në veprimtarinë parësore të ekonomisë?

Përgjigjet më interesante dhe logjike që lidhen me njësinë që do të zhvillohet, shënohen në tabelë.



Ndërtimi i njohurive: Pyetja sjell pyetjen

Shkruhet në tabelë tema dhe çështjet kryesore, paraqiten disa pyetje në tabelë.

Me këtë teknikë duhet të synohet nxitja e hulumtimit dhe të nxënësve dhe e interesit të nxënësve për çështjet që do të shtjellohen.

- Çka është bujqësia?
- Cilat janë kushtet natyrore për zhvillimin e bujqësisë?
- Ç'kuptoni me bujqësi intensive?
- Cilat janë shtetet me bujqësi intensive më të theksuar? etj.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet humane

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan procesin e industrializimit;

Identifikon degët kryesore të industrisë, faktorët që ndikojnë në zhvillimin e saj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-2,6; II-1,7; III-3,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe të përfshirjes në të. 1.1, 1.3

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Industria

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Analizon zhvillimin industrial dhe tregon përparësitë dhe mangësitë për shoqërinë njerëzore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti “Gjeografia 6-Dukagjini”, fletore pune, atlas gjeografik, fletë A4, mjete shkrimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

“Asociacion” (punë me grupe sipas rreshtave në klasë)

Arsimtari formon një asociacion në tabelë si vegës, që nxënësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka asociojnë me njësinë e re.

Bujqësia ekstensive paraqet një formë të prapambetur të punimit dhe shfrytëzimit të tokës. Me bujqësi ekstensive merret popullsia e vendeve të pazhvilluara, nga e cila përfitohet ushqimi dhe sigurohet mbijetesja. Përdor shumë fuqi punëtore, mjete primitive pune, nuk përdoren plehurat artificiale, andaj rendimentet janë të ulëta.

Bujqësia intensive është formë e përparuar e bujqësisë, e cila dallohet me përdorimin e mjeteve agroteknike dhe aplikimin e njohurive të reja shkencore; gjë që sjell deri te rritja e rendimenteve dhe e prodhimitarisë bujqësore. Kjo formë e bujqësisë arrin të krijojë teprica të prodhimeve bujqësore të cilat shiten në treg.


Përdorimi i madh i mjeteve agroteknike në bujqësinë intensive ka edhe anë të veta negative. Shkatërrohen dhe modifikohen ekosistemet natyrore, si: pyjet, kënetat e livadhet për t'u shndërruar ato në toka punuese. Përdorimi i madh i kimikateve çon deri te ndotja e tokave dhe ujit, metodat joadekuate të ujitjes çojnë deri te kripëzimi i tokave etj.

Industria

Industria është një ndër veprimtaritë më të rëndësishme ekonomike. Ajo merret me eksplotimin e mineraleve, prodhimin e energjisë dhe përpunimin e lëndëve të para. Industria prodhon produkte industriale, të cilat kanë një përdorim të gjerë, siç janë: ushqimi, veshmbathja, makinat, instrumentet, mjetet e ndryshme të punës etj. Përdorimi gjithnjë e më i madh i robotëve dhe i mjeteve të tjera automatike në prodhimtarinë industriale çon deri te rritja dhe llojlloshmëria e produkteve industriale.

Industria ndahet në **industri nxjerrëse ose ekstraktive** dhe **industri përpunuese**. Në industrinë ekstraktive bëjnë pjesë xehetaria, energjetika, industria e rëndë kimike, elektroindustria dhe makineria. Industria, po ashtu, ndahet në industrinë e rëndë dhe industrinë e lehtë. E para siguron mjetet për prodhimtari, kurse e dyta prodhon mjetet për përdorim të gjerë.

Industria ekstraktive




Industria e rëndë përfshin eksploatimin e lëndëve minerale, prodhimin e energjisë si dhe prodhimin e mjeteve dhe materialeve, të cilat shfrytëzohen në proceset e mëvonshme të prodhimit.

Industria e lehtë përfshin industrinë ushqimore, të tekstilit, të drurit, të lëkurës, të letrës etj. Industria ushqimore është ndër degët më të përhapura të kësaj industrie. Ajo merret me përpunimin e lëndëve të para me prejardhje bimore dhe shtazore, konservimin dhe ruajtjen e prodhimeve ushqimore etj.

Transporti

Transporti merret me bartjen e njerëzve, të mirave materiale dhe informacioneve nga një vend në vendin tjetër. Përmes transportit lidhet prodhimtaria me konsumatorët. Transporti ndahet në tokësor, ujor, ajror dhe gypor. Në transportin tokësor bëjnë pjesë ai rrugor dhe hekurudhor. Transporti rrugor ose automobilistik ka përhapje më të madhe se të gjitha llojet e transportit. Përdorimi gjithnjë e më i madh i transportit urban mundëson lidhjen e mirë dhe të shpejtë të njerëzve brenda lagjeve të qytetit.



Transporti hekurudhor, për herë të parë u lansua në Angli. Ky lloj i transportit kushton më lirë, por është më i ngadalshëm. Megjithatë, shtetet e zhvilluara po e rrisin gjithnjë e më tepër cilësinë dhe shpejtësinë e këtij transporti, siç janë: Japonia, Kina, Gjermania dhe Franca.

Transporti detar paraqet një ndër format më të vjetra të transportit. Përmes tij janë bërë udhëtime të gjata, janë zbuluar toka të reja dhe është zgjeruar horizonti gjeografik. Transporti detar është më i zhvilluar ndërmjet Evropës dhe Amerikës Veriore nëpërmjet Oqeanit Atlantik.

Transporti ajror është formë e re e transportit që kohët e fundit po shënon një zgjerim të madh. Ai është më i shpejtë dhe nuk kufizohet nga barrierat fizike, por është më i shtrenjtë se format e tjera të transportit, kushtëzohet nga kushtet klimatike, krijon zhurmë dhe mund të bartë më pak mallra.

142

A	B	C	D
Energjia	E rëndë	Ushqimore	Makinave
INDUSTRIA			

Pasi identifikohet njësia, mësimdhënësi pyet nxënësit:

Pse:

Energjia?

E rëndë?

Ushqimore?

E makinave?



Ndërtimi i njohurive:

DRTA

Nxënësit drejtohen që të lexojnë tekstin. Mësimdhënësi/ ja ndan disa letra në të cilat janë shënuar disa pyetje (3-4 pyetje), pa u bazuar në paragrafë.

Nxënësit gjatë leximit identifikojnë përgjigjet dhe i shënojnë ato në fletoret e tyre.

Pyetjet mund të jenë të njëjta te disa nxënës.

Letra 1:

- Çka është industria?
- Kush bën pjesë në strukturën energjetike?
- Çka është energjia nukleare?

Letra 2:

- Si ndahet industria?
- Çka është nafta dhe si u formua?
- Cilat janë shtetet me prodhimin më të madh të çelikut? (vazhdon).



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Tabela analizuuese (punë në dyshe) pa ndihmën e burimeve të informacionit

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që, te tabelat e gatshme që u ofron, të shënohen përparësitë dhe dobësitë e zhvillimit industrial.

Përparësitë	Dobësitë
-------------	----------

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 76-77.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet humane

Rezultati i të nxënit të temës:

Shpjegon veçoritë e transportit (automobilistik, hekurudhor, ujor, ajror) dhe rolin e tij në zhvillimin e vep- rimitarive ekonomike dhe të vetë ekonomisë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat krye- sore të shkallës: I-1,2; II-6,7; III-5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe të përfshirjes në të. 1.1' 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Transporti

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon rolin dhe rëndësinë e transportit në zhvillimin e shoqërisë njerëzore të shekullit XXI.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti “Gjeografia 6-Dukagjini”, fletore pune, atlas gjeografik, fletë A4, mjete shkrimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Rrjeti i diskutimit

Mësimdhënësi shënon një pyetje në tabelë dhe kërkon nga nxënësit në mënyrë të pavarur, duke respektuar rregullat që të dëgohet tjetri, t’iu përgjigjen pyetjes:

- Çka mendoni, si do të dukej bota dhe cilat do të ishin pasojat nëse nuk do të ekzistonte ky lloj transporti që kemi sot?

Industria e rëndë përfshin eksploatimin e lëndëve minerale, prodhimin e ene- rgjisë si dhe prodhimin e mjeteve dhe materialeve, të cilat shfrytëzohen në pro- ceset e mëvonshme të prodhimitarisë.

Industria e lehtë përfshin industrinë ushqimore, të tekstilit, të drurit, të lëkurës, të letërës etj. Industria ushqimore është ndër degët më të përhapura të kësaj industrie. Ajo merret me përpunimin e lëndëve të para me prejardhje bimore dhe shtazore, konservimin dhe ruajtjen e prodhimeve ushqimore etj.

Transporti

Transporti merret me bartjen e njerëzve, të mirave materiale dhe informa- cioneve nga një vend në vendin tjetër. Përmes transportit lidhet prodhimitaria me konsumatorët. Transporti ndahet në tokësor, ujor, ajror dhe gypor. Në trans- portin tokësor bëjnë pjesë ai rrugor dhe hekurudhor. Transporti rrugor ose au- tomobilistik ka përhapje më të madhe se të gjitha llojet e transportit. Përdorimi gjithnjë e më i madh i transportit urban mundëson lidhjen e mirë dhe të shpejtë të njerëzve brenda lagjeve të qytetit.




Transporti hekurudhor, për herë të parë u lansua në Angli. Ky lloj i transportit kushton më lirë, por është më i ngadalshëm. Megjithatë, shtetet e zhvilluara po e rrisin gjithnjë e më tepër cilësinë dhe shpejtësinë e këtij transporti, siç janë: Japonia, Kina, Gjermania dhe Franca.

Transporti detar paraqet një ndër format më të vjetra të transportit. Përmes tij janë bërë udhëtime të gjata, janë zbuluar toka të reja dhe është zgjeruar hor- izonti gjeografik. Transporti detar është më i zhvilluar ndërmjet Evropës dhe Amerikës Veriore nëpërmjet Oqeanit Atlantik.

Transporti ajror është formë e re e transportit që kohët e fundit po shënon një zgjerim të madh. Ai është më i shpejtë dhe nuk kufizohet nga barrierat fizike, por është më i shtrenjtë se format e tjera të transportit, kushtëzohet nga kushtet klimatike, krijon zhurmë dhe mund të bartë më pak mallra.

Telekomunikacioni si degë e transportit përfshin qarkullimin e informacioneve ndërmjet njerëzve në distanca të mëdha. Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit, i cili kurorëzohet me shpikjen e internetit dhe telefonisë mobile, sjell progres dhe risi të shumta në mënyrat e bartjes së informacioneve dhe komunikimit ndërmjet njerëzve.



Pyetje

1. Çka është bujqësia dhe cilit sektor të veprimtarive i takon ajo?
2. Si ndahet industria?
3. Çka është transporti dhe si ndahet ai?

143


Disa komente, duke përdorur si fjalë kyçe, shënohen në tabelë.



Ndërtimi i njohurive:

Pema e mendimeve

Mësimdhënësi drejton nxënësit të lexojnë tekstin individualisht dhe në heshtje. Pasi që lexohet teksti, nxënësit formojnë pyetje në tabelë, njëkohësisht mund edhe t’iu përgjigjen pyetjeve apo të shtojnë diçka. Ky proces realizohet në heshtje. Secili nxënës pajiset me marker (ngjyra të ndryshme) dhe shënohet në formën e organizuesit grafik ose të diagramit të degëzuar (qendër-periferi).



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Punë individuale

Mësimdhënësi paraqet një tabelë të ndarë në sektorë para nxënësve, nxënësit duhet të votojnë për llojin e transportit që ata mendojnë se është më i sigurti dhe duhet dhënë koment që të mbrojnë pëlqimin e tyre. Votojnë në tabelë dhe e mbrojnë votën me gojë (diskutim).

Tokësor	Ajror	Ujor

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Reflektim për veprimtarinë e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet humane

Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan rëndësinë e tregtisë për zhvillimin ekonomik; Vlerëson rolin e turizmit në shoqërinë bashkëkohore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I – 1, 2, 3, 4, 7, 8; II – 1, 2, 3, 6, 8; III – 1, 3, 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe të veprimit, shpërndarjen dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, në nivel rajonal dhe në atë global.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Turizmi dhe tregtia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon tregtinë si veprimtari ekonomike;
- Tregon rolin e tregtisë në zhvillimin e ekonomisë;
- Dallon motivet e turizmit;
- Arsyeton rolin e tij në zhvillimin e ekonomisë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë e botës, fotografi me shembuj të tregtisë dhe të turizmit.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Di-Dua të di-Mësova

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të tregojnë se çfarë dinë ata rreth popullsisë në botë. Pas çdo informacioni që



Turizmi

Turizmi paraqet çdo ndërrim të vendit të banimit (udhëtim), i cili nuk ka karakter afarist, por bëhet për shkak të pushimit, argëtimit dhe rehabilitimit. Turizmi është një degë e rëndësishme e sektorit terciar. Të hyrat nga turizmi paraqesin të ashtuquajturin *"eksport i padukshëm"*, i cili është me rëndësi sidomos për vendet me bilanc tregtar negativ. Motivet themelore të udhëtimeve turistike janë rekreative dhe kulturore. Në qëllimet e udhëtimeve turistike bëjnë pjesë dëshirat e njerëzve për të njohur trevat e reja, natyrën, popullsinë, kulturën dhe trashëgiminë kulturore, traditat dhe zakonet etj.

Zhvillimi i turizmit varet nga kushtet natyrore, nga trashëgimia kulturore-historike, shkalla e zhvillimit ekonomik etj. Turizmi veror ose bregdetar zhvillohet në vendet me klimë të nxehtë, me kohëzgjatje të mjaftueshme të shkëlqimit diellor. Në anën tjetër, turizmi dimëror zhvillohet në viset me lartësi të madhe mbidetare, me reshje të borës dhe kohëzgjatje të mjaftueshme të mbulesës së borës. Lokalitetet e ndryshme të trashëgimisë kulturore ose edhe trashëgimia e pasur shpirtërore e plotësojnë ofertën turistike dhe e bëjnë atë më të pasur.


Tregtia

Tregtia është veprimtari ekonomike e cila merret me këmbimin e mallrave ndërmjet prodhuesve dhe konsumatorëve. Tregtia mund të jetë lokale, kur zhvillohet brenda një vendbanimi apo krahine, e brendshme, kur zhvillohet brenda territorit të një shteti dhe e jashtme, kur zhvillohet me shtete të tjera.

Bilanci tregtar i shteteve varet nga raporti ndërmjet importit dhe eksportit. Kur vlera e eksportit të mallrave kalon atë të importit, **bilanci tregtar është pozitiv**, ndërsa, kur vlera e importit është më e madhe se ajo e eksportit, **bilanci tregtar është negativ**.



Fluturimet e lira filluan në vitet '70, duke mundësuar numër më të madh të njerëzve që të udhëtojnë



Motivet turistike dhe lëvizja e numrit të turistëve ndër vite



Pyetje

1. Çka është tregtia dhe si ndahet ajo?
2. Çka është turizmi?
3. Cilat janë motivet kryesore të udhëtimit turistike?

145

ata theksojnë se dinë, dalin dhe e shkruajnë në tabelë te rubrika “DI”.

Di	Dua të di	Mësova
Tregtia merret me shitjen dhe blerjen e mallrave. Kemi tregti me shumicë dhe me pakicë. Turizmi ka të bëjë me vizitat në vendet e huaja. Të vizitosh detin është turizëm.		



Ndërtimi i njohurive:

Di-Dua të di-Mësova

Nxënësit parashtrojnë pyetje rreth popullsisë së botës ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj mësimit ndërsësisht. Të gjitha i vendosin në rubrikën “Dua të Di”.

Di	Dua të di	Mësova
Tregtia merret me shitjen dhe blerjen e mallrave. Kemi tregti me shumicë dhe me pakicë. Turizmi ka të bëjë me vizitat në vendet e huaja. Ta vizitosh detin është turizëm.	Si ndahet tregtia? Nga çka varet zhvillimi i turizmit? Çka është importi? Çka nënkupton eksporti? Cilat janë llojet e turizmit? Kush quhej tregti primitive?	



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënësve:

Di-Dua të di-Mësova

Pasi që nxënësit ta kenë lexuar njësinë mësimore, ata shpjegojnë pjesë-pjesë mësimin që mësuan gjatë orës.

Di	Dua të di	Mësova
Tregtia merret me shitjen dhe blerjen e mallrave. Kemi tregti me shumicë dhe me pakicë. Turizmi ka të bëjë me vizitat në vendet e huaja. Ta vizitosh detin është turizëm.	Si ndahet tregtia? Nga çka varet zhvillimi i turizmit? Çka është importi? Çka nënkupton eksporti? Cilat janë llojet e turizmit? Kush quhej tregti primitive?	Tregtia ndahet në: tregti të brendshme dhe tregti të jashtme. Zhvillimi i turizmit varet nga kushtet natyrore, trashëgimia kulturore-historike, shkalla e zhvillimit ekonomik etj. Blerja e mallrave nga jashtë paraqet importin.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të saktësisë së përgjigjeve, të ideve dhe argumenteve se si ndikon turizmi në zhvillimin e shtetit, duke përmendur edhe llojet e tij.

Detyrë:

Në fletoret personale, nxënësit t'i punojnë përgjigjet e pyetjeve nga libri bazë në faqe 145.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Sistemet humane

Rezultati i të nxënësve të temës:

Shpjegon rolin e transportit, të tregtisë, të turizmit dhe të veprimtarive të tjera (të sipërpërmendura) në zhvillimin ekonomik;

Vlerëson rolin e turizmit në shoqërinë bashkëkohore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I – 2, 3, 5; II – 2, 6, 8; III – 1, 3, 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe të veprimtarive, shpërndarjen dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, në nivel rajonal dhe në atë global.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime: Transporti, tregtia dhe turizmi

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Shpjegon lidhjet dhe dallimet mes sektorit të tretë të ekonomisë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë ekonomike.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim për njohuritë paraprake

Në fillim të orës mësimore, mësimdhënësi/ja ua kontrollon nxënësve detyrat e shtëpisë.

Industria e rëndë përfshin eksploatimin e lëndëve minerale, prodhimin e energjisë si dhe prodhimin e mjeteve dhe materialeve, të cilat shfrytëzohen në proceset e mëvonshme të prodhimit.

Industria e lehtë përfshin industrinë ushqimore, të tekstilit, të drurit, të lëkurës, të letërës etj. Industria ushqimore është ndër degët më të përhapura të kësaj industrie. Ajo merret me përpunimin e lëndëve të para me prejardhje bimore dhe shtazore, konservimin dhe ruajtjen e prodhimeve ushqimore etj.

Transporti

Transporti merret me bartjen e njerëzve, të mirave materiale dhe informacioneve nga një vend në vendin tjetër. Përmes transportit lidhet prodhimtaria me konsumatorët. Transporti ndahet në tokësor, ujor, ajror dhe gypor. Në transportin tokësor bëjnë pjesë ai rrugor dhe hekurudhor. Transporti rrugor ose automobilistik ka përhapje më të madhe se të gjitha llojet e transportit. Përdorimi gjithnjë e më i madh i transportit urban mundëson lidhjen e mirë dhe të shpejtë të njerëzve brenda lagjeve të qytetit.




Transporti hekurudhor, për herë të parë u lansua në Angli. Ky lloj i transportit kushton më lirë, por është më i ngadalshëm. Megjithatë, shtetet e zhvilluara po e rrisin gjithnjë e më tepër cilësinë dhe shpejtësinë e këtij transporti, siç janë: Japonia, Kina, Gjermania dhe Franca.

Transporti detar paraqet një ndër format më të vjetra të transportit. Përmes tij janë bërë udhëtime të gjata, janë zbuluar toka të reja dhe është zgjeruar horizonti gjeografik. Transporti detar është më i zhvilluar ndërmjet Evropës dhe Amerikës Veriore nëpërmjet Oqeanit Atlantik.

Transporti ajror është formë e re e transportit që kohët e fundit po shënon një zgjerim të madh. Ai është më i shpejtë dhe nuk kufizohet nga barrierat fizike, por është më i shtrenjtë se format e tjera të transportit, kushtëzohet nga kushtet klimatike, krijon zhurmë dhe mund të bartë më pak mallra.



Fluturimet e lira filluan në vitet '70, duke mundësuar numër më të madh të njerëzve që të udhëtojnë



Motivet turistike dhe lëvizja e numrit të turistëve ndër vite



Pyetje

1. Çka është tregtia dhe si ndahet ajo?
2. Çka është turizmi?
3. Cilat janë motivet kryesore të udhëtimit turistike?

145

Pastaj ua kalon fjalën 2 - 3 nxënësve për të përsëritur pjesë nga njësiti e kaluara mësimore.



Ndërtimi i njohurive:
Dil rrotull, fol rrotull

Mësimdhënësi/ja krijon një rreth me nxënësit në mes të klasës. Kërkohet nga nxënësit që të shikojnë këmbët e tyre, dhe kur mësimdhënësi/ja thotë “tash”, ata ngulin sytë te njëri nga nxënësit që kanë përballë. Dy nxënës që ndeshin shikimet e tyre te njëri-tjetri do t'i bëjnë nga një pyetje njëri-tjetrit dhe do të duhet të përgjigjen në ato pyetje. Ai nxënës që nuk e di përgjigjen largohet nga rrethi. Kjo vazhdon derisa të mbesin dy nxënësit e fundit.



Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit:
Rrjeti i diskutimit

Në fund, mësimdhënësi/ja jep temën me titull: “tregtia – turizmi – transporti, profesioni im” dhe nxënësit japin mendimet e tyre se në cilin profesion do të dëshironin të punonin.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen me anë të të shprehurit me gojë dhe të përgjigjeve të mira që do japin rreth dallimeve dhe të përbashkëta të sektorit të tretë ekonomik.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Bashkëveprimi njeri – natyrë

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik dhe anasjellas.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

I – 2, 3, 4, 5; II – 1, 3, 5; III – 3, 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm.

5.1. Inicion aktivitete konkrete grupore me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bashkësisë për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor. 5.2. Vlerëson dhe vepron sipas parimeve bazë të zhvillimit të qëndrueshëm.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mjedisi gjeografik dhe ruajtja e tij

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan elementet e mjedisit gjeografik në të cilin jeton;
- Shpjegon dallimin në mes të mjedisit jetësor dhe atij gjeografik;
- Analizon videon rreth mjedisit gjeografik;
- Argumenton gjërat negative dhe ato pozitive.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografii, ilustrime, laptop, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Teknologjia, Biologjia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Shpjegim i përparuar

Në fillim të orës, mësimdhënësi/ja, përmes projektorit, shfaq foto dhe një video të shkurtër rreth njësisë mësimore,

MJEDISI GJEOGRAFIK DHE RUAJTJA E TIJ

Mjedisi jetësor nënkupton ambientin ose rrethinën ku jetojnë qeniet e gjalla, të cilat janë në marrëdhënie të përhershme dhe të ndërsjella. Mjedisi jetësor paraqet një tërësi ambientale, ku elementet, si: uji, ajri, toka, energjia dhe bota e gjallë ndikojnë në njëra-tjetrën dhe varen njëra prej tjetrës. Brenda çdo mjedisi bëhet këmbimi i gjërave materiale, ndërsa qarkullimi i materies dhe rrjedha e energjisë mundësojnë zhvillimin e jetës brenda rrethit jetësor. Meqenëse çdo element në mjedis është i varur dhe ndikon në tjetrin, atëherë çfarëdo çrregullimi në këtë tërësi shkakton ndryshime të njëpasnjëshme. Si mjedise natyrore, sot në Tokë kanë mbetur vetëm viset polare, shkretëtirat, pyjet tropike etj. Por, nën ndikimin e veprimtarive njerëzore, edhe këto mjedise natyrore në mënyrë të tërthortë po preken nga ndotja, nga rritja e sasisë së dyoksidit të karbonit në atmosferë etj.

Njeriu sot banon në pjesën më të madhe të botës dhe ndryshimet në mjedis lidhen me veprimet e tij, prandaj për këtë arsye, përdoret edhe kuptimi mjedisi gjeografik. Mjedisi gjeografik paraqet përbërjen komplekse të ambientit, që përfshin elementet fiziko-gjeografike, strukturën ekonomike, mënyrën e jetesës dhe komponentët e tjerë të mjedisit. Pra, mjedisi gjeografik paraqet ambientin e ndryshuar natyror, ku ka ndërhyrje njeriu me veprimet e tij të organizuara në nivele të ndryshme.



MJEDISI GJEORAFIK DHE RUAJTJA E TIJ

Mjedisi jetësor nënkupton ambientin ose rrethinën ku jetojnë qeniet e gjalla, të cilat janë në marrëdhënie të përhershme dhe të ndërsjella. Mjedisi jetësor paraqet një tërësi ambientale, ku elementet, si: uji, ajri, toka, energjia dhe bota e gjallë ndikojnë në njëra-tjetrën dhe varen njëra prej tjetrës. Brenda çdo mjedisi bëhet këmbimi i gjërave materiale, ndërsa qarkullimi i materies dhe rrjedha e energjisë mundësojnë zhvillimin e jetës brenda rrethit jetësor. Meqenëse çdo element në mjedis është i varur dhe ndikon në tjetrin, atëherë çfarëdo çrregullimi në këtë tërësi shkakton ndryshime të njëpasnjëshme. Si mjedise natyrore, sot në Tokë kanë mbetur vetëm viset polare, shkretëtirat, pyjet tropike etj. Por, nën ndikimin e veprimtarive njerëzore, edhe këto mjedise natyrore në mënyrë të tërthortë po preken nga ndotja, nga rritja e sasisë së dyoksidit të karbonit në atmosferë etj.

Njeriu sot banon në pjesën më të madhe të botës dhe ndryshimet në mjedis lidhen me veprimet e tij, prandaj për këtë arsye, përdoret edhe kuptimi mjedisi gjeografik. Mjedisi gjeografik paraqet përbërjen komplekse të ambientit, që përfshin elementet fiziko-gjeografike, strukturën ekonomike, mënyrën e jetesës dhe komponentët e tjerë të mjedisit. Pra, mjedisi gjeografik paraqet ambientin e ndryshuar natyror, ku ka ndërhyrë njeriu me veprimet e tij të organizuara në nivele të ndryshme.



146

me qëllim që të nxisë kureshtje te nxënësit për temën e re mësimore rreth mjedisit gjeografik.

Shtrohen disa pyetje lidhur me fotot dhe videon.

<https://www.bing.com/videos/riverview/related-video?&q=mjedisi+gjeografik+n%c3%ab+Kosov%c3%ab&&mid=DDA9761481343721D1DED-DA9761481343721D1DE&&FORM=VRDGAR>



Ndërtimi i njohurive:

Lexim i orientuar

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të lexojnë në heshtje temën. Pas leximit u kërkon që të nxjerrin shënime me informacionet kyçe të temës, dhe t'i krahasojnë me ato që i kanë shikuar në fillim të orës përmes projektorit.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Organizues grafik



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për aktivitetin e tyre gjatë mësimin, gjithnjë duke i pasur parasysh përgjigjet e sakta rreth dallimit të mjedisit jetësor nga ai gjeografik, elementet e mjedisit dhe të analizimit të videos së paraqitur.

Detyrë:

Ese: “Përshkruani mjedisin tuaj gjeografik”.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Bashkëveprimi njeri – natyrë

Rezultati i të nxëniet të temës:

Shpjegon marrëdhënien ndërmjet njeriut dhe mjedisit, si: pasojat e ndryshimeve klimatike në mjedis dhe në shëndet, të rreziqeve natyrore dhe të atyre të krijuara nga njeriu dhe mënyra të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I – 4, 6; II – 1, 3, : III – 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.

Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm;

5.1. Inicion aktivitete konkrete grupore, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bashkësisë për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndikimet e njeriut në mjedis

Rezultatet e të nxëniet të orës mësimore:

- Shpjegon ndikimet e njeriut në mjedis si pasojë e punës së tij;
- Analizon pasojat që mund t'i vijnë njeriut nga ndotja që ai vetë e shkakton.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Atlas enciklopedik, fotografi, hartë, projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Biologjia, Kimia, Edukata qytetare, Teknologjia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Shpjegim i përparuar

Nxënënsve iu shfaqet një video e shkurtër rreth bashkëveprimit njeri – natyrë dhe iu shtrohen disa pyetje sipas



Ndikimi i njeriut në mjedis

Edhe njeriu është pjesë e mjedisit, por me organizimin shoqëror ai u dallua nga llojet e tjera, duke u bërë faktor me ndikim të madh në ndryshimin e natyrës. Nga ndikimet njerëzore ndodhën ndryshime të mëdha në natyrë. Shoqëria njerëzore që nga lashtësia e ka zgjeruar vazhdimisht veprimtarinë e saj në natyrë, duke prodhuar e ndërtuar objekte të banimit, objekte ekonomike, infrastrukturë etj.

Në këtë mënyrë, njeriu e transformoi mjedisin natyror në mjedis të kultivuar, duke i ashpërsuar ndikimet e ndërsjella të natyrës dhe shoqërisë. Krahas rritjes së numrit të popullsisë, sidomos nga fillimi i shekullit të kaluar, kur mori hov zhvillimi i industrisë dhe i qyteteve, u shtuan edhe kërkesat e njerëzimit për ushqim, për minerale dhe burime të energjisë. Për këtë arsye, presioni i shoqërisë njerëzore mbi mjedisin natyror vazhdon të rritet gjithnjë.

Nën ndikimin e njeriut ndryshoi dukshëm mbulesa bimore, bota shtazore, përbërja e tokave, cilësia dhe sasia e ujit nëpër vise të ndryshme etj. Njeriu ndikoi edhe në përhapjen e biodiversitetit prej një kontinenti në tjetrin. Disa lloje gjetën kushte shumë të volitshme dhe u shumuan së tepërmi, kurse disa të tjera e zvogëluan numrin e tyre deri në shfarosje. Bizonët dikur banonin dendur preriet e Amerikës Veriore, por tani gjenden vetëm në disa rezervate. Gjithashtu, edhe numri i elefantëve, tigrave, luanëve, ujqve etj., është sjellë në minimum. Ndërsa, nga gjuajtja e pakontrolluar në det, numri i disa llojeve të peshqve është zvogëluar dukshëm, e disa lloje ndodhen në prag të shfarosjes (balenat në Detin e Veriut).

Zhvillimi i shpejtë ekonomik, urban dhe popullativ kanë ndikuar dukshëm në ndryshimin e komponentëve të mjedisit. Njeriu, përmes shpenzimit të madh të energjisë dhe zhvillimit të industrisë, e ka ndotur rrethinën me mbeturina industriale, pesticide, me metale të rënda etj. Rrezikimi i planetit tonë nga ndotja ka marrë përmasa shqetësuese, duke sjellë në pikëpyetje edhe ekzistencën e njerëzimit.



T
Lirimi i gazeve helmuese nga energjëtika në mjedis

Për çdo ditë zhduken shumë lloje bimore e shtazore, kurse ambientet natyrore çrregullohen dhe shkatërrohen përfundimisht. Prerja e pakontrolluar e pyjeve po ndikon në shpëlarjen e tokës, zvogëlimin e rezervave të ujit dhe zgjerimin e shkretëtirave. Nga fillimi i shekullit të kaluar e këtej, në botë janë shkatërruar dhe kanë humbur me miliona hektarë sipërfaqe të pyjeve. Për shkak të urisë, sëmundjeve të shkaktuara nga uji dhe ajri i ndotur, për çdo vit në botë vdesin disa miliona njerëz, sidomos në vendet ekonomiksht të pazhvilluara. Krejt këto ndryshime ndodhën si pasojë e rritjes së numrit të banorëve dhe kërkesave të tyre për ushqim, energji dhe objekte të standardit, duke sjellë çrregullime serioze në dëm të vetë njeriut dhe mirëqenies së tij.

Qytetet janë mjediset më të rrezikuara nga ndotja. Në këto qendra ajri është ndotur në një shkallë të rrezikshme. Në qytete lirohet sasi e madhe e materieve ndotëse, prandaj edhe kushtet klimatike dallojnë nga rrethina e tyre. Në ajër lirohet sasi e madhe e pluhurit, grimca të imëta të hirit, tym dhe gaze helmuese nga makinat e shumta të trafikut, nga fabrikat, ngrohoret, nga oxhaqet e amvisërive etj. Sasi të mëdha të gazeve të dëmshme përqendrohen në ajrin e qytetit për një kohë, varësisht nga kushtet klimatike. Për këtë arsye, në qytet krijohen kushte të tjera klimatike për dallim nga rrethina, që njihet si mikroklima e qytetit.



T
Ndotja e qytetit

Qyteti freskohet nga rrymat e ajrit që vijnë nga rrethina. Prandaj, me planifikim duhen ndërtuar rrugë të gjera, të orientuara në drejtim të erërave dominante. Klimën e qytetit e përmirëson dukshëm edhe prezenca e gjelbërimit. Për këtë arsye, qyteti ka nevojë për sipërfaqe të shumta të gjelbëruara. Në qytetet e Evropës sipërfaqet e gjelbra sillen në rreth 15 m² për banor, kurse në qytetet e Kosovës ka më pak se 3 m².

Ndryshimet klimatike

Me zhvillimin e veprimtarive të shumta, si: industria, energjëtika, komunikacioni etj., në atmosferë vazhdimisht po lirohen gaze të dëmshme, të cilat po dëmtojnë edhe shtresën e ozonit. Kështu pra, njeriu me punën e tij po e ndryshon përbërjen e atmosferës dhe proceset e tjera që zhvillohen në të. Koncentrimi i këtyre gazeve në atmosferë ka shkaktuar efektin serrë dhe ndryshimet klimatike në planetin tonë. Kjo me siguri se do të ketë pasoja të rënda për jetën në Tokë.

nevojës.

<https://www.youtube.com/watch?v=WfGMYdalCIU>



Ndërtimi i njohurive:

Sistemi ndërveprues i shënimeve-INSERT

Udhëzohen nxënësit të lexojnë njësinë e re duke i përdorur shenjat e insertit. Pastaj diskutojnë me radhë se cilat informata ishin të njohura, cilat të reja dhe sqarohen pyetje nga mësimdhënësi, të shënuara nga nxënësit.

√	+	-	?
Infor- macion i njohur	Informa- cion i ri	Informa- cion që ndryshon nga ai që di	Sqarime për infor- macionin

Pas shikimit të videos dhe të instertit hapet diskutim në klasë për to.

Si ju duken marrëdhëniet e njeriut me natyrën?



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Imagjinata e drejtuar

Nxënësit do të reflektojnë rreth temës, duke treguar një ndikim pozitiv dhe një ndikim negativ të njeriut në natyrë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi bëhet në bazë të informatave kthyesë dhe të saktë rreth ndikimit të njeriut në mjedis dhe nga dëmet që mund t'i vijnë nga ndotja që ai vetë shkakton.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune në faqe 77.

Reflektim për vejedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Bashkëveprimi njeri – natyrë

Rezultati i të nxënësve të temës:

Shpjegon marrëdhënien ndërmjet njeriut dhe mjedisit, si: pasojat e ndryshimeve klimatike në mjedis dhe në shëndet, të rreziqeve natyrore dhe atyre të krijuara nga njeriu dhe mënyra të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I – 4, 6; II – 1, 3, : III – 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm; 5.1. Inicion aktivitete konkrete grupore, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bashkësisë për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndryshimet klimatike

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Analizon pasojat që mund t'i vijnë njeriut me efektin serrë;
- Identifikon mënyra të përmirësimit të gjendjes aktuale të ngrohjes globale.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Tabelë, laptop, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Historia, Teknologjia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënës

Krahasim dhe kategorizim

Mësimdhënësi/ja paraqet me anë të projektorit një videofilm të shkurtër, i cili flet për ndryshimet klimatike, ku



Për çdo ditë zhduken shumë lloje bimore e shtazore, kurse ambientet natyrore çrregullohen dhe shkatërrohen përfundimisht. Prerja e pakontrolluar e pyjeve po ndikon në shpëlarjen e tokës, zvogëlimin e rezervave të ujit dhe zgjerimin e shkretëtirave. Nga fillimi i shekullit të kaluar e këtej, në botë janë shkatërruar dhe kanë humbur me miliona hektarë sipërfaqe të pyjeve. Për shkak të urisë, sëmundjeve të shkaktuara nga uji dhe ajri i ndotur, për çdo vit në botë vdesin disa miliona njerëz, sidomos në vendet ekonomisht të pazhvilluara. Krejt këto ndryshime ndodhën si pasojë e rritjes së numrit të banorëve dhe kërkesave të tyre për ushqim, energji dhe objekte të standardit, duke sjellë çrregullime serioze në dëm të vetë njeriut dhe mirëqenies së tij.

Lirimi i gazeve helmuese nga energjëtika në mjedis

Qytetet janë mjediset më të rrezikuara nga ndotja. Në këto qendra ajri është ndotur në një shkallë të rrezikshme. Në qytete lirohet sasi e madhe e materieve ndotëse, prandaj edhe kushtet klimatike dallojnë nga rrethina e tyre. Në ajër lirohet sasi e madhe e pluhurit, grimca të imëta të hirit, tym dhe gaze helmuese nga makinat e shumta të trafikut, nga fabrikat, ngrohoret, nga oxhaqet e amvisërive etj. Sasi të mëdha të gazeve të dëmshme përqendrohen në ajrin e qytetit për një kohë, varësisht nga kushtet klimatike. Për këtë arsye, në qytet krijohen kushte të tjera klimatike për dallim nga rrethina, që njihet si mikroklima e qytetit.



Ndotja e qytetit


Qyteti freskohet nga rrymat e ajrit që vijnë nga rrethina. Prandaj, me planifikim duhen ndërtuar rrugë të gjera, të orientuara në drejtim të erërave dominante. Klimën e qytetit e përmirëson dukshëm edhe prezenca e gjelbërimit. Për këtë arsye, qyteti ka nevojë për sipërfaqe të shumta të gjelbëruara. Në qytetet e Evropës sipërfaqet e gjelbra sillen në rreth 15 m² për banor, kurse në qytetet e Kosovës ka më pak se 3 m².

Ndryshimet klimatike

Me zhvillimin e veprimtarive të shumta, si: industria, energjëtika, komunikacioni etj., në atmosferë vazhdimisht po lirohen gaze të dëmshme, të cilat po dëmtojnë edhe shtresën e ozonit. Kështu pra, njeriu me punën e tij po e ndryshon përbërjen e atmosferës dhe proceset e tjera që zhvillohen në të. Koncentrimi i këtyre gazeve në atmosferë ka shkaktuar efektin serrë dhe ndryshimet klimatike në planetin tonë. Kjo me siguri se do të ketë pasojë të rënda për jetën në Tokë.


Efekt i serrë ka kuptimin e kopshtit të qelqit, ku rrezet e diellit depërtojnë në brendi të "kopshtit qelqor" dhe ngrohjin ajrin brenda. Por, pastaj qelqi e pengon daljen e kësaj nxehtësie nga brendia. Në këtë përbërje të gazeve të efektit serrë, të shkaktuara nga veprimi i njeriut, marrin pjesë: dyoksidi i karbonit, metani, dyoksidi i azotit etj. Si pasojë e këtyre ndryshimeve, në përbërjen e atmosferës, temperatura mesatare në sipërfaqen e Tokës është ngritur për 0.6 °C.

Krahas rritjes së temperaturave mesatare, po rriten vazhdimisht edhe fatkeqësitë natyrore, të cilat kohët e fundit kanë marrë përmasa shqetësuese. Ndryshimet klimatike mund të sjellin uragane më të fuqishme, valë të temperaturave të larta, thatësira dhe ngritje të nivelit të detit për një metër deri në fund të këtij shekulli. Këto ndryshime me siguri se do të kenë pasojë edhe më të mëdha në dekadat në vijim. Oqeanet nuk mund ta absorbojnë sasinë e tepruar të dyoksidit të karbonit, ndërsa kjo do të shprehet në çrregullimin e temperaturave në tërë planetin tonë.



Disa nga kontribuesit kryesorë në ngrohjen globale (burimi: Friedland et al., 2012)

Si pasojë e ndryshimeve klimatike, fatkeqësitë natyrore gjithnjë e më tepër po intensifikohen duke u bërë më të furishme; gjysma e tokës së punueshme është degraduar, rezervat e peshkut janë zvogëluar, disa rryma detare dhe atmosferike kanë ndryshuar drejtimin etj. Efektet e ndryshimeve klimatike mund të dëshmojnë me shumë fakte: për katër dekadat e fundit trashësia e akullit në Arktik është zvogëluar përreth 2 metra; sipërfaqja e disa liqeneve është zvogëluar për disa herë (liqeni Aral, liqeni Çad në Afrikë etj.); Akullnajat e Alpeve e kanë përgjysmuar sipërfaqen e tyre. Sipërfaqja e akullit në Kilimanxharo (Afrikë) gjatë shekullit të fundit është zvogëluar rreth 80 %, kurse lumenjtë më nuk rrjedhin; thatësia dhe zjarret kanë përfshirë gati se të gjitha kontinentet, duke rrezikuar shumë vendbanime, kurse, në anën tjetër, disa regjione përfshihen nga vërshimet me pasojë të rënda në ekonomi dhe në njerëz.



Koncentrimi i CO₂ në atmosferë



**Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënës:**
Rrjeti i diskutimit

Si dhe sa mund ta ndimojmë planetin tonë nga ndryshimet klimatike?
Nxënësit japin opinionet e tyre.
Si mund ta ndihmojmë ne planetin dhe ta ulim ndotjen?

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen me anë të përgjigjeve të sakta që japin për efektin serrë dhe me anë të ideve për përmirësimin e ndotjes.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune, faqe 77 dhe 78.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

shihen pamje se si ka qenë planeti ynë; si kanë qenë temperaturat dhe si janë tani.

<https://www.bing.com/videos/riverview/related-video?&q=ngrohja+globale&&mid=A9B51B7F-05B88CA49ECDA9B51B7F05B88CA49ECD&&FORM=VRDGAR>.

Kështu, nxënësit njoftohen me temën që do të zhvillohet.



Ndërtimi i njohurive:
Ditari dypjesësh

Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit që të lexojnë tekstin në heshtje dhe individualisht. Deri sa nxënësit lexojnë, mësimdhënësi/ja shënon në tabelë disa pyetje, të cilat nxënësit, pas leximit, i plotësojnë me ato fragmente që mendojnë se e plotësojnë pyetjen e parashtuar.

Pyetje	Komente
1. Çka nënkupton efekti serrë?	Efekt i serrë ka kuptimin e kopshtit të qelqit, ku rrezet e diellit depërtojnë në brendi të "kopshtit qelqor" dhe ngrohjin ajrin brenda.
2. Kush është shkaktari i ndryshimeve klimatike?	Industria, energjetika, komunikacioni, ndotja etj.
3. Si mund ta parandalojmë këtë dukuri apo si ta mbrojmë planetin tonë?	Duke ulur ndotjen e mjedisit, shpenzimet në energji dhe industri, mbjellja e drunjeve, kujdesi ndaj natyrës etj.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Bashkëveprimi njeri – natyrë

Rezultati i të nxënësve të temës:

Shpjegojnë marrëdhënien ndërmjet njeriut dhe mjedisit, si: pasojat e ndryshimeve klimatike në mjedis dhe në shëndet, të rreziqeve natyrore dhe atyre të krijuara nga njeriu dhe mënyra të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I – 1, 2, 4; II – 1, 3, ; III – 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.

Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm;

5.1. Inicion aktivitete konkrete grupore me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bashkësisë për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shkrirja e akullnajave

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Shpjegojnë pasojat e shkrirjes së akullnajave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografji, hartë, projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Biologjia, Kimia, Teknologjia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënës

Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi para nxënësve paraqet hartën fizike të botës, ku me theks të veçantë përmend pjesët e ngrira të



Shkrirja e akullnajave


Derisa temperatura mesatare në planetin tonë përgjatë shekullit të 20-të është rritur për 0.6 °C, ajo në viset arktike është rritur për më shumë se 2 °C që nga viti 1950. Në Polin e Veriut, sipërfaqja e akullit është zvogëluar përreth 30 % vetëm në tri dekadat e fundit. Kjo tregon se viset polare janë më të ndryshme ndaj ndryshimeve klimatike.

Si pasojë e shkrirjes së akullnajave, niveli i detit gjatë shekullit të 20-të është rritur për 15 cm, kurse deri në fund të shekullit të 21-të, parashihet të rritet për 1 metër. Nga rritja e nivelit të detit, shumë ujdhese po zhyten në ujë. Trashësia e akullit në Grenlandë është në proces të zvogëlimit, ndërsa, nga shkrirja e plotë e saj, niveli i detit mund të rritet për disa metra. Nëse niveli i detit do të ngrihet për 1.5 m, shumë vende të ulëta të botës do të mbulohej nga uji, kurse vetëm në Bangladesh do të humbin rreth 22 mijë km² sipërfaqe të tokës, në të cilën sot jetojnë mbi 20 milionë banorë.

Shfrytëzimi i burimeve natyrore dhe problemet mjedisore

Për plotësimin e të gjitha nevojave të veta, njeriu i përdor burimet natyrore vazhdimisht. Ato njihen edhe si resurse natyrore, të cilat nuk janë rezultat i punës së njeriut, por që vijnë nga toka, bota bimore e shtazore, uji, druri, nafta, metale etj. Burimet natyrore janë të pandashme nga procesi i zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Me ndihmën e tyre mundësohet prodhimi i të gjitha të mirave materiale të nevojshme për punë dhe standard shoqëror. Burimet natyrore i përdorim për përfitim të energjisë, prodhimin e ushqimit, ngasjen e makinave etj. Në të vërtetë, me gjithçka që ushqehemi, përdorim dhe furnizohemi nga burimet natyrore. Burimet natyrore gjenden çdokund rreth nesh, kurse ne i shfrytëzojmë ato shumë shpejt. Shumë burime varfërohen më shpejt sesa që mund të zëvendësohen me të reja.

Burimet natyrore dallojnë ndërmjet vete si për nga prejardhja, ashtu edhe për nga natyra dhe efektet në mjedis. Në bazë të kohëzgjatjes, burimet natyrore ndahen në tri grupe: të papërtëria, të përtëria dhe të përhershme.



Shkrirja e akullnajave

Derisa temperatura mesatare në planetin tonë përgjatë shekullit të 20-të është rritur për 0.6 °C, ajo në viset arktike është rritur për më shumë se 2 °C që nga viti 1950. Në Polin e Veriut, sipërfaqja e akullit është zvogëluar përrreth 30 % vetëm në tri dekadat e fundit. Kjo tregon se viset polare janë më të ndjeshme ndaj ndryshimeve klimatike.

Si pasojë e shkrirjes së akullnajave, niveli i detit gjatë shekullit të 20-të është rritur për 15 cm, kurse deri në fund të shekullit të 21-të, parashihet të rritet për 1 metër. Nga rritja e nivelit të detit, shumë ujdhësa po zhyten në ujë. Trashësia e akullit në Grenlandë është në proces të zvogëlimit, ndërsa, nga shkrirja e plotë e saj, niveli i detit mund të rritet për disa metra. Nëse niveli i detit do të ngrihet për 1.5 m, shumë vende të ulëta të botës do të mbuloohen nga uji, kurse vetëm në Bangladesh do të humbin rreth 22 mijë km² sipërfaqe të tokës, në të cilën sot jetojnë mbi 20 milionë banorë.

Shfrytëzimi i burimeve natyrore dhe problemet mjedisore

Për plotësimin e të gjitha nevojave të veta, njeriu i përdor burimet natyrore vazhdimisht. Ato njihen edhe si resurse natyrore, të cilat nuk janë rezultat i punës së njeriut, por që vijnë nga toka, bota bimore e shtazore, uji, druri, nafta, metallet etj. Burimet natyrore janë të pandashme nga procesi i zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Me ndihmën e tyre mundësohet prodhimi i të gjitha të mirave materiale të nevojshme për punë dhe standard shoqëror. Burimet natyrore i përdorim për përfitimin e energjisë, prodhimin e ushqimit, ngasjen e makinave etj. Në të vërtetë, me gjithçka që ushqehemi, përdorim dhe furnizohemi nga burimet natyrore. Burimet natyrore gjenden çdokund rreth nesh, kurse ne i shfrytëzojmë ato shumë shpejt. Shumë burime varfërohen më shpejt sesa që mund të zëvendësohen me të reja.

Burimet natyrore dallojnë ndërmjet vete si për nga prejardhja, ashtu edhe për nga natyra dhe efektet në mjedis. Në bazë të kohëzgjatjes, burimet natyrore ndahen në tri grupe: të papërtërita, të përtërita dhe të përhershme.

150

Tokës, Polin e Veriut dhe atë të Jugut dhe bën disa pyetje, si:

1. A mund të ndodhë që të shkrihen viset polare?
2. Çka i ndodh planetit nëse shkrihen akullnajat?
3. Pse po ngriten temperaturat gjithnjë e më shumë?
4. A keni parë ndonjë dokumentar rreth shkrirjes së akullnajave, si vjen deri te shkrirja e tyre?

Kështu fillon diskutimi dhe nxënësit njihen me njësinë që do zhvillohet.



Ndërtimi i njohurive:

Prezantim

Mësimdhënësi paraprakisht përgatit një prezantim me *Power Point*, ku paraqet një foto-kolazh me pamje nga viset polare duke u shkrirë akullnajat, gjithnjë duke i pasqyruar edhe efektet negative që po paraqiten.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Diskutim i përbashkët

Nga nxënësit kërkohet që ata ta komentojnë, duke reflektuar nga njësia që mësuuan.

Po të ishit ministër i ambientit, çfarë hapash do të merrnit për ta ndihmuar sadopak mosshkrirjen e akullnajave?

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimin, gjithnjë duke u bazuar në angazhim dhe saktësi të përgjigjeve rreth analizimit të shkrirjes së akullnajave dhe parandalimit të saj.

Detyrë:

Të shikohet në shtëpi dokumentari <https://tvklan.al/shkrirja-e-akullit-ne-antarktide-alarmohen-shkencetaret>.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Bashkëveprimi njeri/natyre

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik dhe anasjellas; Shpjegon marrëdhënien ndërmjet njeriut dhe mjedisit, si: pasojat e ndryshimeve klimatike në mjedis dhe në shëndet, të rreziqeve natyrore dhe të atyre...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-2,4,5; 2-1,6; III-3,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm 5.1; 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shfrytëzimi i burimeve natyrore dhe problemet mjedisore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Gjykon ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedis dhe tregon pasojat që rrjedhin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri “Gjeografia 6”, atlas enciklopedik, fotografi, hartë, projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Rrjeti i diskutimit

Mësimdhënësi paraqet një videoprezantim para nxënësve, ku dokumentohet historia e “Ishullit të pashkëve”. Ky videoprezantim tregon shfrytëzimin pa kriter të resurseve natyrore dhe tregon pasojat që ndodhin në një ishull të vogël. Link: <https://www.youtube.com/watch?v=gfbQA-Krx9Q> 14.10.2018



Shkrirja e akullnajave

Derisa temperatura mesatare në planetin tonë përgjatë shekullit të 20-të është rritur për 0.6 °C, ajo në viset arktike është rritur për më shumë se 2 °C që nga viti 1950. Në Polin e Veriut, sipërfaqja e akullit është zvogëluar përreth 30 % vetëm në tri dekadat e fundit. Kjo tregon se viset polare janë më të ndryshme ndaj ndryshimeve klimatike.

Si pasojë e shkrirjes së akullnajave, niveli i detit gjatë shekullit të 20-të është rritur për 15 cm, kurse deri në fund të shekullit të 21-të, parashihet të rritet për 1 metër. Nga rritja e nivelit të detit, shumë ujdhësa po zhyten në ujë. Trashësia e akullit në Grenlandë është në proces të zvogëlimit, ndërsa, nga shkrirja e plotë e saj, niveli i detit mund të rritet për disa metra. Nëse niveli i detit do të ngrihet për 1.5 m, shumë vende të ulëta të botës do të mbulohen nga uji, kurse vetëm në Bangladesh do të humbin rreth 22 mijë km² sipërfaqe të tokës, në të cilën sot jetojnë mbi 20 milionë banorë.


Shfrytëzimi i burimeve natyrore dhe problemet mjedisore

Për plotësimin e të gjitha nevojave të veta, njeriu i përdor burimet natyrore vazhdimisht. Ato njihen edhe si resurse natyrore, të cilat nuk janë rezultat i punës së njeriut, por që vijnë nga toka, bota bimore e shtazore, uji, druri, nafta, metalet etj. Burimet natyrore janë të pandashme nga procesi i zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Me ndihmën e tyre mundësohet prodhimi i të gjitha të mirave materiale të nevojshme për punë dhe standard shoqëror. Burimet natyrore i përdorim për përfitimin e energjisë, prodhimin e ushqimit, ngasjen e makinave etj. Në të vërtetë, me gjithçka që ushqehemi, përdorim dhe furnizohemi nga burimet natyrore. Burimet natyrore gjenden çdokund rreth nesh, kurse ne i shfrytëzojmë ato shumë shpejt. Shumë burime varfërohen më shpejt sesa që mund të zëvendësohen me të reja.

Burimet natyrore dallojnë ndërmjet vete si për nga prejardhja, ashtu edhe për nga natyra dhe efektet në mjedis. Në bazë të kohëzgjatjes, burimet natyrore ndahen në tri grupe: të papërtëria, të përtëria dhe të përhershme.



Disa prej këtyre burimeve përdoren për përfitim të energjisë. Energjetika është ndër faktorët më të rëndësishëm të zhvillimit dhe njëkohësisht përbën edhe ndër problemet kryesore të mjedisit. Që nga zbulimi i saj e deri sot, energjia ka ndikuar në ndryshimin dhe përmirësimin e kushteve jetësore, kurse zhvillimi i shoqërisë njerëzore nuk mund të paramendohet pa të. Por, burimet e papërtërirra përdoren vetëm gjatë një procesi (thëngjilli, nafta, gasi natyror), ndërsa ato shpenzohen duke ndotur mjedisin jetësor. Materiet ndotëse të emetuara nga energjetika kontribuuan më së shumti në fenomenin e efektit serrë dhe në ndryshimet klimatike.



Zhvillimi i industrisë u manifestua me ndryshime të rëndësishme në regjionet e ndryshme të botës, duke zbratur hapësira të mëdha që ishin të banuara nga popullsia rurale. Ndërsa, në anën tjetër, përqendrimi i degëve të ndryshme industriale solli edhe grumbullimin e materieve ndotëse në vendet më të populluara. Me këtë rast, mjediset e shumta natyrore humbën aftësinë e rigjenerimit nga ndotja kimike dhe zgjerimi i pakontrolluar i sipërfaqeve artificiale.

Ne si individë, por edhe si shoqëri gjithësesi, duhet t'i respektojmë dhe t'i vlerësojmë të mirat natyrore nga të cilat jetojmë. Fatqësisht, njerëzimi kësaj nuk i ka kushtuar rëndësi aq sa duhet deri sot. Rritja ekonomike me eksploitim të tepruar të burimeve natyrore dhe me dëmtimin e natyrës nuk do të garantojë mirëqenien tonë. Prandaj, duhet kuptuar se pa mjedis të shëndoshë nuk ka cilësi të jetës dhe të ardhme të sigurt.


Mënyrat e shfrytëzimit të burimeve natyrore (burimi: Friedland et al., 2012)



Ndërtimi i njohurive:

Organizues grafik: Tabela e konceptit

Harta e të pyeturit mund të përdoret me mjaft sukses në këtë fazë të kësaj teme mësimore. Me këtë teknikë duhet të synohet nxitja e të menduarit dhe e interesit të nxënësve për çështjet që shtjellohen. Mësimdhënësi, në tabelë formon një grup të fjalëve kyçe dhe kërkon nga nxënësit që, në mënyrë vullnetare, të shprehin komente në lidhje me fjalët.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Paragraf përmbledhës

Tema: Ndikimi i shoqërisë njerëzore në mjedis dhe pasojat

Kriteret e paragrafit:

- Të paktën pesë veprimtari njerëzore që shkaktojnë ndotje të mjedisit;
- Pesë pasoja nga kjo veprimtari;
- Një shembull ku shoqëria njerëzore mbron mjedisin.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për kriteret e arritura në përshkrimin e temës për shkrimin e lirë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 79.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

Mësimi 67

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Bashkëveprimi njeri/natyrë

Rezultati i të nxënit të temës:

Ofron alternativa dhe strategji të mundshme të mbrojtjes dhe të shfrytëzimit të burimeve natyrore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I – 2, 3, 5; II – 1,2,3,4, 6; III – 1, 3, 5; V, 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.

Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm;

5.1. Inicion aktivitete konkrete grupore me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bashkësisë për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor; 5.2. Vlerëson dhe vepron sipas parimeve bazë të zhvillimit të qëndrueshëm.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Aktivitet: Riciklimi

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson rolin e riciklimit për mjedisin jetësor dhe jetën e njeriut;
- Ndërlidh procesin e riciklimit me zvogëlimin e sasisë së mbeturinave në mjedis, duke treguar së paku një shembull.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Qese plastmase, dorëza gome, shkopinj, letra, shporta plastike etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Biologjia, Kimia, Fizika, Edukata qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Veprimtari praktike

Nxënësit, në dyshe, mbledhin mbeturinat në oborrin e shkollës dhe përreth.





Ndërtimi i njohurive:

Rigrupimi

Nxënësit, pasi t'i kenë mbledhur mbeturinat, bëhen bashkë dhe i klasifikojnë ato në shporta të ndara, si:

1. Qelqin;
2. Letrën;
3. Plastikën;
4. Metalet.

Ora mund të mbahet së bashku edhe me “Klubin e gjelbër” të shkollës ose në bashkëpunim me lëndët e tjera mësimore, si: Biologji, Kimi, Fizikë, Edukatë qytetare.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Finalizim i veprimtarisë

Mbeturinat dorëzohen në kategori të “Klubi i gjelbër” dhe dërgohen për riciklim.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të punës në grup, duke e shpërblyer grupin më të mirë me mirënjohje.

Detyrë:

Në shtëpi, të bëjnë një punim me mjete recikluese dhe ta sjellin në shkollë.

• *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VI
Tema: Bashkëveprimi njeri/natyrë

Rezultati i të nxënit të temës:
 Ofron alternativa dhe strategji të mundshme të mbrojtjes dhe të shfrytëzimit të burimeve natyrore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I-2,6; II-1,7; III-3,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm 5.1; 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Rrezikimi i pyjeve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson rolin dhe rëndësinë e pyjeve në jetën dhe në veprimtarinë e shoqërisë njerëzore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Mjedis, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri “Gjeografia 6”, atlas enciklopedik, fotografi, hartë, projektor, laptop.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Asociacion

Arsimtari formon një asociacion në tabelë si vegës, që nxënësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka asociojnë me njësinë e re.

A	B	C	D
Druri	Amazona	Ekuatoriale	Tajgat
Pyjet			



Rrezikimi i pyjeve


Pyjet si burime të përtërrira natyrore kanë rëndësi të madhe për njerëzimin, por edhe për shumë procese të tjera që zhvillohen në planetin tonë. Në pyje jetojnë shumë organizma shtazorë, ku gjejnë ushqimin, mbrojtjen, strehimin, shumimin etj. Pyjet kanë rol shumë të rëndësishëm në mjedisin jetësor, sepse kanë ndikim të drejtpërdrejtë në klimë. Ato prodhojnë oksigjenin, absorbojnë dhe fiksuarin dyoksidin e karbonit, ndërsa ndikojnë në lagështinë e ajrit, zvogëlojnë ndotjen e ajrit, shpejtojnë qarkullimin e ujit në atmosferë me procesin e transpirationit etj.

Mirëpo, që nga zbulimi i zjarrit, njeriu ndikoi vazhdimisht në zvogëlimin e fondit të pyjeve, ndërsa nga revolucioni bujqësor e këndej u përfutuan me miliona hektarë tokë punuese për zhvillimin e bujqësisë. Por, kulmi u arrit nga revolucioni industrial e këndej, me çka u rritën edhe kërkesat për lëndë të parë drunore në industri. Krahas kësaj, u rrezikuan shumë lloje shtazore, të cilat e humbën vendin e tyre të banimit dhe burimin e ushqimit e që ndërkohe u zhdukën.

Nga eksploatimi i tepruar i drurit, shumë vende nuk janë më në gjendje që t'i plotësojnë nevojat e industrisë. Si pasojë e këtij eksploatimi të tepruar, vise të tjera kanë ndryshuar pamjen e mëparshme, duke u shndërruar në peizazhe antropogjene si qytete të mëdha dhe të pakufizuara, por edhe në shkretëtira. Sot kanë mbetur shumë pak peizazhe natyrore në viset tropike dhe në tajga, mirëpo edhe këto nuk kanë mbetur pa u prekur në mënyrë indirekte nga ndotja e atmosferës.

Dikur rreth gjysma e territorit të Kinës ishte e mbuluar me pyje, ndërsa tani ka mbetur vetëm 8 % e sipërfaqes së saj. Para disa shekujve, rreth 70 % e sipërfaqes së kontinentit të Evropës ishte e mbuluar me pyje, kurse sot ka mbetur vetëm 20 %. Nga prerja e pakontrolluar e pyjeve sot shkaktohen vërshime të shpeshta, që sjellin dëme të mëdha në ekonomi dhe viktima në njerëz.

Në shumë vende aziatike, afrikane dhe amerikane sipërfaqet e pyjeve janë shkatërruar ose janë sjellë në minimum. Druri edhe sot përdoret si lëndë djegëse për një pjesë të madhe të njerëzimit. Në disa vende të stërrpopulluara të Azisë Jugore, për çdo vit priten rreth 40 milionë hektarë pyje tropike,



Ndryshimet e mjedisit nga shpyllëzimi (burimi: Miller, 2006)

ndërsa me këtë trend të prerjes në ultësirat e Malajzisë dhe Filipineve nuk do të ketë më drurë brenda një periudhe të shkurtër. Për çdo vit, rrëketë e ujit shpërfajnë sasi të madhe të dheut produktiv, duke e sjellë në luginë dhe duke i vërshuar urat e pëlleshme, duke e zvogëluar aftësinë lundruese të lumenjve etj. Si pasojë e kësaj, në 100 vitet e fundit sipërfaqet shkretinore në botë janë zgjeruar përrreth tri herë, nga 11 milionë km², në rreth 30 milionë km², ndërsa ky proces është vazhdimisht në rritje.

Nga ndotja e madhe e atmosferës, kohët e fundit, gjithnjë e më tepër paraqiten reshjet e tharta, të cilat po ndikojnë në shkatërrimin e mjedisit, e veçanërisht në tharjen e pyjeve. Reshjet e tharta krijohen nga dyoksidi i sulfurit dhe oksidet e azotit të emetuara nga djegia e karburanteve, të cilat në atmosferë kthehen në acide sulfurore dhe të azotit.

Këto thartira kthehen në tokë bashkë me pikat e shiut ose ndonjëherë si pluhur i grimcave të thata, të cilat po ndikojnë në zvogëlimin e fondit të pyjeve, por dhe në produktivitetin bujqësor. Përveç dëmeve që sjellin në ligene dhe në pyje, reshjet e tharta dëmtojnë edhe fasadat e ndërtesave, urat dhe monumentet kulturore nga mermeri, por edhe janë të dëmshme për shëndetin e njeriut.



Shkatërrimi i pyjeve nga reshjet e tharta

153

Pasi identifikohet zgjidhja (njësia që do të zhvillohet), mësimdhënësi pyet nxënësit se pse janë marrë këto fjalë kyçe: Druri, Amazona, Ekuatoriale, Tajgat...



Ndërtimi i njohurive:

Të nxënësit me këmbime: Grupet e ekspertëve

Në këtë fazë nxënësit ndahen në grupe, udhëzohen të lexojnë temën “Rrezikimi i pyjeve”. Secilit grup i ndahen pyetjet e përgatitura nga arsimtari, që iu ofrohen në fleta.

Grupi 1

- Cili është roli i pyjeve për mjedisin?
- Cili është roli i reshjeve të tharta për pyjet?
- Cilat aktivitete rekreative mund të bëhen në pyje?

Grupi 2

- Cilat janë të mirat që na ofrojnë pyjet?
- Cili është roli i pyjeve për relievin?
- Cilat vende njihen për shpyllëzim?

Grupi 3

- Cili është pylli më i afërt i vendlindjes tënde?
- Për çka përdoret druri?
- Cili është roli i pyjeve për mjedisin?

Grupi 4

- Cilat kafshë jetojnë në pyje?
- Cilat janë pasojat e prerjes së pakontrolluar të pyjeve?
- Pse bëhet shpyllëzimi?
- Përfaqësuesit e grupeve iu përgjigjen pyetjeve dhe debatojnë lidhur me to.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Në 15 minutat e fundit, mësimdhënësi kërkon nga grupet që të lexojnë të arriturat gjatë bashkëpunimit. Pyetjet kryesisht synojnë dhe formulohen mbi bazën e kritereve të paraqitura në klasë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve që arrijnë kriteret e parashikuara dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Reflektim për veçdhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VI
Tema: Bashkëveprimi njeri/natyrë

Rezultati i të nxënit të temës:
 Ofron alternativa dhe strategji të mundshme të mbrojtjes dhe të shfrytëzimit të burimeve natyrore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-2,6; II-1,III-1,3,5,6, 8.VI-3, V-5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm 5.1. 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Aktivitet: Pylli im

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:


- Planifikon strategji së bashku me mësimdhënësit për mbrojtjen e mjedisit dhe vetëdijësimin për rëndësinë që ka.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Letra ngjitëse, shkopinj, ngjitës, marker, hamer (letër), plastifikues, spango, tablo druri industrial, ngjyra vaji.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Biologji, Edukatë qytetare (Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm).



Rrezikimi i pyjeve

Pyjet si burime të përtëria natyrore kanë rëndësi të madhe për njerëzimin, por edhe për shumë procese të tjera që zhvillohen në planetin tonë. Në pyje jetojnë shumë organizma shtazorë, ku gjejnë ushqimin, mbrojtjen, strehimin, shumimin etj. Pyjet kanë rol shumë të rëndësishëm në mjedisin jetësor, sepse kanë ndikim të drejtpërdrejtë në klimë. Ato prodhojnë oksigjenin, absorbojnë dhe fiksuarin dyoksidin e karbonit, ndërsa ndikojnë në lagështinë e ajrit, zvogëlojnë ndotjen e ajrit, shpejtojnë qarkullimin e ujit në atmosferë me procesin e transpirationit etj.

Mirëpo, që nga zbulimi i zjarrit, njeriu ndikoi vazhdimisht në zvogëlimin e fondit të pyjeve, ndërsa nga revolucioni bujqësor e këndej u përfutuan me miliona hektarë tokë punuese për zhvillimin e bujqësisë. Por, kulmi u arrit nga revolucioni industrial e këndej, me çka u rritën edhe kërkesat për lëndë të parë drunore në industri. Krahas kësaj, u rrezikuan shumë lloje shtazore, të cilat e humbën vendin e tyre të banimit dhe burimin e ushqimit e që ndërkohe u zhdukën.

Nga eksploatimi i tepruar i drurit, shumë vende nuk janë më në gjendje që t'i plotësojnë nevojat e industrisë. Si pasojë e këtij eksploatimi të tepruar, vise të tëra kanë ndryshuar pamjen e mëparshme, duke u shndërruar në peizazhe antropogjene si qytete të mëdha dhe të pakufizuara, por edhe në shkretëtira. Sot kanë mbetur shumë pak peizazhe natyrore në viset tropike dhe në tajga, mirëpo edhe këto nuk kanë mbetur pa u prekur në mënyrë indirekte nga ndotja e atmosferës.

Dikur rreth gjysma e territorit të Kinës ishte e mbuluar me pyje, ndërsa tani ka mbetur vetëm 8 % e sipërfaqes së saj. Para disa shekujve, rreth 70 % e sipërfaqes së kontinentit të Evropës ishte e mbuluar me pyje, kurse sot ka mbetur vetëm 20 %. Nga prerja e pakontrolluar e pyjeve sot shkaktohen vërshime të shpeshta, që sjellin dëme të mëdha në ekonomi dhe viktima në njerëz.


Në shumë vende aziatike, afrikane dhe amerikane sipërfaqet e pyjeve janë shkatërruar ose janë sjellë në minimum. Druri edhe sot përdoret si lëndë djegëse për një pjesë të madhe të njerëzimit. Në disa vende të stërrpopulluara të Azisë Jugore, për çdo vit priten rreth 40 milionë hektarë pyje tropike,

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
AKTIVITETI:

Në këtë orë bëhet përgatitja e shenjave lajmëruese dhe vetëdijësimin për mbrojtjen e pyjeve. Mësimdhënësi së bashku me nxënësit përpilojnë një plan se si duhet të kryhen disa shenja (pllakat) paralajmëruese, fletushka, letër lajmërimi... për mbrojtjen e pyjeve. Puna organizohet në grupe nga 3 nxënës për një punë.



Ndryshimet e mjedisit nga shpyllëzimi (burimi: Miller, 2006)

ndërsa me këtë trend të prerjes në ultësirat e Malajzisë dhe Filipineve nuk do të ketë më drurë brenda një periudhe të shkurtër. Për çdo vit, rrëketë e ujit shpërfaqin sasi të madhe të dheut produktiv, duke e sjellë në luginë dhe duke i vërshuar arat e pëlleshme, duke e zvogëluar aftësinë lundruese të lumenjve etj. Si pasojë e kësaj, në 100 vitet e fundit sipërfaqet shkretinore në botë janë zgjeruar përreth tri herë, nga 11 milionë km², në rreth 30 milionë km², ndërsa ky proces është vazhdimisht në rritje.

Nga ndotja e madhe e atmosferës, kohët e fundit, gjithnjë e më tepër paraqiten reshjet e tharta, të cilat po ndikojnë në shkatërrimin e mjedisit, e veçanërisht në tharjen e pyjeve. Reshjet e tharta krijohen nga dyoksidi i squfurit dhe oksidet e azotit të emetuara nga djegia e karburanteve, të cilat në atmosferë kthehen në acide sulfurore dhe të azotit.

Këto thartira kthehen në tokë bashkë me pikat e shiut ose ndonjëherë si pluhur i grimcave të thata, të cilat po ndikojnë në zvogëlimin e fondit të pyjeve, por dhe në produktivitetin bujqësor. Përveç dëmeve që sjellin në liqene dhe në pyje, reshjet e tharta dëmtojnë edhe fasadat e ndërtesave, urat dhe monumentet kulturore nga mermeri, por edhe janë të dëmshme për shëndetin e njeriut.



Shkatërrimi i pyjeve nga reshjet e tharta

153

Pllakatet kryesisht duhet të kenë fjalë të urta/motivuese për mbrojtjen e mjedisit ose të pyjeve, shenja lajmëruese... Shenja paralajmërimi për moshedhjen e mbeturinave dhe shenja e riciklimit... gjithashtu shenja orientuese ku të drejtojnë drejt konteinerëve, mbrojtjen e kafshëve të pyllit. Grupi i botanikës: Shenja paralajmëruese dhe mbrojtëse për kafshët që jetojnë në atë zonë.

Në klasë, mësimdhënësi në këtë fazë bën ndarjen e detyrave për secilin nxënës dhe mjetet e nevojshme për realizimin e aktivitetit, për të kursyer kohën gjatë aktivitetit në mjedis.

Në këtë orë duhet të bashkëpunohet edhe me mësimdhënësit e biologjisë dhe të edukatës qytetare. Aktiviteti parashihet që t'i ketë dy orë mësimore nëse pylli ose parku janë afër. Nëse pylli ose parku janë larg shkollës, mësimdhënësi paralajmëron organet e shkollës dhe organizohet si aktivitet jashtëkurrikular.

Vlerësimi i nxënësve:

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Për mësimdhënësin/en

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3

Klasa: VI

Tema: Bashkëveprimi njeri/natyrë

Rezultati i të nxënit të temës:

Ofron alternativa dhe strategji të mundshme të mbrojtjes dhe të shfrytëzimit të burimeve natyrore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-2,6; II-1,7; VI-3,5,6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm 5.1. 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Aktivitet: Mbrojtja e pyllit/parkut të qytetit (Ora realizohet jashtë klase)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Demonstron strategji për mbrojtjen e mjedisit dhe vetëdijësimin për rëndësinë që ka.


Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Letra ngjitesë, shkopinj, ngjites, marker, hamer (letër), plastifikues, spango, tablo druri industrial, ngjyra vaji.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Biologji, Edukatë qytetare; (Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm).



Rrezikimi i pyjeve

Pyjet si burime të përtërita natyrore kanë rëndësi të madhe për njerëzimin, por edhe për shumë procese të tjera që zhvillohen në planetin tonë. Në pyje jetojnë shumë organizma shtazorë, ku gjejnë ushqimin, mbrojtjen, strehimin, shumimin etj. Pyjet kanë rol shumë të rëndësishëm në mjedisin jetësor, sepse kanë ndikim të drejtpërdrejtë në klimë. Ato prodhojnë oksigjenin, absorbojnë dhe fiksuarin dyoksidin e karbonit, ndërsa ndikojnë në lagështinë e ajrit, zvogëlojnë ndotjen e ajrit, shpejtojnë qarkullimin e ujit në atmosferë me procesin e transpirationit etj.

Mirëpo, që nga zbulimi i zjarrit, njeriu ndikoi vazhdimisht në zvogëlimin e fondit të pyjeve, ndërsa nga revolucioni bujqësor e këndej u përfutur me miliona hektarë tokë punuese për zhvillimin e bujqësisë. Por, kulmi u arrit nga revolucioni industrial e këndej, me çka u rritën edhe kërkesat për lëndë të parë drunore në industri. Krahas kësaj, u rrezikuan shumë lloje shtazore, të cilat e humbën vendin e tyre të banimit dhe burimin e ushqimit e që ndërkohe u zhdukën.

Nga eksploatimi i tepruar i drurit, shumë vende nuk janë më në gjendje që t'i plotësojnë nevojat e industrisë. Si pasojë e këtij eksploatimi të tepruar, vise të tëra kanë ndryshuar pamjen e mëparshme, duke u shndërruar në peizazhe antropogjene si qytete të mëdha dhe të pakufizuara, por edhe në shkretëtira. Sot kanë mbetur shumë pak peizazhe natyrore në viset tropike dhe në tajga, mirëpo edhe këto nuk kanë mbetur pa u prekur në mënyrë indirekte nga ndotja e atmosferës.

Dikur rreth gjysma e territorit të Kinës ishte e mbuluar me pyje, ndërsa tani ka mbetur vetëm 8 % e sipërfaqes së saj. Para disa shekujve, rreth 70 % e sipërfaqes së kontinentit të Evropës ishte e mbuluar me pyje, kurse sot ka mbetur vetëm 20 %. Nga prerja e pakontrolluar e pyjeve sot shkaktohen vërshime të shpeshta, që sjellin dëme të mëdha në ekonomi dhe viktima në njerëz.

Në shumë vende aziatike, afrikane dhe amerikane sipërfaqet e pyjeve janë shkatërruar ose janë sjellë në minimum. Druri edhe sot përdoret si lëndë djegëse për një pjesë të madhe të njerëzimit. Në disa vende të stërrpopulluara të Azisë Jugore, për çdo vit priten rreth 40 milionë hektarë pyje tropike,

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Pjesa e dytë e aktivitetit – jashtë klase, në mjedis.

Pjesa e parë: Ora realizohet në oborrin e shkollës ose në pyllin më të afërt.

Mësimdhënësi në këtë fazë bën ndarjen e detyrave për secilin nxënë dhe mjetet e nevojshme për realizimin e aktivitetit.



Ndryshimet e mjedisit nga shpyllëzimi (burimi: Miller, 2006)

ndërsa me këtë trend të prerjes në ultësirat e Malajzisë dhe Filipineve nuk do të ketë më drurë brenda një periudhe të shkurtër. Për çdo vit, rrëketë e ujit shpërlajnë sasi të madhe të dheut produktiv, duke e sjellë në luginë dhe duke i vërshuar arat e pëlleshme, duke e zvogëluar aftësinë lundruese të lumenjve etj. Si pasojë e kësaj, në 100 vitet e fundit sipërfaqet shkretinore në botë janë zgjeruar përrreth tri herë, nga 11 milionë km², në rreth 30 milionë km², ndërsa ky proces është vazhdimisht në rritje.

Nga ndotja e madhe e atmosferës, kohët e fundit, gjithnjë e më tepër paraqiten reshjet e tharta, të cilat po ndikojnë në shkatërrimin e mjedisit, e veçanërisht në tharjen e pyjeve. Reshjet e tharta krijohen nga dyoksidi i squfurit dhe oksidet e azotit të emetuara nga djegia e karburanteve, të cilat në atmosferë kthehen në acide sulfurore dhe të azotit.

Këto thartaria kthehen në tokë bashkë me pikat e shiut ose ndonjëherë si pluhur i grimcave të thata, të cilat po ndikojnë në zvogëlimin e fondit të pyjeve, por dhe në produktivitetin bujqësor. Përveç dëmeve që sjellin në liqene dhe në pyje, reshjet e tharta dëmtojnë edhe fasadat e ndërtesave, urat dhe monumentet kulturore nga mermeri, por edhe janë të dëmshme për shëndetin e njeriut.



Shkatërrimi i pyjeve nga reshjet e tharta

153

Mësimdhënësi së bashku me nxënësit në oborrin e shkollës vendosin shenjat e përgatitura një orë më parë për ngritjen e vetëdijes së nxënësve për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor.

Pjesa e tretë: Përgatitja për përfundim, mbledhja e mbetjeve, pastrimi dhe reflektimi me anën e një raporti për punën që është kryer sot. Raporti mund të realizohet edhe në shtëpi dhe të sillet të nesërmen.

Vlerësimi i nxënësve:

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 71

<p>RREGULLAT GJATË TESTIMIT Mos komuniko me shoqen apo shokun; Kujdes në shenjimin e alternativave; Vetëm një alternativë është e saktë; Shëno shkrimin e lexueshëm; Mos e dëmto testin; Respekto kohën.</p> <p>Tema: Të shënohen temat sipas përqindjes, të cilat janë përfshirë në instrument për vlerësim. Sqarim: Testi shërben vetëm si shembull. Mësimdhënësit i mbetet të formulojë një test të tillë duke ua përshtatur temave.</p>	Emri i shkollës dhe logo
--	--------------------------

Test përmbledhës – gjysmëvjetori i dytë Klasa: _____
 Emri dhe Mbiemri: _____ Data: _____

1. Pyetje e nivelit “njohje”	8 pikë	
2. Pyetje e nivelit “njohje”	8 pikë	
3. Pyetje e nivelit “të kuptuarit”	9 pikë	
4. Pyetje e nivelit “të kuptuarit”	9 pikë	
5. Pyetje e nivelit “të kuptuarit”	9 pikë	
6. Pyetje e nivelit “zbatim”	10 pikë	
7. Pyetje e nivelit “analizë”	11 pikë	

8. Pyetje e nivelit “analizë”	11 pikë	
9. Pyetje e nivelit “sintezë”	12 pikë	
10. Pyetje e nivelit “vlerësim”	13 pikë	

Përqindja	0 - 39 %	40% - 54 %	55% - 69%	70% - 84%	85% - 100%	Pikët
Nota	0 -39 pikë	40 - 54 pikë	55 - 69 pikë	70 - 84 pikë	85 – 100 pikë	
Pikët	1	2	3	4	5	

Shenjat korrigjuese: \surd - e saktë, x- e pa saktë, ~- e paplotësuar Mësimdhënësi: _____

Tabela e testit për vlerësim numerik të pyetjeve sipas niveleve (shembull)

Fusha/Tema mësimore		Njohja	Të kuptuarit	Zbatimi	Mendimi kritik	Shuma
		20%	30%	10%	40%	100%
Tema I	60%	2 (16p)	1 (9p)	1 (10p)	Analizë- 1 (11p) Analizë- 1 (11p)	3 (57p)
Tema II	40%		2 (18 p)		Sintezë- 1 (12p) Vlerësim- 1 (13p)	4 (43p)
Tema III	100%	16 pikë	27 pikë	10 pikë	47 pikë	100 pikë

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VI
Tema: Bashkëveprimi njeri/natyrë

Rezultati i të nxënit të temës:
 Hulumton për raste të keqmenaxhimit të burimeve natyrore, duke parashikuar rrugë dhe mundësi të parandalimit ose të trajtimit të tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-2,6; II-1,7; III-3,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm 5.1; 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Problemet me ujën në Tokë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:


- Vlerëson rëndësinë e ujit për shoqërinë njerëzore;
- Shpjegon problemet që ndodhin me keqmenaxhimin e ujërave në vendin tonë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri “Gjeografia 6”, atlas enciklopedik, fotografi, hartë, projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Biologjia.



Problemet me ujën në Tokë

Uji është një nga elementet natyrore më të përhapura në Tokë. Për këtë arsye, Toka shpeshherë quhet planet i ujit. Por, përkundër kësaj, rezervat e ujit të ëmbël janë të kufizuara. Nga masa e përgjithshme e ujit në planetin tonë, vetëm 1 % e tij është në dispozicion për t’u shfrytëzuar nga ana e njeriut. Uji është një nga elementet themelore të mjedisit që mundëson zhvillimin e jetës. Ndërsa, me ndihmën e ujit njeriu siguron ushqimin, zhvillon industrinë, transportin, energjetikën dhe aktivitetet e shumta. Uji nuk konsiderohet vetëm vend i origjinës së jetës në planetin tonë, por gjithmonë ishte një nga elementet bazë për mbijetesën e njerëzimit. Të kujtojmë të kaluarën e njerëzimit kur u ndërtuan vendbanimet e para në Mesopotami, në Egjiptin e lashtë, në vendin e Inkëve, duke i populluar hapësirat më të begatshme me ujë.

Nëse e krahasojmë sasinë e ujit me numrin e popullsisë në botë, atëherë sasinë më të madhe të ujit disponon Australia, ndërsa sasinë më të vogël për banor e ka Azia, për 21 herë më pak. Mesatarja e rezervave të ujit në botë sillet në rreth 7.000 m³ për një banor. Kosova konsiderohet si vend i varfër me ujë rrjedhëse sipërfaqësore, si dhe me një trend të pavolitshëm kohor të regjimit hidrologjik. Sasia e ujit për kokë banori në Kosovë është më e vogël se në vendet përreth; më pak se Shqipëria për 7 herë. Shumë pjesë të Kosovës konsiderohen si relativisht të thata dhe me mungesë të ujit. Prandaj, në përmirësimin e rezervave të ujit, rol të rëndësishëm ka ndërtimi i akumulacioneve artificiale, edhe pse ky problem përcillet me financime të mëdha.

Ujërat e akumulacioneve mund të shfrytëzohen jo vetëm për furnizimin e vendbanimeve, por edhe për ujitjen e tokave, për nevoja të industrisë, energjetikës etj. Në liqenet e tilla artificiale të Kosovës, (5 liqene) tani grumbullohen rreth 500 milionë m³ ujë, që është rreth 14 % e prurjeve vjetore të të gjithë lumenjve. Lumenjtë e Kosovës, me format e tyre morfologjike, mundësojnë ngritjen edhe të rreth 50 akumulacioneve të tjera, me ç’rast rezervat e ujit do të trefshoheshin.

Vlerësohet se për çdo vit popullsia e botës shpenzon një sasi të madhe të ujit prej rreth 4 mijë km³. Uji është duke u shpenzuar dy herë më shumë se norma e rritjes së popullsisë, që do të thotë se kërkesat për ujë të pijshëm gjatë dy dekadave të ardhshme do të rriten për 6 herë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Asociacion (punë në grupe të mëdha-rreshta)

Arsimtari formon një asociacion në tabelë si vegës, që nxënësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka asociojnë me njësinë e re.

Shpenzimi i ujit në botë varet nga niveli i zhvillimit ekonomik. Vendet e zhvilluara harxhojnë rreth 550 litra ujë për një banor, kurse vendet e pazhvilluara më pak se 50 litra për një banor. Sasia më e madhe e ujit shpenzohet në bujqësi me rreth 70 %, pastaj në industri me 21 % dhe ekonomitë familjare me 10 %.



Zvogëlimi i liqenit Aral ndër vite

Përveç shpenzimit të madh të burimeve ujore nga bujqësia, ujitja e tokave shprehet negativisht edhe në ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Gjatë kullimit në tokë, uji tret dhe merr me vete sasi të konsiderueshme të plehrave dhe pesticideve, kurse nga fermat bujqësore në ujë depërtojnë edhe mikroorganizmat e shumtë të rrezikshëm. Krahas koncentrimit të këtyre ndotësve, në këto ambiente ujore ndodh eutrofikimi dhe ngarkesa me materie, të cilat janë toksike për organizmat e shumtë.

Përpos kësaj, furnizimi me ujë është ngushtuar si pasojë e ndotjes nga urbanizimi dhe industria. Shumë lumenj dhe liqene sot janë shndërruar në deponi të mbeturinave. Problemi i ndotjes së ujit është shqetësues nga fakti se kjo dukuri ka marrë përmasa të mëdha. Sot janë pak vende në botë që kanë mbrojtje adekuata të ujërave, monitorim të cilësisë së ujit dhe kontrollim të ndotjes.

Ndryshimet klimatike kanë ndikim të përhershëm në burimet dhe menaxhimin e ujit. Rritja e temperaturave në shumë vende të ndryshme të botës ndikon në regjimin e reshjeve dhe rrit rrezikun e thatësisë, përmblyetjeve dhe fatkeqësive të tjera që lidhen me ndryshimet e shpejta të regjimit të ujit.

Menaxhimi i burimeve natyrore

Çdo veprim i njeriut në natyrë bart me vete një çmim, prandaj duhet të dimë se ku janë kufijtë e shfrytëzimit të mjedisit. Menaxhimi ka kuptimin e drejtimit të ndonjë aktiviteti që mund të ketë për qëllim zhvillimin shoqëror-ekonomik dhe mbrojtjen e mjedisit. Kjo nënkupton shfrytëzimin e burimeve në mënyrë të kontrolluar, që është në dobi të të gjitha gjallesave të mjedisit jetësor dhe të vetë njeriut. Në veçanti duhen ruajtur burimet natyrore të cilat nuk mund të rigjenerohen (metalet, thëngjilli, nafta etj.).

Shfrytëzimi i tyre duhet vënë nën kontroll të rreptë dhe nën masa të kursimit. Kjo mund të arrihet përmes vlerësimit të ndikimit në mjedis. Vlerësimi i ndikimit në mjedis është parandalues i rëndësishëm për mbrojtjen e burimeve dhe

155

A	B	C	D
Akulli	H ₂ O	Oqeanet	Avull
UJI			

Pasi identifikohet zgjidhja (njësia që do të zhvillohet), mësimdhënësi pyet nxënësit se pse janë marrë këto fjalë kyçe: Akull, H₂O, oqeanet, avull... Çka kishim mundur të vendosim tjetër si fjalë kyçe?



Ndërtimi i njohurive:

Të nxënë të mëmbime: Grupet e ekspertëve

Në këtë fazë nxënësit ndahen në grupe, udhëzohen të lexojnë temën “Rrezikimi i pyjeve”. Secilit grup iu ndahen pyetjet e përgatitura nga arsimtari, që iu ofrohen në fleta.

Grupi 1

- Cili është roli i ujit për mjedisin dhe për njeriun?
- Sa është masa e përgjithshme e ujit në planetin tonë?
- Sa është mesatarja e rezervave të ujit në botë?

Grupi 2

- Cilat janë të mirat që na i ofron uji?
- Sa është numri i liqeneve artificiale në Kosovë?
- Sa mendohet që shpenzohet ujë në botë?

Grupi 3

- Cili është liqeni më i afërt i vendlindjes tëndë?
- Cilat vende në botë kanë mungesë me ujin e pijshëm?

-Në çfarë mënyre mund ta kurseni ujin në shtëpi?

Grupi 4

- Pse Toka ndryshe quhet edhe “Planet i ujit”?
- Cilat janë pasojat e pakontrolluara të shfrytëzimit të ujit?
- Pse krijohen basenet/liqenet artificiale?

Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë dhe debatojnë lidhur me pyetjet e parashtruara.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Në 15 minutat e fundit, mësimdhënësi kërkon nga grupet që të lexojnë të arriturat gjatë bashkëpunimit. Pyetjet kryesisht synojnë dhe formulohen mbi bazën e kriterëve të paraqitura në klasë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve që arrijnë kriteret e parashikuara dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 78.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VI
Tema: Bashkëveprimi njeri/natyre

Rezultati i të nxënësve të temës:
 Hulumton për raste të keqmenaxhimit të burimeve natyrore, duke parashikuar rrugë dhe mundësi të parandalimit ose të trajtimit të tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I-2,6; II-1,7; III-3,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm 5.1; 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Menaxhimi i burimeve natyrore

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Çmon rolin e resurseve natyrore në zhvillimin e shoqërisë dhe atë ekonomik;
- Krahason burimet e përtërira me ato të papërtërira.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri “Gjeografia 6”, atlas enciklopedik, fotografi, hartë, projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Biologjia.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënës
Reflektim nga aktiviteti i pastrimit të oborrit

Mësimdhënësi fillon orën nga reflektimi i aktivitetit jashtë klase në mbrojtje të mjedisit.

- Cilat ishin sfidat gjatë mbledhjes së mbetjeve për riciklim?
- Cilat materiale ishin më të shpeshta?



Zvogëllimi i liqenit Aral ndër vite

Shpenzimi i ujit në botë varet nga niveli i zhvillimit ekonomik. Vendet e zhvilluara harxhojnë rreth 550 litra ujë për një banor, kurse vendet e pazhvilluara më pak se 50 litra për një banor. Sasia më e madhe e ujit shpenzohet në bujqësi me rreth 70 %, pastaj në industri me 21 % dhe ekonomitë familjare me 10 %.

Përveç shpenzimit të madh të burimeve ujore nga bujqësia, ujtja e tokave shprehet negativisht edhe në ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Gjatë kullimit në tokë, uji tretet dhe merr me vete sasi të konsiderueshme të plehrave dhe pesticideve, kurse nga fermat bujqësore në ujë depërtojnë edhe mikroorganizmat e shumtë të rrezikshëm. Krahas koncentrimit të këtyre ndotësve, në këto ambiente ujore ndodh eutrofikimi dhe ngarkesa me materie, të cilat janë toksike për organizmat e shumtë.

Përpos kësaj, furnizimi me ujë është ngushtuar si pasojë e ndotjes nga urbanizimi dhe industria. Shumë lumenj dhe liqene sot janë shndërruar në deponi të mbeturinave. Problemi i ndotjes së ujit është shqetësues nga fakti se kjo dukuri ka marrë përmasa të mëdha. Sot janë pak vende në botë që kanë mbrojtje adekuatë të ujërave, monitorim të cilësisë së ujit dhe kontrollim të ndotjes.

Ndryshimet klimatike kanë ndikim të përhershëm në burimet dhe menaxhimin e ujit. Rritja e temperaturave në shumë vende të ndryshme të botës ndikon në regjimin e reshjeve dhe rrit rrezikun e thatësisë, përbytyjeve dhe fatkeqësive të tjera që lidhen me ndryshimet e shpejta të regjimit të ujit.

Menaxhimi i burimeve natyrore

Cdo veprim i njeriut në natyrë bart me vete një çmim, prandaj duhet të dimë se ku janë kufijtë e shfrytëzimit të mjedisit. Menaxhimi ka kuptimin e drejtimit të ndonjë aktiviteti që mund të ketë për qëllim zhvillimin shoqëror-ekonomik dhe mbrojtjen e mjedisit. Kjo nënkupton shfrytëzimin e burimeve në mënyrë të kontrolluar, që është në dobi të të gjitha gjallesave të mjedisit jetësor dhe të vetë njeriut. Në veçanti duhen ruajtur burimet natyrore të cilat nuk mund të rigjenerohen (metallet, thëngjilli, nafta etj.).

Shfrytëzimi i tyre duhet vënë nën kontroll të rreptë dhe nën masa të kursimit. Kjo mund të arrihet përmes vlerësimit të ndikimit në mjedis. Vlerësimi i ndikimit në mjedis është parandalues i rëndësishëm për mbrojtjen e burimeve dhe

mjedisit: florës, faunës, tokave, ajrit, klimës dhe peizazheve. Përmes vlerësimit të ndikimit në mjedis, identifikohen faktorët e mundshëm të degradimit të mjedisit dhe merren masa adekuate për parandalimin e ndikimeve negative. Në përgjithësi, procesi i menaxhimit përbëhet prej tri fazave kryesore: planifikimit, organizimit dhe monitorimit.

Duke pasur parasysh zhvillimin e qëndrueshëm, janë formuluar edhe rregullat (modelet) për zgjidhjen e problemeve në lidhje me përdorimin e burimeve natyrore dhe masat që duhen ndërmarrë, siç janë: kursimi i burimeve, rigjenerimi i burimeve ripërtëritëse, (pyjet, tokat), ricklimi dhe kompensimi i dëmeve në mjedis etj. Psh: rrypyllëzimi dhe ricklimi i letres mund ta zvogëlojë presionin në pyje. Mbrojtja e mjedisit dhe ruajtja e burimeve natyrore mund të realizohet përmes akteve ligjore, rregullave dhe marrëveshjeve. Për t'u realizuar mbrojtja e mjedisit dhe e burimeve natyrore duhet siguruar shfrytëzimin e planifikuar të lëndëve të para, mbrojtjen e tokave bujqësore, mbrojtjen e zonave ekologjike, mbrojtjen e pyjeve, mbrojtjen e ujërave dhe shfrytëzimin racional të tyre.

Meqenëse mineralet gjatë përdorimit e ndotin mjedisin, atëherë njerëzimi duhet të orientohet në shfrytëzimin e burimeve të përtërira, si: fuqia e erës, fuqia e ujit, energjia diellore etj. Përdorimi i burimeve të përtërira dhe të përhershme ka ndikime më të vogla në mjedis. Këto burime mund të përdoren vazhdimisht pa ndryshuar përbërjen dhe gjendjen e tyre.

Ndërsa, burimet e tjera natyrore, sikurse mineralet e përdorura dhe të ndryshuara, kurrë më nuk mund të kthehen në gjendjen fillestare. Prandaj, ato duhen shfrytëzuar me kujdes, me ripërdorimin ose ricklimin e tyre.



Pyetje dhe detyra

1. Tregoni dallimin ndërmjet mjedisit gjeografik dhe atij natyror.
2. Çka ndikon në krijimin e efektit serrë?
3. Tregoni dallimet ndërmjet burimeve të përtërira dhe të papërtërira.
4. Tregoni pse po zvogëlohet sasia e ujit të pijshëm në Tokë.

156

- Leximi i raporteve (disa nga ato).
- Mbahet shënim në tabelë ose flipçart.



Ndërtimi i njohurive: Ditari dypjesësh

Në pjesën e dytë të orës, mësimmhdhënësi ndan tabelën në dy shtylla. Në shtyllën e parë, mësimmhdhënësi shënon disa fjalë kyçe, të cilat i kishte shënuar më herët në tabelë, dhe kërkon nga nxënësit që, duke lexuar njësinë mësimore “Menaxhimi i burimeve natyrore”, të bëjnë përshkrimin në shtyllën e dytë për këto fjalë:

Citati	Komenti që jepet nga nxënësit
Resurse	
Toka	
Toka me cilësi të dobët	
Burime natyrore	
Ricikluese	
Të pashtershme	
Energji e pastër	
Burime energjetike	



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:

Tabela krahasuese (punë individuale dhe e pavarur)

Mësimmhdhënësi sjell disa tabela (në kategori) në fleta të gatshme, ku kërkon nga nxënësit të plotësojnë përparësitë dhe mangësitë për burimet e përtërira dhe të papërtërira.

Burimet e papërtërira		Burimet e përtërira	
Përparësitë	Mangësitë	Përparësitë	Mangësitë

- Cili është dallimi në mes të resurseve natyrore dhe pasurisë natyrore?
- Vlerësoni rolin e burimeve natyrore për shoqërinë njerëzore.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Reflektim përvojëdhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VI
Tema: Bashkëveprimi njeri/natyre

Rezultati i të nxënit të temës:

- Përshkruan ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik dhe anasjelltas. Shpjegon marrëdhënien ndërmjet njeriut dhe mjedisit, si: pasojat e ndryshimeve klimatike në mjedis dhe në shëndet, të rreziqeve natyrore dhe të atyre të krijuara nga njeriu dhe mënyra të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- Ofron alternativa dhe strategji të mundshme të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore;
- Hulumton për raste të keqmenaxhimit të burimeve natyrore, duke parashikuar rrugë dhe mundësi të parandalimit ose trajtimit të tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II-6; III-7; IV-3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.1; 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përforsim: Bashkëveprimi njeri/natyre

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

Kriteret e suksesit: Duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto apo edhe video të ndryshme të shtresave të atmosferës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Kimia, Fizika, TIK (Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm).


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë

Mësimdhënësi, për të formuar grupe të rastit, fillon të numërojë nxënësit 1, 2, 3, pastaj 1, 2, 3..., secili nxënës duhet ta


Efektet serrë ka kuptimin e kopshtit të qelqit, ku rrezet e diellit depërtojnë në brendi të "kopshtit qelqor" dhe ngrohin ajrin brenda. Por, pastaj qelqi e pengon daljen e kësaj nxehtësie nga brendia. Në këtë përbërje të gazeve të efektit serrë, të shkaktuara nga veprimi i njeriut, marrin pjesë: dyoksidi i karbonit, metani, dyoksidi i azotit etj. Si pasojë e këtyre ndryshimeve, në përbërjen e atmosferës, temperatura mesatare në sipërfaqen e Tokës është ngritur për 0.6 °C.


Krahas rritjes së temperaturave mesatare, po rriten vazhdimisht edhe fatkeqësitë natyrore, të cilat kohët e fundit kanë marrë përmasa shqetësuese. Ndryshimet klimatike mund të sjellin uragane më të fuqishme, valë të temperaturave të larta, thatësira dhe ngritje të nivelit të detit për një metër deri në fund të këtij shekulli. Këto ndryshime me siguri se do të kenë pasoja edhe më të mëdha në dekadat në vijim. Oqeanet nuk mund ta absorbojnë sasinë të tepër të dyoksidit të karbonit, ndërsa kjo do të shprehet në çrregullimin e temperaturave në tërë planetin tonë.



Disa nga kryesoret në ngrohjen globale (burimi: Friedland et al., 2012)

Si pasojë e ndryshimeve klimatike, fatkeqësitë natyrore gjithnjë e më tepër po intensifikohen duke u bërë më të furishme; gjysma e tokës së punueshme është degraduar, rezervat e peshkut janë zvogëluar, disa rryma detare dhe atmosferike kanë ndryshuar drejtimin etj. Efektet e ndryshimeve klimatike mund të dëshmojnë me shumë fakte: për katër dekadat e fundit trashësia e akullit në Arktik është zvogëluar përrreth 2 metra; sipërfaqja e disa liqeneve është zvogëluar për disa herë (liqeni Aral, liqeni Çad në Afrikë etj.); Akullnajat e Alpeve e kanë përgjysmuar sipërfaqen e tyre. Sipërfaqja e akullit në Kilimanxharo (Afrikë) gjatë shekullit të fundit është zvogëluar rreth 80 %, kurse lumenjtë më nuk rrjedhin; thatësia dhe zjarret kanë përfshirë gati se të gjitha kontinentet, duke rrezikuar shumë vendbanime, kurse, në anën tjetër, disa regjione përfshihen nga vërshimet me pasoja të rënda në ekonomi dhe në njerëz.





Ndryshimet e mjedisit nga shpyllëzimi (burimi: Miller, 2006)

ndërsa me këtë trend të prerjes në ultësirat e Malajzisë dhe Filipineve nuk do të ketë më drurë brenda një periudhe të shkurtër. Për çdo vit, rreketë e ujit shpërfaqjnë sasi të madhe të dheut produktiv, duke e sjellë në luginë dhe duke i vërshuar arat e pëlleshme, duke e zvogëluar aftësinë lundruese të lumenjve etj. Si pasojë e kësaj, në 100 vitet e fundit sipërfaqet shkretinore në botë janë zgjeruar përrreth tri herë, nga 11 milionë km², në rreth 30 milionë km², ndërsa ky proces është vazhdimisht në rritje.

Nga ndotja e madhe e atmosferës, kohët e fundit, gjithnjë e më tepër paraqiten reshjet e tharta, të cilat po ndikojnë në shkatërrimin e mjedisit, e veçanërisht në tharjen e pyjeve. Reshjet e tharta krijohen nga dyoksidi i squfurit dhe oksidet e azotit të emetuara nga djegia e karburanteve, të cilat në atmosferë kthehen në acide sulfurore dhe të azotit.



Këto tharitura kthehen në tokë bashkë me pikat e shiut ose ndonjëherë si pluhur i grimcave të thata, të cilat po ndikojnë në zvogëlimin e fondit të pyjeve, por dhe në produktivitetin bujqësor. Përveç dëmeve që sjellin në ligene dhe në pyje, reshjet e tharta dëmtojnë edhe fasadat e ndërtesave, urat dhe monumentet kulturore nga mermeri, por edhe janë të dëmshme për shëndetin e njeriut.

Shkatërrimi i pyjeve nga reshjet e tharta

153

mbajë në mend numrin e vet, pastaj formohen grupet me njëshet, dyshet dhe treshet. Pastaj mësimdhënësi, për të hapur diskutimin/debatin, u shtron pyetje nxënësve me fund të hapur: Për ju si ekspert i ardhshëm, cilat do të ishin alternativat dhe strategjitë për mbrojtjen, menaxhimin dhe trajtimin e burimeve natyrore për zhvillim të qëndrueshëm?



Ndërtimi i njohurive:



Nxënësit fillimisht duhet të tregojnë shkaktarët, pasojat, mënyrën e zgjidhjes së problemit.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve:

Ata ofrojnë alternativa dhe strategji të mundshme të mbrojtjes së mjedisit si dhe mbi keqmenaxhimin e burimeve natyrore, dhe mundohen që idetë e tyre të përkraken nga bashkëmoshatarët e tyre. Pasi t'i kenë dhënë idetë e tyre, në fund nxënësit bëjnë një vetëvlerësim të grupit dhe vlerësim të grupit tjetër.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë dhe mënyrën e ofrimit të zgjidhjes së problemit.

Detyrë:

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

